

Instituti Shqiptar për Gjeopolitikë



GJEOPOLITIKA

Revistë shkencore

Nr. 5

ISSN

Prishtinë, 2026

Drejtor & kryeredaktor

Dr. Sadri Ramabaja

Redaksia

Dr. Enika Abazi, Tiranë

Dr. Selim Ibraimi, Nju-Jork

Dr. Dritan Hoti, Tiranë

Dr. Gurakuq Kuçi, Prishtinë

Këshilli botues

Dr. Odise Çaçi, universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Dr. Martin Berishaj, Universiteti i Lubjanës, ambasador

Dr. Skënder Demaliaj, Universiteti Mesdhetar, Tiranë

Dr. Venera Llunji, Universiteti AAB, Prishtinë

Dr. Gjon Berisha, studiues, Instituti i Historisë, Prishtinë

Mr. sc. Stephan Lipsius, politolog, Kasel [D]

Emin Azemi, UEJ, Tetovë

Redaktore gjuhësore: Sevi Agolli

Revista “Gjeopolitika” botohet një herë në vit. Artikujt e paraqitur në këtë revistë përmbajnë punime origjinale dhe të pabotuara më parë. Ata shoqërohen me një përmbledhje në gjuhën shqipe ose angleze dhe me referencat përkatëse, të cilat përmbajnë emrin e autorit, titullin e plotë të burimit (të librit ose artikullit), vendin dhe vitin e botimit, si dhe faqen referuese. E drejta e autorësisë për artikujt e botuar në këtë revistë i takon Institutit Shqiptar për Gjeopolitikë, por autori është i lirë t’i përdorë materialet e tij edhe në botime të tjera, me kusht që referimet t’i bëhen revistës “Gjeopolitika”, si vendi i parë i botimit.

**INSTITUTI SHQIPTAR PËR GJEOPOLITIKË
ALBANIAN INSTITUTE FOR GEOPOLITICS**

**Nr. 5
2026**

ISSN: 3005-2777

Shtypur në shtypshkronjën: “Lena grafik”

PËRMBAJTJA

I. SHQIPTARËT DHE GJEOPOLITIKA	9
1.1 UÇK-ja si subjekt i lirisë	9
Nga Sead Zimeri, filozof, Berlin-Kumanovë	9
1.2 Konferenca e Sigurisë “Munih 2026”: Rendi ndërkombëtar multipolar kundrejt rendit multivektorial	22
Nga dr. Sadri Ramabaja	22
1.3 HISTORIA PA JUSTIFIKIME: NGA LEGJENDAT TE PËRGJEGJËSIA DHE DOMOSDOSHMERIA E VETËREFLEKTIMIT	38
Nga Artan Nati	38
1.4 NGJARJET E MARSIT 2004 DHE PROJEKTI SERB PËR NDARJEN E KOSOVËS	45
Nga dr. Gurakuq Kuçi	45
1.5 MITROVICA, KUFIRI KU KOSOVA MËSOI TË BËHET SHTET	50
Nga Dijana Toska	50
1.6 ROLI I SHOQATAVE SERBE NË TRAGJEDITË NJERËZORE NË BALLKAN, SIDOMOS KUNDËR SHQIPTARËVE	54
Nga dr. Enver Bytyçi	54
1.7 ALARMI I KUQ	59
Nga dr. Arben Fetoshi	59
1.8 PERDJA E TYMIT	63
Nga Ditmir Bushati	63
1.9 Mësuesi dhe flamuri	71
Nga Arbër Zaimi, politolog	71
1. 10 Shqipëria dhe Kosova në gjeopolitikën imperiale ruse	82
Dr. Lisen Bashkurti	82

II. GJEOPOLITIKA RAJONALE.....	85
2.1 RIKTHIMI I GJEOPOLITIKËS, SIGURIA ENERGJETIKE DHE MENAXHIMI I RIPOZICIONIMIT TË SERBISË: KOSOVA DHE INTERESI JETIK I SHQIPTARËVE NË KËTË PROCES.....	85
Nga dr. Sadri Ramabaja.....	85
2.2 Ballkani Perëndimor ndërmjet arkitekturës së paqes dhe rrezikut të riformatimit gjeopolitik	92
Nga dr. Skënder Asani	92
2.3 Kumanova dëshmoi se shqiptarët nuk janë të mirëpritur në “Maqedoninë e Veriut”.....	98
Nga dr. Mujë Buçpapaj.....	98
2.4 Pavarësimi i Maqedonisë, një fryt i papjekur për shqiptarët!	106
Nga Emin Azemi	106
2.5 Rast studimi: politika e jashtme e vendeve të Ballkanit Perëndimor	113
Nga Gëzim Rushiti, PhD	113
III. BOTA	139
3.1. Midis Hormuzit, MAGA-s dhe mesmandatit	139
Nga dr. Jorgji Kote.....	139
3.2 Realiteti po krijon një Europë të re.....	146
Nga Joshka FISHER, ish-ministër i Jashtëm i Gjermanisë	146
3.3 Epoka e re bërthamore.....	149
Nga dr. Rolf Mützenich [IPG]	149
3.4. Perëndimi i vjetër: Progresi teknologjik i Kinës tregon se liberalizmi nuk është i garantuar.....	154
Nga dr. Miriam Meckel* [NZZ]	154
3.5 Lufta po e shndërron Iranin në një superfuqi botërore	159
Nga dr. Rober A. Pape	159

3.6 Konkurrenca për burime me Kinën qëndronte pas luftës së Trump-it ndaj Iranit	163
Nga dr. Guy Laron.....	163
3.7 Lufta e Gjirit po ndryshon të ardhmen e luftës globale	179
Nga Dan Gashi, Nju-Jork	179
IV. GJEOEKONOMI.....	183
4.1 LUFTA NË IRAN, BURSAT, NAFTA DHE ARI ME BITCOIN	183
Nga akademik Anastas Angjeli.....	183
V. HISTORI.....	191
5.1 KULTPROTEKTORATI PËR KATOLIKËT E SHQIPËRISË.....	191
Nga dr. Mark Palnikaj.....	191
VI. INTERVISTA	198
6.1 Albin Kurti: “Ne jemi qartësisht të përkushtuar ndaj vlerave të demokracisë perëndimore. Ne duam të bashkohemi me BE-në dhe NATO-n... Unë kurrë nuk kam qenë rebel pa kauzë, gjithmonë kam pasur një qëllim. Sot jam një kryeministër me një qëllim”.....	198
Nga Georg Häsler	198
6.2 Dr. Sebastian Sons: “Shtetet e Gjirit nuk kanë interes për një Iran demokratik”	203
Nga Jonas Roth [NZZ]	203
VII. KOMENTI	208
7.1 Kriza në Unionin European.....	208
Nga Shqiprim Pula, PhD	208
7.2 Samiti i ardhshëm i NATO-s dhe paradigma e Turqisë	211
Dan GSHI, Nju-Jork	211
VIII. OPINIONI	214
8. 1 LUFTA E JASHARAJVE DHE NDIKIMI I SAJ	214
Nga Dilaver GOXHAJ, kolonel.....	214

8.3 Albin Kurti në gijotinë!	221
Nga dr. Agim Vinca	221
8.4 Nuk bëhej fjalë për shkëmbim territoresh, por për tregti me sovranitetin e Shtetit.....	226
Nga Lirim Gashi	226
IX. Recensione	229
9.1 DEMOKRACIA NË KOHËN E ZHVESHJES SË RENDIT BOTËROR APO DEMOKRACIA PAS DEMOKRACISË.....	229
Nga dr. Martin Berishaj	229
9. 2 Argumente shteruese kundër idesë antihistorike të të ashtuquajturit “Komb Kosovar”.....	238
Nga Bedri Halimi, shkrimtar, studiues	238
9.3 Rikonceptualizimi i zhvillimit politik shqiptar: Historia ligjore, vazhdimësia institucionale dhe e ardhmja e shtet-kombit	245
Nga dr. Sadri Ramabaja.....	245
X: ANALYSIS IN ENGLISH.....	255
10. 1 THE RE-ARMAMENT OF GERMANY: GEOGRAPHY, POWER, AND THE ARCHITECTURE OF EUROPEAN SECURITY	255
Dr. Dritan HOTI	255
10.2 The nation-state as a structural actor of democratic metamorphosis.....	260
Dr. Sadri RAMABAJA.....	260
10.3 Türkiye and Albania: a Dynamic Defence Partnership	272
Peter Marko Tase, Berat/ÇIKAGO.....	272

EDITORIALI

Në këtë numër të revistës “Gjeopolitika” jemi përqendruar në trajtimin e fenomeneve aktuale në fushën e mendimit gjeopolitik, të cilat po artikuloohen gjithnjë e më qartë në një epokë tranzicioni drejt një Rendi të Ri Botëror. Ky rend, ende në formësim, karakterizohet nga rivaliteti i shtuar midis fuqive të mëdha, fragmentimi i arkitekturës ndërkombëtare dhe rikthimi i logjikës klasike të fuqisë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në këtë kontekst, çështja e rreshtimit strategjik të kombit shqiptar nuk është më një debat teorik, por një domosdoshmëri praktike. Dy republikat tona, Shqipëria politike dhe Republika e Kosovës, tok me hapësirën shqiptare të shtrirë në një rajon me rëndësi të veçantë gjeopolitike si Ballkani Perëndimor, ndodhet në ndërthurjen e interesave të aktorëve të ndryshëm globalë dhe rajonalë, duke e bërë orientimin tonë strategjik një faktor kyç për stabilitetin dhe zhvillimin afatgjatë.

Në këtë numër, analiza të ndryshme trajtojnë pikërisht këtë moment kritik: nga rikthimi i Rusisë si aktor revizionist në sistemin ndërkombëtar, te sfidat që vijnë nga politika e Serbisë në rajon, si dhe roli i NATO-s e i BE-së në garantimin e sigurisë dhe të stabilitetit. Një vëmendje e veçantë u kushtohet edhe formave bashkëkohore të ndikimit dhe ndërhyrjes, përfshirë strategjitë hibride, të cilat synojnë të minojnë institucionet dhe kohezionin shoqëror në vendet e rajonit, me theks në dy republikat tona. Në këtë kuadër, analiza gjeopolitike nuk mbetet vetëm një ushtrim teorik, por shndërrohet në instrument të domosdoshëm për të kuptuar dhe për të përballuar sfidat e kohës. Editoriali ynë synon të nxisë një reflektim më të thellë mbi nevojën për një qartësi më të madhe strategjike në hapësirën shqiptare. Në një kohë kur neutraliteti është gjithnjë e më pak i mundur dhe paqartësia strategjike gjithnjë e më e rrezikshme, rreshtimi ynë nuk mund të jetë i paqartë: ai duhet të mbështetet në vlera, interesa dhe aleanca të mirëpërcaktuara.

Në fund, ky numër i revistës “Gjeopolitika”, e vetmja e këtij lloji në hapësirën tonë, nuk synon vetëm të analizojë botën që po ndryshon, por edhe të kontribuojë në formësimin e një mendimi strategjik shqiptar më të pjekur, më të artikuluar dhe më të aftë për t’u përballur me sfidat e një epoke të re.

Prishtinë, maj 2026

Dr. Sadri RAMABAJA

I. SHQIPTARËT DHE GJEOPOLITIKA

1.1 UÇK-ja si subjekt i lirisë

Nga Sead Zimeri, filozof, Berlin-Kumanovë

Pas marsit 1998, shqiptarët e Kosovës ishin një popull që po themelonte botën e tij politike. UÇK-ja solli dy çështje: çliroi Kosovën nga regjimi i Millosheviqit dhe vuri themelet e shtetit të ri. Kosova e pavarur, e shpallur në shkurt 2008, përfaqëson kalimin nga çlirimi në liri, realizimin e lirisë në institucione, ku subjekti e gjen veten te tjetri ose, siç e formulon Hegeli, “bei sich sein im Anderen”: të jesh me veten edhe duke qenë te tjetri.

I. Liria si çështje shqiptare

Kjo ese synon të mendojë mbi UÇK-në filozofikisht, duke shqyrtuar marrëdhënien mes veprimit të saj dhe konceptit të lirisë përmes një tradite mendimi që shtrihet nga Hegeli tek Arendt-i dhe nga Kanti te Zhizheku, traditë që, siç besoj, e ndërton përvojën shqiptare si rast të rëndësishëm për filozofinë politike. Liria, në historinë shqiptare, nuk ka qenë një temë mes shumë temave, por ka qenë ajo temë, që ka formuar vetëdijen kombëtare, ajo për të cilën është luftuar dhe është flijuar jeta, ajo që është transmetuar nga një gjeneratë në tjetrën si ideal i panegociueshëm.

Kur UÇK-ja ngriti armët në vitin 1998, ajo nuk po bënte diçka të re, por po artikulonte, në kushte të reja historike, të njëjtin ideal që Skënderbeu e kishte artikuluar pesë shekuj më parë, që figurat e Rilindjes Kombëtare e kishin rikthyer në shekullin e nëntëmbëdhjetë dhe që Ismail Qemali e kishte mishëruar në shpalljen e Pavarësisë në Vlorë në vitin 1912. Qëllimi i kësaj eseje është që të ndërtojë këtë marrëdhënie mes UÇK-së dhe lirisë me vegla filozofike: tri konceptet e lirisë që Hegeli i zhvillon në *Filozofinë e së drejtës*, siç i interpreton Axel Honneth dallimin kantian mes lirisë së brendshme dhe lirisë së

jashtme, konceptin e negativitetit radikal te Slavoj Zhizheku dhe dallimin vendimtar mes çlirimit dhe lirisë te Hannah Arendt-i.

Në zemër të kësaj historie qëndron një paradoks. Shqiptarët janë një popull që e ka jetuar lirinë kryesisht si mungesë: nga rënia e Skënderbeut më 1468, deri te Pavarësia e vitit 1912 shtrihen pesë shekuj të pushtimit osman. Pas një periudhe të shkurtër sovraniteti të brishtë, të ndërprerë nga pushtimi italian e gjerman gjatë Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët ranë nën diktaturën komuniste dhe, në rastin e Kosovës, nën shtypjen sistematike serbe, që arriti kulmin në vitin 1989. Momentet e lirisë kanë qenë të shkurtra: rezistenca e Skënderbeut (1443-1468), Pavarësia e Vlorës (1912), vitet e para të shtetit shqiptar. Por, pikërisht kjo mungesë e ka bërë lirinë kategorinë qendrore të vetëdijes shqiptare, sepse një popull që e jeton lirinë si gjendje normale nuk mendon shumë për të, ndërsa një popull që jeton i robëruar, i shtypur, mendon për lirinë çdo ditë. Ky paradoks gjen shprehjen e tij më të thellë te Hegeli, i cili në *“Fenomenologjinë e shpirtit”* ka treguar se vetëdija e lirisë lind pikërisht nga përvoja e mungesës së saj.

Le ta shpjegojmë këtë, sepse është vendimtare për të gjithë argumentin që vijon. Në dialektikën e zotërisë dhe shërbëtorit, Hegeli imagjiron dy vetëdije që përballen me njohjen: njëra preferon të rrezikojë jetën, sesa ta humbë lirinë dhe bëhet zot; ndërsa tjetra, nga frika e vdekjes, pranon nënshtrimin dhe bëhet shërbëtor. Por është pikërisht shërbëtori, jo zoti, që arrin vetëdijen më të thellë të lirisë: zoti, duke ushtruar pushtet mbi tjetrin, mbetet i varur nga ai (i duhet tjetri për ta njohur si zot), ndërsa shërbëtori, nëpërmjet punës, e transformon botën e jashtme dhe, në këtë transformim, e zbulon veten si subjekt që ka fuqinë të formojë realitetin, si qenie që mund ta ribëjë botën e jo thjesht ta pranojë atë (Hegel, 1807-1977, §194-196). Kështu është edhe me shqiptarët: shtypja e gjatë nuk e shkatërroi vetëdijen për lirinë, por e thelloi atë dhe Skënderbeu u bë simbol i lirisë jo pavarësisht shtypjes osmane, por pikërisht për shkak të saj, si figurë që dëshmon se shqiptarët kanë qenë një herë të lirë dhe, rrjedhimisht,

mund të jenë sërish. Kur UÇK-ja ngriti armët, ajo artikuloi jo vetëm idealin e Skënderbeut, por edhe atë të Qemalit, të Rilindjes, të të gjitha momenteve kur shqiptarët e shndërruan idealin e lirisë në veprim politik.

II. Liria e jashtme: çfarë humbi Kosova në vitin 1989

Në *“Filozofinë e së drejtës”* Hegeli dallon tri momente të vullnetit të lirë, të cilat korrespondojnë me tri forma të ndryshme të lirisë në jetën sociale, forma që Honneth-i në esenë “Mbi varfërinë e lirisë sonë” i interpreton jo si kategori abstrakte, por si mënyra konkrete, në të cilat ne, si qytetarë të modernitetit, e jetojmë dhe e kuptojmë lirinë (Honneth, 2023, f. 19-34). *Momenti i parë* është liria në kuptimin e saj më bazik: hapësira e jashtme ku subjekti mund të veprojë pa ndërhyrjen e të tjerëve, të lëvizë lirisht, të flasë, të zotërojë, ta organizojë jetën e vet pa u penguar nga një fuqi e jashtme. Para se të analizojmë zbatimin e këtij koncepti në rastin e Kosovës, vlen të ndalemi te Kanti, sepse ai na ofron një kuptim më të thellë të asaj që humbi Kosova në vitin 1989. Për Kantin, liria e jashtme nuk është thjesht mungesa e ndërhyrjes, një hapësirë pasive ku askush nuk të ngacmon, por një e drejtë e lindur (*angeboren*) që na takon si qenie njerëzore, thjesht për faktin se ekzistojmë. Kjo liri ndahet në mënyrë të barabartë të të gjithë dhe rregullohet nga Parimi Universal i së Drejtës: liria ime e jashtme mund të kufizohet vetëm nga liria e jashtme e tjetrit dhe ky kufizim është reciprok (Kant, 1797-1996, 6:237-238). Kjo do të thotë se liria e jashtme nuk është thjesht “negative” në atë kuptim të cekët që sugjeron Isaiah Berlin. Ajo është liri morale, e kufizuar reciprokisht, që justifikon përdorimin e forcës kundër atyre që e cenojnë: nëse dikush na sulmon, kemi të drejtë ta mbrojmë veten; nëse dikush na vjedh pronën, kemi të drejtë ta rikërkojmë. Shteti ekziston pikërisht për ta garantuar këtë liri, por kur nuk ka shtet ose kur shteti vetë është shkelësi i saj, atëherë e drejta për mbrojtje bie mbi individin dhe mbi popullin (Kant, 1797/1996, 6:256).

Revokimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989, i garantuar nga kushtetuta jugosllave e vitit 1974, ishte pikërisht eliminimi sistematik i kësaj lirie, që Kanti e konsideron të lindur. Noel Malcolm-i e përshkruan me saktësi këtë proces: Asambleja e Kosovës u detyrua të votonte nën presionin e tankeve dhe policisë, ndërsa vetëm një pjesë e vogël e deputetëve arriti të votonte kundër (Malcolm, 1998, f. 344-346). Ajo që pasoi ishte ndërtimi i një sistemi, që Rugova vetë e quante “aparteid” (Malcolm, 1998, f. 348): shkollat shqipe u mbyllën dhe u imponua kurrikula serbe; mësuesit shkarkoheshin nga detyra nëse nuk nënshkruanin betimin e besnikërisë ndaj Serbisë, gjë që shumica dërrmuese refuzoi; Akademia e Shkencave u shpërbë; ligje të reja kriminalizuan blerjen e pronës pa leje nga Beogradi; papunësia arriti mbi shtatëdhjetë për qind; rreth treqind e pesëdhjetë mijë shqiptarë u detyruan të largoheshin; dhuna policore ishte e përditshme: ndalime arbitrare, rrahje, tortura, vrasje ekstrajgyqësore (Amnesty International, 1998). Ky ishte rast paradigmatic i tiranisë sistematike (Buchanan, 2004), por ajo që na intereson këtu është dimensionin filozofik: regjimi nuk e kufizonte lirinë e jashtme të shqiptarëve për ta harmonizuar me lirinë e të tjerëve, siç kërkon Parimi Universal i së Drejtës, por e eliminonte atë krejtësisht, duke mohuar momentin më elementar të lirisë dhe duke shndërruar edhe gjërat më të thjeshta që një qytetar i lirë i bën pa menduar, si të shkosh në punë, të dërgosh fëmijët në shkollë, të blesh një shtëpi, në akte të pamundura.

III. Liria e brendshme: Rugova dhe sistemi paralel

Momenti i dytë i lirisë, ajo që Honneth-i e interpreton si *liria refleksive*, korrespondon me konceptin kantian të lirisë së brendshme: autonominë morale, aftësinë për të vepruar sipas arsyes, pavarësisht kushteve të jashtme. Konkretisht, kjo do të thotë se liria nuk matet vetëm me hapësirën që subjekti ka në dispozicion, por edhe me cilësinë e arsyeve mbi të cilat ai vepron: një njeri mund të jetë i lirë në këtë kuptim edhe në burg, nëse vepron sipas arsyeve që vetë i ka reflektuar e që i konsideron të drejta.

Liria e brendshme është, në njëfarë kuptimi, më e thellë se liria e jashtme, sepse ajo është kushti i mundësisë së kësaj të fundit: pa vetëdije për lirinë, pa ndjenjën se liria na takon si qenie njerëzore, ne as nuk do ta kërkonim atë. Pikërisht sepse shqiptarët e Kosovës e ruajtën këtë vetëdije, pikërisht sepse e dinin që ishin të lirë edhe kur realiteti i përditshëm ishte shtypje, ata ishin të gatshëm ta kërkonin lirinë e jashtme kur erdhi momenti. Por liria e brendshme, sado e thellë që të jetë, mbetet e pamjaftueshme, nëse nuk shoqërohet me lirinë e jashtme. Liria e brendshme, pa lirinë e jashtme, është aspiratë pa realizim, ndërsa liria reale, liria më e rëndësishme, është liria e jashtme, mundësia për t'i ndjekur qëllimet tona në botën reale, përfshirë lirinë politike, lirinë për të marrë pjesë në vendimarrjen që na prek si qytetarë. Honneth-i e formulon kufizimin e lirisë reflektive në të njëjtin drejtim: ajo mbetet “thjesht posedim i qëllimeve dhe i dëshirave racionale”, ndërsa liria aktuale “varet shumë më tepër nga pyetja nëse ne mund ta kuptojmë realitetin si objektivizim, si mishërim i vetëdeterminimit subjektiv” (Honneth, 2023, f. 24-25).

Rezistenca paqësore e Ibrahim Rugovës ndërmjet viteve 1989 dhe 1998, ishte artikulli më i jashtëzakonshëm i lirisë së brendshme, kur liria e jashtme është mohuar dhe meriton të analizohet në thellësi. Rugova, profesor i letërsisë në Universitetin e Prishtinës, që kishte studiuar me Roland Barthes-in në Paris në vitet shtatëdhjetë, ishte një intelektual evropian në formim dhe temperament, një njeri që besonte thellësisht në fuqinë e fjalës, të arsyes dhe të durimit. Ai themeloi Lidhjen Demokratike të Kosovës në vitin 1989, parti që fitoi mbështetjen e nëntëdhjetë për qind të popullsisë shqiptare dhe që avokonte pavarësinë përmes mjeteve paqësore. Strategjia e Rugovës nuk ishte mospërballje pasive, por ndërtim aktiv i një bote alternative: Howard Clark, në studimin e tij mbi rezistencën civile në Kosovë, e përshkruan atë që ndodhi si një nga eksperimentet më të jashtëzakonshme të vetorganizimit qytetar në Europën pas Luftës së Ftohtë (Clark, 2000).

Shqiptarët ndërtuan një sistem paralel institucional, që përfshinte: shkolla në shtëpi private, ku mësuesit që kishin refuzuar betimin e besnikërisë, vazhdonin të jepnin mësim në gjuhën shqipe; klinika ilegale, ku mjekë të pushuar nga puna ofronin kujdes shëndetësor; një sistem tatimor vullnetar që i financonte këto shërbime, si dhe struktura të një shteti hije, që funksiononte nën sipërfaqen e regjimit serb. Në maj 1992, shqiptarët organizuan zgjedhje paralele, ku Rugova u zgjodh president i këtij shteti, që asnjë shtet nuk e njohu, një akt i jashtëzakonshëm i autonomisë morale kolektive. Ishte vendimi i një populli të tërë për të vepruar sipas arsyeve që i konsideronte të drejta, pavarësisht se bota e jashtme nuk njohu asnjë nga këto akte; refuzim i thellë për ta brendësuar mesazhin e regjimit, se shqiptarët janë një popull i dorëzuar, pa të drejta, pa mundësi veprimi (Hay, 2011, f. 36-37).

Por kufizimi i kësaj strategjie, me kalimin e kohës, u bë gjithnjë më i dukshëm dhe është pikërisht ky kufizim, që konfirmon argumentin se liria e brendshme, sado e vlefshme, nuk mund ta zëvendësojë lirinë e jashtme.

Rugova e bazonte shpresën e tij te bashkësia ndërkombëtare, duke besuar se durimi dhe dinjiteti i rezistencës paqësore do ta detyronin Perëndimin të ndërhynte, por Clark-u vëren me të drejtë, se kjo strategji ishte e orientuar tepër nga perceptimi i jashtëm dhe se i mungonte një plan veprimi për ta përshtatur ndaj ndryshimeve në taktikën serbe (Clark, 2000). Momenti vendimtar ishte Marrëveshja e Dejtonit, në nëntor 1995, që i dha fund luftës në Bosnjë, por e la Kosovën krejtësisht jashtë diskutimit, duke dërguar një mesazh të rëndë: në Ballkanin e viteve nëntëdhjetë vetëm dhuna e tërhiqte vëmendjen ndërkombëtare, siç vëren Tim Judah në historinë e tij të luftës së Kosovës (Judah, 2000, f. 101-103). Pas Dejtonit, hendeuku mes lirisë së brendshme, që shqiptarët e ruanin me heroizëm, dhe mungesës së lirisë së jashtme, u bë i pamundur për t'u duruar: Lëvizja Studentore e vitit 1997, që kërkonte “rezistencë aktive paqësore”, tregonte se brezi i ri nuk ishte i gatshëm të priste më, ndërsa në zonat

rurale, një lëvizje paramilitare po merrte formë gradualisht. Duhej një akt që do ta çante këtë hendek, që do ta shndërronte vetëdijen për liri në liri të vërtetë.

IV. Negativiteti radikal: kur liria bëhet veprim

Zhizheku në *“Freedom: A Disease Without Cure”* (2023), e dallon lirinë abstrakte nga liria konkrete, dallim që ndërton atë që ndodhi në Kosovë në prag të luftës. “Liria abstrakte, shkruan ai, është aftësia për të bërë atë që do, pavarësisht rregullave dhe zakoneve sociale, për t’i shkelur këto rregulla e zakone, madje për të vepruar kundër natyrës së vet substanciale në një shpërthim të “negativitetit radikal”, siç ndodh në mënyrë paradigmatiche në një revoltë ose situatë revolucionare” (Zhizhek, 2023, f. 17-18). Ky koncept nuk është përkufizim i ri i lirisë, por rikuperim i momentit të parë të vullnetit hegelian në dimensionin e tij më radikal: tërheqja nga çdo përmbajtje, kthimi në vetvete si negativitet i pastër, që normalisht është vetëm një moment logjik që kalon shpejt te momenti i dytë (përcaktimi, zgjedhja) dhe te momenti i tretë (realizimi në institucione), por që Zhizheku thekson se ka momente historike, kur pikërisht ky negativitet, kjo aftësi për të thënë një “Jo” absolute, bëhet e vetmja rrugë për ta hapur hapësirën e një lirie të re, sepse pa shpërthimin e negativitetit rendi i vjetër vazhdon të riprodhojë veten.

Masakra e Drenicës në mars të vitit 1998, kur forcat serbe vranë familjen Jashari, shënoi pikërisht një moment të tillë. Për gati një dekadë, shqiptarët kishin ushtruar lirinë e brendshme me heroizëm të jashtëzakonshëm, por Dejttoni kishte dëshmuar se kjo rrugë nuk po çonte askund. Dhe, kur Adem Jashari refuzoi të dorëzohej edhe përballë një force dërmuese dhe ai luftoi deri në frymën e fundit bashkë me familjen e tij, ky akt përfaqëson lirinë abstrakte në formën e saj më të skajshme: momentin kur një subjekt kolektiv thotë “Jo” me gjithë qenien e tij, jo në faqet e një libri, jo në një debat parlamentar, por me gjak, me jetë, me gjithçka që kishte.

Jashari e jetoi momentin e parë të vullnetit në formën e tij më të skajshme: tërheqjen absolute nga çdo kusht që regjimi kishte imponuar, refuzimin e çdo jete që nuk ishte jetë e lirë, artikulum i një parimi, për të cilin filozofia ka shkruar shekuj me radhë, se jeta pa liri nuk është vërtet jetë dhe se ka momente kur njeriu duhet të zgjedhë mes robërisë së sigurt dhe lirisë që kushton gjithçka. Dhe këtu e shohim edhe logjikën kantiane për lirinë e jashtme në veprimin e saj më të skajshëm: kur shteti vetë bëhet shkelësi i kësaj lirie, kur nuk ka më institucion që e garanton atë, atëherë e drejta për mbrojtje bie mbi individin dhe mbi popullin. Ndaj UÇK-ja ishte pikërisht ushtrimi i kësaj të drejte: mbrojtja e lirisë së jashtme, kur shteti që duhej ta garantonte atë e kishte shndërruar në armikun më të madh të saj.

Por negativiteti radikal, nëse mbetet thjesht negativitet, nuk prodhon liri, sepse nëse mbetesh në refuzimin absolut të çdo determinimi, ajo që fiton është ajo që Hegeli e quan “liria e zbrazëtisë”: negativiteti i pastër, pa përmbajtje pozitive, që prodhon shkatërrim, jo liri, siç ndodhi kur Revolucioni Francez degjeneroi në terror. Kjo ka rëndësi për kontekstin tonë, sepse UÇK-ja nuk mbeti në negativitet të pastër dhe pikërisht ky dallim e ndan negativitetin e justifikuar nga shkatërrimi i verbër: sakrifica e Jasharit ishte refuzim i një rendi të caktuar në emër të një rendi tjetër që duhej themeluar, negativitet që u shndërrua në akt themelimi, “Jo” që u bë njëherazi “Po” ndaj një bote të re, ndaj institucioneve, ndaj një rendi ku liria e jashtme, ajo liri që na takon si qenie njerëzore, të realizohet në institucione. Për ta kuptuar këtë kalim nga çlirimi në liri, na duhet Arendt-i.

V. Nga çlirimi në liri

Hannah Arendt ofron një vegël konceptuale, që është thelbësore për argumentin tim. Në *“On Revolution”* (1963), ajo dallon çlirimin, që nënkupton largimin e shtypjes (momentin kur zgjedha bie, kur tirani ikën, kur forcat pushtuese tërhiqen), nga liria, që kërkon diçka më shumë: themelimin e një bote të re politike, ku njerëzit veprojnë si

subjekte sovrane, ku ata janë autorë të ligjeve që i qeverisin. Çlirimi është kusht i nevojshëm i lirisë, por nuk e garanton atë, sepse shumë revolucione e kanë arritur çlirimin, por kanë dështuar në liri, duke zëvendësuar një tiran me një tjetër ose duke krijuar rende që riprodhojnë shtypjen në forma të reja (Arendt, 1963, f. 29-33). Koncepti që e ndërlidh çlirimin me lirinë është *nataliteti*: aftësia njerëzore për të filluar diçka krejtësisht të re, për të sjellë në botë atë që nuk ka ekzistuar më parë, sepse çdo akt i vërtetë i lirisë është një fillim që nuk mund të deduktohet nga ajo që ka ndodhur më parë.

Në këtë dritë, sakrifica e familjes Jashari dhe lëvizja që ajo frymëzoi ishte moment nataliteti, fillimi i diçkaje krejtësisht të re: pas marsit 1998, shqiptarët e Kosovës ishin popull që po themelonte botën e tij politike. UÇK-ja solli të dyja: çliroi Kosovën nga regjimi i Millosheviqit dhe vuri themelet e shtetit të ri. Kosova e pavarur, e shpallur në shkurt 2008, përfaqëson kalimin nga çlirimi në liri, realizimin e lirisë në institucione, ku subjekti e gjen veten te tjetri ose, siç e formulon Hegeli, *bei sich sein im Anderen*: të jesh me vete duke qenë edhe te tjetri (Cristi, 2005, f. 46). Honneth-i e përshkruan këtë moment duke iu kthyer shembujve të vetë Hegelit: në miqësi dhe në dashuri “ne nuk jemi njëanshëm; e kufizojmë veten me dëshirë, duke u lidhur me tjetrin, por në këtë kufizim e njohim veten si veten” (cit. në Honneth, 2023, f. 25), gjë që, në gjuhë më të thjeshtë, do të thotë se liria e vërtetë nuk është të jesh i izoluar në abstraksion, por të jesh i lirë bashkë me të tjerët, në institucione që na njohin të gjithëve si subjekte të lira: shteti, ligji, rendi kushtetues që garantojnë lirinë e jashtme të çdonjërit në harmoni me lirinë e të gjithëve.

Ky kalim, që qëndron në zemër të argumentit të kësaj eseje, mbetet i paplotë në rastin e Kosovës, sepse Kosova e sotme vazhdon të përballët me sfida të thella: institucione të brishta, sovranitet të kufizuar, njohje ndërkombëtare të paplotë. Liria objektive mbetet projekt, jo realitet i plotë, por pikërisht kjo është natyra e lirisë konkrete: ajo nuk është gjendje statike, por proces i vazhdueshëm, sepse institucionet e lirisë janë historikisht të hapura, të revizueshme,

të papërfunduara (Honneth, 2023, f. 35). Akti themelues i UÇK-së e hapi këtë proces dhe realizimi i tij i plotë mbetet detyrë e gjeneratave që pasojnë, por pa aktin themelues, pa momentin e negativitetit radikal që çau hendekun mes lirisë së brendshme dhe mungesës së lirisë së jashtme, as procesi nuk do të kishte filluar, sepse liria objektive nuk lind nga asgjëja: ajo lind nga negativiteti, nga akti i rebelimit, nga momenti kur një popull vë në lojë gjithçka për të çelur rrugën drejt një bote të re.

VI. Skënderbeu dhe UÇK-ja: kontinuiteti normativ i lirisë

Një kundërshtim i mundshëm ndaj kësaj eseje është se krahasimi mes Skënderbeut dhe UÇK-së është anakronik, sepse Skënderbeu ishte princ feudal i shekullit të pesëmbëdhjetë, ndërsa UÇK-ja ishte lëvizje çlirimtare moderne dhe kontekstet historike, motivet, strukturat shoqërore janë krejtësisht të ndryshme. Ky kundërshtim meriton të merret seriozisht, sepse dallimet historike mes dy konteksteve janë reale dhe nuk duhen minimizuar, megjithatë ai nuk e prek atë që është thelbësore në argumentin tim.

Krahasimi nuk pretendon identitet historik, por identifikon një kontinuitet normativ: një vlerë themelore që riartikullohet në kontekste të ndryshme. Kjo vlerë është liria. Në të dy rastet, një popull i shtypur nga një fuqi shumëfish më e madhe ushtarakisht vendosi të rrezikojë gjithçka për lirinë, pa llogari utilitare dhe pa garanci suksesi. Kushtet normative të rezistencës së armatosur (Finlay, 2015; Brennan, 2019) ishin të plotësuara në të dy rastet, edhe pse në mënyra të ndryshme: në rastin e Skënderbeut, shtypja osmane nuk linte hapësirë për asnjë formë tjetër veprimi politik; në rastin e UÇK-së, dekada e rezistencës paqësore kishte dëshmuar se mjetet diplomatike ishin shteruar dhe në të dy rastet akti i rezistencës ishte artikulum i lirisë. Skënderbeu, kur ngriti flamurin në Krujë në nëntor 1443 dhe bashkoi principatat shqiptare në Besëlidhjen e Lezhës, e artikuloi lirinë si vlerë kolektive (Qosja, 2005); UÇK-ja e artikuloi pikërisht të njëjtin parim pesë shekuj më vonë.

Një aspekt tjetër i këtij kontinuiteti meriton vëmendje: si Skënderbeu, ashtu edhe UÇK-ja e lexuan situatën gjeopolitike me mprehtësi të jashtëzakonshme. Skënderbeu e dinte se rezistenca shqiptare ndaj osmanëve ishte në interes të të gjithë Europës së krishterë dhe e përdori këtë fakt për të siguruar mbështetje nga Napoli, Vatikani dhe Venecia; udhëheqja e UÇK-së e kuptoi se, pas masakrës së Srebrenicës (1995) dhe ndërhyrjes së NATO-s në Bosnjë, Perëndimi do ta gjente të pamundur të lejonte edhe një gjenocid në Ballkan dhe se rezistenca e armatosur do ta detyronte bashkësinë ndërkombëtare të ndërhynte. Ky lexim strategjik ishte i saktë në të dy rastet, gjë që tregon se vendimi për rezistencë nuk ishte impuls emocional, por gjykim racional i thellë, vetëdeterminim në kuptimin më të plotë të fjalës. Në këtë kuptim, UÇK-ja mishëronte njëherazi negativitetin radikal, refuzimin absolut të shtypjes dhe gjykimin racional të kushteve të veprimit, gjë që e bën atë një subjekt të lirisë në kuptimin e plotë filozofik: jo thjesht shpërthim spontan i revoltës, jo thjesht gjykim i ftohtë strategjik, por bashkim dialektik i të dyjave, në shërbim të një ideali që kishte jetuar në vetëdijen shqiptare për pesë shekuj.

VII. Përfundim

Adem Jashari, në kornizën filozofike që kemi zhvilluar, është Skënderbeu i kohës sonë: jo në kuptimin mitologjik të një krahasimi retorik, por në kuptimin e thellë normativ, si figurë që personifikon momentin kur vetëdija shqiptare për lirinë kalon nga ideja në veprim, nga liria e brendshme në negativitetin radikal, që hap rrugën për lirinë objektive.

Kjo ese argumenton se përvoja e shqiptarëve të Kosovës mes viteve 1989 dhe 2008 përbën një rast paradigmatic të dialektikës së lirisë: humbja e lirisë së jashtme përmes shtypjes sistematike të regjimit të Millosheviqit, artikulimi i lirisë së brendshme në dekadën e jashtëzakonshme të rezistencës paqësore të Rugovës, shpërthimi i

negativitetit radikal në mars 1998, dhe kalimi gradual në lirinë objektive përmes themelimit të shtetit të pavarur.

Njëzet e shtatë vjet pas masakrës së Drenicës, liria që UÇK-ja solli mbetet projekt i paplotësuar. Por, çdo projekt i lirisë fillon me një akt themelimi, me një moment kur një popull e artikulon lirinë me të gjithë forcën e veprimit. Më 28 nëntor 1443 Skënderbeu ngriti flamurin në Krujë. Më 28 nëntor 1912 Ismail Qemali shpalli Pavarësinë në Vlorë. Në mars 1998, Adem Jashari e vuri trupin e tij mes lirisë dhe robërisë. Tri momente, pesë shekuj larg njëri-tjetrit, por i njëjti akt: ***artikulimi i lirisë si vlerë, për të cilën ia vlen të jetohet dhe të sakrifikohet jeta.***

Historia botërore, siç na ka mësuar Hegeli, është përparimi i vetëdijes së lirisë (Hegel, 1956). Shqiptarët kanë kontribuar në këtë përparim tri herë, çaste këto me rëndësi universale. Detyra e gjeneratave që pasojnë është ta shndërrojnë lirinë e fituar në liri të jetuar: ta realizojnë lirinë objektive, një botë institucionale ku shqiptarët e njohin veten si subjekte të lira, ku liria nuk është më kujtim i së kaluarës ose dëshirë e së ardhmes, por përvojë e përditshme.

Bibliografi

1. Amnesty International. (1998). Kosovo: The Evidence. London: Amnesty International Publications.
2. Arendt, H. (1963). On Revolution. New York: Viking Press.
3. Brennan, J. (2019). When All Else Fails: The Ethics of Resistance to State Injustice. Princeton: Princeton University Press.
4. Buchanan, A. (2004). Justice, Legitimacy, and Self-Determination: Moral Foundations for International Law. Oxford: Oxford University Press.
5. Clark, H. (2000). Civil Resistance in Kosovo. London: Pluto Press.
6. Cristi, R. (2005). Hegel on Freedom and Authority. Cardiff: University of Wales Press.

7. Finlay, C. (2015). *Terrorism and the Right to Resist: A Theory of Just Revolutionary War*. Cambridge: Cambridge University Press.
8. Hay, C. (2011). The Obligation to Resist Oppression. *Journal of Social Philosophy*, 42(1), 21-45.
9. Hegel, G. W. F. (1807/-1977). *Phenomenology of Spirit* (A. V. Miller, Trans.). Oxford: Oxford University Press.
10. Hegel, G. W. F. (1956). *The Philosophy of History* (J. Sibree, Trans.). New York: Dover.
11. Hegel, G. W. F. (1991). *Elements of the Philosophy of Right* (A. W. Wood, Ed.; H. B. Nisbet, Trans.). Cambridge: Cambridge University Press.
12. Honneth, A. (2023). *The Poverty of Our Freedom: Essays 2012—2019*. Cambridge: Polity Press.
13. Judah, T. (2000). *Kosovo: War and Revenge*. New Haven: Yale University Press.
14. Kant, I. (1797/1996). *The Metaphysics of Morals* (M. Gregor, Trans.). Cambridge: Cambridge University Press.
15. Malcolm, N. (1998). *Kosovo: A Short History*. New York: New York University Press.
16. Qosja, R. (2005). *Skënderbeu në histori dhe në letërsi*. Prishtinë: Buzuku.
17. Žižek, S. (2023). *Freedom: A Disease Without Cure*. London: Bloomsbury Academic.

1.2 Konferenca e Sigurisë “Munih 2026”: Rendi ndërkombëtar multipolar kundrejt rendit multivektorial

Nga dr. Sadri Ramabaja

Abstrakt

Vështrimi “*Konferenca e Sigurisë ‘Munih 2026’*”: Rendi ndërkombëtar multipolar kundrejt rendit multivektorial” analizon transformimin aktual të sistemit ndërkombëtar në kontekstin e debatit strategjik të zhvilluar në Konferencën e Sigurisë në Munih 2026, duke argumentuar se bota po kalon nga rendi liberal pas Luftës së Ftohtë drejt një faze tranzitore të pasigurisë strukturore.

Këtu trajtojmë konkurrencën konceptuale midis **multipolaritetit**, që përshkruan shpërndarjen e fuqisë ndërmjet disa qendrave globale, dhe **multivektorialitetit**, që shpjegon mënyrën se si shtetet orientojnë politikën e tyre të jashtme përmes drejtimesh të shumëfishta strategjike.

Analiza argumenton se multipolariteti nënkupton rikthimin e politikës klasike të fuqisë, fragmentimin e institucioneve ndërkombëtare dhe rritjen e rivaliteteve strategjike, ndërsa multivektorialiteti paraqitet si model adaptimi për shtetet, veçanërisht ato të vogla dhe të mesme, përmes diversifikimit të aleancave, partneriteteve ekonomike dhe orientimeve të sigurisë. Duke u mbështetur në teorinë realiste dhe neorealiste, si dhe në qasjet bashkëkohore të gjeopolitikës së rrjeteve, studimi propozon konceptin e “vektorëve strategjike” si një kornizë analitike për të kuptuar sjelljen fleksibile të shteteve në një sistem ndërkombëtar plural dhe të fragmentuar.

Në planin europian, punimi interpreton autonominë strategjike të Bashkimit Europian dhe modelin e “Europës së disa rrathëve”, si shprehje praktike të logjikës multivektoriale, ku integrimi nuk është më linear, por diferencues dhe funksional. Brenda këtij transformimi, hapësira shqiptare fiton rëndësi të re strategjike: Shqipëria si anëtare e

NATO-s dhe Kosova përmes arkitekturës euroatlantike të sigurisë kalojnë nga periferi politike në zonë funksionale sigurie.

1. Hyrje

Konferenca e Sigurisë e Munihut (MSC) 2026, që zhvilloi punimet e saj për tri ditë radhazi [13,14 e 15 shkurt] në një moment historik tranzicioni sistemik, ku debati kryesor nuk është më vetëm mbi krizat konkrete të sigurisë, por mbi vetë arkitekturën e rendit ndërkombëtar. Konferenca e Sigurisë në Munih po zhvillohet në sfondin e një politike të re dhe agresive të fuqive të mëdha. SHBA-ja nuk duket më si një fuqi globale e besueshme. Referuesit në këtë konferencë njëzëri shtruan pyetjen e ligjshme: *A jemi të sigurt në Europë?* Dy koncepte konkurrojnë për të shpjeguar dhe orientuar këtë transformim: *rendi multipolar* dhe *rendi multivektorial*.

Kjo analizë ka për objekt trajtimi sistemin ndërkombëtar (multi) vektorial në krahasim me konceptin e një rendi ndërkombëtar (multi) polar. Ajo është një vazhdim dhe thellim i studimeve të mia paraprake mbi rikthimin e gjeopolitikës dhe ndeshtrashat e pritshme të shteteve të vogla. Qëllimi i kësaj analize është të hedhë dritë mbi elementet e rendit ndërkombëtar multivektorial në kontrast me multipolaritetin, duke nxjerrë edhe përfundime se si mund të zbatohet ai në politikën e jashtme të shteteve, respektivisht çfarë ndikimi do të mund të kishte ai në procesin e krijimit të Federatës Shqiptare, duke dhënë përmasat reale që ka, nga një çështje kombëtare në variabël gjeopolitik.

2. Konferenca e Sigurisë “Munih 2026”

Wolfgang Ischinger, kryetari me shërbim të gjatë në krye të MSC-së, përdori një gjuhë jashtëzakonisht të fortë në vigjilje të konferencës. Ai deklaroi se, që kur mori për herë të parë kryesinë në vitin 2008, nuk kishte pasur kurrë kaq shumë luftëra dhe konflikte njëkohësisht sa ka tani. Ish-ambasadori, duke folur në një konferencë për shtyp në Berlin, deklaroi si të mirëqenë një “krizë të konsiderueshme besimi dhe

besueshmërie” në marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara. Ai pohoi se po merremi me “sfida serioze, në disa raste sistematike”.¹ Kush do ta kishte menduar këtë?

Konferenca më e rëndësishme e sigurisë në botë tashmë është shndërruar *de facto* në një pasqyrë të rendit global. Rrjedhat e zhvillimeve në frontet e luftës në Ukrainë, por edhe ndeshtrashat që po shkakton rivaliteti midis SHBA-së dhe Kinës, me theks dobësimin e institucioneve ndërkombëtare dhe polarizimin politik të theksuar në shoqëritë perëndimore, do të jenë temat bosht të kësaj konference historike.

Konferenca si e tillë vazhdon ruajë rolin e saj specifik: nuk është një vend për negociata formale ose miratimin e deklaratave, por më tepër një hapësirë ku takohen rivalët, testohen mesazhet politike dhe formulohen vizionet strategjike. Për këtë arsye, Munihu shpesh bëhet një skenë, ku manifestohen publikisht ndryshimet, që vetëm më vonë marrin formë institucionale.

Në këtë kontekst, pritjet për konferencën aktuale janë rritur përsëri. Diskutimet rreth të ardhmes së NATO-s, autonomisë potenciale të mbrojtjes europiane, perspektivës së luftës në Ukrainë dhe ripërcaktimit të marrëdhënieve me Rusinë dhe Kinën do të zhvillohen së bashku me çështjet e stabilitetit të brendshëm të demokracive perëndimore. Fokusi programatik i konferencës pasqyron njëkohësinë e krizave globale. Të premtën, agjenda përfshin multilateralizmin, sigurinë ekonomike, mbrojtjen e klimës, luftën hibride, rreziqet bërthamore dhe garën globale të inteligjencës artificiale. Konferenca e Sigurisë e Munihut nuk simbolizon më sigurinë në kuptimin klasik, por më tepër pasigurinë e një bote, në të cilën rendi i vjetër po shkatërrohet dhe ai i riu nuk është përcaktuar ende qartë.

Në fjalimin e tij, Sekretari i Shtetit i SHBA-së, Marko Rubio, pavarësisht diferencave, theksoi unitetin midis SHBA-së dhe Europës në Munih. Wolfgang Ischinger, kreu i Konferencës së Sigurisë së Munihut, shprehu lehtësimin e tij. Por Sekretari i Shtetit, Marco

Rubio, e bëri të qartë: SHBA-ja dhe Europa i përkasin njëra-tjetrës. Ato janë pjesë e të njëjtit qytetërim dhe të lidhura nga lidhje të thella kulturore dhe historike. Por Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, pret reciprocitet, tha Rubio. Nëse është e nevojshme, SHBA-ja do të krijojë rrugën e saj. Megjithatë, preferenca është “ta bëjmë këtë së bashku me Europën”. Ai vazhdoi: “Ne duam që Europa të jetë e fortë. Ne besojmë se Europa duhet të mbijetojë”. SHBA-ja gjithmonë “do të mbeten fëmijë i Europës”.²

Megjithatë, Rubio, ashtu si Vance vitin e kaluar, erdhi në Munih me deklarata të qarta. Amerikanët janë të përkushtuar ndaj partneritetit me Europën, por sipas kushteve të tyre.³ Shtetet e Bashkuara nuk kanë interes të jenë administratorët e sjellshëm të rënies, tha Rubio. Më tej, pyetja thelbësore mbetet e hapur: nëse Konferenca e Sigurisë “Munih 2026” do të jetë më shumë sesa thjesht një klub debati i nivelit të lartë?

Historia tregon se diskutimet joformale në periferi të ngjarjes zyrtare janë shpesh më të rëndësishme sesa fjalimet kryesore. Në hapësirat e mbrojtura të hotelit “Bayerischer Hof”, disa nisma diskrete diplomatike janë nisur në të kaluarën. Nëse kjo do të ndodhë përsëri këtë herë, në një botë që po braktis me shpejtësi strukturat shumëpalëshe, mbetet për t’u parë.

3. Rendi multipolar: rikthimi i logjikës së fuqive të mëdha

“Under destruction” (*Nën shkatërrim*) është titulli i raportit për Konferencën e Sigurisë në Munih dhe mesazhi i tij është i qartë: bota siç e njihnim është një gjë e së kaluarës.⁴ Bota siç e njihnim gjatë tri dekadave pas Luftës së Ftohtë po shpërbëhet gradualisht. Rendi ndërkombëtar liberal, i ndërtuar mbi rregulla, institucionet shumëpalëshe dhe besimi relativ ndërmjet aktorëve kryesorë, nuk po transformohet përmes reformave evolutive, por po hyn në një fazë erozioni strukturor.

Pavarësisht pranisë së vazhdueshme, Shtetet e Bashkuara, për vite me radhë, e kanë inkurajuar Europën që të rrisë shpenzimet e saj

të mbrojtjes dhe të marrë përsipër përgjegjësi më të mëdha për sigurinë e vet. Kjo nuk është diçka unike për administratën e Presidentit Trump. Raporti vëren se midis viteve 2021 dhe 2025, anëtarët europianë të NATO-s rritën buxhetet e mbrojtjes me rreth 41 për qind. Ky është një ndryshim i prekshëm, megjithëse boshllëqet në aftësi vazhdojnë. Paralelisht, diskutimet rreth lidërshiptit europian brenda strukturave komanduese të NATO-s sugjerojnë një rikalibrim gradual të përgjegjësiave. Ndërsa është e parakohshme ta etiketojmë këtë si një transformim strukturor, ai mund të sinjalizojë një lëvizje të vërtetë drejt të ashtuquajturës “NATO Europiane”.⁵

Normat qendrore të këtij rendi, si respektimi i sovranitetit, mekanizmat kolektivë të sigurisë dhe institucionet ndërkombëtare, nuk po sfidohen më vetëm retorikisht; ato po dobësohen sistematikisht ose po vihen në pikëpyetje në mënyrë të qëllimshme nga vetë aktorët shtetërorë. Në vend të gradualizmit institucional, politika ndërkombëtare po karakterizohet gjithnjë e më shumë nga rikthimi i politikës së fuqisë, rivaliteti strategjik dhe prioritizimi i interesave kombëtarë afatshkurtër.

Raporti i Sigurisë i Munihut 2026 përshkruan një realitet global, ku besimi ndërmjet shteteve është në rënie, ndërsa bashkëpunimi shumëpalësh po humbet legjitimitetin politik dhe mbështetjen shoqërore. Një tendencë veçanërisht shqetësuese është gatishmëria në rritje e aktorëve politikë për të çmontuar struktura ekzistuese sigurie pa ofruar alternativa të qëndrueshme institucionale. Ky proces prek jo vetëm organizatat ndërkombëtare, por edhe partneritetet tradicionale dhe garancitë e sigurisë, që për dekada konsideroheshin të qëndrueshme.

Në këtë kuptim, rendi multipolar nuk paraqitet si një sistem i ri i stabilizuar, por si një fazë tranzitore e pasigurisë strategjike, ku fuqitë e mëdha rikthehen si aktorë dominues dhe konkurrenca gjeopolitike zëvendëson gradualisht logjikën e bashkëpunimit universalist. Për Europën, raporti paralajmëron pasoja të thella. Ndryshimet në balancat globale të fuqisë, luftërat e vazhdueshme në

periferi të kontinentit dhe pasiguritë në marrëdhëniet transatlantike imponojnë një domosdoshmëri të re: forcimin e kapaciteteve autonome në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Europa nuk mund të mbështetet më ekskluzivisht në arkitektura të trashëguara sigurie; ajo duhet të zhvillojë aftësi veprimi strategjik të pavarur.

Në këtë kontekst, bëhet edhe më e qartë urgjenca strategjike për dy republikat shqiptare, Shqipërinë politike dhe Republikën e Kosovës. Transformimet e rendit ndërkombëtar nuk janë zhvillime abstrakte globale; ato prodhojnë pasoja konkrete për hapësirat periferike të Europës, veçanërisht për rajone me kapacitete të fragmentuara shtetërore dhe peshë të kufizuar negociuese.

Rikthimi i logjikës së fuqive të mëdha nënkupton se siguria nuk garantohej më automatikisht nga normat ndërkombëtare, por nga koherenca strategjike dhe kapaciteti institucional. Në një mjedis të tillë, fragmentimi politik shndërrohet në vulnerabilitet strukturor, ndërsa koordinimi dhe integrimi funksional bëhen kushte mbijetese strategjike. Prandaj sfida për hapësirën shqiptare nuk është vetëm adaptimi ndaj rendit multipolar, por ndërtimi i një forme të re veprimi politik, që mund të përballojë pasigurinë sistemike: një arkitekturë bashkëpunimi që rrit kapacitetin kolektiv për siguri, zhvillim dhe përfaqësim ndërkombëtar.

Në një botë ku rendi i vjetër po shpërbëhet dhe rendi i ri ende nuk ka marrë formë të qartë, pyetja thelbësore nuk është më nëse ndryshimi do të ndodhë, por nëse aktorët e vegjël do ta përballojnë atë si objekte të politikës globale apo si subjekte strategjike të saj.

Rendi ndërkombëtar po vihet nën presion në rritje. Normat qendrore, mekanizmat dhe institucionet e rendit botëror të bazuar në rregulla jo vetëm që po sfidohen, por po dobësohen ose vihen në pikëpyetje qëllimisht.⁶ Në vend të reformave graduale, qasjet politike shkatërruese, politika e fuqisë dhe interesat kombëtarë afatshkurtër po formësojnë gjithnjë e më shumë veprimin ndërkombëtar.

Nëse raporti i MSC-së paralajmëron për pasojat e përmasave të gjera për Europën në dritën e ndryshimeve gjeopolitike të fuqisë,

luftërave të vazhdueshme dhe pasigurive në rritje në marrëdhëniet transatlantike, forcimi i aftësive të saj në politikën e jashtme dhe të sigurisë është i nevojshëm⁷, është më se e qartë urgjenca, me të cilën dy republikat tona [Shqipëria politike dhe Republika e Kosovës] kanë për të përballuar këto pasoja të pritshme.

3.1 Karakteristikat kryesore

- Balancë klasike fuqie (balance of power)
- Rivalitet strategjik afatgjatë
- Fragmentim i institucioneve ndërkombëtare
- Rajonalizim i sigurisë
- Rritje e politikës frenuese ushtarake

Në këtë kuptim, lufta në Ukrainë dhe tensionet SHBA-Kinë shihen si simptoma të një sistemi që po rikthehet drejt logjikës së shekullit XIX, por me teknologji të shekullit XXI. Multipolariteti presupozon stabilitet përmes ekuilibrit, por edhe rrezik më të madh për përplasje strukturore.

4. Vektorët në marrëdhëniet ndërkombëtare: një kornizë teorike për analizën e rendit multivektorial

Në kushtet e transformimit të rendit ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë dhe veçanërisht në dekadën e tretë të shekullit XXI, analiza klasike e aleancave binare apo e blloqeve ideologjike rezulton gjithnjë e më e pamjaftueshme. Sjellja e shteteve nuk mund të shpjegohet më vetëm përmes kategorive tradicionale të aleancës dhe kundëraleancës. Në këtë kontekst, koncepti i *vektorëve strategjikë* paraqitet si një instrument analitik, që mundëson kuptimin e orientimeve të shumëfishta të politikës së jashtme.

Vektorët përfaqësojnë drejtimet e diferencuara të angazhimit ndërkombëtar të një shteti: në siguri, ekonomi, teknologji dhe identitet politik, të cilat zhvillohen paralelisht dhe jo domosdoshmërisht në mënyrë ekskluzive.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, “vektorët” janë një *metaforë analitike* e marrë nga fizika dhe matematika, që përdoret për të përshkruar drejtimet strategjike të politikës së jashtme të një shteti. Pra, një vektor nuk është aktor apo institucion, por *një drejtim orientimi politik, ekonomik, ushtarak ose civilizues*.

Kuptimi etimologjik i fjalës “vektor” rrjedh nga fjala latine “vector” (bartës), e cila njihet edhe si “vehere” (të bartësh) (Portali i Gjuhës Kroate, 2026). “Koncepti i vektorit u zhvillua nga teoria e gjatësive të drejtuara. Një gjatësi e drejtuar AB është një gjatësi AB me një pikë fillimi të përcaktuar A dhe një pikë fundore B dhe përfaqësohet grafikisht nga një shigjetë nga A në B” (Enciklopedia Kroate, 2026). Çfarë do të thotë kjo për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikën a diplomacinë e jashtme?

Një **vektor në politikën ndërkombëtare** përbëhet nga tri elemente:

1. **Drejtimi** – kahu gjeopolitik (p.sh., drejt NATO-s, Kinës, BE-së).
2. **Intensiteti** – niveli i angazhimit ose i varësisë.
3. **Qëllimi strategjik** – interesi që synohet të arrihet.

Pra, një shtet mund të ketë *më shumë se një vektor njëkohësisht*.

Kuptimi etimologjik dhe matematik i vektorit rezulton veçanërisht i rëndësishëm në analizën e shkencës politike të marrëdhënieve ndërkombëtare. Vektori tregon një orientim të politikës së jashtme të drejtuar, që ka një pikënisje të qartë në interesat kombëtarë, identitetin dhe burimet e shtetit A (pika A) dhe është i drejtuar drejt shteteve të tjera specifike B, C, D etj.⁸

Në këtë kontekst është e qartë se një shtet mund të ndjekë:

- **Vektor sigurie** → bashkëpunim me NATO-n
- **Vektor ekonomik** → investime nga Kina
- **Vektor energjetik** → marrëdhënie me Lindjen e Mesme
- **Vektor politik** → integrim në BE

Kjo quhet **politikë multivektoriale**.

5. Multipolariteti vs Multivektorialiteti

Koncepti

Çfarë përshkruan

Multipolariteti

Strukturën e sistemit global (shumë qendra fuqie)

Multivektorialiteti

Sjelljen strategjike të shteteve brenda këtij sistemi

Ky koncept aplikohet gjithnjë e më shumë, meqë realiteti i sotëm nuk është më bardhë e zi (Lindje vs Perëndim). Ndërkaq në anën tjetër, disa shtete nuk duan aleanca ekskluzive, të tjerat kërkojnë autonomi strategjike, të tretat po diversifikojnë partnerët për të reduktuar rrezikun. Në marrëdhëniet ndërkombëtare, vektorët janë drejtimet e diferencuara të orientimit strategjik, përmes së cilave një shtet shpërndan marrëdhëniet e tij të sigurisë, ekonomisë dhe diplomacisë për të maksimizuar autonominë dhe sigurinë në një sistem ndërkombëtar plural. ***Vektorët shërbejnë për të analizuar këtë politikë të balancimit fleksibël. Kjo marrëdhënie është e matshme dhe shprehet në një nivel politik, ushtarak, ekonomik ose normativ.***

5.1 Bazat teorike në realizëm dhe neorealizëm

Në traditën e *realizmit klasik* (Hans Morgenthau), politika ndërkombëtare konceptohet si garë për fuqi brenda një sistemi anarkik. Aleancat janë instrumentale dhe të përkohshme, të orientuara nga interesi kombëtar. Kjo premisë krijon bazën për të kuptuar vektorët si **drejtime fleksibile të maksimizimit të fuqisë**.

Neorealizmi strukturor i Kenneth Waltz-it e zhvendos fokusin nga natyra njerëzore te struktura e sistemit ndërkombëtar. Në një sistem multipolar, shtetet kërkojnë balancim për të shmangur dominimin nga një fuqi e vetme. Megjithatë, në realitetin bashkëkohor, balancimi nuk realizohet më vetëm ushtarakisht; ai shpërndahet në disa fusha njëkohësisht.

Kështu, vektorët mund të interpretohen si:

- **balancim sektorial**, jo vetëm strategjik;

- kombinim i balancimit dhe manovrimit strategjik;
- mekanizëm për reduktimin e pasigurisë strukturore.

Shteti nuk zgjedh vetëm një aleancë, por ndërton një *arkitekturë marrëdhëniesh të shumëdrejtuar*.

5.2 Gjeopolitika e rrjeteve dhe transformimi i hapësirës së fuqisë

Qasjet bashkëkohore të gjeopolitikës, veçanërisht koncepti i **gjeopolitikës së rrjeteve** (network geopolitics), sfidojnë modelin territorial tradicional të fuqisë.

Në vend të kontrollit të hapësirës fizike, fuqia matet përmes:

- rrjeteve ekonomike,
- zinxhirëve të furnizimit,
- infrastrukturës digjitale,
- rrjeteve energjetike dhe teknologjike.

Në këtë kontekst, vektorët përfaqësojnë **nyja lidhjeje (nodes of connectivity)** në rrjetin global.

Një shtet mund të jetë:

- i integruar në rrjetin e sigurisë euroatlantike,
- pjesë e rrjeteve tregtare aziatike,
- i lidhur energjetikisht me rajone të tjera.

Pra, politika e jashtme nuk është më linearitet territorial, por *pozicionim brenda rrjeteve të ndërvarura*.

Vektori bëhet kështu një njësi analize e marrëdhënieve në epokën e globalizimit të fragmentuar.

6. Autonomia strategjike europiane dhe logjika multivektoriale

Debati mbi autonominë strategjike europiane brenda Bashkimit European pasqyron në mënyrë të qartë logjikën multivektoriale. Autonomia strategjike nuk nënkupton shkëputje nga aleancat ekzistuese, por:

- diversifikim kapacitetesh,
- reduktim varësish kritike,

- aftësi veprimi të pavarur në fusha të caktuara.

Europa synon të ruajë vektorin transatlantik (SHBA/NATO), krahas vektorit ekonomik global, por edhe vektorin teknologjik sovran dhe vektorin energjetik alternativ. Kjo tregon se multivektorialiteti nuk është strategji vetëm e shteteve të vogla, por ai po bëhet paradigmë edhe për aktorë të mëdhenj integruar.

Një politikë e jashtme shumëvektoriale, pra, i përshtat veprimet e një shteti me interesat e tij kombëtarë në marrëdhëniet e tij me të gjitha shtetet e tjera që kontribuojnë në realizimin e këtyre interesave kombëtarë. Shembulli klasik: Danimarka mund të kishte hyrë në një marrëdhënie vektoriale me çdo aktor tjetër që mbron interesat e Danimarkës në Groenlandë, ashtu si Kanadaja e përafroi politikën e saj të jashtme me Kinën për të kompensuar marrëdhëniet negative me SHBA-në. Ose merrni si shembull Indinë, e cila ka marrëveshje bashkëpunimi me BE-në, SHBA-në dhe Rusinë, ndërsa njëkohësisht i përket Komonuelthit me Mbretërinë e Bashkuar.

6.1 Nga integrimi linear tek integrimi diferencues

Për dekada me radhë, integrimi evropian u konceptua si proces linear: të gjithë drejt të njëjtit destinacion institucional. Sot po shfaqet një paradigmë tjetër:

- **rrethi i brendshëm** → bashkëpunim i thelluar në siguri dhe mbrojtje,
- **rrethi ndërmjetës** → integrim ekonomik dhe institucional gradual,
- **rrethi periferik** → partnerë strategjikë të lidhur funksionalisht me BE-në.

Kjo nuk është krizë e BE-së, por adaptim ndaj realitetit multipolar.

Koncepti i një Europe me “*gjeometri të ndryshueshme*”, apo i ashtuquajtur edhe modeli i *Europës së disa rrathëve*, shënon një transformim thelbësor të projektit evropian. Ai sinjalizon kalimin nga ideja e integritetit uniform drejt një arkitekture fleksibile, ku shtetet

nuk ecin më domosdoshmërisht me të njëjtin ritëm, por sipas gatishmërisë politike, kapaciteteve dhe interesave strategjikë.

Në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, ky model nënkupton një realitet të ri: ***Europa nuk pret më konsensus të plotë për të vepruar.*** Vendet që janë të gatshme avancojnë përpara në iniciativa konkrete, ndërsa të tjerat bashkohen më vonë. Konferenca e Sigurisë në Muni duket se e ka institucionalizuar praktikisht këtë logjikë, sidomos përmes modelit të “koalicionit të të gatshmeve” në mbështetje të Ukrainës dhe përpjekjes për forcimin e shtyllës europiane brenda NATO-s.

Theksi i Massolo-s, se nuk ekziston alternativë reale ndaj NATO-s dhe se autonomia europiane duhet të zhvillohet brenda saj, përbën pikën kyç të këtij transformimi strategjik.

6.2 Çfarë nënkupton kjo për shqiptarët?

Për hapësirën shqiptare (Shqipërinë dhe Kosovën), ky zhvillim ka pasoja strategjike të drejtpërdrejta.

a) Fundi i pritjes pasive për anëtarësim

Në modelin e ri europian, integrimi nuk është më vetëm anëtarësim formal, por *pjesëmarrje funksionale paraprake*.

Kjo krijon një mundësi historike: të integrohesh në politika konkrete sigurie dhe mbrojtjeje edhe pa qenë ende anëtar i plotë i BE-së. Pra, statusi juridik nuk është më pengesë absolute për integrim real.

b) Rëndësia e shtyllës euroatlantike

Meqenëse autonomia europiane zhvillohet brenda NATO-s:

- Shqipëria (anëtare e NATO-s) fiton peshë strategjike më të madhe;
 - Kosova, përmes partneritetit të sigurisë dhe pranisë ndërkombëtare, bëhet pjesë indirekte e arkitekturës euroatlantike.
- Në këtë kuptim, hapësira shqiptare shndërrohet nga periferi politike në *zonë funksionale sigurie*.

7. Impakti mbi konceptin e Federatës Shqiptare

Europa e rrathëve e ndryshon edhe kuptimin e bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë. Federata ose integrimi funksional shqiptar nuk do të ishte më projekt jashtëeuropean, por një mekanizëm për hyrje më të shpejtë në rrathët e avancuar europianë.

Sepse BE-ja e re do të favorizonte aktorë rajonalë koherentë, ashtu si edhe hapësira të integruara ekonomikisht dhe partnerë sigurie të besueshëm.

Një hapësirë shqiptare e koordinuar institucionalisht përshtatet natyrshëm me këtë logjikë. Koncepti i autonomisë strategjike europiane krijon një hapësirë të re për aktorë rajonalë koherentë.

Një Federatë Shqiptare mund të:

- kontribuojë në sigurinë periferike të Europës,
- stabilizojë kufirin juglindor të kontinentit,
- shërbejë si partner operacional në politikat e mbrojtjes dhe energjisë.

Në këtë mënyrë, federata nuk do të ishte alternativë ndaj integritetit european, por *instrument për ta përsheptuar atë*.

Si një komb i vogël në një botë multipolare, shqiptarët pavarësisht se nuk paraqesin një pol, që do të thotë se nuk posedojnë fuqi të mjaftueshme ushtarake, ekonomike ose politike, të strukturuar në një Federatë të përbërë nga dy republikat ekzistuese, në koordinim me partnerët e tyre, sidomos në aleancë me Kroacinë dhe Britaninë e Madhe, mund të formësojnë në mënyrë solide rregullat dhe strukturën globale të sistemit ndërkombëtar në përputhje me interesin nacional.

Kjo do të thotë që Federata Shqiptare mbetet e kufizuar në rrafshin strukturor nga marrëdhëniet dhe aktivitetet e fuqive të mëdha, qendrat e poleve dhe duhet të përshtatet me hierarkinë e fuqisë që përcakton fushëveprimin e saj brenda atij poli ose blloku. Multipolariteti do të përfaqësonte një kontekst të politikës së jashtme për Federatën Shqiptare, në të cilin ekzistojnë qendra të ndryshme

pushteti brenda blloqeve. Në këtë kuadër, është e nevojshme të zhvillohen dhe balancohen interesat dhe marrëdhëniet midis këtyre blloqeve.

Megjithatë, është e pamundur të krijohen thjesht marrëdhënie me vendet jashtë një poli/blloku të caktuar, pasi blloqet nuk lejojnë një balancim strategjik të interesave kombëtarë, por përkundrazi promovojnë bindjen ndaj bllokut.

Në praktikë, kjo do të thotë që Federata Shqiptare, megjithëse nuk do të ishte vetë një qendër fuqie, ajo do të mund të përdorte politikën e jashtme si një instrument për të maksimizuar autonominë dhe sovranitetin, për të siguruar sigurinë, për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe politik dhe për të garantuar përmbushjen e interesave kombëtarë, të cilët duhet të përcaktohen në dokumente të reja strategjike dhe doktrinare shtetërore.

8. Federata Shqiptare: nga një çështje kombëtare në variabël gjeopolitik

Ideja e një Federate Shqiptare, si formë bashkërendimi funksional midis

Shqipërisë dhe Kosovës, nuk mund të analizohet më vetëm në kuadër historik apo identitar. Në kushtet e transformimit të rendit ndërkombëtar, ajo shfaqet si një *variabël strategjik* brenda një sistemi që po kalon nga unipolariteti liberal drejt një *konfigurimi multipolar* dhe një praktike gjithnjë më të përhapur *multivektoriale*.

Pyetja qendrore nuk është më *a është e mundur federata*, por *çfarë funksioni strategjik do të kishte ajo në arkitekturën e re ndërkombëtare?* Në një rend multipolar, fuqia globale shpërndahet ndërmjet disa poleve kryesore (SHBA, Kinë, BE, Rusi dhe fuqitë rajonale). Për shtetet e vogla dhe të mesme, sfida kryesore është shmangia e marginalizimit.

Në këtë kontekst, një federatë Shqipëri-Kosovë do të prodhonte:

a) Konsolidim të kapacitetit shtetëror

- bashkim tregu dhe resursesh njerëzore,

- koordinim diplomatik,
- rritje të peshës negociuese ndërkombëtare.

b) Rritje të relevancës strategjike rajonale, Federata do të shndërrohej në:

- një stabilitet në Ballkanin Perëndimor,
- korridor lidhës Adriatik-Ballkan-Europë Qendrore,
- partner më koherent për NATO-n dhe BE-në.

Në logjikën realiste, madhësia relative dhe koherenca institucionale rrisin sigurinë dhe federata do të ishte një formë *balancimi përmes integritetit*.

Ndryshe nga multipolariteti, rendi multivektorial fokusohet në mënyrën se si shtetet navigojnë ndërmjet fuqive.

Federata Shqiptare do të kishte potencial të zhvillonte disa vektorë paralelë:

Vektori	Orientimi strategjik
Siguri	NATO-ja dhe partneriteti transatlantik
Integrim	Bashkimi European
Ekonomik	korridore tregtare euro-mesdhetare
Energjetik	diversifikim Adriatik-Ballkan
Teknologjik	integrim në rrjetet digjitale europiane
Diasporik	kapital social global shqiptar

Kjo do ta kthente federatën në një *aktor multivektorial funksional*, jo në një projekt ekskluziv gjeopolitik.

9. Përfundim: Federata si aktor i rendit në formim

Në një botë ku rendi liberal po transformohet dhe rivalitetet globale po shtohen, shtetet e vogla mbijetojnë përmes koherencës dhe fleksibilitetit strategjik. Federata Shqiptare mund të konceptohet si një përgjigje e duhur ndaj multipolaritetit (rritje kapaciteti), si instrument i multivektorialitetit (diversifikim strategjik), si një e gjeopolitikës së rrjeteve (lidhshmëri) dhe si kontribuues në autonominë strategjike europiane. Prandaj, rëndësia e saj nuk qëndron vetëm në bashkimin politik, por në potencialin për t'u bërë aktor racional i një rendi ndërkombëtar pa qendër të vetme graviteti.

Bibliografi

1. <https://www.kettner-edelmetalle.de/news/munchner-sicherheitskonferenz-2026-wenn-die-weltordnung-brockelt-und-europa-hilflos-zuschaut-12-02-2026>
2. <https://www.spiegel.de/ausland/muenchner-sicherheitskonferenz-rubio-betont-zusammenhalt-von-usa-und-europa-a-bd78fc9c-f160-4ead-ad2d-ff1957668c80>
3. <https://www.nzz.ch/international/rubio-an-der-sicherheitskonferenz-in-muenchen-usa-brauchen-europa-als-partner-ld.1924667>
4. <https://www.swr.de/kultur/gesellschaft/die-muenchner-sicherheitskonferenz-zu-viele-gefahren-im-fokus-forum-2026-02-13-100.html>
5. <https://thegeopost.com/analiza/veshtrime-mbi-sigurine-europiane-nga-raporti-i-sigurise-i-mynihut/>
6. <https://www.linkedin.com/pulse/weltordnung-im-stresstest-hanns-seidel-stiftung-qqcaf/>
7. <https://www.linkedin.com/pulse/weltordnung-im-stresstest-hanns-seidel-stiftung-qqcaf/>
8. <https://www.geopolitika.news/analyze/visepolarni-vs-visevektorski-medunarodni-poredak/>

1.3 HISTORIA PA JUSTIFIKIME: NGA LEGJENDAT TE PËRGJEGJËSIA DHE DOMOSDOSHMERIA E VETËREFLEKTIMIT

Nga Artan Nati

Shqipëria, ky vend që mban në stemë shqiponjën, po i ngjan gjithnjë e më pak simbolit që e përfaqëson. Sepse sot, shqiponjat e vetme që fluturojnë lart janë politikanët, ndërsa shqipet, njerëzit e zakonshëm, qytetarët, shqiptarët kanë mbetur poshtë, të pambrojtur, të heshtur, pre e kthetrave të pushtetit. Në këtë paradoks tragjik, simboli i lirisë është përmbysur: ai që duhej të ishte shenjë krenarie kombëtare është kthyer në metaforë grabitjeje. Politika ka marrë trajtat e një grabitqari të stërvitur, që ushqehet me varfërinë, me frikën dhe me mungesën e shpresës.

Tragjedia nuk qëndron vetëm te varfëria materiale, por te shkatërrimi i dinjitetit. Një vend që, historikisht, i ka kënduar lirisë, sot mëson të jetojë me nënshtrim. Shqiponja, dikur simbol i qëndresës, sot përdoret si logo, si dekor, si alibi patriotike për një pushtet që vepron kundër vetë shqipeve. Dhe kështu, në tokën e shqiponjave, liria mbetet vetëm në flamur, ndërsa njerëzit jetojnë si pre, të lodhur, të zhgënjyer, të mësuar me faktin se grabitqari gjithmonë fiton.

Shqipëria është ndoshta i vetmi vend, që i thur lavde një historie madhështore, por trashëgon gjithmonë anën e errët të saj. Një vend që flet me krenari për gjuhën “më të vjetër në botë”, për mbrojtjen e krishterimit nga Gjergj Kastrioti, për figurat që i ka dhënë qytetërimit perëndimor, 4 papë, duke përfshirë Papën Klementi XI (nga familja e shquar Albani). Shumë perandorë romakë erdhën nga rajoni më i gjerë ilir (përfshirë edhe Shqipërinë e sotme), me figura kyç si Kostandini i Madh, Justiniani I dhe Anastasi I, të shekujve 3-6, të cilët e shpëtuan perandorinë nga kriza. Shqiponjat i krijuam, por fatin e tyre nuk e patëm kurrë.

Nga Gjergj Kastrioti nuk morëm Europën që ai mbrojti me shpatë, por emrin e tij mysliman, Skënderbeu, si një shenjë e paradoksit tonë historik: mbrojtëm Perëndimin, por përfunduam jashtë tij. Nga Kostandini i Madh nuk trashëguam Romën e re dhe krishterimin si bosht qytetërimi, por Kostandinopojën e rënë dhe më pas Stambollin që na pushtoi, na sundoi dhe na ndryshoi fenë, mentalitetin dhe raportin me pushtetin. Nga Aleksandri i Madh, një figurë që sot njihet si helene, mbeti vetëm një krenari e paqartë, e paartikulluar, një lavdi që të tjerët e administruan më mirë se ne.

Historia shqiptare është një varg humbjesh simbolike: fitore morale, por edhe disfata politike, morëm heroizma epike, por edhe përfundime tragjike. Ne u bëmë roja të qytetërimit perëndimor, por përfunduam provincë e perandorive lindore. Mbrojtëm krishterimin, por jetuam shekuj nën sundim osman. Krijuam shqiponja historike, por gjithmonë na mbeti fati i shqipes së plagosur, jo i shqiponjës që sundon qiellin.

Dhe kjo tragjedi nuk është vetëm e shkuara. Ajo vazhdon sot, në formën e “shqiponjave të demokracisë”, politikanë që flasin në emër të Perëndimit, por ndërtojnë një sistem, që termin “demokraci” e kanë vetëm në fjalor. Shqiponjat moderne nuk çlirojnë, por grabisin; nuk ndërtojnë shtet, por e zhvatin; nuk i mbajnë njerëzit në vend, por i ndjekin drejt emigrimit. Si dikur perandoritë, sot pushteti vendas e trajton popullin si burim, jo si subjekt.

Kështu, Shqipëria mbetet vendi i paradoksit të përhershëm: me një histori për t’u admiruar dhe një realitet për t’u vajtuar. Një vend që flet për lavdinë e së shkuarës, sepse e tashmja është shumë e dhimbshme për t’u mbrojtur. Shqiponjat tona fluturuan lart në histori, por ne, shqipet, vazhdojmë të ecim në tokë të lodhur, të zhgënjyer dhe gjithnjë gati për t’u larguar nga vendi ynë.

Ndoshta ka ardhur dita që, përpara se të dehemi nga zërat e zhurmshëm të interpretuesve të historisë, të zbresim më në fund në tokë. Përpara se të dëgjojmë me adhurim Eleni Kocaqin, Marin Memën, Sazan Gurin dhe korin gjithnjë në rritje të rrëfimtarëve të

lavdisë së përhershme, ndoshta duhet të ndalemi dhe të dëgjojmë atë që kemi zgjedhur ta shmangim. Natyrisht, historianët shqiptarë nuk gënjejnë hapur: ata thjesht tregojnë gjysmën e së vërtetës. Por historia na ka mësuar një gjë të thjeshtë: gjysma e së vërtetës është forma më elegante e gënjeshtërisë së plotë. Të thuash të vërtetën nuk ka kosto, është falas. Ndërsa të ndërtosh mite mbi heshtje, përzgjedhje dhe harresë selektive, na ka kushtuar shtrenjtë: identitet, vetëdije dhe, në fund, vetë të ardhmen.

Në vend të kësaj, sot dëgjojmë pseudo-shkrimtarë dhe pseudo-analistë që na servirin një histori qetësuese, gati narkotike. Një histori ku ne jemi gjithmonë të pafajshëm, gjithmonë viktimë, gjithmonë heroikë, ku faji është përherë i grekëve, i serbëve, i të huajve dhe ku në një përmbysje tragjike absurde, Turqia shfaqet si “mbrojtësi ynë më i madh”. Kjo nuk është analizë historike, por terapi e rreme kombëtare, një mënyrë për të shmangur pyetjen më të dhimbshme: çfarë kemi bërë ne vetë me veten tonë?

Tragjedia e vërtetë është se kjo histori e rreme na pëlqen më shumë se e vërteta. Ajo na lejon të ndihemi krenarë pa u ndier përgjegjës; të mallkojmë të tjerët pa u përballur me dështimet tona, të ëndërrojmë një lavdi të shkuar, ndërkohë që shkatërrojmë të tashmen. Ndërsa Kadareja, me gjithë ashpërsinë e tij, na fton në një akt të rrallë qytetar: vetëkritikën.

Ndoshta pikërisht kjo është arsyeja pse duhet ta dëgjojmë sot. Sepse një shoqëri që ushqehet vetëm me mite nuk zgjohet kurrë. Dhe një komb që i trembet së vërtetës, sado e dhimbshme të jetë ajo, mbetet i dënuar ta ripërsërisë tragjedinë e vet, herë si farsë, herë si emigrim masiv, por gjithmonë si humbje.

Disa nga të vërtetat më të hidhura që duhet të ndriçojmë, janë pikërisht ato që kemi mësuar t'i shmangim. *E para*: shpesh kemi zgjedhur mbijetesën mbi dinjitetin, kompromisin mbi përballjen, heshtjen mbi revoltën. Kjo na ka mbajtur gjallë në afat të shkurtër, por na ka varfëruar shpirtërisht në afat të gjatë. *E dyta*: kemi kultivuar një kulturë nënshtrimi ndaj pushtetit, ku sundimtari pranohet si i

pashmangshëm dhe jo si i përkohshëm. *E treta*: kemi pranuar shpesh padrejtësinë si “normalitet” dhe e kemi shndërruar korrupsionin, nepotizmin dhe servilizmin në mekanizma funksionimi shoqëror.

Një tjetër e vërtetë e dhimbshme është mungesa jonë kronike e vetëkritikës. Ne dimë të jemi të ashpër me të tjerët, por të mëshirshëm me veten. Dimë të shkruajmë histori për armiqtë, por jo për fajet tona. Dhe pikërisht këtu qëndron tragjedia: pa vetëkritikë nuk ka reformim, pa reformim nuk ka të ardhme.

Historia shqiptare ka plagë që nuk janë thjesht pasojë e pushtimeve të huaja, por edhe rezultat i zgjedhjeve tona kolektive, i frikës sonë historike dhe i mungesës së një ndërgjegjeje të qëndrueshme qytetare. T’i përmendësh këto të vërteta me emra dhe ngjarje nuk është akt armiqësor ndaj kombit, por një përpjekje për ta nxjerrë atë nga mjegulla morale ku endet prej shekujsh.

Që nga vdekja e Skënderbeut, shqiptarët kanë treguar një aftësi të jashtëzakonshme për t’u përçarë, pikërisht atëherë kur bashkimi ishte jetik. Grindjet e brendshme dhe pazaret personale u bënë më të forta se interesi i përbashkët; Hamza Kastrioti mbeti jo thjesht figurë historike, por model i përsëritur i sjelljes sonë politike.

Nën Perandorinë Osmane, shqiptarët mësuam të mbijetojnë dhe, madje, të ngjiten lart në hierarki, duke prodhuar pashallarë e vezirë, por jo një vetëdije shtetformuese. Ndërtuam Stambollin, reformuam perandorinë, ndërsa Shqipërinë e lamë në pritje. Jetonim si individë të suksesshëm, por jo si komb i vetëdijshëm. Kur fqinjët tanë kishin hedhur themelet e shteteve moderne, ne ende debatonim për alfabetin. Kongresi i Manastirit ishte një arritje kulturore madhore, por njëkohësisht një sinjal alarmi: po hynim në shekullin XX duke u marrë ende me bazat elementare të identitetit kombëtar.

Pavarësia e vitit 1912 solli flamurin, por jo unitetin. Shteti lindi i dobët, i kapur nga interesa personale dhe feudale. Esat pashë Toptani nuk ishte përjashtim i rastësishëm, por shenjë e një elite, që e shihte pushtetin si pronë private dhe shtetin si mall pazari. Edhe diktatura nuk ra nga qielli. Ajo u ushqye nga frika, u pranua nga lodhja dhe u

mbajt gjallë nga bashkëpunimi i heshtur. Nuk ishte vetëm vullneti i një diktatori, por një sistem, ku shumëkush zgjodhi të shërbejë, të heshtë ose të përfitojë.

Pas viteve '90, Shqipëria humbi një tjetër mundësi historike. Në vend të drejtësisë, zgjodhi harresën. Dosjet u mbyllën, përgjegjësitë u ricikluan dhe 1997-a u shfaq si pasojë e drejtpërdrejtë e mashtrimit dhe vetëmashtrimit kolektiv. Në të gjitha këto etapa, një pjesë e madhe e inteligjencës nuk u ngrit si ndërgjegje kritike, por u përshtat me pushtetin e radhës. Nga oborret e pashallarëve te partia dhe më pas tek oligarkët, komoditeti u zgjodh më shpesh se e vërteta.

Këto të vërteta dhembnin, sepse na rrëzojnë mitin e përhershëm të viktimës. Tragjedia jonë nuk qëndron vetëm tek ajo që na bënë të tjerët, por tek ajo që pranuan dhe normalizuan vetë. Prandaj pyetja thelbësore mbetet kaq e rrezikshme dhe kaq e shmangur: a do të vazhdojmë të jetojmë duke u ankuar për historinë, apo do të guxojmë, më në fund, ta shkruajmë atë?

Në historinë shqiptare, të vërtetat e hidhura nuk janë thënë nga shumica, por nga pak zëra të vetmuar, shpesh të anatemuar në kohën e tyre. Faik Konica denoncoi pa mëshirë provincializmin, servilizmin dhe mungesën e kulturës qytetare, duke e quajtur shoqërinë shqiptare të papërgatitur për shtet. Gjergj Fishta i dha satirë brutalitetit moral dhe hipokrizisë kombëtare, duke ekspozuar përçarjen dhe mendjemadhësinë boshe. Fan Noli foli hapur për elitën grabitqare dhe dështimin moral të klasës politike, duke e parë shtetin si një projekt të tradhtuar nga vetë shqiptarët.

Kadareja nuk ka qenë kurrë narkotizues i ndërgjegjes kombëtare. Ai na nxjerr nga roli i viktimës së përhershme dhe na ul në bankën e të akuzuarve. Ai nuk e ktheu historinë shqiptare në mit lavdie, por në autopsi morale, si një trup i lodhur, ku frika ka jetuar më gjatë se liria dhe nënshtrimi ka qenë më funksional se revolta. Prandaj sulmohet. Prandaj banalizohet. Sepse Kadareja na rrëzon maskat dhe na detyron të pranojmë një të vërtetë të padurueshme: ne nuk kemi qenë vetëm viktima të tiranisë, por edhe materiali i saj. Ai tregoi se

diktatura nuk sundon vetëm nga lart, por ushqehet nga heshtja, përshtatja dhe bashkëfajësia jonë kolektive. Dhe kjo është arsyeja pse Kadareja nuk falet: sepse ai nuk na lejon të gënjejmë veten. Arshi Pipa, nga burgu dhe mërgimi, artikuloi më qartë se kushdo përgjegjësinë morale të shoqërisë për diktaturën. Këta intelektualë nuk e ledhatuan kombin; ata e plagosën me të vërtetën, sepse vetëm kështu shpresonin ta zgjonin.

Këto të vërteta duhen ndriçuar jo për të na poshtëruar si popull, por për të na çliruar. Sepse vetëm kur pavetëdija bëhet vetëdije, fati pushon së qeni justifikim dhe kthehet në përgjegjësi. Vetëm atëherë shqiptari pushon së pyeturi “pse na ndodh gjithmonë ne?” dhe fillon të pyesë “çfarë po bëjmë ne që na ndodh gjithmonë kjo?”. Dhe kjo pyetje, sado e dhimbshme, është fillimi i vetëm i një historie tjetër. Nëse do ta lexonim shoqërinë shqiptare si një dosje psikologjike kolektive, do të shihnim jo një “mallkim”, por një grumbull traumash të pashëruara, të trashëguara dhe të riprodhuara brez pas brezi. Problemet më të mëdha psikologjike të shqiptarëve nuk janë misterioze; ato janë pasojë logjike e një historie të dhunshme, të ndërprerë dhe të paanalizuar kurrë seriozisht. Dalja nga ky rreth vicioz nuk është ekonomike apo thjesht politike: është “psikologjike dhe kulturore”. Fillon aty ku frika pranohet, trauma emërtohet dhe viktimizimi zëvendësohet me përgjegjësi. Vetëm kur shqiptari pushon së pyeturi “pse na ndodh kjo?” dhe fillon të pyesë “çfarë po mbajmë brenda që e prodhon këtë?”, tragjedia humbet statusin e fatit dhe kthehet në problem që mund të zgjidhet.

Shqipëria nuk vuan nga mungesa e ligjeve apo e projekteve, por nga mungesa e guximit për t’u parë në pasqyrë. Në vend që të shohim veten në pasqyrë, do të krijojmë një komision për ta interpretuar atë. Se e vërteta, pa ndërmjetës, është shumë e rrezikshme. Kriza jonë është më e thellë se ekonomia dhe më kokëfortë se institucionet: ajo është historike dhe psikologjike. Pa një ballafaqim të ndershëm me të shkuarën, e ardhmja mbetet një premtim i shtyrë pafund. Zgjidhja nuk nis me slogane, por me të vërtetën: me

hapjen e arkivave, me dëshmi që thyejnë heshtjen, me rrëzimin e miteve që na kanë mbajtur peng. Diktatura nuk ishte një emër i vetëm, por një mekanizëm frike, konformizmi dhe kompromisi moral, ku shoqëria u bë pjesë e heshtur. Ta pranosh këtë është e dhimbshme, por shëruese. Një shoqëri piqet kur pranon fajin, jo kur stolis krenarinë. Vetëm duke kaluar nga roli i viktimës te përgjegjësia, Shqipëria mund të ndërtojë një narrativë të re më të vërtetë, më të pjekur, më të lirë.

1.4 NGJARJET E MARSIT 2004 DHE PROJEKTI SERB PËR NDARJEN E KOSOVËS

Nga dr. Gurakuq Kuçi

Tani, 22 vjet pas trazirave të marsit dhe në dritën e rishikimit të ngjarjeve të viteve të fundit, si sulmi terrorist në Banjskë, sulmi në Ibër-Lepenc dhe kapja e një rrjeti të spiunazhit të lidhur me BIA-n në Kosovë, trazirat e marsit marrin një kuptim më të qartë politik dhe strategjik. Ngjarjet duken si pjesë e një logjike, ku kriza e sigurisë, infiltrimi dhe destabilizimi përdoren për ta mbajtur veriun e Kosovës të kontestuar e shtetësinë e Kosovës të paplotë.

Infrastruktura dhe kontrolli ilegal i Veriut (2000-2004)

Pas luftës në Kosovë, situata nuk karakterizohej vetëm nga tranzicioni institucional dhe vendosja e pushtetit nga misionet ndërkombëtare, por në të njëjtën kohë edhe nga vendosja e një realiteti paralel nga strukturat ilegale serbe në enklavat serbe, e sidomos në veri të Kosovës. Raportet e organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe Grupin Ndërkombëtar të Krizave (ICG), i përshkruanin qartë këto fenomene dhe, për këtë, në vitin 2002, ata sqaronin ndikimin dhe financimin e Serbisë për ndarjen e Kosovës.

Ky grup kërkonte në mënyrë eksplicite presion ndaj Beogradit për të ndërprerë mbështetjen për strukturat paralele në veri të Mitrovicës. Raporti vinte në pah infiltrimin e Beogradit në Kosovë dhe financimin e strukturave paralele, duke përfshirë në qendër grupin “Rojat e urës”. Raporti theksonte se financimi bëhej drejtpërdrejt nga Ministria e Brendshme e Serbisë (MUP) dhe përbënte një shkelje të Rezolutës 1244 të OKB-së. I njëjti raport vinte në pah edhe faktin, se Misioni Ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara (UNMIK), asokohe e kishte të vështirë të vendoste autoritetin e vet matanë Ibrit, për shkak të pranisë së institucioneve paralele serbe të financuara nga Beogradi.

ICG-ja kërkonte nga komuniteti ndërkombëtar që ta kushtëzonte ndihmën financiare për Serbinë me ndërprerjen e

mbështetjes për strukturat paralele. Po ashtu, propozohej që Serbisë, për shkak të këtyre veprimeve, t'i mohohej anëtarësimi në Këshillin e Europës, në Partneritetin për Paqe me NATO-n dhe në marrëveshjet me BE-në. Analistët e raportit argumentonin se Beogradi nuk do të bashkëpunonte në këtë drejtim pa një presion serioz ndërkombëtar, të barabartë me atë që u përdor për të siguruar bashkëpunim me Tribunalin e Hagës, pasi stabiliteti politik në Kosovë ishte në rrezik. Ky raport analizonte hollësisht, asokohe, përpjekjet e Serbisë për ndarjen dhe kantonizimin e Kosovës, duke i identifikuar këto si strategji të Beogradit, për ta mbajtur nën kontroll veriun dhe për të diktuar statusin final të Kosovës. Raporti theksonte se Mitrovica ishte e ndarë *de facto* dhe se qëllimi i Beogradit ishte ndarja përfundimtare e provincës. Plani i kantonizimit, si propozim i Beogradit, synonte ndarje formale gjeografike përmes një sistemi të “vetësundimit”, ku, sipas këtij plani, serbët do të kontrollonin 30% të territorit të Kosovës, të ndarë në pesë kantone. Madje, propozim ishte edhe ndarja sipas modelit të Bosnjës dhe krijimi i “entiteteve”.

Serbët, që më së shumti e shtynin këtë ide, ishin nga qeveria e Serbisë e deri tek ata me pozita në Kosovë. Lista fillonte me Vojislav Koshtunicën, kryeministër asokohe; Nebojsa Çović, zëvendëskryeministër i Serbisë dhe udhëheqës i qendrës koordinuese për Kosovën; Branislav Kërstić, zëvendës drejtor i qendrës koordinuese dhe autor i shkrimeve ku bazoheshin propozimet e Çovićit për kantonizim; Oliver Ivanović, asokohe anëtar i koalicionit “POVRATAK”; Marko Jakshiq, nënkryetar i partisë DSS dhe udhëheqës radikal në veri; si dhe Millan Ivanović, kryetar i Këshillit Kombëtar Serb të Kosovës Veriore, i cili, bashkë me Jakshiqin, shmangnin bashkëpunimin me UNMIK-un dhe kërkonin ndarjen etj. Synimi ishte që gjithmonë të paraqitej se multietniciteti nuk funksionon.

Në atë kohë, ICG-ja raportonte se Beogradi kishte derdhur në Kosovë mbi 50 milionë euro vetëm në tetë muajt e parë të vitit 2001. Sipas raportuesve, Banka Botërore duhej t'i ndalte ndihmat për

buxhetin e Serbisë, pasi paratë e kësaj banke tërthorazi përfundonin në financimin e strukturave paralele.

Se sa të fuqishme dhe të paprekshme ishin këto struktura paralele, këtë e tregon fakti, se në një përleshje të bandës së Slavoljub Jovic “Pagi”, pjesëtar i Rojave të Urës, me policët e UNMIK-ut, nga këta të fundit mbetën të plagosur 26 policë.

Të gjitha këto përbënin një provokim strukturor dhe një krijim situatash, që çonin në ndarjen e Kosovës nëpërmjet strukturave paralele, sistemeve të segregimit, grupeve që mbanin gjendjen e tensionuar nëpërmjet përplasjeve, barrikadave rrugore, konfrontimeve tek ura etj.

Trazirat e marsit 2004 dhe indikacionet për përfshirjen e Serbisë

Edhe raporte të tjera të asaj kohe theksonin elementin e tendencave të Serbisë për kantonizimin e Kosovës apo ndarjen e saj. Në raportin e “Human Rights Watch” për trazirat e marsit 2004, vlerësohej se kishte shqetësime të mëdha të pala shqiptare nga ngritja e “institucioneve paralele” nga Beogradi. Sipas raportit, frika rritej edhe nga dështimi i UNMIK-ut për t’i sfiduar këto struktura dhe kjo lejonte Beogradin ta bënte akt të kryer kantonizimin e Kosovës.

Po ashtu, i njëjti raport përmendte edhe “Rojat e urës” si grup, ku bëhej pikënisja e dhunës në çdo rast, duke identifikuar si vendtakimin e tyre kafenenë “Dolce Vita”, që ndodhej pranë urës.

Nebojsa Çović, në një intervistë të tij, tregonte për një operacion të fshehtë ushtarak të kryer nga forcat serbe në emër të mbrojtjes së Manastirit të Graçanicës gjatë trazirave të marsit. Ai deklaronte se, bashkë me një grup kryesisht parashutistësh dhe oficerësh policie, kishin kaluar kufirin me veturë civile dhe ishin vendosur brenda kishës. Ai më tutje shtonte se kishte kontaktuar komandantin e KFOR-it për t’u takuar. Ky i fundit i kishte kthyer se nuk mund ta takonte për shkak të largësisë, por kur Çović i njofton se ai tashmë është në Manastir dhe kishte arritur rreth orës 09:00 të mëngjesit, kjo kishte shkaktuar befasi te komandanti i KFOR-it. Kjo

deklaratë e Çoviqit tregon se Serbia e dinte më herët se çfarë pritej të ndodhte në Kosovë.

Shfrytëzimi politik i trazirave dhe avancimi i planeve për ndarje

Në një raport të muajit prill 2004 nga Borut Grgic dhe Jana Urh prezantohet plani i Beogradit, menjëherë pas trazirave të marsit, për ndarje etnike. Qëllimi ishte një ndarje inxhinierike përmes decentralizimit të pushtetit mbi baza etnike, me rajone autonome që dërgonin drejt ndarjes.

Një raport tjetër, që përmban shumë analiza nga disa autorë, shpjegon të njëjtën gjë: se si Beogradi po synonte ndarjen e Kosovës. Tim Judah argumentonte se plani i Beogradit parashikonte krijimin e pesë distrikteve autonome serbe, që do të formonin “Komunitetin Autonom Serb të Kosovës dhe Metohisë”. Janusz Bugajski, po ashtu, argumentonte se plani për “decentralizimin etno-territorial” është një përpjekje e hershme për ndarjen e Kosovës. Madje, asokohe, Bugajski tërhiqte vërejtjen, se nuk ka një rrugë të tretë për Kosovën mes varësisë dhe pavarësisë, dhe se vonesat për përcaktimin e statusit inkurajojnë radikalët dhe planet për ndarje.

Këto trazira u përdorën fuqishëm nga Beogradi kundër lëvizjes së Kosovës drejt statusit final, duke argumentuar se qeverisja multietnike është e paqëndrueshme dhe duke shtyrë përpara planet e tyre për kantonizimin dhe ndarjen e Kosovës, të cilat i kishin filluar para trazirave të marsit.

Më 25 gusht 2005, Nebojsa Çoviq shkarkohet nga detyrat, për shkak të përplasjeve të tij të shpeshta me Koshtunicën, i cili asokohe mbante pozitën e kryeministrit. Çoviqi e akuzonte qeverinë për mungesë të strategjisë së qartë për Kosovën dhe bllokim të iniciativave të tij. Ndërsa, në anën tjetër, shkarkimi i tij u shoqërua me akuza të rënda për keqpërdorimin e fondeve shtetërore të destinuara për serbët në Kosovë, që publikisht ishin të destinuara kryesisht për ndërtimin e shtëpive që nuk përfunduan kurrë. Këto akuza publike lënë hijen e përdorimit të tyre të dështuar në trazirat e marsit.

Çoviqi më pas u zëvendësua me Sanda Rashkoviç-Iviq, e cila kishte një qasje më të afërt me Koshtunicën.

Vazhdimësia e një strategjie: nga marsi 2004 deri sot

Tani, 22 vjet pas trazirave të marsit dhe në dritën e rishikimit të ngjarjeve të viteve të fundit, si sulmi terrorist në Banjskë, sulmi në Ibër-Lepenc dhe kapja e një rrjeti të spiunazhit të lidhur me BIA-n në Kosovë, trazirat e marsit marrin një kuptim më të qartë politik dhe strategjik. Ngjarjet duken si pjesë e një logjike, ku kriza e sigurisë, infiltrimi dhe destabilizimi përdoren për ta mbajtur veriun e Kosovës të kontestuar, shtetësinë e Kosovës të paplotë dhe për ta penguar konsolidimin e plotë të saj. Ndaj marsi 2004 paraqitet si një provokim dhe nxitje, që kishte si synim krijimin e një ambienti, ku të dëshmohej se multietniciteti nuk funksionon dhe se ndarja e Kosovës ose trajtimi i saj si çështje e papërfunduar mbetet opsion politik.

Parë nga perspektiva kronologjike, nga ngjarjet para marsit 2004, ato më pas e deri më sot, kuptohet se ekziston një strategji e qëndrueshme, e cila synon realizimin e planeve të Serbisë për ndarjen e Kosovës dhe që ka ndryshuar në forma dhe modele veprimi ndër vite, por jo në qëllime. Pikërisht në këtë kuptim, krizat nuk shfaqen vetëm si episode dhune, por edhe si mjete për të prodhuar pasoja politike dhe për të shtyrë përpara objektiva, që Serbia nuk ka arritur t'i realizojë me mjete të drejtpërdrejta. Transdisiplinariteti në analizimin e këtyre ngjarjeve ofron një pasqyrë, që e zhvesh propagandën dhe e vendos fokusin mbi faktet.

(Autori është profesor në kolegjin “Universum”, bashkëpunëtor i jashtëm në ISLH “OCTOPUS” dhe në Institutin Shqiptar për Gjeopolitikë - ISHGJ)

1.5 MITROVICA, KUFIRI KU KOSOVA MËSOI TË BËHET SHTET

Nga Dijana Toska

Mitrovica nuk është vetëm histori e një qyteti të ndarë. Është prova më e madhe se sa i brishtë është shteti kur nuk e ushtron veten; sa i fortë bëhet kur merr përgjegjësitë dhe sa i rrezikshëm bëhet krimi kur tolerohet nga të gjithë. Mitrovica na tregoi se plagët nuk shërohen me heshtje; shërohen me vullnet dhe me të vërtetën e shqiptuar pa frikë. Mitrovica nuk është më kufiri i frikës, është kufiri i kurajës së re të Kosovës.

Mitrovica është shpirti i zbuluar i shtetit të Kosovës. Një territor që, për një çerek shekulli, bartte mbi vete gjithë mëkatet e politikës ndërkombëtare dhe gjithë dobësitë e politikës vendore. Aty ku përshkohen shpejt datat, vendimet, marrëveshjet e nënshkruara e të pazbatuara, një terren ku gjithçka ndryshonte shumë ngadalë, aq ngadalë, sa çdo vit shtesë i jepte Serbisë edhe më shumë kohë për ta thelluar kontrollin, edhe më shumë hapësirë për të kultivuar frikën, si dhe më shumë terren për të rekrutuar varësinë e qytetarëve të vet.

Nëse Kosova ka një metaforë të luftës së saj të brendshme për shtet, ajo është Mitrovica. Qyteti që mbeti jashtë çlirimit në vitin 1999, u la pezull nga frika e një përplasjeje ushtarake, u stis nga politika ndërkombëtare si “zonë e ndjeshme”, u ndërtua nga Serbia si laborator i kontrollit kriminal, u harrua nga institucionet e Kosovës, u përdor nga politikanë vendorë si kartë patriotike për fushata zgjedhore, u keqpërdor nga diplomatët e BE-së si eksperiment i dështuar i multietnicitetit, dhe u quajt “tokë neutrale” nga të gjithë, vetëm që të mos quhej me emrin e tij të vërtetë: *territor i braktisur*. Në këtë qytet, më shumë se në çdo vend tjetër të Ballkanit, shihet fytyra e botës së pasluftës: një botë që kërkon *status quo* më shumë se drejtësi; një botë që ka frikë të ngrejë zërin kundër Serbisë; një botë që luan politika të ftohta gjeostrategjike në kurriz të njerëzve të zakonshëm. Për vite të

tëra, diplomatët e BE-së flisnin për “normalizimin e jetës në veri”, ndërsa jeta e vërtetë atje nuk kishte asgjë normale: kishte frikë, presion, banditizëm, dhunë, por, mbi të gjitha, kishte një sistem të tërë të ngritur për ta mbajtur këtë territor sa më larg shtetit të Kosovës. Një “normalitet” i rremë, i mbështetur mbi heshtjen ndërkombëtare dhe mbi pasivitetin e institucioneve vendore, u quajt *përparim*. Në fakt ishte iluzion.

Mitrovica na mësoi se pa shtet, pa rend, pa vullnet politik dhe pa kurajë morale, liria mbetet vetëm fjalë. Ky qytet na tregoi se liria e Kosovës ishte e paplotë, derisa të hyhej në veriun e saj jo vetëm me polici, por me vetëbesim, me strategji dhe me vijë të qartë politike, se askush nuk e negocion territorin. Na tregoi se frika nga Serbia është shumë më e vogël, sesa frika që ushqueu vetë Kosova nga mëdyshja e saj. Dhe se diplomacia europiane nuk është gjithmonë aleati i së drejtës, por shpesh është aleati i *status quo*-së.

Nëse kërkojmë të kuptojmë pse Mitrovica ka qenë plagë për 25 vjet, përgjigjet nuk janë misterioze: sepse Serbia punoi pa pushim, ndërkohë që Kosova priti; sepse bandat krijuan ekonomi të tëra paralele, ndërkohë që shteti nuk ndërhynte; sepse ndërkombëtarët ushtronin presion mbi Prishtinën, ndërsa Beogradit i bënin thirrje “për përmbajtje”; sepse për çdo barrikadë, diplomacia i drejtohej Kosovës “të mos e acarojë situatën” dhe sepse për çdo sukses të vogël të Kosovës në veri, dikush nga jashtë e quante “veprim të njëanshëm”. Mitrovica pasqyroi edhe dobësitë tona: paaftësinë për të ndërtuar strategji afatgjata, ndarjet e brendshme politike, retorikën pa vepra, përdorimin e patriotizmit si dekor e jo si politikë konkrete, mungesën e guximit për të marrë vendime të vështira.

Por Mitrovica na tregoi edhe diçka tjetër: se ***kur Kosova vendos, rezultatet duken***. Kur filloi të ndërhyjë me operacione policore, kur vendosi të mos tërhiqet përballë presioneve diplomatike, kur e quajti krimin krim e jo “situatë të ndjeshme”, kur e shihte veriun jo si problem, por si pjesë të vetën, atëherë gjithçka filloi të lëvizë.

Banjska ishte çasti i së vërtetës

Sulmi terrorist i Radojçiçit, i orkestruar nga strukturat e Serbisë, e çoi botën përballë një realiteti të pastër: veriu i Kosovës nuk kishte qenë peng i etnisë, por peng i krimit të organizuar, të financuar nga Beogradi dhe i toleruar për 20 vjet nga heshtja ndërkombëtare. Pas asaj dite, Serbia nuk mund ta fshihte më dorën. Por as BE-ja nuk mund ta fshihte më dështimin e saj.

Në këtë pikë, Kosova fitoi moralin e shtetit të drejtë: ajo nuk luftoi për interes politik, por për siguri, rend e ligj. Dhe pikërisht sepse bëri gjënë e duhur, u ndëshkua nga BE-ja me masa politike e ekonomike - absurdi i fundit i një epoke të vjetër diplomatike, që nuk është në koherencë me kohën e re.

Dhe në kulm të këtij paradoksi, erdhën zgjedhjet e vitit 2025 në Mitrovicë, ku një pjesë e qytetarëve votuan jo për ata që e çliruan territorin, por për ata që, në një mënyrë apo në një tjetër, e lanë veriun nën robëri. ***Mitrovica nuk kishte nevojë për balotazh.***

Ky qytet duhej ta dinte se liria nuk matet me kalkulime, por me mirënjohje. Ata që sollën çlirimin e veriut meritonin votën e zemrës që në raundin e parë, pa ngurrim, pa mëdyshje, pa llogari politike. Sepse ka momente kur populli nuk voton për parti, por për drejtësi; jo për kandidat, por për ata që i kthyen frymën territorit të harruar për një çerek shekulli.

Por historia nuk mbyllet me një rezultat zgjedhor. Historia mbyllet me fakte. Dhe faktet janë këto: veriu i Kosovës sot është më i sigurt se kurrë; bandat janë dëmtuar; Serbia është ekspozuar botërisht si sponsori kryesor i destabilitetit; ndërkombëtarët nuk e kontrollojnë më narrativën si dikur; dhe shteti i Kosovës është i vetmi aktor, që ka prodhuar ndryshim real në terren. Për herë të parë që nga viti 1999, Mitrovica është në tërësinë e saj të Kosovës. Për herë të parë në Mitrovicë ka më shumë prishtinas sesa beogradas. Dhe kjo është fitore pa zhurmë, fitore e heshtur, fitore që shumë media në Kosovë nuk deshën apo nuk ditën ta mbrojnë si duhet, duke harruar se gazetaria është mbrojtja e parë e shtetit.

Kjo analizë nuk mbyll vetëm historinë e një territori, por mbyll rrëfimin e një ndërtimi shteti. Mitrovica nuk është vetëm histori e një qyteti të ndarë. Është prova më e madhe, se sa i brishtë është shteti kur nuk e ushtron veten; sa i fortë bëhet kur merr përgjegjësitë dhe sa i rrezikshëm bëhet krimi kur tolerohet nga të gjithë.

Mitrovica na tregoi se plagët nuk shërohen me heshtje, por shërohen me vullnet dhe me të vërtetën e shqiptuar pa frikë. Në fund, ***Mitrovica nuk është më kufiri i frikës, është kufiri i kurajës së re të Kosovës.*** Dhe kjo, më shumë se çdo marrëveshje, çdo presion diplomatik, çdo votë, është ajo që do ta përcaktojë të ardhmen e këtij vendi.

Mitrovicë, u bëfsh dritë për kombin!

28 nëntor 2025

1.6 ROLI I SHOQATAVE SERBE NË TRAGJEDITË NJERËZORE NË BALLKAN, SIDOMOS KUNDËR SHQIPTARËVE

Nga dr. Enver Bytyçi

Në përpjekje për të realizuar “Botën Serbe” Vulin këto ditë krijoi Shoqatën Historike Ruse në Serbi me program “ndërtimin paqësor të botës serbe”! Ky hap është shumë i rrezikshëm për stabilitetin, sigurinë dhe paqen në rajonin tonë dhe në kontinentin europian.

Aleksandër Vulini është një figurë e njohur në Serbi, në Rusi dhe më gjerë. Për më shumë se një dekadë ka qenë krah i djathtë i Aleksandër Vuçiqit, si dhe kreu i grupeve kriminale serbe, që kanë punuar për destabilizimin e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Vulini ka drejtuar jo vetëm Ministrinë e Brendshme e të Mbrojtjes të Vuçiqit, por edhe BIA-n, pra Shërbimin Sekret të Serbisë. Njihet si mik i shquar i Rusesë, i Putinit dhe Lavrovit, dhe si përkrahës e zbatues i të gjithave planeve anti-BE e anti-SHBA në rajonin tonë. Është një prej njerëzve besnikë të presidentit Vuçiq, i ngarkuar me detyrën e stërvitjes së terroristëve me emrat e Milan Radoiqit.

Aq i dukshëm ishte Aleksandër Vulin, sa nuk u fsheh kurrë në lidhjet e tij me Moskën, edhe në kohët e sulmeve ushtarake të saj në Ukrainë. Thuhet se është një prej garantuesve të influencës ruse në Ballkan dhe së bashku me Dodikun e Vuçiqin përbëjnë treshen më të rrezikshme për destabilizimin e tij. Vulini ishte ministër i Mbrojtjes i Serbisë, kur para disa vitesh në prani të presidentit të Serbisë shpalli projektin e “Botës Serbe” në Ballkan. Ky projekt u prezantua sipas modelit të projektit të Aleksandër Dugin dhe Vladimir Putin për “Botën Ruse”!

Sipas projektit të “Botës Serbe”, Serbia duhet të luftojë me vetëmohim për të rikthyer brenda kufijve të saj të gjitha territoret ku banojnë serbët, ose ku flitet serbisht e sllavisht, ku aplikohet kultura dhe tradita serbe dhe, madje, edhe ku gjenden varrezat e “martirëve

serbë”! Kjo formulë, në fakt, është e njohur nga shqiptarët dhe popujt e tjerë joserbë në Ballkan. Është e njohur nga projekti i Naçertanies së Garashaninit. Po ashtu edhe nga memorandum i 7 marsit 1937 të Vasa Çubrilloviçit, nga rekomandimet e Vlladan Gjoregjeviçit, Nikolla Pashiqit; nga *Raporti për Shqipërinë* i vitit 1939 të Ivo Andriçit, Aleksandër Rankoviçit, si dhe nga fjalimet e Slllobodan Milosheviçit. Por edhe nga memorandum i vitit 1995 i shefit të presidentit Vuçiç me emrin Vojislav Sheshel dhe nga Memorandumi i vitit 1986 i Akademisë së Shkencave të Serbisë për të ashtuquajturin “Gjenocid të shqiptarëve kundër serbëve”!



Në përpjekje për të realizuar “Botën Serbe”, Vulini këto ditë krijoi Shoqatën Historike Ruse në Serbi, me program “ndërtimin paqësor të botës serbe”! Ky hap është shumë i rrezikshëm për stabilitetin, sigurinë dhe paqen në rajonin tonë dhe në Kontinentin European. Për të kuptuar se pse ky rrezik është vërtet kërcënues, ne mund të kthehemi mbrapsht në histori dhe të shohim se cili ka qenë roli i shoqatave të tilla të Serbisë nga fillimi i shekullit XX e deri më

sot. Gjithmonë Beogradi kur ka planifikuar luftëra, konflikte dhe spastrime etnike, fillimisht ka krijuar organizata ekstremiste e terroriste, si Shoqata Historike Ruse në Serbi, dhe ka nisur fushatat e spastrimit etnik, të cilat kanë përfunduar me tragjedi të mëdha, me humbjen e jetëve të mijëra e dhjetëra mijë njerëzve të pafajshëm.

Organizata e parë çetnike serbe u krijua në vitin 1902. Duke nuhatur shpërbërjen e Perandorisë Osmane, Beogradi mori të gjitha masat për të realizuar idetë e tij të Serbisë së Madhe, e cila sot përshfaqet me projektin e “Botës Serbe”. Këshilli kryesor i organizatës së parë çetnike të Serbisë u themelua në Beograd. Atëherë u tha se çetnikët nuk kishin të bënin me qeverinë e Serbisë, por në fakt, organizata u financua nga shteti serb dhe prapa saj qëndronte ish-ministri i atëhershëm i Luftës, Millovan Pavloviç. Në organizatën çetnike në fjalë bënin pjesë ushtarakë, politikanë, tregtarë e biznesmenë, intelektualë dhe njerëz të tjerë me autoritet, të cilët ishin gjithashtu përgjegjës për planifikimin, drejtimin dhe organizimin e akteve terroriste kundër popujve joserbë në Ballkan, sidomos kundër shqiptarëve. Në këshillin kryesor të organizatës ishte edhe gjenerali Jovan Atanaskoviç dhe kapiteni i ushtrisë, Dimitroje Aspiç. Ky i fundit më pas u bë shef i zbulimit të ushtrisë së Serbisë, sigurisht për merita të veçanta në angazhimin e tij në organizatën ekstremiste të çetnikëve.

Në vitin 1908 ishte marrë vesh se Perandoria Osmane do të shkatërrohej. Ndaj dhe shteti serb po përgatitej që, me çdo kusht e me çdo mjet, të përfitonte territore nga rënia e kësaj perandorie. Këto territore i shihte në jug, në drejtim të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë, si dhe në Perëndim, në drejtim të Bosnjë-Hercegovinës. Për të realizuar këto synime, qeveria serbe mbështeti dhe financoi krijimin dhe veprimtarinë e organizatës “Narodna Obbrama” (Mbrotjtja Popullore). Qendra ishte në Beograd. Por veprimtaria e saj u orientua në Kosovë dhe Maqedoni. Kryetari kësaj organizate u caktua gjenerali në pension, Bozha Jankoviç, një njeri i afërt dhe besnik me kryeministrin serb, Nikolla Pashiq. Ky gjeneral e udhëhoqi

organizatën e lartpërmendur deri në tetor të vitit 1912, kur filloi sulmi i ushtrisë serbe për pushtimin e Kosovës dhe të Shqipërisë së Veriut, për të siguruar daljen e Serbisë në Adriatik (Durrës dhe Lezhë).

Në këtë moment, gjenerali Jankoviç emërohet *Komandant i Armatës së Tretë* të Ushtrisë së Serbisë, e cila kishte marrë si detyrë asgjësimin e popullsisë shqiptare në Kosovë, Shkup, veri të Shqipërisë (Lumë) dhe territore të tjera, ku jetonin shqiptarët. Aleksandër Leo Freundlich në librin e tij “Golgota e Shqipërisë”, flet për 25 mijë shqiptarë të masakruar të kësaj periudhe, shumica dërmuese fëmijë, gra dhe pleq.

Pas kësaj organizate, nën kujdesin dhe me financimin e qeverisë së Beogradit në vitin 1911 u themelua edhe një organizatë tjetër famëkeqe. Ajo mori emrin “Ujedinjenje ili Smrt” (Bashkim ose vdekje). Ndrshe quhej edhe si organizata “Dora e zezë”! Njësoj si edhe Shoqata Historike Ruse në Serbi, edhe organizata “Bashkim ose vdekje” e vitit 1911 kishte në programin e saj bashkimin e serbëve në një perandori të vetme. Brenda kësaj “perandorie” ajo përfshinte Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Shqipërinë e Veriut. Të njëjtat territore synon gjithashtu projekti i “Botës Serbe”, i lansuar vitet e fundit.

“Bashkim ose vdekje” më pas e quajtur edhe si “Dora e zezë”, u organizua më mirë se dy organizatat e përmendura më parë. Në Prekuplje, afër Nishit, ajo hapi një shkollë dhe përgatiti çetnikët serbë për luftën terroriste kundër shqiptarëve dhe popujve të tjerë joserbë. Të njëjtën gjë kanë bërë dekadën e fundit Vuçiqi dhe Vulini në Nish, kur ngritën kampin rus të përgatitjes së akteve terroriste në Ballkan, ku akti më i njohur është tentativa e grushtit të shtetit në Mal të Zi (2015). Në shkollën e Prekupljes e kanë fillin shumë prej emrave të njohur të terrorit serb në periudhën e Luftërave Ballkanike dhe gjatë Luftës së Parë Botërore. “Dora e zezë” ishte ekzekutuesja e atentatit të 28 qershorit 1914 kundër Princit Të Kurorës së Austro-Hungarisë, Franc Ferdinandit dhe gruas së tij, Sofisë, në Sarajevë. Atentatori ishte Gavrilo Principi, por në aksionin terrorist mori pjesë edhe i riu, Vasa

Çubrilloviq, i cili më vonë do të bëhej ministër në qeverinë e Beogradit dhe akademik i Serbisë, madje mendja djallëzore e asgjësimit të shqiptarëve.

Është shumë interesant fakti, se në periudhën e Millosheviçit këto organizata morën thjesht emra të tjerë, si *Tigrat e Arkanit* ose *Beretat e Kuqe*. Po ashtu, sot kemi përtëritjen e traditës përmes Shoqatës Historike Ruse në Serbi me autor dhe drejtues ish-ministrin e Mbrojtjes së Serbisë, Aleksandër Dugini. Shoqata dhe organizata të tilla janë shumë të rrezikshme për rajonin dhe paqen në Europë. Nëse vrasja e Franc Ferdinandit në vitin 1914 çoi në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, nuk duhet injoruar fakti që Serbia përpiqet të bëjë të njëjtën gjë në këto kohë të vështira për të.

Edhe në dekadat e fundit kanë ndodhur ngjarje të ngjashme me atë të fillimit të shekullit XX. P.sh., vrasja e ish-kryeministrit të Serbisë, Zoran Xhinxhiç (2003) i ngjan vrasjes së ish-mbretit të Serbisë, Aleksandër dhe mbretëreshës Draga Mashini natën e 28-29 majit 1903.

Asokohe ishte togeri Dimitrije Aspiç me 120 ushtarakë, që sulmuan Pallatin Mbretëror dhe masakruan çiftin mbretëror. Po ashtu i ngjan vrasjes më 20 qershor të vitit 1928 të katër deputetëve kroatë në parlamentin e Beogradit nga një anëtar radikal serb i këtij parlamenti. Ndërkohë duhet kujtuar se viktimë e terrorit të organizatave ekstremiste të Serbisë ishte edhe ish-ministrja e Punëve të Jashtme të Suedisë, Anna Lind, e cila u vra në Stokholm më 10 qershor 2003 nga një ekstremist e terrorist serb me emrin Mihajlloviç!

Beogradi është i pranishëm sot në Kosovë përmes agjentëve të tij sekretë, ndër ta jo pak edhe shqipfolës. Madje eksponentë të Shërbimit Sekret në Beograd mburren publikisht për këtë prani në Kosovë. Prandaj dhe Europa sidomos, por edhe SHBA-ja dhe vende të tjera që duan paqen, stabilitetin dhe sigurinë duhet t'u druhen pasojave të tilla nga një organizatë e tillë, si kjo Shoqata Historike Ruse e Serbisë, e themeluar nga njeriu më i afërt i presidentit Aleksandër Vuçiç qe me të njëjtin emër, por me mbiemrin Vulin!

1.7 ALARMI I KUQ

Pse Shoqëria Historike Ruse e ravijëzon përkatësinë neosovjetike të Serbisë?

Nga dr. Arben Fetoshi

Themelimi i degës së “Shoqërisë Historike Ruse” në Beograd është treguesi më i qartë i superstrukturës hegjemoniste të “vëllazërisë sllave”, që shënon kërcënimin më serioz për sigurinë dhe rendin demokratik.

Qendra “arsimore” e politikës ekspansioniste në epokën cariste (1866), e ringjallur nga Vladimir Putin më 2012 për të komanduar “të vërtetën” ruse nëpërmjet veglës së tij më të sofistikuar, drejtorit të Shërbimit të Jashtëm të Inteligjencës (SVR), Sergei Jaryshkin, e davariti mjegullën e “integritit europian” të Serbisë, duke e nënshtruar plotësisht atë me “lakun” strategjik të Rusisë.

Shefi i degës në Beograd, Aleksandër Vulin, ish-ministër i Brendshëm dhe ish- shef i Shërbimit të Inteligjencës serbe (BIA), i sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për korrupsion dhe lidhje me Kremlinin, e shpërfaqti të vërtetën e shoqërisë në Asamblenë Themeluese në Beograd, duke e prezantuar si një “pikë takimi për të gjithë ata, të cilët e shohin Serbinë si një shtet që do të luftojë pa asnjë rezervë për krijimin paqësor të botës serbe dhe si aleat i vërtetë i Rusisë e Kinës”.

Strategjia e maskuar si “mbrojtje”

Për vetëm katër ditë (24-27 tetor), tri ngjarje të ndërlidhura shpërfaqën tri nivele të një strategjie të maskuar: Aleksandër Vuçiqi amplifikoi narrativën “Serbia drejt BE-së, por pa e njohur Kosovën”; Aleksandër Vulini institucionalizoi “nënshtrimin” strategjik ndaj Rusisë përmes shoqërisë “historike” dhe Sergei Lavrovi propozoi një model të ri të sigurisë për Euro-Azinë, “duke garantuar” se nuk kanë pasur dhe nuk kanë qëllim të sulmojnë ndonjë anëtar të NATO-s dhe BE-së.

Ky trinom Lavrov-Vuçiq-Vulin riformuloi qëndrimin ndaj komunitetit euroatlantik (duke përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor) sipas alternativës: ose lejoni realizimin e interesave ruso-serbë në Europë, ose do të përballeni me luftë. Një strategji e maskuar kjo, që përbën bazën e zbatimit të idesë gjeopolitike të Aleksandër Dugini për Neoeuroaziatizmin.

Megjithatë, nëse “Qendra Humanitare Ruso-Serbe” në Nish (2012) ishte hapi i parë drejt “putinizimit” të Serbisë, themelimi i “Shoqërisë Historike” paraqet zgjatimin më të sofistikuar të saj, që synon ta mishërojë “të vërtetën” e fabrikuar përmes politikës së kujtesës.

Një qendër spiunazhi e kamufluar me mision humanitar, që ka përgatitur infrastrukturën operative përmes rekrutimit, trajnimit e rrjetëzimit, u përforcua me një qendër “akademike” të lidhjes serbo-ruse “për t’u mbrojtur” nga NATO-ja, demokracia dhe Perëndimi - “armiqtë” e “botës së tyre” (Bota Ruse dhe Bota Serbe). Në kuadër të strategjisë, “Shoqëria Historike” që udhëhiqet nga veglat “inteligjente” të Putinit, Jaryshkin dhe Vulin, do të shërbejë si platformë për:

- rishkrimin e historisë në përputhje me narrativat për NATO-n si “agresore” dhe Serbinë si “viktimë”;
- përhapjen e propagandës kulturore dhe diplomatike nën petkun e “akademizmit”;
- përgatitjen e terrenit për depërtim në institucionet arsimore dhe mediatike.

Nëse deri tani ndikimi rus në Serbi kalonte përmes energjisë, medieve dhe politikës, tani ai po institucionalizohet me “historiografinë” dhe kujtesën kolektive, teksa është paralajmëruar të zgjerohet edhe përmes një asociacioni të universiteteve ruso-serbe.

Ndërkaq, karakteri shtetëror i “Shoqërisë Historike” në Beograd, përveçse me Aleksandër Vulinin si “autor” i projektit të “Botës Serbe” dhe jo rastësisht i emëruar edhe senator për Republikën Serbe, vërtetohet nga pjesëmarrja e gjerë politike dhe institucionale

me ministrin e Brendshëm, Ivica Daçiq, zëvendëskryetarin e Parlamentit, Neveda Gjuriq, patriarkun e Kishës Ortodokse, Porfirije etj.

Taktizimi me “neutralitetin”

Në kuadër të “armatosjes” së Serbisë si pika perëndimore e frontit euroaziatik të Putinit, Aleksandër Vuçiqi vazhdon të përfaqësojë “neutralitetin” e fasaduar, me qëllim përfitimin nga procesi i integritetit evropian. Me qasjen e përsëritur se “nuk do ta njohë kurrë Kosovën” dhe i gatshëm për anëtarësimin e Serbisë në BE, ai në fakt prezanton instrumentin perfid të Kremlinit për ta mbajtur Serbinë të lidhur me Brukselin, duke e konceptuar si portë për interesat strategjike të saj. Ndryshe nuk ka si të shpjegohet militarizimi që i ka bërë Serbisë me diversifikim të burimeve (avionët francezë “Rafale”, sistemet ruse dhe armët kineze FK-3/HQ-22 të mbrojtjes ajrore), duke e përdorur taktikisht Francën për “balancim” me Perëndimin.

Militarizimi nuk është “neutralitet”, ashtu siç nuk janë as vizitat e tij në Moskë e Pekin, angazhimi për “Botën Serbe” dhe vendosmëria për të mos iu bashkuar vendeve të tjera kandidate me sanksionet ndaj Rusisë. Përkundrazi, realiteti ka treguar një angazhim gjithnjë e më të hapur në kuadër të politikës revizioniste përmes sinkronizimit të luftës hibride, duke kombinuar propagandën, religjionin, diplomacinë dhe veprimet e kontrolluara ushtarake në Kosovë dhe rajon. Deklaratat e Vuçiqit për “ndryshimin e rrethanave gjeopolitike” konfirmojnë objektivat për destabilizim dhe rrënim të infrastrukturës aktuale të sigurisë, si një parakusht për realizimin e “Botës Serbe”. Në këtë kuadër, *Shoqëria Historike Ruse në Serbi* është një projekt që sendërton infrastrukturën ideologjike për fazën finale të përplasjes ruso-serbe me Perëndimin.

Alarmi i “kujtesës së manipuluar”

Nëse “Shoqërinë Historike Ruse” e vendosim në kontekstin e qëllimeve të Serbisë ndaj Kosovës, përtej kërcënimit për sigurinë, ajo

duhet të shihet si elementi më sfidues ndaj përpjekjeve perëndimore për normalizim nëpërmjet Procesit të Brukselit.

Një shoqëri “shkencore” që udhëhiqet nga njerëz të inteligjencës nuk konsiston në prodhimin e dijes, por të ndikimit. Në këtë kontekst, dega e saj në Beograd do t’i shërbejë etablimit të “kujtesës së manipuluar” si një instrument mobilizimi. Këtë qasje e ka përdorur Serbia, duke kombinuar aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë, si: Lista Serbe, strukturat ilegale, grupet terroriste, mediat, kisha dhe rrjeti i spiunazhit, për të forcuar “unitetin” serb në Kosovë kundër “shtetit të përkohshëm” dhe “agresionit” të NATO-s.

Ka provuar sulme terroriste, duke i arsyetuar si “reagime” me narrativën e “persekutimit të serbëve”, ka ndërhyrë në zgjedhje për të minuar demokracinë, ka fuqizuar propagandën mashtruese të viktimizimit për të thelluar ndarjet etnike dhe ka mohuar krimet për të imponuar “të vërtetën” e saj, duke pretenduar “ilegalitetin” sipas të drejtës ndërkombëtare, pavarësisht vendimit të GJND-së (ICJ, 2010).

Kësaj strategjie tani i duhet “shoqëria historike”, për ta internalizuar në vetëdijen kolektive Rusinë si “shpëtimtare” dhe për ta konsoliduar rezistencën ndaj NATO-s, Perëndimit e demokracisë si “kërcënim” për vlerat, identitetin dhe “vëllazërinë sllave”. Në këtë kuadër, Kosova rrezikohet nga qëllimet e “shoqërisë historike” për të formësuar vetëdijen e komunitetit serb sipas këtyre parametrave. Prandaj, themelimi i degës në Beograd duhet të shihet si një alarm për mbrojtjen e së vërtetës historike, duke mos lejuar që historia të kthehet në armë për qëllimet hegjemoniste.

1.8 PERDJA E TYMIT

Nga Ditimir Bushati

Premtimet entuziaste për përmbylljen e negociatave brenda vitit 2027 dhe procesin e anëtarësimit në Bashkimin Europian brenda vitit 2030 u eklipsuan disi nga nisma e përbashkët e Kryeministrit të Shqipërisë dhe Presidentit të Serbisë, botuar në gazetën gjermane “Frankfurter Allgemeine Zeitung”, për heqjen dorë nga anëtarësimi dhe pranimi i njëfarë raporti “të nivelit të dytë” me BE-në. Që prej agresionit rus në Ukrainë, politika e zgjerimit të BE-së ka pësuar një zhvendosje. Nga anëtarësimi i fundit në BE i Kroacisë në vitin 2013 e deri në shkurtin e vitit 2022, zgjerimi ishte një proces i ngecur dhe i kontestuar politikisht. Si pasojë e luftës, tani ai po konsiderohet një instrument i rëndësishëm për sigurinë europiane.

Sot, procesi i zgjerimit të BE-së nuk ka si qëllim vetëm që vendet kandidate të bëjnë reforma në drejtësi, ekonomi dhe shoqëri. Ai përdoret edhe për t'i lidhur më ngushtë këto vende me BE-në nga ana gjeopolitike dhe e sigurisë, në një kohë kur lufta në Europë ka krijuar pasiguri, luftë e cila ka hyrë në vitin e pestë të saj.

Në këtë sfond është intensifikuar edhe debati nëse procesi i zgjerimit kërkon modele të reja institucionale ose jo, me qëllim intensifikimin e tij. Ndër të tjera, është propozuar: (i) një proces “pranimi gradual” apo me faza të ndryshme, ku secila fazë lidhet me plotësimin e reformave të caktuara; (ii) “integrimi në tregun e brendshëm” të BE-së, si një etapë e ndërmjetme dhe parapërgatitore për të lehtësuar anëtarësimin në BE; (iii) “zgjerim i përmbysur”, që i jep përparësi anëtarësimit para përmbushjes së kriterëve, shoqëruar me garancitë përkatëse për përmbushjen e tyre duke qenë pjesë e BE-së.

Propozime të tilla synojnë të pajtojnë urgjencën gjeopolitike me kornizën e deritanishme të procesit të anëtarësimit në BE. Nga propozimet e lartpërmendura, ai i “zgjerimit të përmbysur” është hedhur poshtë nga vendet anëtare të BE-së, të cilat këmbëngulin në

një proces që kombinon reformat në fushën e sundimit të së drejtës me linjëzimin gjeopolitik.

Ndërkohë, nisma e Kryeministrit të Shqipërisë dhe e Presidentit të Serbisë krijon një perde tymi, pasi propozon modele që nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin: pjesëmarrjen në tregun e brendshëm të BE-së dhe në zonën “Shengen”, duke hequr dorë nga anëtarësimi në BE.

Për një çështje si anëtarësimi në BE, i cili konsiderohet një objektiv kombëtar për t’u përmbushur, pas anëtarësimit në NATO, nisma do të duhej t’i nënshtrohej paraprakisht një diskutimi të njëjmentë politik e shoqëror. Qeveria duhet të demonstrojë aftësi për të kryer tri detyra: (i) kuptimin në kohë të problemeve që kanë lidhje me etapat e ndryshme të procesit të zgjerimit; (ii) përpunimin e thelluar të rrugëzgjdhjeve që propozon pa u shmangur nga përgjegjësia; dhe (iii) formulimin e një strategjie në mënyrë transparente për zbatimin e asaj çka është më e dobishme si rrugëzgjdhje.

Ne shqiptarët nuk kemi asnjë dilemë dhe mbetemi të patundur në aspiratën tonë për t’u bashkuar me popujt e tjerë në familjen europiane. Ndaj meritojmë të informohemi për arsyet e kësaj nisme e të dëgjohemi se çfarë mendojmë se duhet bërë për të jetësuar rrugën europiane. E prezantuar për audiencën gjermane, e cila mban barrën kryesore të shpenzimeve financiare në BE, nisma u përcoll me ftohtësi nga politika gjermane. E vetmja që komentoj nismën ishte komisionerja e zgjerimit, e cila tha se *“propozuesit nuk e kanë idenë se sa shumë punë e reforma nevojiten për të qenë pjesë e tregut të brendshëm dhe Zonës Shengen”*. Një deklaram shkurajues, krahasuar me qëndrimet e mëparshme të saj, se *“objektivi i Shqipërisë për të përmbyllur procesin e bisedimeve për anëtarësim me BE-në brenda vitit 2027, është një objektiv ambicioz, por i arritshëm”*. Nëse përmbyllja e negociatave është një objektiv i arritshëm, nuk ka arsye që pjesëmarrja në tregun e brendshëm të BE-së, që në çdo rrethanë

është më pak sesa anëtarësimi, të mos jetë një objektiv i arritshëm për Shqipërinë.

Gjithashtu, çdo sugjerim dhe nismë nga ana e komisioneres për ngjizjen e një procesi politik dhe demokratik krejtësisht të munguar, që në fakt duhet t'u paraprinte nismave të tilla në Shqipëri dhe Serbi, do të vlerësohej si ndjeshmëri e institucionit që ajo përfaqëson ndaj vlerave dhe parimeve të demokracisë, dialogut dhe mirëkuptimit politik. Në të njëjtën kohë, do të sinjalizonte edhe një rikthim në traditën më të mirë të Komisionit Europian, duke treguar kujdes të posaçëm për inkurajimin dhe respektimin e proceseve demokratike në jetën politike dhe shoqërore, më shumë sesa për mbushjen e kutizave të shumë e shumë planeve, matricave e strategjive, që në një pjesë të rasteve nuk prodhojnë efekte të matshme në jetën e qytetarëve.

Keqkuptimet për tregun e brendshëm

Pjesëmarrja në tregun e brendshëm për vendet joanëtare të BE-së do të thotë pranim i rregullave të BE-së për zbatimin e lirisë së lëvizjes së mallrave, shërbimeve, kapitaleve dhe njerëzve, por pa pasur mundësinë e përfitimit financiar dhe shfrytëzimin e instrumenteve që korrigjojnë pabarazitë që mund të krijohen, të cilat janë të disponueshme vetëm për vendet anëtare. Ndërsa zona “Shengen” nuk është një paketë ekonomike, por një regjim strikt besimi, që përfshin sigurinë, drejtësinë, politikën e vizave dhe kontrollin kufitar.

Është e rëndësishme të dihet se Zona Ekonomike Europiane u krijua në vitin 1992 për të mundësuar pjesëmarrjen në tregun e brendshëm të BE-së të vendeve, si: Norvegjia, Islanda, Lihtenshtajni, të cilat nuk synonin anëtarësimin, por një treg të përbashkët me BE-në, për shkak të interesit ekonomik dhe politik të ndërsjellë. Vendet e lartpërmendura pranuan rregullat e mbikëqyrjes së BE-së, për shkak të madhësisë së tregut dhe standardit të lartë, pasi Zona Ekonomike Europiane përbëhet nga ekonomi të zhvilluara me institucione të konsoliduara, demokraci të përparuara, standarde sigurie dhe sundim të së drejtës. Në këtë mënyrë, si anëtarët e BE-së, ashtu dhe joanëtarët

përfitojnë në një treg më të madh e më të rregulluar, ku ekonomitë kombëtare janë në gjendje të përballojnë forcat e konkurrencës dhe ku konsumatori ka më shumë mundësi zgjedhjeje.

Në praktikë, kjo do të thotë se të gjitha bizneset dhe njerëzit trajtohen sikur të jenë pjesë e BE-së dhe mund të vendosen e të lëvizin lirisht kudo bizneset e tyre, pa kurrfarë pengese tarifore apo jotarifore. Gjithashtu, rregullat e prokurimit publik janë në mbështetje të tregut të brendshëm. Parimet e përgjithshme të tregut, si: mosdiskriminimi, transparenca, trajtimi i barabartë, njohja e ndërsjellë, proporcionaliteti aplikohen edhe për prokurimin publik.

A mund të jetë modeli i Norvegjisë, Islandës dhe Lihtenshtajnit i zbatueshëm në rastin e Shqipërisë dhe Serbisë? Ky mund të ishte një opsion që duhej eksploruar shumë kohë më parë në bashkërendim edhe me nismat e integritetit rajonal. Ky i fundit është konsideruar gjithnjë si parakusht për anëtarësimin në BE. Por, fatkeqësisht, vijon të mbetet i pashfrytëzuar siç duhet ose i keqshfrytëzuar.

Në Samitin e Sofjes në vitin 2018, BE-ja dhe Ballkani Perëndimor u angazhuan për krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal të Ballkanit Perëndimor, si parapërgatitje për përfshirjen e rajonit tonë në tregun e brendshëm të BE-së. Në vend që të punonin për përshejtimin e këtij procesi të ndërlikuar që kërkon përmbushjen e standardeve europiane, Kryeministri i Shqipërisë dhe Presidenti i Serbisë krijuan një projekt paralel, të quajtur Ballkani i Hapur, qëllimi dhe rezultatet e të cilit mbeten edhe sot të paqara.

Mund të tingëllojë ironike, por sapo Shqipëria përparoi me grup-kapitujt për anëtarësim në BE e braktisi “Ballkanin e Hapur”. Teksa presim Raportin për Piketat e Ndërmjetme dhe qëndrimin e përbashkët të BE-së për grup-kapitullin e parë, që ka lidhje me sundimin e së drejtës dhe që është përcaktues për cilësinë dhe shpejtësinë me të cilën do të mbyllet kapitujt e anëtarësimit në BE, Shqipëria ribashkohet me Serbinë, duke deklaruar heqjen dorë nga anëtarësimi dhe pranimin e njëfarë raporti “të nivelit të dytë” me BE-në.

Duke lënë mënjanë kontekstin e mësipërm kontradiktor, në pamje të parë kërkesa për t'u bërë pjesë e tregut të brendshëm të BE-së mund të duket tërheqëse, pasi njerëzit me të drejtë orientohen për nga përfitimet ekonomike kudo në botë. Shqiptarët dhe serbët nuk bëjnë përjashtim në këtë drejtim. Mjafton të kujtojmë impaktin që pati te qytetarët dhe bizneset rënia e “Murit të Shengenit” dhe sigurimi i lëvizjes pa viza.

Mirëpo në BE nuk ka asgjë falas. Sidomos kur bëhet fjalë për tregun e brendshëm, i cili është një nga format më të sofistikuar të integritimit ekonomik që njohim deri më sot. Pjesëmarrja në të nuk është si shëtitjet në park, por si garat olimpike, ku nevojitet stërvitje serioze dhe e përditshme. Tregu i brendshëm funksionon mbi një nivel besimi për zbatimin pa pengesa të lirisë së mallrave, shërbimeve, kapitaleve dhe njerëzve. Për ta bërë të mundur këtë, vendet anëtare të BE-së duhet të besojnë se ne kemi jo vetëm ligjet e shkruara, por edhe kapacitetin për të zbatuar rregullat dhe politikat e BE-së.

Tregu i brendshëm i BE-së nuk ka të bëjë veç me ekonominë, por mbi të gjitha, me sundimin e së drejtës në ekonomi. Ndaj integrimi në tregun e brendshëm të BE-së është i pamundur, nëse nuk ndryshohet modeli i tanishëm i qeverisjes, që bazohet te personalizimi i pushtetit dhe kontrolli i plotë mbi të gjitha institucionet, metastazat e korrupsionit dhe krimin të organizuar në sektorët kritikë të ekonomisë.

Hetimet e SPAK-ut në lidhje me tenderët në infrastrukturë dhe teknologji, ndër të tjera, na dëshmojnë nevojën për të siguruar një garë të barabartë për të gjithë bizneset vendase apo europiane, duke zbatuar rregullat e prokurimit publik dhe të konkurrencës. Po kështu, nevojiten politika dhe veprime që krijojnë besimin e vendeve anëtare për sa i takon zhbllokimit të fondeve të BE-së në fushën e bujqësisë dhe teknologjisë, si pasojë e shkeljeve të pretenduara dhe hetimeve të ndërmarra nga institucionet europiane dhe shqiptare. Me fjalë të tjera, çdo para që del nga buxheti i shtetit apo euro që vjen nga buxheti i BE-së dhe që prokurohet, duhet t'i nënshtrohet së njëjtës logjikë.

Shkurt, pa sundim të së drejtës, demokraci dhe mirëqeverisje as që mund të imagjinohet pjesëmarrja në tregun e brendshëm të BE-së, rritja e fuqisë prodhuese, eksportuese dhe as gëzimi i përfitimeve që vijnë prej kësaj pjesëmarrjeje.

Nismëtarët bëjnë të qartë se nuk po kërkojnë integrim institucional në BE. Pra, nuk e konsiderojnë pjesëmarrjen në tregun e brendshëm si një etapë të ndërmjetme drejt anëtarësimit në BE. Austria, Suedia dhe Finlanda fillimisht u bënë pjesë e tregut të brendshëm të BE-së dhe më pas u pranuan në BE. Gjithashtu Islanda, e cila është pjesë e tregut të brendshëm, ka paralajmëruar mbajtjen e një referendumi, për t'u konsultuar me qytetarët në lidhje me anëtarësimin e mundshëm në BE. Në rast se qytetarët do të përgjigjen pozitivisht, atëherë Islanda do të jetë vendi i 28-të i BE-së.

Pjesëmarrja në institucionet e BE-së është një element përbërës i procesit të anëtarësimit dhe pa të anëtarësimi nuk ekziston. Sado që qëllimi i nismës mund të jetë për të hapur vetëm derën e tregut të brendshëm të BE-së, duke njohur vështirësitë e hapjes së derës së madhe të BE-së, ambicia jonë nuk mund të përfundojë këtu. Aq më tepër që BE-ja është treguar bujare me Shqipërinë, duke na dhënë mundësinë për të hapur me një shpejtësi të paprecedentë të gjithë grup-kapitujt, dhe duke pritur prej nesh përmbushjen e kriterëve që kanë të bëjnë me mbylljen e tyre për anëtarësimin në BE.

Nuk duhet të harrojmë se në mjedisin e tanishëm gjeopolitik BE-ja udhëhiqet jo vetëm nga logjika e tregtisë, por edhe nga logjika e sigurisë dhe, madje, e mbrojtjes së integritetit të tregut të vet. Prandaj, investimet gjithashtu shikohen nën prizmin e sigurisë. Kjo është arsyeja pse BE-ja ka miratuar rregullore mbi shqyrtimin e investimeve të huaja direkte. Këto elemente pasqyrohen edhe në procesin e bisedimeve për anëtarësim, për të vlerësuar se kush po investon, ku po investohet dhe kush kontrollon sektorë kyç, të tillë, si: energjia, infrastruktura, telekomunikacioni, të dhënat dhe teknologjitë e përparuara.

Iluzioni i “Shengenit”

Përvoja e vendeve me të shkuar të ngjashme me atë të Shqipërisë dhe Serbisë tregon se vendet fillimisht janë bërë pjesë e BE-së dhe më pas pjesë e zonës “Shengen”. Kjo është e kundërta e asaj që propozohet në nismën e përbashkët të Kryeministrit të Shqipërisë dhe Presidentit të Serbisë, ku kërkohet pjesëmarrja në “Shengen” pa qenë pjesë e BE-së.

Vendeve që u anëtarësuan në BE në vitin 2004 dhe që vendosën të bëhen pjesë e “Shengenit” iu deshën edhe katër vjet pas anëtarësimit në BE për t’u bërë pjesë e tij. Kroacisë, e cila u bë pjesë e BE-së në vitin 2013, iu deshën edhe dhjetë vite të tjera për t’u bërë pjesë e “Shengenit”. Ndërsa Bullgarisë dhe Rumanisë, që u anëtarësuan në BE në vitin 2007, iu deshën plot tetëmbëdhjetë vjet për t’u bërë pjesë e “Shengenit”. Pjesëtarët e “Shengenit” që nuk janë anëtarë të BE-së janë Zvicra, Norvegjia, Islanda dhe Lihtenshtajni. Standardi i lartë i të cilëve, i pakrahasueshëm me atë të Shqipërisë dhe Serbisë, nuk ka nevojë për komente të mëtejshme.

Faktet e sipërpërmendura flasin vetë. Për t’u bërë pjesë e “Shengenit”, kërkesat janë edhe më të rrepta sesa anëtarësimi në tregun e brendshëm apo anëtarësimi në BE, sepse kërkohet besim i plotë në institucionet e shtetit që po anëtarësohet, luftë pa kompromis ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, bashkëpunim i plotë në fushën policore dhe gjyqësore, si dhe harmonizim i plotë me politikat e BE-së.

Para së gjithash, ky bashkëpunimin nënkupton veprimin mbi urdhërarrestet europiane, në mënyrë që vendi që aderon në “Shengen” të mos bëhet një “strehë e sigurt” për individët apo grupet e strukturuar kriminale që i shmangen drejtësisë. Bilanci i policisë dhe i institucioneve ligjzbatuese shqiptare në ekzekutimin e urdhërarresteve të grupeve të strukturuar kriminale është tejet deficitar.

Ndjeshmëria ndaj kërkesave të përsëritura të partnerëve ndërkombëtarë për eliminimin e grupeve të krimit të organizuar është e ulët. Strukturat e sigurisë në përgjithësi dhe policia në veçanti vuajnë mungesën e besimit të partnerëve ndërkombëtarë. Asnjë strategji marketingu apo plan veprimi nuk e zëvendëson dot vullnetin e hekurt

politik në këtë fushë. E vetmja monedhë që vlen në këtë rast është besimi, se një vend kontrollon territorin e tij dhe rreziqet e sigurisë, dhe se institucionet ligjzbatuese funksionojnë njësoj për të gjithë.

Puna për t'u bërë pjesë e zonës “Shengen” është disafish më e vështirë dhe sfiduese, sesa përmbushja e kritereve që mundësuan heqjen e regjimit të vizave me zonën “Shengen”, apo përmbushja e kritereve për anëtarësim në BE. Prandaj, le të mos ushqejmë asnjë iluzion. Rruga jonë për në “Shengen” do të jetë edhe më e gjatë, edhe më e vështirë se ajo e pjesëmarrjes në tregun e brendshëm dhe anëtarësimit në BE.

Rruga e qëndrueshme

Në të tilla kushte, pyetja që kërkon përgjigje nga vetë nismëtarët e propozimit është se pse po kërkojnë nga BE-ja diçka që është e pamundur ta marrin dhe cila është vlera e këtij propozimi. Pse kjo perde tymi tani?

Cilado qofshin arsyet pas nismës, e sigurt është se, për Shqipërinë, e vetmja rrugë e qëndrueshme është anëtarësimi i plotë në BE dhe ulja me dinjitet në një tryezë, ku të drejtat dhe detyrimet vlejnë njësoj për të gjithë, dhe jo një raport dytësor me BE-në. Ndërkohë, shpërblimi nga ana e BE-së për reformat në fushën e sundimit të së drejtës dhe linjësimit gjeopolitik, mbeten thelbësore për efektivitetin e zgjerimit dhe për rolin e tij në forcimin e sigurisë europiane.

Anëtarësimi në BE mund të arrihet përmes ndërtimit të një klime bashkëpunimi e mirëkuptimi politik, që inkurajon sundimin e së drejtës, garanton zgjedhje të lira dhe të ndershme, lirinë e medias dhe zbatimin me rigorozitet të rregullave europiane në të gjitha fushat e qeverisjes. Ky qëllim mund të arrihet vetëm përmes reformave të qëndrueshme dhe rezultateve të matshme. Jo përmes iluzioneve apo shmangies nga përgjegjësitë politike.

***Analiza është marrë nga “Facebook”-u i autorit Ditmir Bushati.
Ajo është botim i fondacionit “Friedrich-Ebert-Stiftung”, Tiranë.
Titulli origjinal: *Perdja e tymit*.**

1.9 MËSUESI DHE FLAMURI

Nga Arbër Zaimi, politolog

Nacionalizmi kosovar, nën flamurin e multikulturalizmit, ka prodhuar decentralizimin etnik, shformimin e historisë, tentativën për shkombëtarizimin e shqiptarëve, si dhe pezullimin e vendimmarrjes demokratike ose ndalimin e referendumit shtetformues e kushtetues për një popull, i cili vazhdimisht ka qenë i angazhuar në përpjekje çlirimtare për pothuajse një shekull. Sot ky nacionalizëm “i ri” përpiket ndonjëherë ta neutralizojë edhe figurën historike dhe simbolike të Adem Jasharit.

Që Adem Jashari lindi në datën 28 nëntor mund edhe të ketë qenë rastësi, siç mund të ketë qenë edhe një datë e kërkuar nga prindërit e tij, kur kanë marrë vesh se e ëma, Zahideja, po pritej të lindte fëmijën andej nga fundi i nëntorit të vitit 1955. I ati, Shabani, mësues nga Prekazi, rridhte nga familje patriotike dhe vetë ishte i palëkundur në bindjet e tij shqiptariste. Dita e Flamurit për ta ishte destin, ndërsa lindja e Ademit në atë datë do ta ketë përforcuar entuziazmin në ato zona e ato familje, ku gëzimet e hidhërimet priteshin gjithnjë me atë flamurin e përndjekur dhe aq të shtypur prej regjimit jugosllav.

Një tjetër koincidençë e rrethanave bëri që Adem Jashari të shkonte në përjetësi në datën 7 mars, në ditën e tretë të qëndresës në një betejë epike. Por të dyja datat lidhen ngushtë me kthimin në simbol të këtij personaliteti të luftës çlirimtare. Përmes jetës e vdekjes së tij, Adem Jashari u bë një Flamur dhe një Mësues i rëndësishëm për kombin shqiptar, duke iu bashkangjitur panteonit të heronjve të rënë anëmbanë globit në luftë për çlirimin e popujve të tyre.

Jetojmë në periudhë relativizimesh, në periudhën e fetishizimit të opinionit si kufi i së vërtetës. Secili ka të drejtë të ketë një opinion, e pikërisht për këtë shkak asnjë opinion nuk është më i vlefshëm se tjetri dhe drejtësia bëhet e pamundur. Jetojmë një bashkëkohësi të

ngecur në efektin *Rashomon*, do të thoshte ndonjë opinionist liberal, cinik e prepotent, duke iu referuar filmit eponimik të Akira Kurosawas. Fundja, pretendojnë ata, a nuk është edhe puna e Adem Jasharit njësoj si historia e filmit, ku aktorë të ndryshëm e tregojnë ndryshe historinë, duke treguar se si subjektiviteti ndikon në këndvështrimin dhe përjetimin e gjërave dhe duke provuar se si secili aktor, në analizë të fundit, e ka një shpjegim justifikues për veprimet e veta? A nuk e shohin ndryshe serbët e ndryshe shqiptarët historinë e Adem Jasharit? Madje, edhe te shqiptarët, a nuk e shikojnë këtë histori nga pikëpamje të shumta, shpeshherë kundërtëne? Madje, ka pasur edhe nga ata, që e kanë vënë në pikëpyetje ditëlindjen e tij, si diçka të sajuar, sepse në fakt nuk paska qenë 28 Nëntori, por ndonjë datë tjetër. Përpjekje këto për ta shkëputur simbolikën e Adem Jasharit prej simbolikës kombëtare shqiptare, ndoshta me besimin se kështu rriten gjasat për kosovarizmin, si një projekt i ri kombëtarizues ose shkombëtarizues. Pasardhësit e Ademit u detyruan të dalin me certifikatat e lindjes, për t'u dhënë fund absurditeteve... edhe pse absurditetet nuk marrin fund kurrë.

I referohen efektit “Kurosawa”, ndoshta pa e njohur regjisorin e shquar japonez. Por Kurosawa nuk ishte relativisti postmodern. Madje, edhe në fund të filmit të sipërpërmendur me titullin “*Rashomon*”, ai e rikthen të vërtetën si diçka që ekziston përtej e pavarësisht narrativave ose opinioneve, kur njëri prej personazheve ngrihet përmbi rrëfimet egoiste dhe kujdeset për jetën e një foshnje të sapolindur, të mbetur pa përkujdesjen e askujt pas zhvillimit të ngjarjeve në film. Dashuria e painteres, e shfaqur prej personazhit që kujdeset për foshnjën e panjohur që simbolizon të ardhmen, tjetrin, të pambështeturin, tregon atë të vërtetën që as nuk mund ta përmbledhë e as nuk mund ta relativizojë dot opinionin. Ajo çka shpërfaq filmi “*Rashomon*”, pra, nuk qenka rrjeta që na mban në aporinë përfundimtare, së cilës nuk i ikim dot. Vetë Kurosawa ka rithirrur në vëmendjen tonë metaforën biblike të gjyqësisë së mbretit-profet, Solomonit apo Sulejmanit, i cili arriti të gjetja e zgjidhjes për dilemën

se cila prej dy grave është nëna e vërtetë e foshnjës, jo duke dëgjuar rrëfimet e opinionet e tyre, por duke vlerësuar se cila është gati të vetësakrifikohet, që foshnja të mbijetojë.

E, pra, në këtë kuptim, Ademi dhe gjithë heronjtë e familjes Jashari u sakrifikuan, që një foshnjë e panjohur prej tyre të mbijetojë. Ajo foshnjë është çështja kombëtare shqiptare, e cila shkon përpara si një aleancë mes atyre që kanë vdekur me atë ëndërr e dëshirë, të cilën e kanë lënë amanet, mes atyre që janë gjallë e që duhet të bëjnë më shumë dhe atyre që ende s'kanë lindur. Foshnja e panjohur nuk është vetëm çështja a koncepti abstrakt, por konkretisht është secili fëmijë që lind, në secilën familje shqiptare në trojet tona tradicionale ose në diasporë, i cili pavarësisht datës kur lind, ka brenda potencialin për ta çuar përpara atë amanet të këtij kombi që, siç është vënë në dukje prej filologëve e historianëve, nuk e nxjerr identitetin e vet politik as prej shtetësisë e as prej fesë, por prej gjuhës, diçka tepër e pazakontë në rajonin dhe kontinentin ku ndodhemi.

Te përpjekja për relativizim të Adem Jasharit krijohet një kaleidoskop shformues, në të cilin shfaqen këto këndvështrime: serbët nacionalistë, të cilët nuk janë thjesht millosheviqianë, përkundrazi shumica e tyre sot mendojnë se Millosheviqi ka qenë figura më dëmtuese ndaj nacionalizmit serb; e shohin Adem Jasharin si një terrorist, provokues i dhunës serbe, me qëllim shkëputjen e territorit të shenjtë serb të Kosovës e Metohisë nga Serbia. Kjo është narrativa ku, nëse marrim për bazë rezultatet zgjedhore, pak a shumë nënshkruhet 85 për qind e spektrit politik serb. Ata besojnë dhe/ose propagandojnë se Adem Jashari ka qenë një ultranacionalist shqiptaromadh, analfabet, brutal, ndoshta dhe islamist, i cili gjatë rrethimit në Prekaz mori peng fëmijët e gratë e familjes së tij, disa prej të cilëve edhe i vrau, që të mos dorëzoheshin te policia serbe. Sipas tyre, policia serbe paska qenë duke kryer një aksion të drejtë antiterrorist.

Serbët që shfaqen si liberalë, të cilët siç duket nuk janë më shumë se 10 për qind e spektrit politik në Serbi, në masë të madhe mendojnë se Adem Jashari mbase dhe i kishte të gjitha vetitë e këqija

që ia veshin atij serbët nacionalistë, por gjithsesi policia e ushtria serbe nuk do të duhet t'i sulmonte. Sipas tyre, shqiptarët kanë qenë dhe janë thjesht një pengesë, një bezdi, një kokëçarje për europianizimin e Serbisë, kështu që më mirë ta lënë Kosovën të shkëputet e të mos shpenzojnë energji me këto subjekte që duan shumë investim për t'u qytetëruar. Nënshtrati i liberalizmit serb shpesh është kulturalist: ata mendojnë se prapambetja e shqiptarëve në Jugosllavi është si pasojë e kulturës së tyre inferiore. Por, ndryshe nga nacionalistët, ata nuk besojnë se serbët duhet ta marrin përsipër misionin “qytetërues” ndaj shqiptarëve të prapambetur.

Pastaj janë edhe serbët, që dikush do t'i quante revolucionarë e dikush të emancipuar, por për mua janë thjesht normalë, të cilët janë një pjesë e vogël dhe e pamatshme e shoqërisë serbe, që mendojnë se lufta e shqiptarëve për liri ishte një luftë çlirimtare e shkolonizuese. Ata e zhvillojnë analizën e tyre mbi traditën socialiste të nisur prej D. Tucoviçit në fillim të shek. XX. E shohin prapambetjen kulturore dhe ekonomike të shqiptarëve në Jugosllavi si anën tjetër të medaljes të zhvillimit relativ të Serbisë, që për dekada me radhë zhvilloi një qasje tërësisht ekstraktiviste dhe shfrytëzuese ndaj Kosovës, duke ia marrë asaj burimet natyrore e njerëzore e duke e lënë të pazhvilluar. Në këtë kuptim, ata e shohin mbështetjen e së drejtës së shqiptarëve për luftë çlirimtare si të drejtë të tyre për t'u mbrojtur nga dhuna ultranacionaliste, shoviniste e, disa herë, edhe fashiste e shtetit serb. Adem Jashari, sipas tyre, është një nga figurat që ekspozon pushtetin serb në thelbin e tij.

Pos serbëve, janë edhe ndërkombëtarët e ardhur në Kosovë, që “deri dje” kanë qenë kryesisht liberalë, kur nuk kanë qenë moskokëçarës. Ata nuk shprehen shpesh, por po të flasësh, të lënë përshtypjen se mendojnë që Adem Jashari për shqiptarët është një hero mitik, meqenëse shqiptarët ende kanë nevojë për mite, ngaqë ekonomia dhe kultura e tyre është paramoderne. Për shumicën e ndërkombëtarëve, Adem Jashari - mit bashkë me figurat e tjera të UÇK-së që nderohen nëpër sheshe e rrugë të Kosovës, - janë shenjë e

inferioritetit kulturor. Ata neveriten prej veprimit fizik dhe Adem Jashari i trondit si figurë që e shkruan historinë me gjak. Këndvështrimi i tyre nuk është larg atij të serbëve liberalë.

Shqiptarët, mandej, ndahen nëpër parti. Për ata që e kanë mbështetur doktrinën zyrtare të partive të “krahut të luftës”, që erdhën në shprehje në disa nga qeverisjet në Kosovën e pasluftës, Adem Jashari është një hero që ka luftuar për çlirimin e Kosovës dhe për Bashkimin Kombëtar, por meqë kjo nuk u arrit, Adem Jashari do të duhet të shihet thjesht si legjendë, e jo si shënjuar me domethënie reale politike. Prandaj i referohen atij si “komandant legjendar”, edhe pse Ademi nuk ka qenë komandant e nuk ka qenë aspak mit ose legjendë, por një hero real, në krye të një lufte reale, në një sakrificë faktike e historike. Kur i thonë “legjendar”, duket sikur duan të thonë “nuk ka qenë bash ashtu”.

Në anën tjetër kanë qenë edhe shqiptarët, që mbështesnin doktrinën paqësore të autonomisë nën Serbi dhe që ishin kundër luftës çlirimtare. Për ta Adem Jashari është një figurë problematike, e cila duhet kritikuar me kujdes, pasi për shumicën është hero. Gjatë kohës që Adem Jashari ishte i rrethuar në Prekaz e gjatë kohës që në Kosovë zhvilloheshin luftime e Serbia e masakronte popullsinë civile, këta pacifistë përpiqeshin të mbanin zgjedhje presidenciale demokratike, a thua se për t’i treguar botës perëndimore se “gjendja në Kosovë, megjithatë, nuk ishte edhe aq e keqe”. Asokohe disa prej tyre u angazhuan edhe aktivisht në propagandën kundër UÇK-së, duke synuar të trembnin popullin që të mos e mbështeste ushtrinë çlirimtare. Është interesante të shohësh se si sot, po këta përpiqen të bëjnë një “pajtim” të sforcuar me simbolin e dëshmorëve dhe të Adem Jasharit, duke thënë se, ndërkohë që luftën e bënë dëshmorët, punën më të madhe për njohjen ndërkombëtare të çështjes kosovare e bënë pacifistët. Kjo nuk rezulton e vërtetë, pasi ndërkombëtarizimi i çështjes së çlirimit të Kosovës vrullin e mori menjëherë pas jehonës që shkaktoi masakra që policia serbe e shkaktoi në Prekaz. Nëse i

qëndrojmë të vërtetës historike, ndërkombëtarizuesi i vërtetë i çështjes së Kosovës ka qenë Adem Jashari.

Të fundit që do të mund t'i përmendnim janë ata shqiptarë, të cilët do të “kujdeseshin për foshnjën”. Janë ata, që e shohin sakrificën sublime të Adem Jasharit si një themel për sovranitetin e asaj foshnje, që është Kosova e lirë dhe populli i saj. Janë ata, që e shohin lirinë si kusht të pakapërcyeshëm për barazinë politike mes popujve, që do të ishte rruga e vetme për stabilizimin e reciprocitetit e për t'u dhënë fund armiqësisë. Janë ata, të cilët nuk e mashtrojnë veten duke thënë se Adem Jashari u vetësakrifikua për “kombin kosovar”, i cili është projekt i mëvonshëm, që mëton të krijojë një terren më të pranueshëm për Serbinë zyrtare, duke e neutralizuar dhe duke i tjetërsuar përpjekjet politike të shqiptarëve dhe historinë e tyre. Ata që kujdesen për “foshnjën”, janë ata që nuk e harrojnë amanetin e brezave që dhanë jetën për lirinë politike e popullore. Sipas tyre, epizmi i Adem Jasharit nuk lind prej nevojës së një populli “primitiv” për të pasur heronj, por prej nevojës së një ideologjie egërschane, për t'ia marrë frymën çdo përpjekjeje të të shtypurit për t'u bërë subjekt, për ta fituar barazinë.

Po si ka mundësi, mund të thotë dikush, që në fund të shekullit XX dhe në shekullin XXI të kthehemi sërish tek e drejta kombëtare? A nuk është e tejkalluar kjo?

Kjo pyetje është problematike, sepse është e njëanshme. Që të tejkallohet e drejta kombëtare, duhet të tejkallohet shtypja kombëtare. Nacionalizmi çlirimtar shqiptar, flamur e mësues i të cilit është Adem Jashari, kurrë nuk ka qenë shtypës, agresor ose shovinist ndaj ndonjë kombi tjetër. Kjo nuk do të thotë se nuk ka brenda tij problemet dhe eksceset e veta, as që është imun ndaj racizmit apo ksenofobisë. Por thjesht për arsye historike, shqiptarët nuk kanë mundur të zhvillojnë kurrë ndonjë pretendim politik për të ushtruar hegjemoni rajonale ose për të pushtuar toka të banuara nga të tjerë, siç kanë zhvilluar popuj të tjerë në Ballkan.

Vetë Kosova e Adem Jasharit ishte një territor i banuar nga një shumicë dërrmuese shqiptare. Më 1913 ajo u aneksua prej Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene dhe u shkëput dhunshëm nga marrëdhëniet e saj të natyrshme me krahinat e tjera ku jetonin shqiptarët. Studiues serbë, duke u bazuar në të dhënat demografike të kohës, tregojnë se si mbretëria SKS i spastroi fillimisht shqiptarët, duke i vrarë dhe duke i përzënë nga zona të gjera në veri e në lindje të asaj që sot është Kosova, të cilat i kishte pushtuar që në shekullin XIX. Dëshira për spastrimin e shqiptarëve vazhdoi edhe në shekullin XX dhe luftërat ballkanike sollën rastin më të mirë për këtë. Raportues të ndryshëm, ndër ta edhe Leon Trocki, kanë dëshmuar për mizoritë që janë bërë ndaj popullsisë shqiptare në atë kohë. Më vonë, pas mbarimit të luftërave ballkanike, spastrimi mori forma të tjera. Dokumente politike të shkruara në formën e programeve ose memorandumëve, si ai i Çubrilloviçit, rrëfenin se elementi spastrues vazhdoi të ishte përbërës i rëndësishëm i nacionalizmit serb, që përbënte kolonën kryesore ideologjike të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene.

Për t'i rënë shkurt një historie të gjatë, mjafton të themi se në Luftën e Dytë Botërore Italia pushtoi Shqipërinë dhe Kosovën, ndërsa për ta shtypur ndjenjën e rezistencës e për të krijuar pajtueshmëri në popullatë, shfrytëzoi sentimentin antiserb të krijuar gjatë shtypjes dhe dhunës që Serbia kishte ushtruar mbi ta dhe e shpalli një bashkim të Shqipërisë dhe Kosovës. Kuptohet, ky bashkim nuk ishte sovran e as popullor. Si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, pati rezistencë dhe luftë nacional-çlirimtare. Gjatë asaj lufte, Partia Komuniste e Shqipërisë dhe Partia Komuniste Jugosllave vendosën që çështjen e Kosovës ta zgjidhnin duke i njohur popullit të saj të drejtën për vetëvendosje. Kjo e drejtë u konfirmua nga përfaqësuesit serbë edhe në Konferencën e Bujanit (1943). Por, pas përfundimit të luftës, nën diktatin e armëve u organizua një tjetër konferencë, ku u vendos që Kosova të mbetej nën Serbi, pa marrë parasysh vullnetin e shumicës së saj. Marrëdhëniet e Jugosllavisë me Shqipërinë shumë shpejt u prishën, ndërkohë që në Kosovë organizimi kombëtar shqiptar doli në

ilegalitet dhe herë haptazi e më shpesh fshehurazi vijoi ta kundërshtonte për dekada me radhë sundimin serb në Kosovë.

Socializmi jugosllav, edhe pse në parim do të duhej të ishte indiferent ndaj etnisë a përkatësisë kombëtare, shpeshherë u shfaq edhe si një kolonializëm i kuq, në rastin e Kosovës. Kjo mund t'i tronditë jugo-nostalgjikët, por Kosova në vitin 1945 kishte të ardhura për kokë tri herë më të vogla sesa ato në Serbi. Ndërsa pas 45 vjetësh socializëm, pra më 1989, të ardhurat për frymë në Kosovë ishin shtatë herë më të ulëta sesa ato në Serbi. Si është e mundur që brenda socializmit, ku pretendohej dhe premtohej arritja e barazisë, pabarazia e trashëguar veç ishte thelluar? Prapë, duke iu referuar intelektualëve serbë të emancipuar, shqiptarët në Jugosllavi morën statusin e “zezakut”, qytetarit të dorës së dytë. Ata mbetën, u lanë të jenë shumë më pak e më keq të arsimuar, përjashto disa familje të favorizuara nga sistemi, dhe nuk kishin qasje në punë cilësore (kryesisht bënin punë krahull ose nxiteshin të emigronin në vendet perëndimore). Shqiptarët që organizoheshin politikisht për të kërkuar barazi e të drejta, merrnin damkën e nacionalistit dhe të separatistit. Të vetmit që mund të fitonin avantazhe ishin - po të përdornim një koncept nga lufta për të drejta civile në Amerikë - “zezakët e shtëpisë”, ata që pranonin t'u bindeshin urdhrave, që pranonin t'i shtypnin kërkesat e popullit të tyre, pra që bëheshin sundimtarë lokalë. Tradita e sundimtarëve lokalë nuk u shpik nga jugosllavët, pasi edhe më parë nën Perandorinë Osmane popullin e varfër e qeverisnin përgjithësisht bejlerët e agallarët vendas. Kësisoj ka qenë edhe në perandoritë paraosmane.

Edhe nën socializmin jugosllav vazhduan spastrimet, por me emër tjetër. U quajtën “shkëmbim popullsish mes Turqisë dhe Jugosllavisë”. Shqiptarët u quajtën turq, pa u marrë atyre asnjë mendim. Me turqit i lidhte veç feja, por jo gjuha, as kultura, as aspirata politike kombëtare. Kështu llogaritet që, mbi 250 000 shqiptarë, të jenë shpërngulur vetëm në vitet '50-të për në Turqi, me qëllim “rregullimin e demografisë”. Shkëmbimi zakonisht nënkupton marrje e dhënie, por kësaj radhe shkëmbimi ishte njëkahësh, se nuk

kishte “jugosllavë” të vinin nga Turqia në Kosovë. Në Kosovë kryesisht erdhën kolonë të subvencionuar nga Serbia. Pak a shumë, po ajo strategji që kemi parë në veprim përgjatë dekadave në Rripin e Gazës ose në Bregun Perëndimor.

Megjithatë, ndryshe nga historia e palestinezëve, kosovarët kurrë nuk përqafuan veprimtari terroriste, nuk sulmuan civilë a fëmijë të pafajshëm. Asnjëherë nuk është përpiluar ndonjë platformë për spastrimin e serbëve të Kosovës, as nuk është ndjekur ndonjë synim i tillë. Përkundrazi, një pjesë e madhe e ilegalëve vinin nga tradita të majta, ndonjëherë marksist-leniniste e ndonjëherë më centriste e socialdemokrate, por kjo nuk mjaftoi që Kosova ta fitonte simpatinë e majtistëve anembanë botës, siç e ka fituar, fjala vjen, çështja palestineze. Arsyet kryesore pse Kosova nuk e fitoi edhe aq simpatinë e së majtës ndërkombëtare janë: në radhë të parë idealizimi i socializmit jugosllav, si një variant më “i qytetëruar” dhe më i pranueshëm nga stalinizmi, ndërsa në radhë të dytë është ideja, se Kosova është një projekt amerikan e asgjë më shumë. Të dyja këto janë arsye të parrënjosura në histori, e sidomos të bazuara mbi propagandë. Socializmi jugosllav, për Kosovën (por jo vetëm për Kosovën), ishte veçse një kolonializëm me maskë të kuqe, ndërsa çështja e Kosovës nuk është projekt i importuar, por është e rrënjosur te historia dhe populli i saj, shumë dekada përpara se të ndërhynte me dashamirësi dhe drejtësi Amerika.

Pas ndërhyrjes së vitit 1999 në Kosovë, një pjesë e vogël e ish-marksist-leninistëve, që dikur kishin qenë luftëtarë, ndoqën shembullin faqezi të prijësve ish-komunistë në vendet e Europës Lindore, pra kapën pushtetin dhe u kthyen në oligarkë, politikanë të korruptuar dhe zbatues të agjendës privatizuese që shkatërruan edhe atë pak industri e ekonomi bujqësore që kishte Kosova. Kuptohet, as korrupsioni e as doktrina neoliberales e zbatuar prej tyre nuk ishin fenomene endemike. Ato u zhvilluan në konkordancë dhe nën këshillimin e vazhdueshëm të zyrtarëve ndërkombëtarë të vendosur në Prishtinë. Kështu mbërritëm në situatën ku gjendemi sot.

Aktualisht në Kosovë, megjithatë, erdhi në pushtet një brez i ri, i cili përpiket të dalë prej binarit jokreativ të krijuar menjëherë pas luftës, sipas të cilit nga njëra anë janë kombëtaristët, që janë të paarsimuar, ndërsa nga ana tjetër janë jokombëtaristët e arsimuar - të dyja palët të hapura për korrupsion. Thyerja e këtij binari krijon një sintezë prej tezës dhe antitezës, një parti si “Vetëvendosja”, ku po përpiket të bashkohet në një linjë vija kombëtare dhe ekspertiza. Kundër këtij vektori të ri shqiptar është një pol jo i papushtetshëm, i përbërë prej tri segmentesh qartësisht të dallueshme, që hera-herës duket sikur kanë konflikt ose mospajtim me njëri-tjetrin, por që në fakt përbëjnë bllok. Këto segmente shfaqen te: ndërkombëtarët e korruptuar, oligarkët vendorë dhe strukturat paralele të Beogradit.

Për vetë kushtet historike ku ka kaluar populli dhe spektri politik në Kosovë, nacionalizmi shqiptar i zhvilluar aty është një nacionalizëm progresist (po të përdorim këtu të njëjtat kriterë që përdorte dikur Ernest Mandeli, kur fliste për nacionalizmin flamand në Belgjikë). Ky nacionalizëm në shumicën e vet është informuar vazhdimisht nga marksizmi, dikur zyrtar në Shqipëri, por edhe nga ideale socialiste të kampit lindor, e më vonë, në vitet '80-'90, është frymëzuar edhe prej autorësh të ndryshëm, duke filluar nga antikolonialisti Fanon e gjer te antipostmodernisti Žižek.

Ndryshe është çështja kur flasim për nacionalizmin kosovar, kimerën e krijuar nga bashkëpunimi tripartiak mes një pjese të ndërkombëtarëve të interesuar që Kosova të ketë gjithnjë nevojë për ta, oligarkëve vendorë dhe serbëve. Nacionalizmi kosovar, nën flamurin e multikulturalizmit, ka prodhuar decentralizimin etnik, shformimin e historisë, tentativën për shkombëtarizimin e shqiptarëve dhe pezullimin e vendimmarrjes demokratike ose ndalimin e referendumit shtetformues e kushtetues për një popull, i cili ka qenë vazhdimisht i angazhuar në përpjekje çlirimtare për pothuajse një shekull.

Sot ky nacionalizëm “i ri” përpiket ndonjëherë ta neutralizojë edhe figurën historike dhe simbolike të Adem Jasharit. Ama, edhe pse

kur ishte në pushtet e uli flamurin kombëtar dhe shkatërroi shkollimin shqip, vështirë e ka ky nacionalizëm i imponuar të imponohet ndaj një populli, i cili kurrë nuk e ka ndalur *Lëvizjen*, si mënyrë e të bërit politikë, si rrugë e vështirë, por shpërblyese drejt emancipimit. Për këtë lloj të politikës, pra për *Lëvizjen*, Adem Jashari është edhe mësuesi i 7 Marsit, është edhe flamuri i 28 Nëntorit.

Republika me afër 1,9 milionë banorë vendosi të bëjë ndryshimet që nuk po i bëjnë dot vendet e tjera të rajonit, edhe pse janë më të mëdha e më të pasura. Kjo republikë e re është aktualisht vendi me demokracinë më të gjallë dhe entuziazmuese në këtë kohë, kur demokracia po bën prapakthime në të gjithë kontinentin. Por, pikërisht pse po punohet mirë, pse po bëhen punë të mira dhe po tregohet se shqiptarët janë në gjendje të prodhojnë shtet, qytetërim e drejtësi, shtohen rreziqet.

Kur çohesh në këmbë, bëhesh edhe më shumë cak i grabitqarëve. Ndaj është e rëndësishme të kuptohet se “nuk u kry” dhe se mësimi i Jasharit nuk është legjendar, por aktual, politik, shqetësues i atyre që duan të imponojnë nënshtrimin, kokuljen dhe pafuqinë, dhe nxitës e zemërdhënës për ata që duan dinjitetin, paqen, punën dhe zhvillimin jo për inat të fqinjëve, por bashkë me ta, për një të ardhme, ku do të mund ta shohim njëri-tjetrin në sy. Kjo e ardhme ende është larg dhe e pasigurt. Për të shkuar drejt saj na duhet mësimi i Ademit dhe Jasharëve, si dhe flamuri i tyre.

1. 10 SHQIPËRIA DHE KOSOVA NË GJEOPOLITIKËN IMPERIALE RUSE

Dr. Lisen Bashkurti

Në librin tim *“Rusia - Gjeopolitika imperiale e rrethit të mbyllur”*, të botuar në fillim të vitit 2026, zënë një vend të veçantë analiza e mënyrës se si Shqipëria dhe Kosova u bënë pjesë e gjeopolitikës imperiale ruse.

Shqipëria u bë direkt pjesë e pranisë dhe e ndikimit gjeopolitik rus në mënyrë indirekte, përmes misionit komunist jugosllav nga viti 1941 deri në vitin 1947. Në këtë periudhë sovjetikët filluan ndikimin gjeopolitik mbi Shqipërinë përmes PK Jugosllave. Atëherë kur marrëdhëniet midis Titos dhe Stalinit u përkeqësuan deri në ndarjen midis tyre, 1947, Shqipëria e reflektoi këtë kontradiktë sovjeto-jugosllave, duke anuar vendosmërisht nga regjimi i Stalinit. Nga viti 1948 deri në vitin 1961 Shqipëria nën regjimin e E. Hoxhës hapi dyer e dritare për praninë dhe ndikimin e thellë të gjeopolitikës sovjetike mbi çdo qelizë të vendit. Pas vdekjes së Stalinit më 1953, dhe ardhjen në krye të BRSS-së të Hrushovit, prania dhe ndikimi gjeopolitik sovjetik mbi Shqipërinë gradualisht filluan të ftoheshin. Në themel të kësaj ftohjeje ishte qëndrimi i Hrushovit ndaj Stalinit në Kongresin XX të PK-së të BRSS-së, ku përmes një raporti sekret kritikohet Stalini dhe regjimi i tij si i ashpër dhe mizor.

Pas këtij kongresi, Hrushovi nisi fushatën e spastrimeve të liderëve stalinistë në Europën Lindore, duke përfshirë edhe Shqipërinë. Hrushovi i kërkoi Enver Hoxhës dhe udhëheqësve të tjerë shqiptarë të tërhiqeshin nga pushteti për t'i hapur rrugë një klike pro-hrushoviane. Hoxha dhe pasuesit e tij nuk pranuan kurrsesi, duke filluar nga ky moment ndarjen përfundimtare partiake dhe shtetërore midis Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik.

Nga viti 1961 e deri në 1968 vijoi procesi i tensionuar dhe i vështirë i ndarjes gjeopolitike shqiptaro-sovjetike, që filloi me ndërprerjen e çdo marrëdhënieje, përfshirë edhe ato diplomatike

Shqipëri-Bashkimi Sovjetik, e kulmoi me daljen e Shqipërisë nga Traktati i Varshavës në vitin 1968.

Kosova gjithashtu zë vend të posaçëm dhe shumë me rëndësi në librin tim “Rusia - Gjeopolitika imperiale e rrethit të mbyllur”. Për sa kohë është krijuar dhe ka ekzistuar Jugosllavia në format e saj, Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, më tej Jugosllavia dhe Federata Jugosllave, Kosova konsiderohej pjesë e Serbisë dhe, si e tillë, nën ndikimin e gjeopolitikës ruse.

Çështja e Kosovës doli si çështje më vete atëherë kur u shpërbë BRSS-ja dhe Federata Jugosllave. Në këto momente doli në pah doktrina nacionaliste Serbe, që i vuri zjarrin Federatës Jugosllave, mohoi të drejtat kushtetuese jugosllave të Krahinës Autonome të Kosovës dhe, pas Marrëveshjes së Dejtonit për Bosnjë-Hercegovinën më 1995, pushtoi me ushtri dhe polici dhe filloi të ushtronte haptazi dhunë, represione, krime, pastrime etnike dhe gjenocid mbi shqiptarët e Kosovës.

Pas agresionit nationalist etnik kundër Slllovenisë, Kroacisë, Bosnjë-Hercegovinës, nacionalizmi serb filloi të diskreditohej ndërkëmbëtarisht për ekspansionizmin e dhunshëm mbi popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë. Kështu që ndërmarrja e agresionit të fundit serb mbi Kosovë ndeshi në një reagim të fuqishëm dhe të unifikuar të Aleancës Transatlantike, e cila në vitin 1999 ndërmori sulmin ajror mbi objektivat strategjike serbë në Kosovë dhe Serbi. Ky operacion ajror i suksesshëm i hapi rrugë procesit të pavarësimit të Kosovës nga Serbia.

Ndërkohë, për sa kohë Federata Ruse drejtohej nga Jelcini, qëndrimi i saj ndaj Kosovës ishte kontrovers, por vetëm në planin retorik dhe jo operacional ushtarako-strategjik. Me ardhjen në Kremlin të Putinit, qasja ruse për Kosovën ndryshoi radikalisht. Kosova në politikën dhe gjeopolitikën e Putinit nisi të konsiderohej si pjesë e skemave gjeopolitike dhe gjeostrategjike ruse.

Nga Konferenca e Munihut e vitit 2007 e më tej akoma në tre hapat gjeopolitikë rusë: sulmi mbi Gjeorgjinë më 2008, aneksimi

manipulativ dhe i dhunshëm i Krimesë më 2014 dhe “operacioni special” ushtarak kundër Ukrainës 2022, Putini e ka bërë Kosovën gjatë tërë kohës, në të gjithë retorikën e tij politike dhe justifikimet ndërkombëtare gjeopolitike, si rast për të justifikuar dhe argumentuar hapat e tij gjeopolitikë rreth Federatës Ruse. Në këtë lojë diabolike ruse ka hyrë edhe Serbia. Të dy këto shtete aleate, Rusia dhe Serbia, e kanë vënë çështjen e Kosovës midis tyre dhe përpiqen të përfitojnë reciprokisht për interesat e veta gjeopolitikë nacionalë.

Në librin tim “Rusia - Gjeopolitika imperiale e rrethit të mbyllur”, trajtohen gjerësisht dhe thellësisht vendi dhe ndikimi gjeopolitik rus, direkt dhe respektivisht edhe përmes Serbisë në Ballkanin Perëndimor. Politika imperiale ruse tenton vazhdimisht të mbajë një hap prezent në Ballkan, ndërkohë që Serbia vijon të luajë politikën e saj bivektorale euroaziatike dhe të Kalit të Trojës në mes të Europës.

II. GJEOPOLITIKA RAJONALE

2.1 RIKTHIMI I GJEOPOLITIKËS, SIGURIA ENERGIJETIKE DHE MENAXHIMI I RIPOZICIONIMIT TË SERBISË: KOSOVA DHE INTERESI JETIK I SHQIPTARËVE NË KËTË PROCES

Nga dr. Sadri Ramabaja

Vendosja e masave shtesë kufizuese [2] kundër Industrisë së Naftës së Serbisë (NIS), një kompani me pronësi shumicë ruse, nga OFAC (Zyra e Kontrollit të Aseteve të Huaja) në Departamentin e Financave të Shteteve të Bashkuara, theksohet që në hyrje të një analize të gjatë të institutit sloven IFIMES, Instituti Ndërkombëtar për Studime të Lindjes së Mesme dhe Ballkanit, me seli në Lubjanë, përfaqëson një nga sfidat më të ndjeshme për pozicionin energjetik, ekonomik dhe të politikës së jashtme të Serbisë në vitin 2025.¹ Sanksionet kundër NIS as nuk mund të shihen si një çështje teknike e kufizuar në sektorin e energjisë e as nuk janë realisht të tilla; ato janë e duhet konsideruar si zhvillime me natyrë gjeopolitike, jo teknike, sepse prekin varësitë strategjike të Beogradit dhe levat ruse në rajon.

Përshkrim i shkurtër i situatës.

- Në 2025 SHBA/OFAC vuri sanksione ndaj NIS-it, për arsye të pronësisë dhe lidhjeve me aktorët rusë (*Gazprom Neft/Gazprom*), masa që rrezikojnë zinxhirin e furnizimit me naftë të Serbisë.²
- Sanksionet kanë sjellë lehtësisht ndërprerje në furnizime dhe presion mbi pagesat/transaksionet e NIS-it; qeveria serbe ka tentuar të marrë zgjidhje (waiver/afate 3-muajsh, ndërhyrje shtetërore etj.).³
- Analiza e IFIMES, e cituar më lart, vlerëson se për Serbinë masat ishin katalizator për diversifikim dhe forcim të autonomisë

energjetike, por edhe sfidë e madhe për pozicionin ekonomik/politik të Beogradit.⁴

Këto tri pika formojnë sfondin e çdo parashikimi për Ballkanin dhe për rolin që mund të luajë Kosova.

Rezistenca gjeopolitike e Serbisë

Serbia zbaton vazhdimisht një politikë të bazuar në konceptin e “katër shtyllave”, duke zhvilluar dhe ruajtur njëkohësisht marrëdhënie politike, ekonomike dhe të sigurisë me BE-në, SHBA-në, Rusinë dhe Kinën.

Rirreshtimi i supozuar i Serbisë pro Perëndimit a ka të bëjë me premtimet e garancive, të cilat mundësojnë avancimin në procesin e krijimit të Botës Serbe, që gjithsesi do të reflektoheshin më pas në rishikimin e hartës politike të rajonit?

Kjo është dilema qenësore, që kërkon analizë të gjerë dhe kundërpërgjigjen meritorë nga palët që implikohen.

Gjatë gjithë periudhës 2022-2025, që kur shpërtheu agresioni rus në përmasa të gjera ndaj Ukrainës, Serbia ka demonstruar rezistencë të jashtëzakonshme për ruajtjen të pacenueshme të raporteve të saj me Moskën. Kjo rezistencë nuk mund të cilësohet ndryshe, përveçse si rezistencë gjeopolitike, duke vazhduar ta proklamojë neutralitetin ushtarak, marrëdhëniet e qëndrueshme me BE-në, SHBA-në, Rusinë dhe Kinën, por në sytë e Perëndimit gradualisht ka humbur peshën që pretendonte ta kishte si aktor rajonal i pavarur dhe i besueshëm.

Si në rastin e negociatave mes Uashingtonit dhe Moskës, duket se edhe në ato mes Uashingtonit dhe Beogradit po dominojnë qasjet e reja amerikane që thirren në realpolitikë. Strategjia e re amerikane e sigurisë dhe plani 28-pikësh që po pretendohet t'i imponohet Kievit për ta ndalur luftën, duket se ka të bëjë me faktin që SHBA-ja e njeh rolin e Moskës, ashtu siç po bëjnë me Beogradin, duke njohur gjithnjë e më shumë rolin kyç të Rusisë dhe Serbisë për rishikimin e arkitekturës së sigurisë europiane!

Prandaj viti 2026 do ta përballojë Brukselin me dilemën nëse dëshiron ta rishikojë pozicionin në raport me Kosovën dhe Serbinë dhe ta integrojë Ballkanin Perëndimor në procedura më të shpejtuara, apo ta lërë atë në “zonën gri” gjeopolitike.

Prandaj viti 2026 do ta përballojë Brukselin me dilemën nëse dëshiron ta rishikojë pozicionin në raport me Kosovën dhe Serbinë dhe ta integrojë Ballkanin Perëndimor, apo ta lërë atë në “zonën gri” gjeopolitike.

Interesi jetik i shqiptarëve - tri dimensione thelbësore

A. Siguria territoriale dhe politike

Kosova (dhe shqiptarët si Komb) kanë interes jetik, që **Serbia të mos përdorë dobësinë ekonomike për të intensifikuar presionin politik ose për të nxitur aktorë Proxy** [Republika Sërpska, elementë të minoritetit serb në Kosovë...]. Çdo marrëveshje në emër të prodhimit të “stabilitetit” në rajon duhet të përfshijë garanci ligjore/monitoruese kundër ndërhyrjeve të jashtme.

B. Siguria energjetike dhe ekonomike

Shqiptarët (Kosova + Shqipëria) kanë interes që të **shfrytëzojnë vakumin tregtar për të forcuar rrjetet e furnizimit** (terminalë, depo, rrugë transiti), të diversifikojnë burimet dhe të përshpejtojnë tranzicionin drejt energjive të ripërtërishme dhe kjo rrit reziliencën kombëtare dhe rajonale.

C. Legjitimiteti ndërkombëtar dhe integrimi euroatlantik

Çdo ndryshim strategjik që afron Serbinë me Perëndimin duhet të filtrohet nga perspektiva e **sigurisë së shqiptarëve**: zhbllokimi i ndikimit rus nuk duhet të bëhet në kurriz të sovranitetit të Kosovës apo të parimeve të paanshmërisë. Për rrjedhojë, shqiptarët duhet të kërkojnë mekanizma, që i bëjnë garancitë të verifikueshme (jo vetëm deklarata politike).

Pse sanksionet ndaj NIS-it rrisin peshën e Kosovës në skenën rajonale

A. Kosova si “aks furnizimi” dhe si mundësi për transit/burime alternative

Nëse furnizimi i Serbisë me produkte rafinerie dëmtohet (p.sh., ndalesa e punës së rafinerisë në Pançevë), tregu rajonal duhet të gjejë furnizime alternative dhe këtu hapet hapësira për shtete fqinje që ofrojnë rrugë transiti, depozita, stacione apo akses në rrjete tregtare. Nga ky prizëm, Kosova mund ta rrisë rëndësinë e infrastrukturës së saj tranzituese dhe të ofrojë lehtësi tregtare për import-eksport alternative (CEFTA, rrugë hekurudhore/rrugore). (P.sh. CEFTA/raportet e investimit).

B. Kosova si partnere strategjike e Perëndimit (US/EU) në presionin kundër ndikimit rus

Sanksionet ndaj NIS-it janë pjesë e një beteje më të madhe perëndimore kundër depërtimit rus në Ballkan. Kosova, si shtet me prirje properëndimore dhe partner i NATO/SHBA-së, mund të bëhet bashkëpunëtorë e rëndësishme në iniciativa për siguri energjetike, ndarjen e informacionit dhe zbatimin e masave financiare. Kjo rrit peshën diplomatike të Prishtinës në vendimmarrje rajonale.

C. Kosova si “hapësirë shtrënguese” për politikën serbe

Problemet energjetike dhe ekonomike i dobësojnë kapacitetet e qeverisë serbe për të manovruar politikisht (p.sh., financime për projekte klienteliste, sponsorizime politike). Një Serbi e dobësuar ekonomikisht ka më pak kapacitet për projekte të jashtme me karakter të pastër ekspansionues [siç është projekti i Botës Serbe] ose për lojëra në fushën e ndikimit (në Bosnjë apo Luginë etj.). Kjo krijon një mjedis, ku Kosova mund të forcojë pozicionin e saj diplomatik në BE/SHBA.

Çfarë duhet të bëjë Kosova - rekomandime prioritare

Afatshkurtër - sigurim dhe menaxhim krize

1. Aktivizim i koordinuar me SHBA/BE-në për informim dhe mbështetje

- Kontakt intensiv me ambasadat dhe me sektorët përkatës (*Treasury/OFAC contact points, EU energy task forces*) për të harmonizuar veprimin dhe për të kërkuar asistencë teknike/financiare.

2. Përforsim i vetëmbrojtjes kibernetike dhe kundër dezinformimit

- Aktivizim i qendrave kombëtare të reagimit (CERT), bashkëpunim me NATO/ENISA për trajnime dhe mbështetje.

3. Parandalim i presioneve humanitare/çmimeve

- Stokim strategjik i karburanteve, masa fiskale/ndihmë për konsumatorët në rast të rritjes së çmimeve.

Afatmesëm - fuqizim institucional dhe përfitim strategjik

1. Ofertë proaktive për transit dhe infrastrukturë

- Hartëzoni paketën investuese: terminale, depot e depozitimit, lehtësira doganore/administrative për operatorët që duan të kanalizojnë furnizime për rajonin. Kërkoni financim nga institucione multilaterale dhe partnerë (EIB, EBRD, USAID etj.).

2. Diplomaci energjetike e koordinuar me BE/SHBA

- Kosova të ofrohet si partner real në skema të përbashkëta për diversifikim energjetik të Ballkanit (p.sh., rrjete alternative, rezerva strategjike, logjistika e importit).

3. Forcim i institucioneve dhe rregulloreve

- Përdorni rastin për të përmirësuar rregullimin e tregut energjetik, transparencën dhe klimën e investimeve (që do ta bënte Kosovën më atraktive për operatorë privatë).

4. Koalicion rajonal properëndimor

- Ngjashëm siç është krijuar aleanca shqiptaro-kroate [Prishtinë-Tiranë-Zagreb] në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, urgjentisht duhet të bëhen përpjekjet për krijimin e një fronti të koordinuar për siguri energjetike dhe për politika që zmbrebsin ndikimin e Moskës dhe të Pekinit. Në qendër të këtij fronti, gjithsesi, duhet të jenë Prishtina-Tirana e Zagrebi, por duke bërë çmos që këtij boshti t'i bashkohet edhe Maqedonia e Veriut dhe, pse jo, edhe Bosnja.

Përfundim - çfarë do të thotë kjo për perspektivën e Ballkanit?

- Serbia mund të riorientohet pro Përfundimit në këmbim të garancive mbi “Botën Serbe”, *vetëm nëse Përfundimi ofron një paketë të besueshme ekonomike, politike dhe siguri*, dhe nëse Beogradi e sheh kompensimin si të mjaftueshëm për kostot politike. Largpamësia e zgjidhjes kërkon instrumente ligjore/verifikuese, qasje ndaj opinionit publik serb dhe oferta të prekshme ekonomike (shumica e së cilave lidhen me energjinë dhe statusin e NIS-it), pikërisht fusha ku sanksionet OFAC kanë krijuar levë negociimi.

- **Ripozicionimi i Serbisë**, nën presionin e sanksioneve (NIS), krijon një mundësi reale për depolarizim në Ballkan, por nuk është automatikisht i sigurt. Për shqiptarët, ky proces përbën si rrezik, ashtu edhe mundësi: rrezik nëse Beogradi thjesht performon pro Përfundimin pa ndryshime reale; mundësi nëse ripozicionimi vjen i shoqëruar me garanci të verifikueshme dhe investime, që rrisin reziliencën rajonale.⁵

- **Kosova** duhet të jetë proaktive: të ofrojë zgjidhje të prekshme (infrastrukturë transiti, depo), të forcojë reziliencën energjetike dhe kibernetike, si dhe të kërkojë garanci ligjore/monitoruese në çdo marrëveshje që prek marrëdhëniet rajonale. Kjo është interesi i saj jetik dhe i shqiptarëve në përgjithësi.

- Sanksionet ndaj NIS-it i ngrenë kostot e “balancimit” për Serbinë dhe krijojnë hapësirë për aktorë properëndimorë në rajon. Kosova mund ta shfrytëzojë këtë vakum si mundësi të re diplomatikisht dhe

ekonomikisht, por vetëm nëse vepron shpejt dhe me kapacitete të forta menaxhuese.

- **Për sa i përket idesë së Federatës Shqiptare:** një Kosovë më e fuqishme ekonomikisht dhe diplomatikisht, e aftë të ofrojë zgjidhje energjetike/ regjionale, do ta rrisë legjitimitetin e çfarëdo forme bashkëpunimi të zgjeruar me Shqipërinë, por çdo hap duhet të komunikojë qartë, se synimi është **stabiliteti dhe përforcimi i rendit euroatlantik**, jo destabilizimi.

Prandaj roli i Kosovës tani është me përmasa të dyfishta:

- a) të menaxhojë rreziqet e menjëhershme (krizën energjetike/ disinformim/ presione politike);
- b) të transformojë krizën në mundësi për të forcuar pozicionin e vet rajonal dhe lidhjet me Perëndimin.

Referenca

1. <https://mailchi.mp/522a79f376a2/istraivanje-srbija-2025-geopolitika-otpornost-energetska-sigurnost-i-upravljanje-sankcijama?e=13573def3c>
2. https://sanctionssearch.ofac.treas.gov/Details.aspx?id=52141&utm_source=chatgpt.com
3. https://www.reuters.com/business/energy/serbia-secures-three-month-reprieve-us-sanctioned-oil-firm-nis-says-official-2025-11-15/?utm_source=chatgpt.com
4. <https://mailchi.mp/522a79f376a2/istraivanje-srbija-2025-geopolitika-otpornost-energetska-sigurnost-i-upravljanje-sankcijama?e=13573def3c>
5. https://www.reuters.com/business/energy/serbias-nis-oil-refinery-halts-operations-us-sanctions-bite-report-2025-11-25/?utm_source=chatgpt.com

2.2 BALLKANI PERËNDIMOR NDËRMJET ARKITEKTURËS SË PAQES DHE RREZIKUT TË RIFORMATIMIT GJEOPOLITIK

Nga dr. Skënder Asani

Faza e re e reformatimit gjeopolitik në Ballkanin Perëndimor përkon me një moment kritik, që kërkon nga faktori shqiptar një ripozicionim më të artikuluar strategjik, të mbështetur mbi qartësi vizioni, koordinim institucional dhe një qasje të përbashkët politike në të gjithë hapësirën shqiptare të rajonit. Nëse proceset e stabilizimit të rajonit po hyjnë në fazën e tyre përfundimtare, atëherë edhe faktori shqiptar duhet të hyjë në këtë fazë me një veprim të harmonizuar, ku roli i Shqipërisë të shndërrohet në një katalizator diplomatik dhe institucional për koordinimin e politikës shqiptare në rajon.

Ballkani Perëndimor, më shumë se tri dekada pas shpërbërjes së Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë, vazhdon të mbetet një hapësirë gjeopolitike e karakterizuar nga ndërthurja komplekse e historisë, interesave strategjike dhe projeksioneve të fuqive rajonale dhe ndërkombëtare. Proceset e shtetformimit, konsolidimit institucional dhe integritit në strukturat euroatlantike nuk mund të kuptohen pa analizuar arkitekturën e marrëveshjeve ndërkombëtare, që u dhanë fund konflikteve të përgjakshme të viteve '90 dhe që, në të njëjtën kohë, projektuan një rend të ri politik në rajon.

Në këtë kuadër, tri marrëveshje përbëjnë shtyllat themelore të arkitekturës së pasluftës në Ballkanin Perëndimor: Marrëveshja e Dejtonit, Marrëveshja e Kumanovës dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Këto dokumente nuk përfaqësojnë vetëm instrumente të ndërprerjes së konflikteve të armatosura, por mekanizma të një inxhinierie të thellë kushtetuese dhe institucionale, përmes së cilës bashkësia ndërkombëtare synoi të ndërtojë një arkitekturë të re stabiliteti dhe bashkëjetese politike në rajon. Në thelb, këto marrëveshje artikuluan një paradigmë të re të ndërhyrjes ndërkombëtare në konfliktet

rajonale: paqja nuk u konceptua vetëm si ndërprerje e dhunës, por si një proces afatgjatë transformimi institucional dhe kulturor. Përmes Marrëveshjes së Dejtonit u institucionalizua një model kompleks i organizimit shtetëror në Bosnjë-Hercegovinë, duke krijuar një arkitekturë federative të ekuilibruar mbi baza etnike dhe territoriale. Ndërkohë, Marrëveshja e Kumanovës, e arritur pas ndërhyrjes së NATO-s kundër regjimit të Republikës Federale të Jugosllavisë, hapi rrugën për administrimin ndërkombëtar të Kosovës dhe krijimin e një realiteti të ri politik në këtë hapësirë. Në të njëjtën linjë, Marrëveshja Kornizë e Ohrit e vitit 2001 përfaqësoi një model të veçantë të zgjidhjes së konfliktit të brendshëm në Maqedoninë e Veriut përmes reformave kushtetuese dhe institucionalizimit të barazisë ndëretnike.

Paralelisht me këtë proces institucional të stabilizimit rajonal, në hapësirën politike të Serbisë po artikullohet gjithnjë e më qartë një koncept gjeopolitik me implikime të gjera rajonale, i njohur në diskursin publik si “Bota Serbe”. Ky koncept synon konsolidimin e një hapësire të përbashkët politike, kulturore dhe identitare për komunitetet serbe në rajon dhe krijimin e një rrjeti ndikimi, që mund të aktivizohet në momentet kyç të rikonfigurimit gjeopolitik të Ballkanit Perëndimor.

Manifestimet e këtij projekti janë tashmë të dukshme në disa zhvillime politike dhe institucionale në rajon. Në Bosnjë-Hercegovinë, diskursi për autonomi të zgjeruar apo edhe për shkëputje nga struktura shtetërore artikullohet vazhdimisht nga lidërshipi politik i entitetit të njohur si Republika Sërpska. Në Malin e Zi ndikimi i këtij projekti reflektohet përmes rolit të strukturave kishtare dhe përmes polarizimit të thellë politik rreth çështjeve të identitetit kombëtar dhe orientimit gjeopolitik të shtetit.

Gjatë viteve të fundit, sinjale të depërtimit të këtij diskursi janë vërejtur edhe në hapësirën politike dhe shoqërore të Maqedonisë së Veriut. Veçanërisht pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2024, në diskursin analitik është vërejtur një intensifikim i ndikimit të kësaj narrative në orientimin politik të qeverisë, e cila në disa raste

perceptohet se po vepron si një paravan politik për interesat strategjike të Serbisë në raport me proceset rajonale dhe me ritmin e integritetit evropian të shtetit.

Ky ndikim nuk kufizohet vetëm në sferën politike. Ai shtrihet edhe në dimensione të tjera strukturore, si depërtimi i kapitalit financiar dhe investimeve bankare të lidhura me qarqe ekonomike serbe, fuqizimi gradual i oligarkive me lidhje rajonale në sektorë strategjike ekonomike dhe një prani në rritje në hapësirën kulturore dhe mediatike. Paralelisht, raportime të ndryshme ndërkombëtare kanë ngritur shqetësime lidhur me rrjetet e krimit të organizuar ndërkufitar, që operojnë në korridoret që lidhin Serbinë me Maqedoninë e Veriut. Në një kontekst më të gjerë politik, një element që ka ngritur debate të forta në hapësirën publike dhe akademike lidhet me qasjen e qeverisë ndaj Marrëveshjes së Ohrit. Tendencat për relativizimin, suprimimin gradual ose riinterpretimin e disa prej parimeve të saj themelore perceptohen nga shumë analistë si procese që mund të çojnë drejt degradimit të pozitës politike dhe institucionale të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut dhe dobësimit të arkitekturës së bashkëjetesës ndëretnike të ndërtuar pas vitit 2001.

Në kontrast me këtë dinamizëm strategjik të projektit serb, faktori shqiptar në rajon duket se po hyn në një fazë historike vendimtare pa një platformë të konsoliduar strategjike dhe pa një mekanizëm efektiv koordinimi politik. Shqiptarët, megjithëse përbëjnë një nga komunitetet më të mëdha etnike në Ballkanin Perëndimor dhe janë të shpërndarë në disa shtete të rajonit, vazhdojnë të përballen me një fragmentim të theksuar politik dhe institucional, që dobëson kapacitetin e tyre për të vepruar si faktor stabiliteti dhe balancimi në arkitekturën e re rajonale. Në optikën e analizës strategjike bashkëkohore, fragmentarizimi i elitave politike shqiptare në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Luginën e Preshevës dhe në Malin e Zi po interpretohet gjithnjë e më shumë nga qendrat përëndimore të vendimmarrjes si një dobësi strukturore, që mund të shfrytëzohet nga agjenda të kundërta me orientimin euroatlantik të rajonit. Në diskursin

analitik të institucioneve në Bashkimin European dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ky fragmentim politik shihet jo vetëm si mungesë e një artikulimi të unifikuar strategjik të faktorit shqiptar, por edhe si një hapësirë potenciale, ku mund të investojnë qarqe me prirje antiperëndimore për të prodhuar tensione dhe për të relativizuar orientimin euroatlantik të rajonit. Në këtë sfond kompleks, faktori ndërkombëtar e sheh rolin e Shqipërisë si një element stabilizues dhe koheziv. Pozicioni i saj si anëtare e NATO-s dhe avancimi i saj në procesin integruar drejt Bashkimit European i japin asaj legjitimitet diplomatik për të nxitur një koordinim më të qëndrueshëm të politikës shqiptare në rajon.

Në këtë kontekst, angazhimi i Tiranës në këto momente historike duhet të artikulohet më qartë dhe të orientohet drejt disa prioriteteve strategjike: konsolidimit të shtetësisë së Kosovës në arenën ndërkombëtare, informimit sistematik të institucioneve ndërkombëtare mbi tendencat për dobësimin e Marrëveshjes së Ohrit në Maqedoninë e Veriut dhe ekspozimit të depërtimit të projektit ideologjik të “Botës Serbe” në hapësirën institucionale dhe diskursive të rajonit. Në Kosovë, tensionet politike dhe ndasitë institucionale shpesh prodhojnë një atmosferë polarizimi, që ndikon drejtpërdrejt në procesin e konsolidimit të shtetësisë dhe subjektivitetit ndërkombëtar të vendit. Në Maqedoninë e Veriut, ndërkaq, vërehet një proces gradual i relativizimit të pozitës kushtetuese të shqiptarëve si faktor shtetformues, i shoqëruar me fragmentimin e spektrit politik shqiptar dhe dobësimin e ndikimit të tij në vendimmarrjen strategjike të shtetit.

Në të njëjtën kohë, shqiptarët e Luginës e Preshevës vazhdojnë të përballen me kufizime serioze në fushën e të drejtave politike, arsimore dhe kulturore, ndërsa shpesh janë subjekt i politikave administrative, që perceptohen si forma të heshtura të presionit institucional dhe demografik. Edhe në Malin e Zi komuniteti shqiptar përballlet me sfida që lidhen me përfaqësimin politik, zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e identitetit kulturor në një kontekst gjithnjë e më të polarizuar. Kjo panoramë e ndërlikuar sugjeron se dekada që po

hapet për Ballkanin Perëndimor mund të jetë vendimtare për përmbylljen e proceseve historike të nisura pas viteve '90. Në këtë kontekst, roli i Tiranës merr një rëndësi të veçantë strategjike. Si kryeqendra politike e shtetit shqiptar dhe si anëtare e NATO-s, Shqipëria zotëron potencialin diplomatik, institucional dhe akademik për të shndërruar koordinimin e faktorëve shqiptarë në një platformë të qëndrueshme strategjike.

Ky rol nuk duhet të interpretohet si një projekt ndërhyrës në punët e brendshme të shteteve të rajonit, por si një mekanizëm legjitim koordinimi dhe harmonizimi të interesave të komuniteteve shqiptare në përputhje me parimet e stabilitetit rajonal dhe integritimit europian. Në këtë kuadër, edhe Republika e Shqipërisë, në përputhje me frymën dhe dispozitat e Kushtetutës së saj, që parashikojnë përkujdesjen institucionale për shqiptarët jashtë kufijve shtetërorë, ka një rol të ligjshëm në mbështetjen dhe promovimin e të drejtave të tyre politike, kulturore dhe kombëtare në rajon dhe në botë. Nëse proceset e stabilizimit të Ballkanit Perëndimor po hyjnë në fazën e tyre përfundimtare, atëherë edhe faktori shqiptar duhet të hyjë në këtë fazë me qartësi strategjike, koordinim institucional dhe një vizion të përbashkët politik.

Në përmbyllje të kësaj analize, bëhet e qartë se faza e re e riformatimit gjeopolitik në Ballkanin Perëndimor përkon me një moment kritik, që kërkon nga faktori shqiptar një ripozicionim më të artikuluar strategjik, të mbështetur mbi qartësi vizioni, koordinim institucional dhe një qasje të përbashkët politike në të gjithë hapësirën shqiptare të rajonit. Nëse proceset e stabilizimit të rajonit po hyjnë në fazën e tyre përfundimtare, atëherë edhe faktori shqiptar duhet të hyjë në këtë fazë me një veprim të harmonizuar, ku roli i Shqipërisë të shndërrohet në një katalizator diplomatik dhe institucional për koordinimin e politikës shqiptare në rajon.

Në këtë kuadër, bëhet i domosdoshëm intensifikimi i përpjekjeve për konsolidimin ndërkombëtar të Kosovës, artikulimi në forumet euroatlantike i shqetësimeve që lidhen me tendencat për

relativizimin e parimeve të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në Maqedoninë e Veriut, si dhe adresimi diplomatik i projeksioneve rajonale të konceptit të ashtuquajtur të “Botës Serbe”. Paralelisht imponon nevoja për ndërtimin e një mekanizmi të qëndrueshëm koordinimi strategjik ndërmjet Tiranës, Prishtinës dhe përfaqësuesve politikë të shqiptarëve në rajon në Maqedoninë e Veriut, në Malin e Zi dhe në hapësirat shqiptare të Luginës së Preshevës, me qëllim artikullimin e një qasjeje të harmonizuar politike, diplomatike dhe akademike përballë transformimeve të reja gjeopolitike. Vetëm përmes një koordinimi të tillë strategjik dhe një veprimi të përbashkët institucional, faktori shqiptar mund të shndërrojë fragmentimin aktual në kapital politik dhe diplomatik, duke afirmuar rolin e tij si faktor stabiliteti në rajon dhe duke siguruar që prania historike dhe politike e shqiptarëve të mos marginalizohet në konfiguracionin e ri gjeopolitik të Ballkanit Perëndimor, por të konsolidohet si një komponent i rëndësishëm i arkitekturës së re të sigurisë dhe të integritetit euroatlantik.

2.3 KUMANOVA DËSHMOI SE SHQIPTARËT NUK JANË TË MIRËPRITUR NË “MAQEDONINË E VERIUT”

Nga dr. Mujë Buçpapaj

Ky nuk ishte një incident sportiv. Ky ishte një mesazh i koduar politik. Tifozët që thërrasin për “dhoma gazi për shqiptarët” nuk janë të vetmuar - ata janë produkti i një edukimi nacionalist, i një shkolle që mëson urrejtje dhe i një shteti që injoron krimet dhe shpreson se do të harrohen. Por shqiptarët nuk harrojnë. Dhe as nuk dorëzohen.

Pyetja që shtrohet pas incidentit racist në Kumanovë është: *a mund të ndërtojnë shqiptarët e Maqedonisë së Veriut një republikë të tyre brenda shtetit ekzistues, ose të ndahen përfundimisht duke iu bashkuar Shqipërisë?* Kjo është një nga dilemat më serioze dhe më legjitime të ditëve tona, me rrënjë të thella historike, politike dhe gjeostrategjike. Nuk është hera e parë që shqiptarët përballen me urrejtje, fyerje dhe kërcënime në Maqedoninë e Veriut, por ajo që ndodhi më 2 gusht në palestrën sportive të Kumanovës i kalon të gjithë kufijtë e një incidenti sportiv: ishte një shpërthim i hapur i racizmit institucional, një thirrje për spastrim etnik, një atentat i ulët ndaj bashkëjetesës dhe i vetë ideve, mbi të cilat supozohet të jetë ndërtuar shteti i përbashkët.

Gjatë ndeshjes së basketbollit Maqedoni e Veriut - Rumani, tifozë vendas, pa asnjë frikë e me mbështetjen e heshtjes shtetërore, lëshuan parulla, që vetëm regjimet fashiste të viteve 1930 do të kishin guxuar t'i lëshonin, në mes të një Europe moderne: “Shqiptari i mirë është shqiptari i vdekur”, “Dhoma gazi për shqiptarët”, “Maqedoni e pastër, e pastër, e pastër” - të gjitha duke u brohoritur në prani të drejtuesve të lartë të shtetit maqedonas, të cilët jo vetëm që nuk reagueshan, por me heshtjen e tyre u bënë bashkëfajtorë. A nuk mjaftuan dekadat e diskriminimit sistematik? A nuk ishin të qarta mesazhet e Marrëveshjes së Ohrit? A duhet që shqiptarët të jetojnë çdo ditë si qytetarë të dorës së dytë, në një shtet që, me gjithë përfitimet nga

paqja, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndihma perëndimore, nuk e pranon dot realitetin historik dhe etnik të bashkëjetesës?

Ky nuk ishte një incident sportiv. Ky ishte një mesazh i koduar politik!

Përmes thirrjeve raciste në një event publik dhe ndërkombëtar, në një qytet me shumicë shqiptare, u përçua qartë vizioni i errët i një “Maqedonie të pastër”: pa shqiptarë, pa shumë kulturë, pa demokraci funksionale.

A është ky shteti, për të cilin SHBA-ja dhe BE-ja dhanë garanci?

Maqedonia e Veriut është sot një krijesë politike, që ekziston falë përpjekjeve të jashtëzakonshme ndërkombëtare dhe mirëkuptimit të shqiptarëve etnikë. Pa shqiptarët nuk do të kishte as NATO, as emër të ri, as stabilitet minimal. Dhe për këtë, maqedonasit nuk mund të sillen më si popull zotërues, por si partnerë të barabartë. Për ata që nuk e dinë, emri “Maqedoni” u krijua politikisht nga Titoja pas Luftës së Dytë Botërore, për të ndërtuar një identitet të ri sllav në troje historikisht shqiptare e bullgare. Kjo republikë është, në thelb, një mbetje artificiale e një federate të vdekur: asaj jugosllave. Dhe në këtë hapësirë të improvizuar, shqiptarët kanë qenë gjithnjë elementi më i përjashtuar dhe më i vuajtur, megjithëse etnikisht dhe historikisht janë autoktonë në këtë tokë, qysh nga epoka ilire dhe pellazge.

E vërteta është kjo: shteti maqedonas ekziston, sepse shqiptarët e kanë duruar. E vërteta është kjo: shteti maqedonas ekziston, sepse shqiptarët e kanë duruar. Por ky durim ka një kufi. Një shtet që nuk ofron barazi, nuk ka të ardhme. Një bashkëjetesë që prodhon vetëm përçmim, nuk ka kuptim. Shqiptarët nuk do të presin pafundësisht, që maqedonasit të piquen politikisht dhe të kuptojnë se jeta në këtë hapësirë kërkon respekt të ndërsjellë, jo urrejtje primitive. Nëse qeveria maqedonase nuk arrin të ndalë këto akte turpi, atëherë zgjidhja e shqiptarëve është e qartë: bashkimi me shtetin amë, Shqipërinë. Kjo është jo vetëm një kërkesë historike e pambyllur, por një përgjigje politike ndaj një realiteti që po bëhet gjithnjë e më i papranueshëm.

Tifozët që thërrasin “Dhoma gazi për shqiptarët” nuk janë të vetmuar, por janë produkti i një edukimi nacionalist, të një shkolle që mëson urrejtje dhe të një shteti që injoron krimet dhe shpreson se do të harrohen. Por shqiptarët nuk harrojnë. Dhe as nuk dorëzohen.

I. Konteksti historik: shqiptarët në trojet e tyre, shteti në kërkim të identitetit

- Autoktonia shqiptare në territorin e Maqedonisë së Veriut është e padiskutueshme dhe e dokumentuar që në periudhat antike ilire, romake dhe mesjetare. Në zona, si: Tetova, Gostivari, Kumanova, Shkupi, Struga, Dibra, Kërçova e gjerë, Manastiri etj., shqiptarët kanë qenë dhe mbeten popullsi shumicë ose autoktone, që i parapriu çdo vale sllave të shekujve VI-VII.
- Sllavët në Ballkan janë të ardhur pas shekullit VII dhe formimi i “identitetit maqedonas” është i vonshëm, i ndërtuar nga elitat komuniste jugosllave, posaçërisht pas vitit 1945, kur Josip Broz Tito krijoi Republikën Popullore Socialiste të Maqedonisë, si një element për të kundërshtuar pretendimet greke dhe bullgare në këtë territor. Pra, përplasja etnopolitike në Maqedoninë e Veriut është mbi një themel artificial: një shtet i ndërtuar mbi identitet të rremë politik (maqedonas), që përpiqet të zëvendësojë një realitet shumë më të vjetër etnik dhe kulturor: shqiptarët.

II. Diskriminimi sistematik (1991-2001): nga shpallja e pavarësisë te konflikti i armatosur

- Me shpalljen e pavarësisë në vitin 1991, Maqedonia e Veriut u krijua si një shtet monoetnik, ku Kushtetuta e parë përcaktonte se: “Maqedonia është shtet i maqedonasve...”. Shqiptarët nuk u njohën si komb shtetformues, por si pakicë kombëtare, megjithëse përbënin mbi 45% të popullsisë.

Shqiptarët u përjashtuan në mënyrë të strukturuar nga:

- përfaqësimi në institucionet shtetërore (administratë, polici, ushtri, drejtësi);

- arsimit dhe kultura publike (mungesë universitetesh në gjuhën shqipe, ndalim i flamurit kombëtar);
- e drejta për përdorim të gjuhës shqipe dhe të simboleve kombëtare;
- diskriminimi në vitin 2001 solli një konflikt të armatosur të UÇK-së në Maqedoni, i cili përfundoi me Marrëveshjen e Ohrit (13 gusht 2001), një ndër dokumentet kyç, që shënoi një moment historik në avancimin e të drejtave të shqiptarëve.

III. Marrëveshja e Ohrit: një kontratë politike, e cila nuk është zbatuar plotësisht

Parimet kryesore të Marrëveshjes së Ohrit janë:

1. Përfaqësim proporcional i shqiptarëve në institucione.
2. Përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe.
3. Arsimit në gjuhën amtare dhe legalizimi i institucioneve shqiptare të arsimit të lartë (Universiteti i Tetovës).
4. Simbolet kombëtare të pakicave të lejohen dhe të përdoren në mënyrë të barabartë.
5. Zgjerimi i vetëqeverisjes lokale në komunat me shumicë shqiptare.

Realiteti sot:

- Në letër, disa nga këto pika janë realizuar (ligji për gjuhët, universiteti i Tetovës, përfaqësim më i mirë në polici dhe ushtri), por në praktikë, shpesh zbatimi është selektiv, i politizuar dhe i varur nga koniunukturat qeverisëse.
- Gjykatat, prokuroria dhe institucionet kyç të sigurisë mbeten nën dominim sllavo-maqedonas.
- Përdorimi i gjuhës shqipe pengohet me mjete burokratike dhe nëntekst politik.
- Tensionet kulturore dhe nacionaliste nuk janë fashitur, përkundrazi, nën qeveritë konservatore dhe me retorikë nacionaliste, si ajo aktuale, ka regres të qartë.

IV. Drejtësia ndërkombëtare dhe standardet europiane

Të drejtat e shqiptarëve si popull autokton në Maqedoninë e Veriut mbështeten në disa standarde dhe dokumente ndërkombëtare:

- Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)
- Konventa për të Drejtat e Pakicave Kombëtare (1995)
- Kushtetuta e BE-së dhe Parimet e Kopenhagës
- Rezolutat e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat kolektive dhe vetëvendosjen

Këto dokumente sanksionojnë qartë të drejtën për:

- përdorimin e gjuhës amtare në administratë dhe gjykata;
- arsimin në gjuhën amtare;
- autonomi lokale dhe simbole kombëtare;
- të drejtën për përfaqësim proporcional;
- të drejtën për mospërfjashtim politik, ekonomik dhe kulturor mbi baza etnike.

Por, mungesa e mekanizmave të detyrueshëm zbatues e ka lënë zbatimin në dorë të vullnetit të qeverive.

V. Çfarë ndodh tani? Drejt një riformulimi të statusit të shqiptarëve

Ngjarje si incidenti racist në Kumanovë nuk janë të rastësishme, por simptoma të dështimit të modelit të bashkëjetesës në Maqedoninë e Veriut. Shqiptarët janë, *de facto*, bashkëpronarë të shtetit, por *de jure* ende trajtohen si qytetarë të dorës së dytë. Në këtë kontekst, me të drejtë shtrohet pyetja: *A është Marrëveshja e Ohrit e mjaftueshme? Apo është koha për:*

- riformatim të plotë kushtetues, që i njeh shqiptarët si komb shtetformues;
- model federal ose konfederal, për t'u dhënë shqiptarëve autonomi të plotë kulturore, politike dhe financiare;
- ose, në mungesë të garancive reale, konsiderimin legjitim të së drejtës për bashkim me shtetin amë, Shqipërinë, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për vetëvendosje.

Përfundim: Marrëveshja e Ohrit i dha paqe Maqedonisë, por jo drejtësi shqiptarëve

Shqiptarët nuk mund të jetojnë në një shtet që u mohon të drejtën për të qenë vetvetja. Aty ku drejtësia mungon, pakënaqësia etnike dhe politike vetëm sa rritet. Ngjarje si rasti i Kumanovës janë sinjale të qarta dështimi dhe nuk duhet trajtuar si “prapësira të tifozeve”, por si provë për kapacitetin demokratik dhe etik të shtetit maqedonas. Nëse shteti nuk ndërmerr masa të qarta, atëherë shqiptarët kanë të drejtën:

- të kërkojnë garanci ndërkombëtare për mbrojtjen e tyre,
- të ndërtojnë struktura politike më të fuqishme për përfaqësim real,
- të konsiderojnë opsionin e vetëvendosjes si mjet për zgjidhje të drejtë dhe të qëndrueshme.

Pyetja që shtrohet pas incidentit racist në Kumanovë është: *A mund të ndërtojnë shqiptarët e Maqedonisë së Veriut një republikë të tyre brenda shtetit ekzistues, ose të ndahen përfundimisht duke iu bashkuar Shqipërisë?*

Kjo është një nga dilemat më serioze dhe më legjitime të ditëve tona, me rrënjë të thella historike, politike dhe gjeostrategjike.

Le ta shqyrtojmë çështjen në mënyrë të qartë, me tre skenarë të mundshëm dhe vlerësim realist të pasojave për secilin.

Skenari I: Federatë shqiptaro-maqedonase - dy republika brenda një shteti të përbashkët

Çfarë do të nënkuptonte kjo?

- Formim i dy republikave përbërëse: njëra me shumicë shqiptare (Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, Dibër, Kumanovë, Manastir, zona të Shkupit), tjetra me shumicë sllavo-maqedonase.
- Kushtetutë e re që njeh dy popuj shtetformues: shqiptarë dhe maqedonas.
- Strukturë federale (si Bosnja-Hercegovina apo Belgjika), ku secila republikë ka parlamentin e vet, sistemin arsimor, buxhetin lokal, policinë rajonale etj.

- Kompetenca të ndara dhe pushtet i përbashkët vetëm në çështje të jashtme, mbrojtje dhe ekonomi kombëtare.

A është e mundur?

Teorikisht, po. Federatat janë struktura të pranueshme në sistemin juridik ndërkombëtar. Kushti kryesor është marrëveshja e brendshme politike. Federata do të kërkonte:

- riformatim të plotë të shtetit,
- pranim nga maqedonasit që shqiptarët nuk janë “pakicë”, por popull me të drejta të barabarta shtetformuese,
- garanci ndërkombëtare për stabilitetin e modelit.

A ka precedentë?

- Bosnja-Hercegovina: me dy entitete (Federata boshnjako-kroate dhe Republika Serbe).
- Belgjika: me entitete flamande dhe vallone.

Vështirësitë?

- Refuzimi historik i maqedonasve për të pranuar modelin federal (nga frika e ndarjes).
- Nevojë për presion të madh ndërkombëtar dhe vullnet të ndërsjellë.

Skenari II: Bashkimi i pjesës shqiptare me Shqipërinë - ndarje e qartë dhe paqësore

Çfarë do të nënkuptonte?

- Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut shpallin vullnetin e tyre politik për bashkim me Shqipërinë.
- Territoret shqiptare (në perëndim dhe veri të vendit) shkëputen me referendum ose vendim politik kolektiv, duke ndjekur parimin e vetëvendosjes.
- Krijimi i një kufiri të ri midis Shqipërisë dhe pjesës maqedonase.

A është kjo juridikisht e mundur?

Po, në teori, mbi bazën e:

- parimit të vetëvendosjes së popujve (neni 1 i Kartës së OKB-së);
- praktikës ndërkombëtare të ndarjeve;

- referendumit të mbështetur nga shumica dërmuese e popullsisë shqiptare.

Çfarë e bllokon këtë sot?

- Marrëveshja e Ohrit dhe kushtetuta e RMV-së nuk lejojnë ndarje territoriale.
- SHBA-ja dhe BE-ja janë kundër ndryshimit të kufijve në Ballkan, nga frika e zinxhirit të ndarjeve (Bosnjë, Serbi etj.).
- Rrezik i konflikteve të dhunshme, nëse ndarja nuk bëhet në mënyrë të kontrolluar dhe me dakordësi.

Skenari III: Vazhdimi i *status quo*-së me përmirësime graduale

Ky është modeli aktual:

- Shqiptarët mbeten pjesë e një shteti unitar me disa përfitime nga Marrëveshja e Ohrit.
- Zgjidhjet vijnë përmes qeverisjes së përbashkët dhe negociatave të vazhdueshme për përmirësim të statusit.
- Një shtet multietnik, por jo federal.

Problemi?

- Ky model ka dështuar të ofrojë barazi reale.
- Dështimi i zbatimit të ligjeve ekzistuese.
- Racizmi strukturor vazhdon (siç u pa në Kumanovë).
- Mund të prodhojë radikalizim, frustrim dhe ndarje të heshtur *de facto*, nëse nuk ka ndryshim rrënjësor.

Përfundim: Koha e zgjidhjeve të mëdha po afron

Nëse Maqedonia e Veriut do të mbijetojë si shtet, ajo duhet:

- të federalizohet dhe të pranojë shqiptarët si popull bashkështetformues;
- ose të përgatitet për ndarje të qetë dhe të drejtë, bazuar në vullnetin e popujve dhe mbështetjen ndërkombëtare. Ndryshe, shteti do të vazhdojë të mbijetojë si një krijesë e brishtë, ku bashkëjetesa është e detyruar, jo e dëshiruar, dhe historia ka treguar se modeli i bashkëjetesës së shtirur nuk zgjat përjetë.

***Autori është drejtor i Institutit të Studimeve Kombëtare dhe botues i gazetës javore “Nacional” në Tiranë.**

2.4 PAVARËSIMI I MAQEDONISË, NJË FRYT I PAPJEKUR PËR SHQIPTARËT!

Nga Emin Azemi

Nëse në vitet nëntëdhjetë shqiptarët vepronin nën ombrellën e një kushtetute që nuk e shprehte realitetin shumetnik të shtetit dhe, më vonë, kur u bënë ndryshimet kushtetuese, si dhe kur u definua statusi i shqiptarëve, u vërejt një shpërputhje mes luftës që ata bënë në 2001-in dhe trofeve politike të asaj lufte, që shqiptarët megjithatë i rangon si pakicë kombëtare në të gjitha ligjet që dalin nga kushtetuta aktuale. Procesi i shtetformësisë së shqiptarëve është kapitulli i ri i marrëdhënieve mes dy popujve më të mëdhenj në Maqedoninë e Veriut. Pa rrumbullakimin e këtij procesi, perspektiva e Maqedonisë së Veriut do t'i ngjante një fryti gjysmë të pjekur dhe garës se kush do të arrinte të vilte sa më shumë fruta të pjekura.

Përmes një referendumi të 8 shtatorit të vitit 1991, me pjesëmarrje të mbi 95 për qind të qytetarëve, Maqedonia e sotme u pavarësua nga ish-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë. Referendumit i parapriu Deklarata për Pavarësi, të cilën Parlamenti i parë i Maqedonisë shumëpartiake e miratoi më 25 janar të vitit 1991. Formalisht, vullneti i popullit për shtet të pavarur ishte konstatuar me Deklaratën për Pranimin e Rezultateve të Referendumit më 18 shtator të vitit 1991 në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Pas referendumi të 8 shtatorit 1991, i bojkotuar nga shqiptarët, Kiro Gligorovi u zgjodh presidenti i parë. Hapi i ardhshëm me rëndësi në përforcimin e shtetit ishte miratimi i Kushtetutës së re (pa votat e deputetëve shqiptarë) më 17 nëntor 1991. Dhjetë vite më vonë, Kushtetuta u plotësua pas luftës së vitit 2001 dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit. Me marrëveshjen e Prespës që tejkalonte kontestin me Greqinë, emri i Maqedonisë pësoi ndryshim, duke u riemërtuar si “Maqedonia e Veriut”, kusht ky që ndikoi të anëtarësohet

në NATO, kurse pas nënshkrimit të protokollit me Bullgarinë këtë vit, filloi negociatat e anëtarësimit me Bashkimin European.

Shqiptarët e përjetuan në dy mënyra pavarësimin e Maqedonisë: në njërën anë pretendonin se po përfshiheshin në një proces demokratik, ku edhe kontributi i tyre me pjesëmarrje në jetën institucionale do të ndikonte në forcimin e kapaciteteve shtetndërtuese, kurse në anën tjetër, po shkëputeshin nga aspiratat shekullore për të jetuar në një shtet të përbashkët në Ballkan.

Shqiptarët kundërvihen me referendum për autonomi politike dhe territoriale

Por, pas pavarësimit të Maqedonisë, shqiptarët filluan ta ndiejnë anashkalimin që u bëhej nga nomenklatura e atëhershme politike maqedonase. Në të shumtën e rasteve, pjesëmarrja e shqiptarëve në pushtet më tepër kuptohej si dekor sesa si kontribut substancial i tyre, prandaj këto ishin edhe arsytet për organizimin e një referendumi të veçantë më 11 dhe 12 janar, 1992, ku populli shqiptar do të shprehte vullnetin e vet përmes deklarimit gjithëpopullor. Vendimin për shpalljen e referendumi për autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni e mori Kuvendi i Autonomisë më 27 dhjetor 1991. Zhvillime të këtilla politike, përmes deklarimit plebicitar, ishin karakteristikë e të gjithë popujve në ish-Jugosllavi, që përpiqeshin të fitonin lirinë përmes procesit demokratik. Në Maqedoni, referendumi i popullit shqiptar ishte kundërpërgjigje ndaj të gjitha vendimeve të njëanshme të faktorit politik maqedonas, të cilët anashkaluan skajshmërisht interesat kombëtarë të shqiptarëve.

Në vend të statusit shtetformues, shqiptarëve iu dhurua një paradhomë e sistemeve koloniale

Tani, pas 34 vjetësh nga pavarësimi i Maqedonisë si shtet, shqiptarët kaluan nëpër disa procese politike e institucionale, ku roli dhe kontributi i tyre ndikonte edhe në ruajtjen e baraspeshave gjeopolitike

e etnokulturore, që reflektoheshin përpos në konsolidimin e brendshëm si shtet, edhe në përmasa rajonale.

Të gjitha qeveritë që u formuan në Maqedoni u bazuan mbi parimin e multietnicitetit, mirëpo kur filluan të funksionojnë në praktikë, ato i ktheheshin avazit monoetnik. Madje, ngandonjëherë ato funksiononin aq papengueshëm, saqë ishte vështirë të dalloje nëse ato qeveri funksiononin me apo pa partnerët shqiptarë. Dilema bëhej më e madhe, kur nacionalizmi institucional maqedonas ndodhte para hundës së përfaqësuesve shqiptarë të pushtetit. Për rrjedhojë ndodhi 2001, kur akumulimi i pakënaqësive të shqiptarëve mori formën e rezistencës së armatosur. Pasi marrëveshja paqësore e Ohrit dhe domosdoja e ndryshimeve kushtetuese, ku shqiptarët morën disa të drejta që nuk i kishin, por sërish ngelën si një element joshëtformues në funksionimin praktik të shtetit të Maqedonisë. Në vend të statusit shtëtformues, shqiptarëve iu dhurua një paradhomë e sistemeve koloniale, që përkufizohej përmes 20 përqindëshit, si element që shprehte njëfarë autonomie kulturore-gjuhësore, por pa kurrfarë garancie kushtetuese.

Edhe përkundër kësaj qasjeje retrograde ndaj pozitës kushtetuese në Maqedoninë e Veriut, shqiptarët sërish treguan ndjenjë të lartë lojaliteti ndaj shtetit që nuk i përmbushte të gjitha nevojat dhe aspiratat e tyre. Sa herë që Maqedonia kalonte nëpër kriza dhe turbulenca identitare, shqiptarët treguan mirëkuptim ndaj fqinjëve të tyre maqedonas, duke i flijuar agjendat e tyre etnike. Por ky lojalitet i shqiptarëve mbeti i pavlerësuar nga politikanët maqedonas. Deri më tani shumë rrallë na ka rënë të dëgjojmë ndonjë kryeministër maqedonas të ketë shprehur publikisht mirënjohje për rolin konstruktiv të partnerëve shqiptarë në mirëkuptimin e proceseve, ku në të shumtën e rasteve shqiptarët si kolektivitet, formimin e subjektivitetit të tyre kushtetues e këmbenin me lojalitet ndaj shtetit të Maqedonisë.

Subjektiviteti juridiko-kushtetues i shqiptarëve pa një platformë politike shqiptare

Forcimin e subjektivitetit të tyre kushtetues shqiptarët jo rrallë e këmbenin edhe me luftën brenda llojit. Në kushte të tilla, të një konkurrence të çuditshme politike brendashqiptare, nacionalizmi institucional maqedonas lulëzonte pa pengesa, ndërkohë që ambiciet joracionale të shqiptarëve mbanin gjallë këtë nacionalizëm, duke prodhuar altruizëm të tepruar dhe, herë-herë, duke plasuar ide bajate për ruajtjen e Maqedonisë nga prirjet dezintegruese. Prandaj fuqia politike e faktorit vendimmarrës maqedonas është varur gjithmonë nga shkalla e kohezionit brendashqiptar dhe e mungesës së bashkëpunimit dhe e bashkërendimit të forcave politike të shqiptarëve.

Marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe maqedonasve mund të degradohen edhe në të ardhmen në përmasa brengosëse, nëse nuk ndërhyhet shpejt në gjetjen e një kompromisi afatgjatë, duke ndërhyrë në ato çështje që barasvlerësojnë cilësinë e përfaqësimit përmes projekteve konkrete e shumë urgjente dhe kapacitetin e shtetndërtimit.

Sipas Kushtetutës aktuale, shqiptarët kanë statusin e banorëve nën çadra me stacionim të përkohshëm

Logjika e segmenteve të caktuara të politikës shqiptare në Maqedoni për të zaptuar një copë pushtet në oborrin e kryeministrave maqedonas, ende pa ndodhur faktorizimi i vërtetë i shqiptarëve, ka degjeneruar në kuptimin e përfaqësimit dinjitoz institucional të tyre.

Sa iu shpagua shqiptarëve kostoja e lojalitetit, duke filluar nga fillimi i viteve '90 e deri më sot? Në vitet '90 shqiptarët vepronin nën ombrellën e një kushtetute, që nuk e shprehte realitetin shumetnik të shtetit, por më vonë, kur u bënë ndryshimet kushtetuese, u definua statusi i shqiptarëve dhe ka një shpërputhje mes luftës që ata bënë në 2001-in dhe trofeve politike të asaj lufte, që shqiptarët megjithatë i klasifikon si pakicë kombëtare në të gjitha ligjet që dalin nga kushtetuta aktuale.

Nëse në vitet '90 Gligorovi u thoshte shqiptarëve: "Rrini urtë, mos kërkonit shumë, se po e irritoni VMRO-në nacionaliste!", tani

shqiptarëve u thuhet gati e njëjta gjë, por me një konotacion dhe ambalazh tjetër.

Tani u thuhet shqiptarëve se duhet të rrinë urtë, sepse rrymat proruse dhe proserbe e shfrytëzojnë këtë si avantazh për ta destabilizuar Maqedoninë dhe, për pasojë, për ta rrezikuar kauzën e saj europiane. Lojaliteti i shqiptarëve përdoret si terapi gjeopolitike, sepse vetëm shqiptarët qenkan ata që po i përcaktuakan kauzat europiane të shtetit! Madje, me çmim që ata të jenë ekstremisht luajalë, ndërkohë që autorët dhe redaktorët maqedonas, në librat e tyre shkollorë, pa fije turpi dhe shpengueshëm, i trajtojnë shqiptarët si ardhacakë dhe si uzurpatorë.

Në njërën anë shqiptarëve u kërkohet të jenë luajalë ndaj shtetit të Maqedonisë, kurse në anën tjetër, ata trajtohen si një trup i huaj i këtij shteti. Madje, shqiptarët “ardhacakë” dhe “uzurpatorë”, siç quhen në librat e shkollarëve maqedonas, qenkan përcaktuesit gjeopolitikë të Maqedonisë Europiane (!).

Tani thuhet se janë bërë ndryshime kushtetuese, por shqiptarët sërish nuk janë një komb shtetformues në Maqedoninë e Veriut. Janë avancuar shumë çështje, siç është çështja e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe dhe ajo e përfaqësimit të duhur, por të gjitha këto çështje nuk janë bërë kategori kushtetuese. Mjafton të shikohet *Ligji për Shtetësi*, ku kusht për marrjen shtetësisë së Maqedonisë është njohja e gjuhës letrare maqedonase (!).

Askund nuk përmendet gjuha shqipe dhe, për pasojë, plot shqiptarë janë refuzuar të pajisen me shtetësi, vetëm sepse nuk e kanë zotëruar mirë (me shkrim dhe me gojë) gjuhën letrare maqedonase. Sikur gjuha shqipe të ishte kategori kushtetuese, shqiptarët do ta merrnin automatikisht shtetësinë e Maqedonisë, por kjo nuk ndodh, sepse sovraniteti shtetëror ende buron nga shtylla shtetformuese e popullit maqedonas. Shqiptarët e Maqedonisë aktualisht ndodhen mes të drejtave ligjore dhe kufizimeve kushtetuese.

Sikurse dihet, kushtetutshmëria e një të drejte është më e lartë se ato që definojnë me ligje, sepse këto të fundit dinë të jenë edhe

kontradiktore dhe të dyfishta, siç është, bie fjala, *Ligji për Përdorimin e Gjuhëve*, në të cilin nuk përmendet askund gjuha shqipe, për arsye të boshllëqeve kushtetuese, kështu që shqiptarët, megjithatë, klasifikohen si qytetarë të rendit të dytë, pas maqedonasve, të cilët janë shtylla e kombit shtetformues.

Në planin praktik kjo është lehtësisht e vërejtshme dhe e prekshme, madje edhe tepër eksplicite, për arsye se liderët maqedonas, bie fjala, mund të takohen kur t'u teket dhe të vendosin si t'u teket, pa marrë mundin që për këtë të kenë edhe miratimin paraprak të politikanëve shqiptarë. Ky miratim mund të vijë post-festum, por kjo flet për diçka tjetër.

Për çka flet kjo? Kjo flet se maqedonasit e shohin veten si shtyllë të kombit shtetformues, kurse shqiptarët i shohin si mbështetës të këtyre shtyllave. Në dioptrinë maqedonase, shqiptari duhet të jetë ekstremisht luajal ndaj shtetit (të maqedonasve) dhe ata (maqedonasit) vendosin se sa të drejta (ose sa kilogram të drejta) duhet të kenë shqiptarët. Të drejtat e shqiptarëve aktualisht u ngjasojnë marrëdhënieve mes shitësit dhe blerësit që blen mall me veresi. Ky i fundit, për të mos hyrë më shumë në borxh, është i detyruar që groshën të mos e blejë me kilogram, por kokrra-kokrra, shalqirin ta blejë me flegra, kurse akullloren ta shijojë duke e lëpirë xhamin e ëmbëltores.

Në dioptrinë maqedonase në Maqedoni nuk jeton kombi autokton shqiptar, por “një pjesë e kombit shqiptar” që ndodhet diku, jashtë territorit të Maqedonisë. Kjo i bie që shqiptarët në Maqedoni, pasi janë pjesë e kombit shqiptar, janë ca kalimtarë të rastit, që i kanë hapur çadrat dhe përkohësisht janë vendosur në tokën e “shenjtë maqedonase”.

Me fjalë të tjera, shqiptarët, sipas Kushtetutës aktuale të Maqedonisë së Veriut, shqiptarët e kanë statusin e banorëve nën çadra me stacionim të përkohshëm, kurse madhësia e çadrave, si edhe hapësira që zënë ato aktualisht përcaktohen me ligj.

Në dioptrinë maqedonase nuk ka gjuhë zyrtare shqipe në Maqedoni, por ka një popullatë prej 20% që e flet atë gjuhë. Nesër t'u teket romëve me u bë 20% komod mund ta përdorin zyrtarisht gjuhën e tyre, sepse këtë ua garanton ligji. Procesi i shtetformësisë së shqiptarëve është kapitulli i ri i marrëdhënieve mes dy popujve më të mëdhenj në Maqedoninë e Veriut. Pa rrumbullakimin e këtij procesi, perspektiva e Maqedonisë së Veriut do t'i ngjante një fryti gjysmë të pjekur, dhe garës se kush do të arrinte të vilte sa më shumë fruta të pjekura.

A ka rrezik që shqiptarëve sërish t'u mpihen dhëmbët, për shkak të ofertave gjysmake në kopshtin europian me fruta (të kontrabanduara) ballkanike?

Tani kur Maqedonia e Veriut po feston 34-vjetorin e pavarësisë, shqiptarët si duket ende nuk kanë nxjerrë mësim, pasi te shqiptarët ka politikë, por nuk ka platformë dhe strategji për veprime afatgjata. Te shqiptarët ka politikanë, por nuk ka lidership. Duke qenë kundërthënës e mospajtues ndërmjet tyre dhe shumë kohezivë e kooperues me maqedonasit, kjo ka ndikuar që politikat hermafrodite të shqiptarëve “të avullohen” në paradhomat e politikës maqedonase. Në mungesë të një “kompasi” strategjik e ideor, partitë shqiptare jo rrallë kanë humbur rrugën në planimetrinë politike maqedonase dhe, për pasojë, faturën e tyre e paguanin shqiptarët, ndonëse kjo pakënaqësi ende nuk ka arritur të formalizohet në trajtat e një platforme të fuqishme opozitare. Se çfarë fituan dhe çfarë humbën shqiptarët, përgjigjen më të mirë e dhanë proceset nëpër të cilat kaluan ata, por një përgjigje më të përpiktë do të duhej ta japin brezat e ardhshëm, të cilët merren me politikë e nuk do ta kuptojnë vetëm si mekanizëm ardhjen në pushtet, por edhe si katalizator që rregullon kompleksitetin shoqëror, ekonomik, politik e kulturor të jetës së shqiptarëve.

Shkup, 8 shtator 2025

2.5 RAST STUDIMI: POLITIKA E JASHTME E VENDEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Nga Gëzim Rushiti, PhD

Abstrakt

Politika e jashtme paraqet përmbledhjen e veprimeve politike që rregullojnë marrëdhëniet dhe ndërveprimet e një shteti me një shtet tjetër, ose marrëdhëniet e një shteti me disa shtete të tjera ose me organizatat e tjera në botë. Qëllimi i politikës së jashtme është që të ndihmojë qeveritë për të mbrojtur interesat e tyre kombëtarë, sigurinë e vendit, pikëpamjet ideologjike, qëndrimet politike dhe prosperitetin ekonomik. Zhvillimi i politikës së jashtme të një vendi ndikohet nga politika e tij e brendshme, pozicioni i tij në skenën ndërkombëtare, politikat dhe sjellja e vendeve të tjera, si dhe konteksti specifik gjeopolitik në të cilin ndodhet vendi. Shtetet i përcaktojnë qëllimet e tyre të politikës së jashtme në varësi të fuqisë që kanë në dispozicion për t'i arritur ato qëllime. Tempulli i diplomacisë dhe i politikës së jashtme të një shteti është Ministria e Punëve të Jashtme. Analiza e politikës së jashtme fillon me teoritë që identifikojnë faktorë të ndryshëm, forca të ndryshme që ndikojnë në politikën e jashtme të një shteti.

Maqedonia e Veriut procesin e formësimit të politikës së jashtme e ka filluar që nga pavarësia e saj në vitin 1991. Politika e jashtme ka të bëjë me qëllimet dhe aktivitetet politike për marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me shtetet dhe me organet, organizatat dhe bashkësitë ndërkombëtare, të cilat i realizojnë interesat e Republikës së Maqedonisë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe i mbrojnë interesat e qytetarëve të saj. Politika e mirëfilltë e jashtme e Shqipërisë fillon me krijimin e qeverisë së parë shqiptare të vitit 1912, me kryeministër Ismail Qemalin. Si një shtet i ri i sapoformuar, politikat e jashtme të Shqipërisë ishin ende të brishta, të paorientuar dhe pa qëllime konkrete. Me kalimin e viteve Shqipëria

filloi dhe përforcoi pozitat e saj, me ngjitje, me ulje dhe me vështirësi të shumta, me përçarje dhe me kërcënime për ndryshim kufijsh nga fqinjët. Në shekullin XXI kemi një ridimensionim të politikave globale jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën. Rrëfimi mbi politikën e jashtme të Kosovës është një interpretim mbi procesin e shtetndërtimit ndërkombëtar në Kosovë.

Historia e politikës së jashtme, me të gjitha arritjet e sfidat e saj, me sukseset e konsiderueshme e problemet e shumta, është në të njëjtën kohë edhe imazhi i Kosovës së paspavarësisë. Pra, politika e jashtme në rastin e Kosovës është e lidhur në mënyrë organike me procesin e shtetndërtimit që nga viti 2008. Në këtë mënyrë, rrëfimi kuptimplotë i politikës së jashtme të Kosovës nuk mund të bëhet jashtë kornizës së narrativës së shtetndërtimit. Shtetndërtimi në Kosovë është një proces që vazhdon ende dhe ajo shpërfaq ndarjen e madhe ndërmjet një bote të shkuar dhe një toke që po bëhet. Serbia po përdor strategjinë e saj të politikës së jashtme për të ndjekur një bashkëpunim të mirë si me Rusinë, ashtu edhe me BE-në, të cilat deri më tani kanë qenë të suksesshme në aspektin e aftësisë për të blerë naftë dhe gaz rus me zbritje, si dhe të sigurojë një mbështetje ushtarake për Kosovën, por edhe në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Përpyekja për pavarësinë e Malit të Zi dhe largimi nga shteti i përbashkët me Serbinë, të cilat ishin të ndërmjetësuara dhe jo të mbështetura nga BE-ja, gjeneruan një divergjencë në politikën e jashtme të Malit të Zi nga ajo e Serbisë. Politika e jashtme e Malit të Zi u formësua gradualisht nga ajo e një republike në Republikën Federale të Jugosllavisë në atë të një shteti të pavarur. Politika e jashtme bashkëkohore e Bosnjë-Hercegovinës, e cila e nxjerr legjitimitetin dhe ligjshmërinë e saj nga Kushtetuta dhe ligjet e sjella nga viti 1992 e deri më sot, është përbërësi kryesor i kthimit të shtetësisë boshnjake në kuptimin formal-juridik. Pra, 'de jure' filloi në vitin 1992, por 'de facto' në vetëdijen etno-territoriale të një pjese të madhe të popullsisë së saj është e pranishme që nga koha e shtetit

mesjetar boshnjak. Parimet e politikës së jashtme të Bosnjë-Hercegovinës përcaktohen nga Presidenca e Bosnjë-Hercegovinës, siç përmendet në dokumentin kyç për politikën e jashtme.

Fjalët kyç: politika e jashtme, politika e jashtme e shteteve të Ballkanit Perëndimor, strategjitë, instrumentet

Politika e jashtme

Politika e jashtme paraqet një tërësi qëllimesh, që udhëheq dhe drejton veprimtarinë e shtetit dhe marrëdhëniet e tij me shtetet e tjera në skenën ndërkombëtare, me qëllim ruajtjen dhe realizimin të interesave të shtetit dhe qytetarëve të tij. Zhvillimi i politikës së jashtme të një vendi ndikohet nga politika e tij e brendshme, pozicioni i tij në skenën ndërkombëtare, politikat dhe sjellja e vendeve të tjera, si dhe konteksti specifik gjeopolitik në të cilin ndodhet vendi. Shtetet i përcaktojnë qëllimet e tyre të politikës së jashtme në varësi të fuqisë që kanë në dispozicion për t'i arritur ato qëllime.¹

Politika e Jashtme është mbrojtja dhe promovimi i interesave nacionalë, sigurisë kombëtare, ekonomisë dhe ideologjisë së një shteti. Gjithashtu mund ta përkufizojmë si një përmbledhje të veprimeve politike, që rregullojnë marrëdhëniet e një shteti në raport me një shtet tjetër ose organizatave të tjera.

Tempulli i diplomacisë dhe i Politikës së Jashtme të një shteti është Ministria e Punëve të Jashtme. Nismëtari i saj ka qenë Kardinali Rishelje (Francë), i cili ndihmoi në formimin e saj në vitin 1626. Një shtet (qeveri), nëpërmjet Ministrisë të Punëve të Jashtme koordinon punët, strategjitë dhe planet, afatshkurtra dhe afatgjata, që duhen realizuar. Mjeti më i rëndësishëm dhe më i përshtatshëm i Politikës së Jashtme të një shteti, që nga fillimet e hershme të saj, ka qenë dhe është *diplomacia*.²

Analiza e politikës së jashtme që nga fillimi i saj, ka përfshirë ekzaminimin se si merren vendimet e politikës së jashtme dhe ka supozuar se qeniet njerëzore, duke vepruar individualisht ose në

kolektivitet, janë burimi i shumë sjelljeve dhe ndryshimeve më të mëdha në politikën ndërkombëtare.³

Analiza e politikës së jashtme fillon me teoritë që identifikojnë faktorë të ndryshëm, forca të ndryshme që ndikojnë në politikën e jashtme të një shteti.

Shumica e analistëve pranojnë se çdo shpjegim i politikës së jashtme zakonisht përfshin faktorë të shumtë. Këta faktorë të shumtë mund të grupohen në dy kategori të gjera shpjegimesh: ata që kanë të bëjnë me faktorë jashtë shtetit dhe ata që kanë të bëjnë me faktorë brenda shtetit.

- **Kategoria e parë** tregon mjedisin ndërkombëtar si shpjegim për politikën e jashtme të vendeve. Me fjalë të tjera, faktorët e jashtëm të shtetit, mënyra se si është organizuar sistemi ndërkombëtar, karakteristikat e marrëdhënieve ndërkombëtare bashkëkohore dhe veprimet e të tjerëve mund ta bëjnë shtetin të reagojë në mënyra të caktuara.
- **Kategoria e dytë** tregon për faktorë të brendshëm të shtetit. Me fjalë të tjera, karakteristikat e sistemit politik të brendshëm - qytetarët dhe grupet brenda atij sistemi, organizatat qeveritare dhe udhëheqësit individualë - shërbejnë si burim i politikës së jashtme të një shteti. Siç u përmend më parë, studimi i politikës së jashtme lidh në mënyrë unike studimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me politikën e brendshme, duke marrë parasysh se si faktorët e brendshëm dhe të jashtëm ndikojnë në sjelljen e shtetit.⁴

Politikëbërësit në politikën e jashtme nuk duhet vetëm të vendosin se çfarë objektivash duhet të ndiqen, por edhe si të realizohen ata, se çfarë instrumentesh duhet të përdoren për t'u përmbushur ata objektiva. Në varësi prej specifikave të situatës në fjalë dhe resurseve të fuqisë që ka shteti, numri i instrumenteve që mund të përdoren mund të jetë i kufizuar apo më i madh.

Zgjedhja e instrumenteve në politikën e jashtme është aq e rëndësishme, sa edhe vetë objektivat, sepse zgjedhja e mjeteve jo të duhura për të arritur ata objektiva mund të dëmtojë vetë realizimin e

tyre. Çdo instrument është i kushtueshëm, por nuk është e lehtë të matet kostoja e çdo instrumenti.

Megjithatë, kostoja si çështje humb rëndësinë e saj në rastet kur veprimi është i ngutshëm dhe rreziku është i madh. Çështja tjetër që duhet të merret në konsideratë është matja e efektivitetit që mund të arrihet me atë instrument. Kjo komplikohet edhe më tej, kur me të njëjtin veprim synohet arritja e disa objektivave përnjëherësh. Gjithashtu, kur bëhet zgjedhja e instrumenteve, duhet të merret parasysh konteksti në të cilin ato duhet të operojnë. Strategjia ekonomike nuk mund të funksionojë njësoj në shtete të ndryshme me zhvillim të ndryshëm ekonomik.⁵

Politika e jashtme përcaktohet si e organizuar nga shteti, pra organet e saj të caktuara me ligj, të cilat veprojnë si aktorë të vendimmarrjes së politikës së jashtme dhe ekzekutuese të vendimeve të caktuara. Në të gjithë veprimtarinë në planin e politikës së jashtme, shteti përpiqet të kënaqë vlerat dhe interesat e tij në masën më të madhe dhe në çdo situatë. Këto vlera dhe interesa janë rezultat i kushteve të ndryshme, traditave, mirëkuptimeve, kulturës, mënyrës së jetesës dhe mjedisit ndërkombëtar etj.

Duke i theksuar shtetet si subjektet kryesore ku drejtohet politika e jashtme e shtetit tjetër, në radhë të parë theksojmë faktin se ato janë partnerët dhe rivalët më të rëndësishëm. Emërtimi i atyre subjekteve kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare nuk e zvogëlon në asnjë mënyrë vlerën e subjekteve të tjera ndërkombëtare. Sidomos organizatat ndërkombëtare, por vetëm i vendos ato në sfond, duke qenë se në botën e sotme gjithnjë e më shumë u kushtohet vëmendje subjekteve të ndryshme ndërkombëtare.

Nga përkufizimi perceptohet se mungon denotimi i politikës së jashtme si plan, program veprimi ose perceptim i caktuar i aktorëve. Pikërisht për shkak të situatës së ndryshme në të cilën krijohet politika e jashtme, duket se është e vështirë të cilësohet si veprimtari e bazuar në plan dhe program të paracaktuar, duke qenë se shumë shpesh nuk ekziston. Në të njëjtën mënyrë, theksimi i vetëm i momentit të

reagimit ndaj veprimeve nga jashtë nuk do të ishte i saktë, pasi do të tërhiqte vëmendjen vetëm në një komponent të veprimtarisë së politikës së jashtme. Kjo është arsyeja pse ne konsiderojmë se veprimtaria e organizuar e një shteti duhet kuptuar si tërësi e veprimit, që përfshin perceptimet e aktorëve të politikës së jashtme, përgjigjet ndaj sjelljes së vendeve në marrëdhëniet ndërkombëtare, zgjidhjen e situatave konkrete dhe, së fundi, përpjekjet për të realizuar ngadalë në praktikë planet afatgjata të veprimit të politikës së jashtme, nëse ato ekzistojnë.⁶

Politika e jashtme mbron dhe promovon interesat nacionalë, sigurinë kombëtare, favoret ekonomike dhe kulturore, si dhe qëllimet ideologjike e politike të një shteti. Ajo është përmbledhje e veprimeve politike që rregullojnë marrëdhëniet dhe ndërveprimet e një shteti me shtetet apo organizatat e tjera në botë. Politikat e jashtme janë, sipas Joshua Goldstein, strategjitë që përdorin shtetet, respektivisht qeveritë për të adresuar çështje të ndryshme në veprimet e tyre në sferën ndërkombëtare. Politika e jashtme është e dizajnuar, me qëllim që të ndihmojë qeveritë për t'i mbrojtur interesat e tyre kombëtarë, sigurinë e vendit, pikëpamjet ideologjike, qëndrimet politike dhe prosperitetin ekonomik.⁷

Politika e jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Politika e jashtme ka të bëjë me qëllimet dhe aktivitetet politike për marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë me shtetet dhe me organet, organizatat dhe bashkësitë ndërkombëtare, të cilat realizojnë interesat e Republikës së Maqedonisë së Veriut në marrëdhënie ndërkombëtare, mbrojnë interesat e qytetarëve të saj, personat juridikë të regjistruar nga ai, në veçanti: ruajtja, konfirmimi dhe avancimi i interesave themelore të Republikës së Maqedonisë, ruajtjen e sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial të Republikës së Maqedonisë dhe rendit kushtetues të saj, respektimin dhe promovimin e vlerave themelore të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ndarjen e vlerave, interesave dhe vullnetit për asociim bazuar në një

marrëveshje të barabartë dhe në përputhje me Kushtetutën, forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në mbarë botën, bazuar në të drejtat dhe liritë e njeriut dhe nëpërmjet zbatimit dhe respektimit të tyre në të drejtën ndërkombëtare, ruajtja e paqes botërore, parandalimin e konflikteve dhe forcimin e sigurisë ndërkombëtare, në përputhje me parimet e përfshira në Kartën e OKB-së, si dhe me parimet e Dokumentit Përfundimtar të Helsinkit dhe qëllimet e Kartës së Parisit, duke përfshirë ato për kufijtë e jashtëm dhe zhvillimin e përmirësimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit të Republikës së Maqedonisë me fqinjët e saj dhe me të gjitha shtetet, bilaterale dhe multilaterale, në organizatat rajonale dhe globale.⁸

Maqedonia e Veriut procesin e formësimit të politikës së jashtme e ka filluar që nga pavarësimi i saj në vitin 1991. Ky vend e filloi menjëherë procesin e ndërtimit dhe të anëtarësimit të tij në institucionet ndërkombëtare dhe paralelisht u angazhua në forcimin e shtetit dhe zgjerimin e komunikimit e bashkëpunimit me mekanizmat e ndryshëm ndërkombëtarë.

Veprimtaritë që kishin për qëllim forcimin e subjektivitetit të saj në arenën ndërkombëtare dhe fuqizimin e shpejtë në marrëdhëniet bilaterale me të gjitha shtetet, dhanë rezultat për RMV-në dhe përfundimisht ajo u bë anëtare i Kombeve të Bashkuara më 8 prill të vitit 1992, si dhe pjesë e të gjitha agjencive të specializuara, programeve dhe fondeve nga sistemi i OKB-së. Ky anëtarësim i mundësoi Maqedonisë së Veriut krijimin e linjave të para direkte me të gjitha diplomacitë e botës përmes mekanizmave ndërkombëtarë, të cilët në procesin e ardhshëm do të forconin juridiksionin kushtetues edhe në rrafshin ndërkombëtar.

Rëndësinë dhe përfitimet nga anëtarësimi në Kombet e Bashkuara, Republika e Maqedonisë së Veriut i përdori edhe për anëtarësim në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë, si Organizata Europiane për Bashkëpunim dhe Siguri dhe në Këshillin e Europës. Nga viti 2003, Maqedonia e Veriut është anëtare e Organizatës

Botërore të Tregtisë, ndërsa nga viti 2006 është anëtare e Marrëveshjes për Tregti të Lirë të Europës Qendrore.⁹

Organet për kryerjen e punëve të jashtme janë: Presidenti i Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë, përfaqësuesit diplomatikë-konsullorë dhe nëpunësit diplomatikë konsullorë.¹⁰

Në realizimin e punëve dhe politikës së jashtme, organet për kryerjen e punëve të jashtme përcaktojnë kahet e përgjithshme, marrin dhe miratojnë vendime për aktivitete dhe qëndrime dhe i realizojnë me një bashkëpunim të ndërsjellë e të harmonizuar të gjitha aktivitetet shtetërore lidhur me punët e jashtme.¹¹

Politika e jashtme është një nga fushat, ku Presidenti ka kompetenca në lidhje me drejtimet strategjike të vendit, përfaqësimin e tij jashtë, mënyrën se si bëhet politika e jashtme, mundësitë për bashkëpunim të ri, si edhe vendosjen e kuadrit të diplomacisë. Rolin e Presidentit në përfaqësimin e Republikës e përcaktojnë Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe *Ligji për Punët e Jashtme*.

Në përputhje me të drejtën dhe ndërkombëtare dhe zakonet, si përfaqësuesi më i lartë i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Presidenti e përfaqëson shtetin në suaza ndërkombëtare, sidomos në kontaktin dhe komunikimin me shtetet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare. Gjithmonë kur Presidenti qëndron në vizitë zyrtare apo pune në një shtet të huaj, ai përfaqëson Republikën e Maqedonisë së Veriut, kurse deklaratat zyrtare të Presidentit janë edhe qëndrim zyrtar i shtetit të Maqedonisë së Veriut.

Njëkohësisht, Presidenti merr pjesë në krijimin e politikës së jashtme në bashkëpunim me qeverinë nëpërmjet përcaktimit të drejtimeve të përgjithshme të politikës së jashtme, duke përfshirë edhe çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare me implikime mbi sigurinë dhe mbrojtjen e vendit; ndjek zbatimin e politikës së jashtme, si dhe për rezultatet dhe mosmarrëveshjet eventuale me organet e tjera për zbatimin e punëve të jashtme mund ta informojë Kuvendin, ku jep

propozime dhe merr pjesë në marrjen e qëndrimeve për çështje të caktuara të politikës së jashtme, që janë në kompetencën e tij. Këtu përfshihen edhe aspektet e sigurisë dhe të mbrojtjes, të cilat dalin nga marrëdhëniet ndërkombëtare; emëron dhe shkarkon, me dekret, ambasadorët dhe të dërguarit e posaçëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë shtetit në procedurë të përcaktuar me *Ligjin për Punët e Jashtme*; jep pëlqimin për dhënie agreementit shefit të përfaqësisë së huaj diplomatike, pranon letrat kredenciale dhe letrat e revokimit të përfaqësuesve të huaj diplomatikë në procedurë të përcaktuar me *Ligjin për Punët e Jashtme*.¹²

Politika e jashtme e Shqipërisë

Politika e mirëfilltë e jashtme e Shqipërisë filloi me krijimin e qeverisë së parë shqiptare të vitit 1912, me kryeministër Ismail Qemalin. Si një shtet i ri i sapoformuar, politikat e jashtme të Shqipërisë ishin ende të brishta, të paorientuar dhe pa qëllime konkrete. Me kalimin e viteve Shqipëria filloi të përforconte pozitat e saj, me ngjitje, me ulje dhe me vështirësi të shumta, me kërcënime për ndryshime kufijsh dhe me përçarje e kërcënime nga fqinjët.

Në shekullin XXI kemi një ridimensionim të politikave globale jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën. Shqipëria, një shtet me 3 milionë banorë, ndër vite ka pasur shumë probleme etnike, gjeografike, politike të brendshme dhe të jashtme. Por tashmë realiteti është ndryshe: Shqipëria është një vend anëtar i NATO-s, i cili është vetëm një hap larg Europës.¹³

Me ndryshimin e sistemeve nga komuniste në demokratike, qeveria e parë demokratike e drejtuar nga Sali Berisha u përball me sfida dërrmuese. Kjo periudhë do të përshkruhej me ulje-ngritje të performancës së saj në raport me marrëdhëniet e brendshme, por edhe me të politikës së jashtme në arenën ndërkombëtare në veçanti me vendet fqinje. Me gjithë krizat dhe pasiguritë që po kalonte vendi, vështirësitë si të punëve të brendshme, ashtu edhe të jashtme u

zhvilluan në një frymë konsensuale për disa prioritete, që mbeten konstante gjatë gjithë periudhës postkomuniste.

Këto prioritete ishin: hapja e Shqipërisë me botën, orientimi perëndimor i të gjitha politikave të jashtme dhe zhvillimore, normalizimi i marrëdhënieve me Fuqitë e Mëdha, veçanërisht me vendet perëndimore dhe vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, balancimi i marrëdhënieve me fqinjët bazuar në themele të reja të bazuara në interesat kombëtarë, si dhe vendosja e çështjes së Kosovës si pikë kryesore e rendit të ditës, deri në shpalljen e pavarësisë së saj.¹⁴

Studimet politike mbi Shqipërinë dhe politikën e saj të jashtme ndajnë një ide intuitive, se politika e një vendi të vogël si Shqipëria është ndikuar në masë të madhe nga konteksti ndërkombëtar, por fokusi te veçantia e Shqipërisë dhe zgjedhjet e veçanta metodologjike kanë sjellë nënvlerësimin e trajtimit sistematik të ndikimit të faktorit ndërkombëtar në formulimin e politikës së jashtme dhe rezultateve të lidhura me të. Kjo ka sjellë përqendrim te faktorë të brendshëm politik, si përgjegjës për politikën e jashtme të Shqipërisë.

Fokusi vendoset tek e veçanta. Politika e jashtme trajtohet si instrument i “udhëheqësit” të kohës, interesave dhe pikëpamjeve të tij. Politika e jashtme shihet si vijimësi natyrale e politikës së brendshme. Në këtë mënyrë humbet e përgjithshmja; ato linja dhe struktura që shkojnë përtej kohës, natyrës së regjimit politik dhe udhëheqësve politikë. Pikërisht ato tipare, që e bëjnë politikën ndërkombëtare dhe politikën e jashtme të ndryshme nga politika e brendshme. Këto tipare janë vetitë sistemike të politikës së jashtme, të cilat pa një kuptim të “natyrës” së sistemit ndërkombëtar dhe shtetit si njësi përbërëse, nuk mund të rrokten nga perceptimet empirike.¹⁵

Për realizmin e një politike të jashtme aktive marketingu dhe pragmatiste, me fokus te promovimi i interesave kombëtarë të vendit, nxitjes dhe tërheqjes së investimeve të huaja, si dhe nevojës për autoritet zyrtar në ndërveprim, brenda strukturës së Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria për Europën dhe Punët e

Jashtme është ngritur Drejtoria e Diplomacisë Ekonomike. Si një instrument i politikës së jashtme dhe si një njësi me funksion bazë të saj ndërveprimin, bashkërendimin dhe bashkëpunimin me struktura brenda dhe jashtë MEPJ-së, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me promovimin e interesave ekonomikë të vendit në tërheqjen e investimeve të huaja, promovimin e vendit, si destinacion turistik dhe promovimin e produkteve dhe të shërbimeve “Made in Albania”. Si një nga prioritetet e politikës së jashtme, diplomacia ekonomike dhe fuqizimi i dimensionit të saj, në kuadrin e bashkëpunimit ekonomik me vende partnere dhe strategjike, në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe interesave strategjikë të vendit, erdhi si nevojë dhe kërkesë e kohës dhe e globalizmit ekonomik, në të cilin influenca dhe kontrolli nëpërmjet diplomacisë ekonomie ka rritur rolin, forcën dhe përfshirjen e Ministrisë së Jashtme në tërësinë e dialogut të jashtëm ndërshtetëror, duke shkuar përtej tregtisë dhe investimeve, deri në zgjidhjen e konflikteve ndërkombëtare.

Me një agjendë gjithëpërfshirëse, diplomacia ekonomike trajton çështje që lidhen me marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare, marrëveshjet gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit ekonomik bilateral dhe multilateral, që lehtësojnë shkëmbimet midis palëve kontraktuese, eliminojnë divergjencat, problematikat e lindura në marrëdhëniet shtet me shtet dhe biznes me shtet, duke tentuar adresimin e saktë me zgjidhje më të mira, si dhe të harmonizojnë standardet në sektorë të ndryshëm ekonomikë, socialë, mjedisorë, arsimorë, kulturorë.¹⁶

Politika e jashtme e Kosovës

Rrëfimi mbi politikën e jashtme të Kosovës është një interpretim mbi procesin e shtetndërtimit ndërkombëtar në Kosovë. Historia e politikës së jashtme, me të gjitha arritjet dhe sfidat e saj, me sukseset e konsiderueshme e problemet e shumta, është në të njëjtën kohë edhe imazhi i Kosovës së paspavarësisë. Pra, politika e jashtme në rastin e Kosovës është e lidhur në mënyrë organike me procesin e shtetndërtimit që nga viti 2008. Në këtë mënyrë, rrëfimi kuptimplotë i

politikës së jashtme të Kosovës nuk mund të bëhet jashtë kornizës së narrativës së shtetndërtimit. Shtetndërtimi në Kosovë është një proces që vazhdon ende dhe ajo shpërfaq ndarjen e madhe ndërmjet një bote të shkuar dhe një toke që po bëhet.¹⁷

Objektivat strategjikë të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës janë:

1. forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar;
2. integrimi në strukturat euroatlantike;
3. promovimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore;
4. promovimi i vlerave të përgjithshme dhe i imazhit të Republikës së Kosovës në botë;
5. promovimi i interesave ekonomikë të Republikës së Kosovës.¹⁸

Politika e Jashtme e Republikës së Kosovës mbështetet në parimet e bashkëpunimit dhe fqinjësisë së mirë, paqes dhe stabilitetit me vendet e rajonit dhe më gjerë. Në këtë frymë, Kosova promovon marrëdhënie të mira fqinjësore, angazhohet për thellim të marrëdhënieve strategjike dhe të partneritetit rajonal, pjesëmarrjes aktive në organizata dhe nisma rajonale, si dhe në përmbyllje të dialogut me Serbinë përmes njohjes së ndërsjellë.

Promovimi i vlerave të përgjithshme dhe i imazhit të ri të Republikës së Kosovës në botë dhe promovimi i interesave ekonomikë të Republikës së Kosovës janë objektiva të veçantë, por me ndërlidhje të ngushtë mes tyre. Diplomacia e Kosovës do të jetë në shërbim të drejtpërdrejtë të promovimit të imazhit sa më pozitiv të vendit, përfshirë këtu nxitjen e investimeve të huaja direkte, promovimin e brendit kosovar të prodhimeve, ndërlidhjes me shoqata botërore të biznesit dhe bashkërendim me panairë relevante.¹⁹

Interesi jetik i një vendi ka të bëjë me identitetin fizik, politik dhe kulturor të kombit. Bazuar në këtë shpjegim, interesi jetik, parësor i Kosovës, është mbijetesa e saj si shtet brenda kufijve të saj të konstituuar dhe përballimi i suksesshëm i sfidave të tranzicionit. Kërcënimi i menjëhershëm për mbijetesën e Kosovës kryesisht ka karakter të brendshëm. Kjo duket të jetë një çështje e politikës dhe e

organizimit të brendshëm, që sido që të shihet nga thjerrëzat e fuqisë kombëtare dhe sigurisë kombëtare, ky interes jetik mund të ketë implikime të rëndësishme në politikën e jashtme të Kosovës dhe vendin e saj në sferën ndërkombëtare gjithashtu. Parimi i ruajtjes së pavarësisë dhe integritetit territorial të Kosovës brenda kufijve të saj të konstituuar, projektimi i stabilitetit dhe lufta në mbrojtje të interesave të saj kundër kërcënimeve të perceptuara të jashtme është interes jetik, i cili duhet të konsiderohet si gur themeli i platformës për interesin kombëtar të Kosovës. Prandaj politika e jashtme e Kosovës duhet të jetë gjithmonë e përkushtuar në mbrojtjen e këtij interesi jetik. Kjo do të thotë se institucionet e Kosovës duhet të jenë autoriteti i vetëm legjislativ dhe ekzekutiv brenda territorit të saj, duke qenë të pavarura nga çdo autoritet ligjor i shteteve të tjera, por gjithmonë në përputhje dhe duke respektuar të drejtën ndërkombëtare.²⁰

Politika e jashtme e Serbisë

Serbia, si republika më e madhe dhe më e rëndësishme në kuadër të Jugosllavisë, përbënte element të rëndësishëm gjeostrategjik në Ballkan. Gjithashtu, roli i saj në rrafshin botëror dhe në organizatat botërore ishte domethënës. Megjithatë, shpërbërja përfundimtare e ish-Jugosllavisë përgjatë konflikteve në vitet 1990-1999, e tkurri dhe e izoloi politikën e jashtme serbe në aspektin ndërkombëtar. Ndonëse këto zhvillime tashmë po kalojnë dekadën e tretë, duke i kaluar historisë, pasojat politike, ekonomike dhe vetizoluese të Serbisë vazhdojnë ta ndjekin edhe sot e kësaj dite. Dikur Serbia, përmes politikës së saj të jashtme, synonte forcimin e rolit të saj gjeopolitik ndërmjet Lindjes e Perëndimit dhe e konsideronte veten si urë lidhëse mes Rusisë e Gjermanisë dhe vendeve të tjera të painkuadruara.²¹

Vitet e fundit, Serbia zhvilloi një politikë të jashtme të bazuar në balancimin midis fuqive të mëdha dhe përpjekjes për të ruajtur lidhjet me to pa anuar plotësisht nga asnjëra prej tyre. Fuqitë e mëdha, rreth së cilave sillet më së shumti politika serbe, janë: BE, SHBA, Rusi dhe Kinë. Kjo politikë ka një themel të fortë të brendshëm, pasi

anketat e opinionit publik tregojnë pikëpamje tepër divergjente, se si opinionit publik serb i percepton këto katër fuqi të mëdha dhe se cila është dilema qendrore e politikës së jashtme serbe: mosmarrëveshja e Kosovës. Këto perceptime janë të dyja produkt i faktorëve objektivë, si p.sh., moszgjidhja e mosmarrëveshjes së Kosovës dhe mënyra se si lidhshipi serb komunikon me qytetarët e saj për këto çështje. Për çështje të tilla, si marrëdhëniet me Rusinë dhe Kinën, udhëheqja serbe projektton një narrativë, që ka më shumë gjasa të sjellë përfitime brenda vendit. Këto disponime divergjente ndihmojnë në formimin e balancimit të Beogradit midis fuqive të mëdha dhe politikës së tij të jashtme shumëplanëshe. Liderët serbë përpiqen të ruajnë një ekuilibër mes këtyre lojtarëve gjeopolitikë për të fituar votuesit e përçarë emocionalisht brenda vendit, duke dërguar edhe mesazhe për politikën e jashtme që do t'i forconte ata brenda vendit.²²

Rëndësia e politikës së jashtme të Serbisë nën Vuçiqin qëndron në qasjen e saj pragmatike, adaptive dhe strategjikisht autonome ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila i ka mundësuar kombit të lundrojë me shkathtësi në peripecitë e peizazhit bashkëkohor gjeopolitik, duke ruajtur gjithashtu interesat dhe sovranitetin e tij kombëtar. Kjo trashëgimi, e karakterizuar nga ndjekja e një ekuilibri delikat midis aspiratave për integrim europian dhe lidhjeve të qëndrueshme me aleatin e saj tradicional, Rusinë, ka të ngjarë të formësojë konturet e trajektores së politikës së jashtme të Serbisë për të ardhmen e parashikueshme.²³

Serbia po përdor strategjinë e saj të politikës së jashtme për të ndjekur një bashkëpunim të mirë si me Rusinë, ashtu edhe me BE-në, të cilat deri më tani kanë qenë të suksesshme në aspektin e aftësisë për të blerë naftë dhe gaz rus me zbritje, si dhe të sigurojë një mbështetje me Kosovën, mbështetje edhe ushtarake, edhe në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Pavarësisht se Serbia ka qenë në gjendje të shfrytëzojë situatën e fuqive konkurruese brenda vendit, ajo gjithashtu sugjeron fuqimisht, se ndoshta këto dinamika të moszbatimit të ndonjë ndryshimi të

politikës që do ta afronte ligjërisht dhe normativisht Serbinë dhe BE-në, mund të arrijë një pikë kthese nëse Serbia nuk e rishikon strategjinë e tyre.²⁴

Fatkeqësisht, para opinionit serb, politika e jashtme e saj vazhdon ende të promovohet si e rëndësishë së dikurshme që kishte dhe si trashëgimtare e potencialit diplomatik të ish-Jugosllavisë, si lidhja mes Lindjes dhe Perëndimit apo Bashkimit Europian dhe Ruisë. Mirëpo kjo tashmë është praktikisht e paqëndrueshme, veçanërisht në rendin e ri gjeopolitik brenda rajonit të Ballkanit.

Politika e jashtme serbe vazhdon ta sfidojë realitetin e ri ballkanik. Qasja e saj karshi zhvillimeve rajonale e globale, që karakterizohet me pozicionimin e ri të NATO-s drejt vendeve të Ballkanit dhe zgjerimin e BE-së në këtë rajon, paraqet stereotipin e diplomacisë serbe. Serbia vazhdon të mbetet e izoluar në rrafshin rajonal sa u takon raporteve fqinjësore dhe ofrimit të alternativave lidhur me zhvillimet e reja brenda rajonit. Ndërsa qasja e saj kundrejt proceseve ndërkombëtare vazhdon të prezantohet me shumë paqartësi.²⁵

Politika e jashtme e Malit të Zi

Përpjekja për pavarësinë e Malit të Zi dhe largimi nga shteti i përbashkët me Serbinë, të cilat ishin të ndërmjetësuara dhe jo të mbështetura nga BE-ja, gjeneruan një divergjencë në politikën e jashtme të Malit të Zi nga ajo e Serbisë. Politika e jashtme e Malit të Zi u formësua gradualisht nga ajo e një republike në Republikën Federale të Jugosllavisë në atë të një shteti të pavarur. Duke qenë se zhvillimet në politikën e jashtme të Malit të Zi u karakterizuan shumë nga marrëdhëniet midis Malit të Zi dhe Serbisë, ato mund të ndahen në katër periudha:

1. politika e jashtme me Serbinë brenda Jugosllavisë para vitit 1996;
2. politika e jashtme gjatë periudhës kur Mali i Zi kundërshtoi Millosheviqin, më 1997-2001;

3. politika e jashtme brenda Bashkimit Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi 2002-2006;

4. politika e jashtme pas pavarësisë 2006 e tani.²⁶

Prioritetet e politikës së jashtme të Malit të Zi, të përcaktuara pas rivendosjes së shtetësisë malazeze si rezultat i referendumit të vitit 2006, në të cilin më shumë se 55 për qind e qytetarëve malazezë vendosën kundër vazhdimit të bashkësisë së dy shteteve me Republikën e Serbisë nuk ndryshuan, pavarësisht humbjes zgjedhore të Partisë Demokratike të Qeverisë së hapur pro europiane dhe pro NATO-s, të udhëhequra nga Partia Demokratike në gusht 2020. Prandaj prioritetet kryesore të politikës së jashtme të dy qeverive pas Partisë Demokratike të Malit të Zi, veprimet e së cilave shënuan periudhën 2020 -2023, deri në zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të mbajtura më 11 qershor 2023, u përcaktuan si:

a. forcim i mëtejshëm i bashkëpunimit rajonal;

b. vazhdim i integritit në NATO;

c. vazhdimi i integritit në Bashkimin Europian.

Bashkëpunimi rajonal është një nga tri prioritetet kryesore të politikës së jashtme të Malit të Zi, i cili është gjithashtu në përputhje me kriteret e Kopenhagës të përcaktuara nga Këshilli European në qershor 1993.²⁷ Qeveria e Malit të Zi ka futur diplomacinë ekonomike në prioritetet e saj të punës për vitin 2021, duke njohur rëndësinë e tërheqjes së investimeve të huaja dhe promovimit të interesave ekonomikë ndërkombëtarisht.

Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Dypalëshe dhe Diplomacinë Ekonomike dhe Kulturore luan rolin qendror në modelin e integruar të institucionalizuar të diplomacisë ekonomike, si “pika e kontaktit dhe qendër mbështetëse” për të gjitha institucionet dhe organizatat e tjera që kanë marrëdhënie ekonomike me jashtë vendit, si dhe promovojnë interesat ekonomikë në fushën e tyre të punës. Ministria e Punëve të Jashtme bashkërendon diplomacinë ekonomike, mbështet dhe promovon aktivitetet e

eksportit dhe investimet e huaja direkte, jep informacion për të gjithë të interesuarit.²⁸

Integrimi european është një prioritet kyç në politikën e jashtme të Malit të Zi. Pas një periudhe stagnimi në zbatimin e reformave gjatë viteve të kaluara, gjatë këtij viti po bëhet progres në përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në BE. Ky proces nënkupton arritjen e progresit, para së gjithash, në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore dhe drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, për të mundësuar rezultate pozitive edhe në kapitujt e tjerë të negociatave. Këto reforma janë thelbësore jo vetëm për arritjen e kushteve për anëtarësim në BE, por edhe për krijimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të drejtë, që do të jetë në përputhje me vlerat dhe standardet.²⁹

Politika e jashtme e Bosnjë-Hercegovinës

Bosnjë-Hercegovina shpalli pavarësinë nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë më 15 tetor 1991, në mes të një krize të thellë dhe dramatike politike.³⁰

Politika e jashtme bashkëkohore e Bosnjë-Hercegovinës, e cila e nxjerr legjitimitetin dhe ligjshmërinë e saj nga Kushtetuta dhe ligjet e sjella nga viti 1992 e deri më sot, është përbërësi kryesor i kthimit të shtetësisë boshnjake në kuptimin formal-juridik, pra *de jure*, filloi në vitin 1992 por *de facto* në vetëdijen etno-territoriale të një pjese të madhe të popullsisë së saj është e pranishme që nga koha e shtetit mesjetar boshnjak.³¹

Parimet e politikës së jashtme të Bosnjë-Hercegovinës përcaktohen nga Presidenca e Bosnjë-Hercegovinës, siç përmendet në dokumentin kyç për politikën e jashtme. Në bazë të parimeve të përfshira në Kartën e OKB-së, Aktin Final të Helsinkit dhe dokumente të tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), si dhe në parimet e pranuar përgjithësisht të së drejtës ndërkombëtare, Bosnjë-Hercegovina, një shtet sovran dhe një vend i njohur ndërkombëtarisht, do të veprojë brenda kornizave ndërkombëtare, me fjalë të tjera, brenda kornizave dypalëshe, rajonale

dhe globale dhe do të rregullojë marrëdhëniet e dakorduara, si dhe marrëdhëniet e ndryshme me të gjitha vendet dhe organizatat ndërkombëtare.³²

Që nga zgjedhjet e vitit 1991, politika e jashtme në Bosnjë-Hercegovinë ka qenë e drejtuar nga një sërë aktorësh. Krahas politikës së jashtme nga Sarajeva, grupe të tjera kryen aktivitetet e tyre të politikës së jashtme kryesisht në mbështetje të agjendës së tyre të brendshme. Politikat e Sarajevës pas shpërbërjes së Jugosllavisë u përqendruan kryesisht në çështjet që ishin instrumentale për promovimin dhe mbijetesën eventuale të shtetit, ndërsa kërkonin të zhvillonte kapacitetet e politikës së jashtme, që nevojiten për një sjellje të duhur të punëve të jashtme.³³

Vendet me histori të gjatë, si Mbretëria Boshnjake, me qeverinë e tyre sovranë, kanë lënë gjurmë të përhershme arkaike, e cila do të zgjatë 529 vjet, dhe pavarësisht forcës dhe pranisë së gjatë të okupatorët dhe tendencave të përgjithshme asimiluese, ajo mban idenë e shtetit të vet.

Përpyekjet sporadike për rehabilitimin e shtetësisë dhe të pavarësisë, si ajo gjatë kryengritjes së kapitenit Husein Gradisceviq apo kryengritjes së popullit pas vendimeve të Kongresit të Berlinit, pastaj fitorja e madhe e idesë së shtetësisë boshnjake me vendimet e Këshillit Kombëtar Antifashist i Çlirimit Popullor të Bosnjës-Hercegovinës dhe Këshilli Antifashist i Çlirimit Popullor të Jugosllavisë, janë dëshmi e aspiratës së përhershme, të pranishme për ripërtëritjen e shtetësisë dhe sovranitetit në kuptimin e plotë të tyre.

Njohja ndërkombëtare e Republikës së Bosnjës-Hercegovinës dhe më pas ripërbërja e saj e brendshme e Dejtonit, kryesisht me qëllim të tejkalimit dhe dobësimit të forcave të brendshme dhe të jashtme centripetale shpërbërëse, ishin fillimi i modernitetit të shtetit dhe shoqërisë së re boshnjake. Kjo Bosnjë-Hercegovinë e re dëshmon kapacitetin e plotë të modernitetit të saj, ndër të tjera me politikën e saj të jashtme në vitet e fundit, e veçanërisht që nga formimi i

institucioneve të reja të bashkuara, proces i cili ka filluar në vitin 1996 dhe zgjati deri më sot.

Faktori historik është një nga përcaktuesit kryesorë standardë të brendshëm të politikës së jashtme dhe kontekstit të brendshëm të përgjithshëm rajonal dhe global të shpërbërjes së RSFJ-së, shpalljes së pavarësisë, pastaj lufta gati katërvjeçare me tipare dominuese të agresionit dhe gjithashtu elemente të konfliktit të brendshëm civil, do të përcaktojë në mënyrë të konsiderueshme kornizën për bërjen dhe zhvillimin e politikës së jashtme bashkëkohore të Bosnjë-Hercegovinës, në epokën e saj pas Dejtonit.³⁴

Ministria e Punëve të Jashtme në Bosnjë-Hercegovinë ka autoritet dytësor. Ajo është përgjegjëse për ekzekutimin e të gjitha aktiviteteve të politikës së jashtme të përcaktuara nga Presidenca e Bosnjë-Hercegovinës. Në praktikë, Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjëse për përfaqësimin e Bosnjë-Hercegovinës në marrëdhëniet diplomatike me vende të tjera dhe organizata ndërkombëtare, në konferenca ndërkombëtare dhe në komunikim të drejtpërdrejtë me agjencitë diplomatike dhe zyrat e organizatave ndërkombëtare. Ministria po monitoron edhe marrëdhëniet e Bosnjë-Hercegovinës me shtetet e tjera, organizatat ndërkombëtare dhe subjektet e tjera ndërkombëtare.

Ambasadat e Bosnjë-Hercegovinës në vende të tjera dhe organizatat ndërkombëtare rregullisht analizojnë dhe raportojnë në Ministri për të gjitha aktivitetet dhe ndryshimet institucionale në vendet pritëse. Ministria e Punëve të Jashtme e Bosnjë-Hercegovinës i paraqet Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës propozime për vendosjen ose pezullimin e marrëdhënieve diplomatike ose konsullore me vendet e tjera. Ministria e Punëve të Jashtme e Bosnjë-Hercegovinës është pjesë e Këshillit të Ministrive të saj si një nga nëntë ministritë shtetërore. Këshilli i Ministrave është organ i autoritetit ekzekutiv të Bosnjë-Hercegovinës, i cili ushtron të drejtat e tij dhe kryen detyrat e tij si funksione qeveritare, sipas Kushtetutës së

Bosnjë-Hercegovinës, ligjeve dhe rregulloreve të tjera të Bosnjë-Hercegovinës.³⁵

Përfundime

Politika e jashtme mbron dhe promovon interesat nacionalë, sigurinë kombëtare, favoret ekonomike dhe kulturore, si dhe qëllimet ideologjike e politike të një shteti. Ajo është përmbledhje e veprimeve politike që rregullojnë marrëdhëniet dhe ndërveprimet e një shteti me shtetet apo organizatat e tjera në botë. Politikat e jashtme janë, sipas Joshua Goldstein, strategjitë që përdorin shtetet, respektivisht qeveritë, për të adresuar çështje të ndryshme në veprimet e tyre në sferën ndërkombëtare. Politika e jashtme është e dizajnuar me qëllim që të ndihmojë qeveritë për të mbrojtur interesat e tyre nacionalë, sigurinë e vendit, pikëpamjet ideologjike, qëndrimet politike dhe prosperitetin ekonomik. Mbështetja e BE-së për perspektivën europiane të Ballkanit Perëndimor është e qartë. Shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet që të organizojnë dhe të angazhojnë të gjithë strukturën e tyre për të negociuar bisedimet e lidhura me anëtarësimin me BE-në në një mënyrë përfshirëse dhe transparente, duke përfshirë njëkohësisht qeverinë dhe opozitën, si edhe organizatat e shoqërisë civile, në mënyrë që procesi i anëtarësimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian të realizohet sa më shpejt.

Vendet e Ballkanit Perëndimor, në kuadër të reformave nga Plani i Rritjes, duhet që të deklarojnë synimet e tyre për harmonizimin e politikës së tyre të jashtme me politikat e BE-së. Harmonizimi me politikën e jashtme të përbashkët të BE-së është përfshirë, si synim specifik, në kuadrin e agjendave të reformave. Kjo do të thotë se vendet do të duhet të shpjegojnë në agjendat e reformave se si do t'i planifikojnë masat që do të marrin, të kontribuojnë në harmonizimin progresiv dhe të vazhdueshëm kur bëhet fjalë për politikën e jashtme.

Bibliografi

1. Adis Arapovic, Foreign policy of Bosnia and Herzegovina: determinates and perspectives, Centres of Civic Initiatives, Tuzla, B&H, Faculty of Political Sciences, University of Sarajevo, B&H, Bosnia and Herzegovina, 2010
2. Adnan Huskiq, Complex system, complex foreign policy: the foreign policy of Bosnia and Herzegovina, The foreign policies of Post-Yugoslav states, London, 2014.
3. Alban Përmeti, Foreign Policy Strategy of the Republic of Albania 1992 - 1997, Mediterranean Journal of Social Sciences MCSER Publishing, Rome-Italy, Vol 6 No 2 S1 March 2015.
4. Alfred Marleku, National Interest and Foreign Policy: The Case of Kosovo, Mediterranean Journal of Social Sciences, 2023
5. Boris Vukotić, Foreign policy priorities of Montenegro with special reference to obstacles to accession to the European Union, University of Zagreb, The Faculty of Political Science, Zagreb, 2024, f. 4
6. Debata nacionale për pozitën e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare, Anketa debatuese për avantazhet dhe sfidat e harmonizimit të Maqedonisë së Veriut me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Europian dhe anëtarësimi në NATO, Europena Policy Institute Skopje, National Democratic Debate, National Endowment for Democracy, Shkup, f. 1
7. Dokumenti strategjik për politikën e jashtme, Draft strategjia e politikës së jashtme, Republika e Kosovës, Qeveria-Zyra e Kryeministrit, Zyra për qeverisje të mirë, 2018
8. Emir HADŽIKADUNIĆ, Foreign policy of Bosnia and Herzegovina: key principles, challenges and achievements, Bosnia and Herzegovina: Law, Society and Politics, International University of Sarajevo, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina, 2016.
9. Fidan Mustafa, Gjeopolitika e Ballkanit - e ardhmja e shqiptarëve në rajon, Tiranë, 2022.

10. Jovanovic, Srdan, The Evolution of Serbian Foreign Policy under Vucic: Navigating between the European Union and Russia. *Perspective Politice*. Vol. XVI (1-2), 2023.
11. Jelena Džankić, From Creeping to Sprinting: The Foreign Policy of Montenegro, The foreign policies of post-yugoslav states, Palgrave Macmillan London, 2014.
12. Jugert Jorgo, Politika e jashtme në mirëqeverisje, Shkolla Shqiptare e Studimeve Politike, Tiranë, 2013.
13. Juliet Kaarbo, Jeffrey S. Lantis, and Ryan K. Beasley, The Analysis of Foreign Policy in Comparative Perspective, Chapter 1, CQ Press, Washington, D.C., 2013.
14. Korab Krasniqi, Politika e Jashtme dhe Diplomaci, University for Business and Technology - UBT, Prishtinë, 2011
15. Ligji për punët e jashtme, Fletorja Zyrtare. i R.M.V Nr: 46/2006 nga 10.04.2006, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut
16. Maja Bjelos, Vuk Vuksanovic, Luka Steric, Many Faces of Serbian Foreign Policy Public Opinion and Geopolitical Balancing, Belgrade Centre for Security Policy (BCSP), 2020.
17. Mikkel Severin Jensen, Serbia as a Geopolitical Partner In between East and West, *Malmö University*, 2023.
18. Milika Mirkovic, Montenegro external relations briefing: EU integration: one step closer to IBAR, China CEE Institute, Weekly Briefing, Vol. 73, No. 4 (ME) May 2024
19. Mentor Beqa, Shqipëria e “kërcënuar”: politika e jashtme e Enver Hoxhës, Universitetit Europian të Tiranës, Tiranë, 2017.
20. Mirlind Behluli, *Problemet e politikës së jashtme kosovare në kuadrin e përpjekjeve për shtetndërtim të Kosovës - politika e jashtme e Kosovës në këndvështrimin shkencor*, Instituti për Politikë të Jashtme i Kosovës, Prishtinë, 2020
21. Valerie M. Hudson, Christopher S. Vore, Foreign Policy Analysis Yesterday, Today, and Tomorrow, *Mershon International Studies Review*, Volume 39, Issue Supplement 2, October, United States, 1995.

Burime nga interneti

1. <https://www.botasot.info/opinione/1424615/cka-eshte-politika-e-jashtme/>
2. <https://pretsedatel.stevopendarovski.mk/al/politika-e-jashtme/>
3. <https://punetejashtme.gov.al/diplomacia-ekonomike/>
4. <https://www.gov.me/en/article/economic-diplomacy>
5. Debate nacionale për pozitën e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare, anketa debatuese për avantazhet dhe sfidat e harmonizimit të Maqedonisë së Veriut me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Europian dhe anëtarësimi në NATO; *Europena Policy Institute Skopje, National Democratic Debate, National Endowment for Democracy, Shkup, f. 1.*
6. Jugert Jorgo, *Politika e jashtme në mirëqeverisje, shkolla shqiptare e studimeve politike*, Tiranë, 2013, f. 2.
7. Valerie M. Hudson, Christopher S. Vore, Foreign Policy Analysis Yesterday, Today, and Tomorrow, *Mershon International Studies Review*, Volume 39, Issue Supplement_2, October, United States, 1995, f. 209.
8. Juliet Kaarbo, Jeffrey S. Lantis, and Ryan K. Beasley, The Analysis of Foreign Policy in Comparative Perspective, Chapter 1, CQ Press, Washington, D.C., 2013, f. 7.
9. Korab Krasniqi, *Politika e Jashtme dhe Diplomaci*, University for Business and Technology - UBT, Prishtinë, 2011, f. 7.
10. Adis Arapovic, Foreign policy of Bosnia and Herzegovina: determinates and perspectives, Centres of Civic Initiatives, Tuzla, B&H, Faculty of Political Sciences, University of Sarajevo, B&H, Bosnia and Herzegovina, 2010, f. 36: <https://www.botasot.info/opinione/1424615/cka-eshte-politika-e-jashtme/>
11. Ligji për punët e jashtme, Fletorja Zyrtare, i RMV-së Nr: 46/2006 nga 10.04.2006, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Neni 2.

12. Fidan Mustafa, *Gjeopolitika e Ballkanit - e ardhmja e shqiptarëve në rajon*, Tiranë, 2022, f. 77.
13. Ligji për punët e jashtme, Fletorja Zyrtare e RMV-së Nr: 46/2006 nga 10.04.2006, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Neni, 2. Ibid, neni 3: <https://pretsedatel.stevopendarovski.mk/al/politika-e-jashtme/>
14. Jugert Jorgo, *Politika e jashtme në mirëqeverisje - shkolla shqiptare e studimeve politike*, Tiranë, 2013, f. 2.
15. Alban Përmeti, *Foreign Policy Strategy of the Republic of Albania 1992- 1997*, Mediterranean Journal of Social Sciences MCSER Publishing, Rome-Italy, Vol 6 No 2 S1 March 2015, f. 1
16. Mentor Beqa, *Shqipëria e “kërcënuar”: politika e jashtme e Enver Hoxhës*, Universiteti Europian të Tiranës, Tiranë, 2017, f. 147: <https://punetejashtme.gov.al/diplomacia-ekonomike/>
17. Mirlind Behluli, *Problemet e politikës së jashtme kosovare në kuadrin e përpjekjeve për shtetndërtim të Kosovës, Politika e jashtme e Kosovës në këndvështrimin shkencor*, Instituti për Politikë të Jashtme i Kosovës, Prishtinë, 2020, f. 69
18. Dokumenti strategjik për politikën e jashtme, *Draft strategjia e politikës së jashtme*, Republika e Kosovë, Qeveria-Zyra e Kryeministrit, Zyra për qeverisje të mirë, 2018, f. 8.
19. Dokumenti strategjik për politikën e jashtme, *Draft-strategjia e politikës së jashtme*, Republika e Kosovë, Qeveria-Zyra e Kryeministrit, Zyra për qeverisje të mirë, 2018, f. 5.
20. Alfred Marleku, *National Interest and Foreign Policy: The Case of Kosovo*, Mediterranean Journal of Social Sciences, 2023, f. 417.
21. Fidan Mustafa, *Gjeopolitika e Ballkanit - e ardhmja e shqiptarëve në rajon*, Tiranë, 2022, f. 73.
22. Maja Bjelos, Vuk Vuksanovic, Luka Steric, *Many Faces of Serbian Foreign Policy Public Opinion and Geopolitical Balancing*, Belgrade Centre for Security Policy (BCSP), 2020, f. 3.

23. Jovanovic, Srdan, The Evolution of Serbian Foreign Policy under Vucic: Navigating between the European Union and Russia. *Perspective Politice*. Vol. XVI (1-2), 2023, f. 122
24. Mikkel Severin Jensen, Serbia as a Geopolitical Partner In between East and West, *Malmö University*, 2023, f. 44.
25. Fidan Mustafa, Gjeopolitika e Ballkanit - E ardhmja e shqiptarëve në rajon, Tiranë, 2022, f. 74.
26. Jelena Džankić, From Creeping to Sprinting: The Foreign Policy of Montenegro, The foreign policies of post-yugoslav states, Palgrave Macmillan London, 2014, f. 173.
27. Boris Vukotić, Foreign policy priorities of Montenegro with special reference to obstacles to accession to the European Union, University of Zagreb, The Faculty of Political Science, Zagreb, 2024, f. 4: <https://www.gov.me/en/article/economic-diplomacy>
28. Milika Mirkovic, Montenegro external relations briefing: EU integration: one step closer to IBAR, China CEE Institute, Weekly Briefing, Vol. 73, No. 4 (ME) May 2024, f. 1.
29. Adnan Huskiq, Complex system, complex foreign policy: the foreign policy of Bosnia and Herzegovina, The foreign policies of Post-Yugoslav states, London, 2014, f. 122.
30. Adis Arapovic, Foreign policy of Bosnia and Herzegovina: determinates and perspectives, Centres of Civic Initiatives, Tuzla, B&H, Faculty of Political Sciences, University of Sarajevo, B&H, Bosnia and Herzegovina, 2010, f. 46
31. Emir Hadžikadunić, Foreign policy of Bosnia and Herzegovina: key principles, challenges and achievements, Bosnia and Herzegovina: Law, Society and Politics, International University of Sarajevo, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina, 2016, f. 277
32. Adnan Huskiq, Complex system, complex foreign polic: the foreign policy of Bosnia and Herzegovina, The foreign policies of Post-Yugoslav states, London, 2014, f. 123
33. Adis Arapovic, Foreign policy of Bosnia and Herzegovina: determinates and perspectives, Centres of Civic Initiatives, Tuzla,

B&H, Faculty of Political Sciences, University of Sarajevo, B&H, Bosnia and Herzegovina, 2010, f. 47

34. Emir Hadžikadunić, Foreign policy of Bosnia and Herzegovina : key principles, challenges and achievements, Bosnia and Herzegovina: Law, Society and Politics, International University of Sarajevo, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina, 2016, f. 275

Shënim: Autori është PhD kandidat në Universitetin “Shën Klimenti” i Ohrit, në Fakultetin Juridik në Manastir, në drejtimin *E drejta ndërkombëtare dhe politika ndërkombëtare*.

III. BOTA

3.1. Midis Hormuzit, MAGA-s dhe mesmandatit

Nga dr. Jorgji Kote

Edhe pse ka kaluar një muaj nga fillimi i sulmeve ushtarake amerikano-izraelite kundër Iranit, duket se shpresat për mbarimin e saj të shpejtë ishin iluzion gjeopolitik. Siç pohoi ditët e fundit edhe ish-ministri amerikan i Mbrojtjes dhe ish-shefi i CIA-s, Leon Paletta, “lufta dhe fitorja blic dështoi”. Kjo pasi, pavarësisht rezultateve të bujshme ushtarake të njohura, siç u shpreh më 25 mars edhe ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, administrata e Presidentit Trump ndërhyri ushtarakisht kundër Iranit pa plan, pa qëllim, pa objektiva të qartë, pa konsultime me europianët dhe, ca më keq akoma, pa një strategji daljeje nga Irani.

Disa objektiva ushtarakë madhorë edhe kur i realizon, siç tregon përvoja e mëparshme, prapë nuk mjaftojnë për një fitore politike “të përkthyer” në paqe, siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm, sidomos kur vjen fjala për një rajon shpërthyes me ndikime të mëdha për sigurinë dhe ekonominë botërore. Tani rrezikohet zgjatja e luftës, përshkallëzimi i saj në të gjithë rajonin e më gjerë, me pasoja të mëtejshme tejet të rënda për të gjithë aktorët dhe faktorët e kësaj lufte kudo në botë. Defekti tjetër ishte se administrata e Presidentit Trump nuk e parashikoi drejt, madje e nënvleftësoi reagimin dhe rezistencën nga Irani. Këtu pa dyshim ndikoi sukcesi i bujshëm i luftës 12-ditore në muajin qershor 2025 dhe rrëmbimi i Maduros, edhe pse ky i fundit ishte vërtet “si nata me ditën” krahasuar me operacionin kompleks në Teheran.

Gabimi tjetër amerikan ishte se sulmin ushtarak kundër Iranit e menduan si një betejë klasike ushtarake, që nisur nga epërsia absolute amerikane, do të fitohej lehtë, shpejt dhe pa kosto. Mirëpo Trump-i, i mësuar me telerealitete nuk e ka kuptuar realitetin e brendshëm, tejet

kompleks dhe të ndërlikuar në Iran dhe në rajon, për pasojë i injoroi dhe nuk u dha përgjigje gjithëpërfshirëse pyetjeve madhore gjeopolitike: “Po pastaj, çfarë do të ndodhë”? Ndërkohë, ndryshe nga SHBA-ja, e cila nuk ka nxjerrë mësim nga e kaluara e hidhur në luftërat e mëparshme dhe nga gabimet e Rusisë, Irani ka mësuar shumë nga Ukraina: i ndërgjegjshëm për epërsinë ushtarake amerikane, ai po shfrytëzon përvojën e Vietnamit, Irakut dhe Afganistanit, duke e shpërndarë dhe përshkallëzuar konfliktin në vatra dhe vende të tjera të rajonit dhe në bazat amerikane.

Amerikanët gabuan edhe kur menduan se, duke vrarë Kamenein dhe mbi 200 liderë të tjerë, do ta detyronin Teheranin të dorëzohej, duke nënvleftësuar faktin se gjatë 47 viteve të saj, ajo ka krijuar një autoritet shtetëror shumëshpresues, që të funksionojë edhe në kushtet më të vështira, siç edhe po ndodh. Gabimi tjetër, ndoshta më i madh amerikan, është se nuk e vunë në peshoren gjeopolitike dhe ushtarake Ngushticën e famshme të Hormuzit dhe bllokimin e saj nga Irani, edhe pse të dhënat dhe sugjerimet nga sektorët përkatës nuk munguan, por u injoruan. Tani Hormuzi është kthyer në një “mal të lartë e të thepisur” pengues, ku do të vendoset edhe fati i kësaj lufte, i së ardhmes në rajon e në botë, por me pasojat të mëdha politike, që në fakt po ndihen që tani edhe në Uashington.

Mirëpo krejt ndryshe nga SHBA-ja, e cila veç Hormuzit është edhe “në ngushticën e kohës”, Irani po luan me kohën, duke i shkaktuar kokëçarje të mëdha SHBA-së. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, nxitimi dhe heqja dorë nga negociatat diplomatike shkurtin e kaluar ishte gabim tjetër i madh me kosto për SHBA-në. Demarshet e tanishme të Presidentit Trump janë me vend, por të vonuara. Me përmbajtjen e tyre të shoqëruar përherë me ultimatumë që shtyhen, ndryshohen dhe riformulohen dhe, në fund, nuk mbahen, ato nuk krijojnë terrenin për sukses. Ndërkohë, nisur nga synimi për një fitore të rrufeshme, SHBA-ja nuk mendoi as pasojat e rënda për imazhin e saj, si dhe marrëdhëniet e saj me aleatët europianë, duke mos i pyetur fare e pa u konsultuar me ta, ndërsa tani kërkon ndihmën e tyre.

Kësisoj, lufta në Iran, ndryshe nga përvoja e mëparshme, në vend që ta forconte aleancën perëndimore, e ka dobësuar dhe përçarë atë më tej. Ndaj kancelari gjerman Merz e tha qartë, se “ne nuk ndërhyjmë në një luftë që nuk është jona”. Ndërsa Presidenti gjerman Steinmeir më 22 mars në fjalimin e tij shkoi edhe më tej, duke e quajtur *gabim politik katastrofik* luftën në Iran dhe shkelje të hapur të së drejtës ndërkombëtare. Qëndrim të ashpër ka mbajtur edhe kryeministri spanjoll, Pedro Sanches, kur përmendi 4 milionë njerëz të zhvendosur nga Irani dhe Libani, 2000 të vdekur dhe mbi 12 miliardë euro shpenzime humanitare. Po aq rëndë është cenuar edhe imazhi i Izraelit dhe i kryeministrit Netianahu, me përshkallëzimin e shfaqjeve antisemitiste dhe antiizraelite në SHBA dhe në botë.

Në këto kushte të vështira, për të fituar kohë dhe për të mbajtur të qeta bursat ndërkombëtare, bashkë me çmimet e naftës e të gazit, Presidenti Trump është detyruar të ndjekë “politikën e zigzageve”, duke ndryshuar pothuajse çdo ditë pohimet, deklaratimet dhe objektivat. Kështu, njëherë deklaronte se “lufta mbaroi, se kemi fituar”, se ishte një ekskursion i vogël për ne”, pastaj se “fitorja dhe mbarimi i luftës janë afër”, se “brenda 48 orëve do të bombardojmë infrastrukturën energjetike”, pastaj “jo, e shtymë 5 dhe tani 10 ditë”; pastaj “jemi në bisedime dhe do të bëjmë armëpushim një muaj, edhe pse pala iraniane e ka mohuar një gjë të tillë. Në fakt, momenti i tanishëm gjeopolitik është më i vështiri për Presidentin Trump dhe për SHBA-në, me rrjedhoja pozitive në rastin ideal, por me pasoja fatale për ta, Lindjen e Mesme, për fatin dhe mbijetesën politike të vetë Presidentit Trump. Sepse tani ai ballafaqohet me disa alternativa dhe skenarë tejet sfiduesë politikë dhe ushtarakë, njëri më i vështirë se tjetri.

Alternativa më e rrezikshme dhe me më shumë kosto njerëzore për SHBA-në, por jo vetëm, është futja e mijëra trupave tokësore në Iran. Një rrezik i madh që po u kalua me sukses, do të jetë fitore e madhe historike për Trump-in, por po dështoi, do të jetë një kataklizëm i vërtetë. Alternativa tjetër është një tërheqje “me lezet”, duke deklaruar fitoren, siç edhe bën vazhdimisht, por që do të lërë hapur plagët dhe

problemet për paqen dhe sigurinë e mëtejshme në rajon dhe aleatët e Gjirit Persik në mëshirë të fatit. Sepse Irani edhe pas qershorit të kaluar, tregoi se, pavarësisht nga dëmet e mëdha dhe shkatërrimi i 92 për qind i flotës detare dhe asaj ajrore dhe 10 000 objektivave që u goditën nga amerikanët, asgjësimit të lidërshpit të tij më të lartë politik dhe ushtarak, regjimi në Teheran mbijeton. Bashkë me pasurimin e mëtejshëm të uranimit në vendet e tij sekrete nën tokë, objekt tjetër i synimeve amerikane. Për të ardhur te bllokimi i Ngushticës së Hormuzit, çlirimi i së cilës bashkë me depërtimin e trupave tokësore amerikane është tejet i vështirë, me rreziqe të mëdha dhe të paparashikueshme për sot dhe për nesër, për shkak të pozicionit gjeografik dhe masave shumështrësore të Iranit.

Alternativa tjetër, të cilën Trump e paralajmëroi, por që e shtyu, është goditja e infrastrukturës energjetike të Iranit, pushtimi i ishullit Kharg dhe tre ishujve të tjerë strategjikë, gjë që do ta çonte në faliment shtetin e Iranit. Mirëpo kjo jo vetëm mund të konsiderohej krim lufte, por do të krijonte tensione të reja të mëdha për emigracionin, çmimet dhe zinxhirët e furnizimit. E megjithatë, kjo është vetëm gjysma e së keqes. Sepse, sipas shumë ekspertëve, shkaqet dhe arsyet e politikës me zigzage, me kthesa të forta e të papritura, veç Iranit e kanë burimin edhe te gjendja e brendshme tejet e nderë në SHBA e sidomos te tri sfidat e mëdha të tanishme atje: sondazhet alarmante mbi pëlqyeshmërinë e Presidentit Trump krahasuar me muajin shkurt; përçarjet brenda MAGA-s dhe afrimi i zgjedhjeve të Mesmandatit për Kongresin Amerikan në muajin nëntor.

Janë pikërisht këto tri “zjarre” përvëlues politike dhe zgjedhorë, të cilët e kufizojnë shumë hapësirën e veprimit për Presidentin Trump dhe shtojnë trysninë e jashtëzakonshme ndaj tij për gjetjen sa më parë të një rrugëdaljeje nëpërmjet bisedimeve, për një zgjidhje diplomatike të shpejtë dhe të qëndrueshme. Qëkurse filloi ndërhyrjen në Iran, pëlqyeshmëria publike për Presidentin Trump ka qenë në rënie të lirë. Sipas sondazheve më të fundit, afro 60 për qind e amerikanëve janë të pakënaqur me performancën e tij. Trump-i është po aq jopopullor sa në

fundin e mandatit të parë në janar 2021. Akoma më e ulët është kjo pëlqyeshmëri për Trump-in, kur vjen puna te menaxhimi i ekonomisë.

Kështu, sipas sondazhit të agjencisë “Reuters” të publikuar më 25 mars, nga 36 për qind në shkurt, pëlqyeshmëria për Presidentin Trimp ka rënë në 29 për qind, niveli më i ulët e të gjitha kohërave. Lidhur me menaxhimin e kostos së jetesës, ajo ka rënë në 34 për qind, ndërsa për inflacionin në 28 nga 40 për qind që ishte në shkurt. Ndërkohë, 67 për qind e amerikanëve parapëlqejnë uljen e çmimeve të naftës/gazit kundrejt kërcënimeve iraniane ndaj Izraelit apo edhe zëvendësimin e mullahëve në Teheran.

Niveli i pëlqyeshmërisë ndaj tij po bie ndjeshëm edhe te republikanët. Krahësuar me muajin shkurt, kjo pëlqyeshmëri për koston e jetesës ka rënë në 27 nga 34, ndërsa për rritjen e inflacionit/çmimeve nga 40 në 28 për qind që ishte në shkurt. Kjo ka ndodhur pasi amerikanët e thjeshtë i shqetëson tej mase rritja e çmimit të benzinës, që gjatë muajit mars kaluan mbi 1 dollar për gallon.

Mirëpo kjo rritje ka efekte të tjera edhe te çmimet e mallrave të tjera bazë. Shqetësimin e shton fakti që, edhe nëse Ngushtica e Hormuzit do të hapej dhe lufta të mbaronte sot apo nesër, sipas drejtuesve më të lartë të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë, prapë do të duhet kohë e gjatë, të paktën 6 muaj për stabilizimin e tregjeve të energjisë. Nisur nga ky shqetësim, nga 45 për qind një muaj më parë, tani është rritur në 58 për qind shifra e atyre që e kritikojnë Trump-in për përqendrimin e tij më të madh në çështjet ndërkombëtare, duke lënë pas dore telashet dhe hallet në shtëpi. Edhe te republikanët ky nivel është rritur në mënyrë shqetësuese, nga 19 në 29 për qind. Shqetësimi i dytë serioz që ka provokuar zgjatja e luftës në Iran lidhet me ndarjet dhe përçarjet që kanë shpërthyer brenda Lëvizjes “Ta bëjmë Amerikën prapë të madhe (MAGA), ku Presidenti Trump është bërë objekt kritikash të ashpra. Veç të tjerash, Presidenti Trump aty ballafaqohet me dy sfida delikate: së pari, ai kritikohet për dobësitë e treguara ndaj Izraelit, mbasi sipas tyre, Trump-i ka vendosur interesat e Izraelit mbi ata “Amerika e para” dhe se është instrumentalizuar nga

Kryeministri Netianahu. Së dyti, shtimin e shfaqjeve dhe incidenteve antisemitiste dhe antiizraelite edhe vetë brenda MAGA-s, duke shtuar krisjet dhe ndarjet brenda bazës republikane.

Këtu ra në sy dorëheqja dy javë më parë e shefit të Antiterrorit Federal dhe protagonist i MAGA-s, Joe Kent, që për shkak të kundërshtimit të luftës në Iran, ditët e fundit ka qenë i ftuari më i shpeshtë në televizionet amerikane. Në intervistën me Megyn Kelly, gazetare televizive dhe opinioniste e njohur konservatore, Joe Kent tha: *“Shumë nga vendimet qendrore në Shtëpinë e Bardhë nuk u referohen më raporteve të 18 shërbimeve të fshehta amerikane, por ndikohen në një masë të madhe nga shumë përfaqësues izraelitë, ndaj Trump-i nuk dëgjon zërat e tjerë”*. Mirëpo, bashkë me të ka edhe shumë eksponentë të tjerë që po ushtrojnë trysni ndaj Trump-it, që të gjejë një dalje nga kjo situatë përpara se të jetë vonë. Këtu bën pjesë edhe zëvendëspresident J. D. Vance, që bashkë me shumë të tjerë duan që Presidenti i tyre të përqendrohet në zbatimin e politikave të brendshme dhe kryesisht në ekonominë e vendit, siç edhe prematuan në fushatën zgjedhore presidenciale 2024. Më konkretisht, Megyn Kelly, një nga përfaqësueset e MAGA-s, i ka kërkuar publikisht senatorit Lindsey Graham, i cili i përket rrethit të ngushtë të Presidentit Trump, që të kundërshtojë dërgimin e trupave tokësore në Iran, duke u shprehur se *“nuk dua të dëgjoj asnjë fjalë nga disa tipa që nuk kanë fëmijë, që duan patjetër të dërgojmë djemtë dhe vajzat tona në një luftë tokësore në Iran”*.

Nga ana tjetër, Graham u përket mbështetësve më të mëdhenj të sulmit mbi Iran, ashtu si edhe influencuesja tjetër konservatore, Laura Loomer, e cila e ka qortuar ashpër Joe Kentin. Mirëpo, një bazë e përçarë republikane nuk është ogur i mirë për Trump-in. Në këtë gjendje të zymtë, për herë të parë në 10 vitet e fundit, Trump-i nuk po merr pjesë në Kongresin e Partisë Konservatore që zhvillohet në Teksas (25-28 mars), i cili u kushtohet zgjedhjeve të mesmandatit në nëntor në Kongresin Amerikan. Mirëpo, sipas Jesse Kelly, moderator konservator i radios amerikane, “nëse këto shifra do të vazhdojnë të jenë në nivelet

e tanishme, atëherë në zgjedhjet e mesmandatit për Kongresin Amerikan në muajin nëntor ne do të masakrohemi”! Si për ironi të fatit, në zgjedhjet e pjesshme më 24 mars për në Dhomën e Përfaqësuesve të Floridës, kandidati republikan humbi përballë sfidantit demokrat, pikërisht në Mar-a-Laho, aty ku ka rezidencën e vet edhe Presidenti Trump. Ky është një sinjal i vogël, por me simbolikë të veçantë në kohë të trazuara për MAGA-n. Ja pse rezultatet e pritshme të këtij mesmandati jetik zgjedhor përbëjnë shqetësimin e tretë madhor për Presidentin Trump, ku ndërhyrja amerikane në Teheran do të jetë përcaktuese për atë vetë dhe gjithë politikën në Uashington.

3.2 REALITETI PO KRIJON NJË EUROPË TË RE

Edhe pse europianët duhet ta ruajnë partneritetin transatlantik për aq kohë sa të jetë e mundur, ata nuk mund ta injorojnë faktin se Shtetet e Bashkuara në thelb janë të pabesueshme. Të kërcënuara nga Vladimir Putini dhe të presionuara nga Donald Trump-i, nuk ka zgjidhje tjetër, veçse të ndjekin vetëmbështetje të plotë.

Nga Joshka FISHER, ish-ministër i Jashtëm i Gjermanisë

Berlin – Po dëshmojmë shfaqjen kaotike të një rendi të ri botëror, dhe procesi po drejtohet nga tre udhëheqës që janë hapur armiqësorë ndaj Bashkimit Europian: Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, Presidenti rus, Vladimir Putin dhe Presidenti kinez, Xi Jinping. Ky rend i ri do të ketë pak të përbashkëta me atë të udhëhequr nga amerikanët, që mbizotëroi përgjatë gjithë shekullit XX. Ndërsa aktorët kryesorë kombëtarë mbeten të njëjtë, rolet e tyre, si dhe peshat e tyre përkatëse politike dhe ekonomike kanë ndryshuar.

Në vend të rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla, që Shtetet e Bashkuara krijuan pas Luftës së Dytë Botërore, do të shohim një rend të bazuar në fuqi të formuar ekskluzivisht nga gjeopolitika. Në vend të tregtisë së lirë globale, do të shohim rivalitete me shumë zero midis blloqeve të mëdha ekonomike, duke nënkuptuar një tendencë drejt autarkisë. Dhe në vend të një bote analoge, do të shohim një botë gjithnjë e më digjitale, ku përparimet në inteligjencën artificiale bëhen faktorë vendimtarë në jetën ekonomike, ndoshta edhe duke përcaktuar kontrollin politik. Ky transformim është, pa dyshim, tendenca mbizotëruese globale makro e kohës sonë. Ai jo vetëm që do të ndikojë në Europë, por ka të ngjarë të përcaktojë nëse Europa mbijeton në ndonjë formë të dallueshme. Në fund të fundit, “Europa” është më shumë sesa një përcaktim gjeografik. Është një realitet politik; një grupim i ngjashëm me konfederatën kontinentale të shteteve të ndërlidhura ngushtë, i ankoruar jo nga fuqia ushtarake, por përmes ideve dhe vlerave të përbashkëta.

Ashtu si rendi ndërkombëtar i udhëhequr nga SHBA-ja, që tani po zhduket, BE-ja mori formë në periudhën menjëherë pas luftës në Europën Perëndimore. Europa e pasluftës ishte jashtëzakonisht e suksesshme si një projekt bashkimi ekonomik midis shteteve ish-armike. Ajo lulëzoi nën sigurinë ushtarake dhe politike të ofruar nga ombrella mbrojtëse e SHBA-së dhe sistemi i tregtisë globale i pasluftës, të cilin Amerika e ndihmoi ta zgjeronte dhe ta mbante.

Por, ndërsa rënia e rendit amerikan u bë më e dukshme në vitet e fundit, BE-ja përjetoi kriza të rënda politike. Viti 2016 ofroi një goditje të dyfishtë, me Mbretërinë e Bashkuar që votoi për t'u larguar nga Bashkimi European dhe amerikanët që zgjodhën Trump-in për herë të parë. Duke parë prapa, tani e dimë se këto zhvillime ndryshuan gjithçka.

Për shkak të rritjes së rolit të Kinës dhe krizës financiare të vitit 2008, skena për trazirat globale ishte përgatitur tashmë. Dhe, megjithëse Brexit dhe fitorja tronditëse e Trump-it nuk u panë si një kambanë vdekjeprurëse për rendin e udhëhequr nga SHBA-ja në atë kohë, ato lëshuan forca shkatërruese që kishin qenë të fshehura nën sipërfaqe për një kohë të gjatë.

Fuqia e këtyre forcave u bë e dukshme me pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës nga Putini në shkurt të vitit 2022, i ndjekur nga rizgjedhja e Trump vitin e kaluar. Në këtë rast, mosmarrëveshjet e vogla midis Mbretërisë së Bashkuar dhe BE-së u harruan shpejt, të zëvendësuara nga një solidaritet i ri ushtarak me Ukrainën dhe një përpjekje e re kolektive për të arritur solidaritet mbrojtës dhe sigurie në të gjithë Europën.

Bërësit e politikave dhe udhëheqësit politikë në Londër, Bruksel dhe kryeqytetet më të rëndësishme europiane e kuptuan se situata kishte ndryshuar rrënjësisht. Realiteti i ri dhe i ashpër, i personifikuar nga Putini, i detyroi të gjithë europianët (qofshin brenda apo jashtë BE-së) të ktheheshin në të njëjtën barkë gjeopolitike. Kur bëhet fjalë për sigurinë, europianët kanë një interes të përbashkët. Norvegjia dhe Mbretëria e Bashkuar janë po aq të prekshme ndaj efekteve të

agresionit ushtarak rus, sa Polonia, Finlanda, Suedia, Gjermania dhe Franca. Udhëheqësit europianë dhe shumica e qytetarëve e kuptojnë se, nëse Trump-i do t'i jepte fund garancisë së sigurisë së Amerikës dhe do të tërhiqte trupat amerikane, Europa do të duhej të mbronte kufijtë e saj, madje edhe vetë ekzistencën e saj

E kërcënuar nga Putini dhe e presionuar nga Trump-i, Europa duhet të gjejë një mënyrë për të zhvilluar aftësitë e saj të pavarura mbrojtëse. Edhe pse duhet ta ruajë partneritetin transatlantik për aq kohë sa të jetë e mundur, nuk mund ta injorojë faktin se Amerika, nën Trump-in, është thelbësisht e pabesueshme. Duhet të ketë një plan B. Të gjitha vendet europiane, qofshin brenda apo jashtë BE-së, duhet të riarmatosen dhe të zhvillojnë plane për secilin nga dy skenarët: një me Amerikën në foto dhe një pa të.

Në të dyja rastet, vendet europiane duhet të punojnë së bashku sa më ngushtë të jetë e mundur, jo vetëm në mbrojtje, por edhe në rigjallërimin e ekonomisë europiane. Kjo kërkon udhëheqje të përbashkët nga lojtarë më të mëdhenj, si: Franca, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia dhe Polonia, të cilët të gjithë kanë burimet e nevojshme humanitare, ushtarake dhe ekonomik, tanimë edhe vullnetin politik. Përballë realiteteve të sotme, dallimet ideologjike të djeshme janë bërë pothuajse të pakuptimta. Çështjet qendrore në politikën europiane nuk lidhen më me zgjerimin, integrimin dhe pavarësinë kombëtare të BE-së; ato kanë të bëjnë, mbi të gjitha, me mbrojtjen e lirisë europiane dhe mbështetjen e vlerave të përbashkëta. [The Pioneer.de]

Shënim: Joschka Fischer, ministër i Jashtëm dhe zëvendëskancelar i Gjermanisë nga viti 1998 deri në vitin 2005, ishte udhëheqës i Partisë së Gjellbër Gjermane për gati 20 vjet.

3.3 EPOKA E RE BËRTHAMORE

Armët bërthamore po përjetojnë një rikthim të rrezikshëm. Pa kontroll të ri të armëve, bota përballet me një Armagedon bërthamor.

Nga dr. Rolf Mützenich [IPG]

Trilleri “A House of Dynamite” [“Një shtëpi dinamite”, i publikuar së fundmi në kinema dhe në “Netflix”, trajton fuqishëm një temë të konsideruar prej kohësh që nga fundi i Luftës së Ftohtë: kërcënimi i Armagedonit bërthamor. Në filmin e Kathryn Bigelow, ushtria amerikane zbulon papritur një raketë balistike ndërkontinentale mbi Oqeanin Paqësor, që mund të arrijë në kontinentin e SHBA-së brenda pak minutash. Nga perspektiva të ndryshme, filmi tregon se si vendimmarrësit politikë dhe ushtarakë përpiqen t’i përgjigjen krizës. Ai thekson se sa të prekshëm mbetemi, pavarësisht sistemeve të sofistikuar të mbrojtjes dhe lojërave strategjike të luftës, dhe sa shpejt një sulm i vetëm bërthamor mund të përshkallëzohet në një katastrofë globale brenda pak minutash.

Filmi nuk është një eksperiment i largët mendor, por përkundrazi pasqyron një skenar gjithnjë e më realist të ditëve tona të sotme. Kohët kur Presidenti i atëhershëm i SHBA-së, Barack Obama, promovoi vizionin e një bote pa armë bërthamore në Pragë në vitin 2009, tani duken si një epokë e kaluar.

Në vend të kësaj, po dëshmojmë kërcënime bërthamore që shprehen hapur përsëri, sulme taktike bërthamore që diskutohen si një opsion serioz ushtarak në diskutimet strategjike të fuqive të mëdha, traktate për çarmatim dhe kontroll të armëve që skadojnë ose po ndërpriten, arsenale bërthamore që modernizohen dhe sisteme të reja shpërndarjeje që po zhvillohen. E vërteta e hidhur është: rreziku i konfliktit bërthamor është pa dyshim më i madh sot se kurrë më parë. Jemi në prag të një epoke të re bërthamore, një epoke që është edhe më

komplekse, e paparashikueshme dhe e pasigurt se e ashtuquajtura “balancë e terrorit” gjatë Luftës së Ftohtë.

Vitet e fundit konteksti gjeopolitik ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Që nga sulmi rus ndaj Ukrainës, Moska ka sforcuar doktrinën e saj bërthamore dhe ka kërcënuar vazhdimisht të përdorë armë bërthamore. Në të njëjtën kohë, Kina po e zgjeron masivisht arsenalin e saj bërthamor. Në një paradë ushtarake që festonte 80-vjetorin e fitores së tij në Luftën e Dytë Botërore në shtator, Pekini zbuloi për herë të parë triadën e tij të plotë bërthamore. Sipas Institutit Ndërkombëtar të Kërkimeve për Paqen në Stokholm (SIPRI), Republika Popullore tani zotëron të paktën 600 koka bërthamore. Ekspertët vlerësojnë se ky numër mund të rritet në 1 500 koka bërthamore deri në vitin 2035, duke u përputhur me nivelin e arsenalet bërthamore amerikane dhe ruse.

Bota aktualisht po lëviz drejt një epoke të re bërthamore tripolare ose edhe shumëpolare. Aktualisht, nëntë shtete zotërojnë armë bërthamore, përfshirë pesë anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si dhe Izraelin, Indinë, Pakistanin dhe Korenë e Veriut. Megjithatë, përballë pasigurisë globale në rritje dhe tensioneve gjeopolitike, gjithnjë e më shumë vende po shqyrtojnë zhvillimin e aftësive të tyre bërthamore. Vetëm më 17 shtator 2025, Arabia Saudite dhe Pakistani i armatosur me armë bërthamore nënshkruan një marrëveshje të re mbrojtëse, që përfshin një klauzolë ndihme të ndërsjellë. Pakti nuk është vetëm një sinjal për rivalët e mundshëm rajonalë, por gjithashtu nxjerr në pah strukturën në ndryshim të pushtetit në Lindjen e Mesme, në të cilën Shtetet e Bashkuara nuk perceptohen më si një garantues i besueshëm i sigurisë.

Këto ndryshime rajonale janë gjithashtu pjesë e një zhvillimi më të gjerë global: “Pax Americana” po ia lë gradualisht vendin një rendi botëror shumëpoler, në të cilin Shtetet e Bashkuara nuk janë më të gatshme ose të afta të sigurojnë stabilitetin ndërkombëtar vetëm. Besimi në rënie në garancitë amerikane të sigurisë do të thotë që jo vetëm kundërshtarët perëndimorë, por edhe aleatët e ngushtë të SHBA-së në

Indo-Paqësor, si Japonia dhe Koreja e Jugut, si dhe shtetet europiane tani po shqyrtojnë hapur aftësitë e tyre bërthamore. Në sfondin e këtyre zhvillimeve, Rafael Grossi, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), paralajmëroi së fundmi në një intervistë me “Repubblica” për një botë me 20 deri në 25 shtete me armë bërthamore.

Megjithatë, është shumë e dyshimtë nëse një botë shumëpolare me më shumë se 20 shtete me armë bërthamore do të kontribuonte në të vërtetë në një siguri më të madhe. Koncepti i parandalimit supozon një shkallë të caktuar racionaliteti dhe parashikueshmërie nga ana e aktorëve të përfshirë. Por sa më shumë aktorë të zotërojnë armë bërthamore, aq më i madh është rreziku i sjelljes irracionale, llogaritjeve të gabuara, keqkuptimeve, aksidenteve teknike dhe dinamikave të përshkallëzimit. Në të njëjtën kohë, një numër në rritje i aktorëve bërthamorë e ndërlikon ndjeshëm krijimin e rregullave të detyrueshme për çarmatimin dhe kontrollin e armëve.

Sistemi ekzistues i çarmatimit dhe kontrollit të armëve është tashmë në prag të kolapsit. Në vitet e fundit, si Rusia ashtu edhe Shtetet e Bashkuara janë tërhequr nga Traktati i Forcave Bërthamore me Rreze të Mesme (INF) dhe Traktati i Qiejve të Hapur. Me skadimin e Traktatit të Ri START në shkurt të vitit 2026, humbja e marrëveshjes së fundit të mbetur për kontrollin e armëve midis dy fuqive më të mëdha bërthamore është e pashmangshme. Edhe pse Putini kohët e fundit propozoi një zgjatje njëvjeçare të traktatit, mbetet e pasigurt nëse kjo, apo edhe një marrëveshje pasardhëse, do të realizohet vërtet.

Megjithatë, nëse Putini dhe Trump arrijnë një marrëveshje për START-in e Ri, Gjermania dhe Europa do të thirren gjithashtu të bëjnë propozime konkrete për ruajtjen e kontrollit shumëpalësh të armëve dhe një rend të ardhshëm europian të sigurisë. Për shembull, vendosja e planifikuar e raketave amerikane me rreze të mesme veprimi në Gjermani vitin e ardhshëm, mund të përfshihet në një ofertë për kontrollin e armëve, nëse Moska tërheq raketat e saj bërthamore me bazë tokësore në këmbim.

Në të njëjtën kohë, megjithatë, është e qartë se nuk duhet të pritet përparim i konsiderueshëm në çarmatim dhe kontroll të armëve deri në fund të luftës në Ukrainë. Për më tepër, Kina deri më tani ka refuzuar të marrë pjesë në bisedimet mbi kontrollin e armëve bërthamore dhe zbutjen e rrezikut. Pekini thekson se arsenali i tij bërthamor mbetet dukshëm më i vogël se ai i SHBA-së dhe Ruisë. Megjithatë, për Uashingtonin, ngritja bërthamore e Kinës është bërë prej kohësh një përparësi strategjike. Kjo rrit rrezikun që bota të hyjë në një fazë, në të cilën më shumë se 20 shtete zotërojnë armë bërthamore pa traktate ose marrëveshje detyruese për kontrollin e armëve për të minimizuar rrezikun.

Prandaj është koha e duhur për të rigjallëruar përpjekjet e ngecura drejt çarmatimit dhe kontrollit të armëve. Fokusi duhet të jetë në kufizimin e arseneleve strategjike bërthamore dhe ruajtjen e traktateve ekzistuese. Po ashtu është po aq e nevojshme të integrohen Pekini dhe fuqitë e tjera bërthamore në zhvillim në një arkitekturë të sapokrijuar ndërkombëtare të kontrollit të armëve dhe të parandalohet përhapja e mëtejshme e armëve bërthamore. Traktati i Mospërhapjes Bërthamore është thelbësor për këtë. Konferenca e Rishikimit në vitin e ardhshëm duhet të kontribuojë në forcimin e mospërhapjes. Një dokument i përbashkët përfundimtar do të dërgonte një sinjal të rëndësishëm në situatën aktuale ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, OKB-ja mbetet e domosdoshme për një politikë të mospërhapjes dhe, më në fund, duhet t'i sigurohen burimet financiare, të personelit dhe të strukturës, për ta mundur atë të përmbushë në mënyrë efektive detyrat e saj. Në këtë drejtim, ne mund të mbështetemi te partnerët nga Jugu Global, që kanë qenë prej kohësh të përkushtuar ndaj çarmatimit dhe duan të luajnë një rol më të madh në formësimin e rendit ndërkombëtar në të ardhmen. Brazili, Indonezia dhe Afrika e Jugut, për shembull, janë anëtarë të traktateve rajonale mbi zonat pa armë bërthamore. Mbështetja duhet të ndërtohet këtu.

Përveç kësaj, ne kemi nevojë për masa për uljen e rrezikut dhe për transparencën. Këto masa përfshijnë kontakte të drejtpërdrejta

ushtarake, njoftimin dhe vëzhgimin e ushtrimeve dhe kanale të përbashkëta komunikimi për parandalimin e krizave. Marrëveshjet e ardhshme për kontrollin e armëve duhet të marrin në konsideratë edhe rreziqet e reja që vijnë nga inteligjenca artificiale ose armët hipersonike, si dhe në hapësirë dhe atë kibernetike.

Në dekadat e fundit, bashkësia ndërkombëtare ka arritur të zbusë rrezikun e një Armagedoni bërthamor përmes bashkëpunimit dhe ndërtimit të besimit në çarmatim dhe kontroll të armëve. Kjo mbetet e mundur dhe e nevojshme. Megjithatë, parakushti për këtë është dhe mbetet vullneti politik i aktorëve përkatës, i cili ka munguar qartë vitet e fundit.

[Përktheu: ISHGJ]

Shënim: Dr. Rolf Mützenich ka qenë anëtar i Bundestagut gjerman që nga viti 2002. Ai ishte kryetar i grupit parlamentar të SPD-së nga viti 2019 deri në vitin 2025.

3.4. PERËNDIMI I VJETËR: PROGRESI TEKNOLOGJIK I KINËS TREGON SE LIBERALIZMI NUK ËSHTË I GARANTUAR

Nga dr. Miriam Meckel* [NZZ]

Kina aktualisht po shkruan kapitullin tjetër në historinë moderne. Në Perëndim, reagimi shumë shpesh ka frymë arrogance ose alarmi, në vend të ndershmërisë intelektuale.

Është një nga ato vetëmashtime perëndimore, që çuditërisht ka vazhduar për një kohë të gjatë, se kemi arritur në fund të historisë dhe, sigurisht, në anën e duhur: liberale, demokratike, pluraliste. Çdo gjë tjetër, sipas bindjes së përhapur, mund të jetë vetëm një hap prapa ose një fazë e ndërmjetme. Moderniteti? Një fëmijë i Perëndimit. Progresi? E drejta jonë e lindur.

Por, ndërsa shumë në Europë ende po e përgëzojnë veten me vetëkënaqësi, e ardhmja tashmë po fillon diku tjetër – me shpejtësi, me talent, me saktësi të pagabueshme në vendimet politike dhe investimet. Kina aktualisht po shkruan kapitullin tjetër të modernitetit, ndërsa Europa rri ulur në tribuna dhe vështro.

- Progresi kërkon veprim

Kushdo që dyshon në këtë, mjafton të shikojë disa statistika bazë. Që nga vitet 1980, Kina ka nxjerrë pothuajse 800 milionë njerëz nga varfëria ekstreme. Jetëgjatësia është tani 78 vjet, në të njëjtin nivel me botën perëndimore. Mbi të gjitha, kjo është e dukshme në zhvillimin teknologjik në fushën e inteligjencës artificiale, të cilën Kina po e kultivon vazhdimisht. Verën e kaluar, qeveria kineze publikoi planin e saj “AI Plus”. Ky plan parashikon integrimin e IA-së pothuajse në çdo fushë të shoqërisë: nga mjekësia tek arsimi, nga energjia tek administrata. Imagjinoni një rregullore të BE-së që urdhëron “IA-në në gjithçka”.

Progresi kërkon veprim. Kjo reflektohet edhe në shkronjat kineze për fjalën “jìnbù”. Ato nënkuptojnë diçka si “hyj” dhe “hap”. Në vitin 2018, gjatë një turneu në Kinë me një delegacion menaxherësh dhe anëtarësh të bordit, shumë u habitën nga modernizimi teknologjik. Një vit më parë, qeveria kineze kishte miratuar një strategji të IA-së, që synonte ta bënte vendin një lider global të teknologjisë deri në vitin 2030, kryesisht të kontrolluar nga qendra dhe i mbështetur nga qindra miliarda dollarë në investime.

Shkronjat kineze për fjalën “progres” nënkuptojnë gjithashtu “të ecësh përpara”. Menaxherët e “Starbucks” në Shanghai, të cilët nuk mund të paguanin më as për kafënë e tyre me kartë krediti dhe, duke mos pasur aplikacionin superkinez “WeChat”, iu desh të kërkonin ndihmë nga të tjerët. Ata mbetën po aq të habitur, sa anëtarët e bordit në kompaninë “SenseTime”, të cilëve iu lejua të dëgjonin se në cilat pjesë të botës po eksportohet teknologjia kineze e njohjes së fytyrës.

Tani vjen “jìnbù” me IA-në: Kina ka publikuar rreth 1 500 modele të mëdha gjuhësore, më shumë se çdo vend tjetër, duke përfshirë edhe më të fundit e të sapoardhurën, si “Deepseek” dhe “Zhipu”. Dhe ndërsa disa pjesë të Europës ende po debatojnë nëse makinat e faksit duhet të hiqen në zyrat qeveritare, Kina tashmë po mendon në terma të teknologjisë kuantike, logjistikës autonome dhe konstelacioneve më të çuditshme të bashkëpunimit njeri-makinë.

Kompania “Huawei” ka arritur të prodhojë telefona inteligjentë jashtëzakonisht të fuqishëm, për të ofruar një alternativë vendase ndaj “Apple” në tregun e saj vendas. Çipi i ri i IA-së i “Huawei”, “Ascend 910C”, u zhvillua si përgjigje kineze ndaj A100 të “Nvidia”-s: i fuqishëm, i prodhuar në vend dhe gjeopolitikisht i rëndësishëm. “Kina është vetëm “nanosekonda larg” nga kapja e

SHBA-së, tha CEO i “Nvidia”-s, Jenson Huang, disa javë më parë.

- Besimi se e ardhmja vjen nga Perëndimi tani është vetëm një nocion nostalgjik në shumë pjesë të botës.

Në robotikë, njësitë luftarake G1 të “Unitree Robotics” demonstrojnë në mënyrë mbresëlënëse në Samitin Botëror të IA-së në Shanghai, se Kina nuk po ia lë botën reale “Silicon Valley”. Dhe në elektromobilitet, BYD-ja e ka rrëzuar prej kohësh Teslën nga froni, duke e çuar industrinë europiane të automobilave në prag të dështëpimit. Pa përmendur monopolin pothuajse të Kinës mbi elementet kryesore të rrallë të tokës, që gjenden në pothuajse çdo pajisje dhe çip.

- BE-ja është një mjeshtër e rregullimit?

Teknologjikisht, Europa ia ka lënë garën për IA-në si teknologjinë shumëpërdorimëshe të së ardhmes SHBA-së dhe Kinës. BE-ja është një mjeshtër e rregullimit, por për fat të keq, arrin vetëm zhvillimet e veta teknologjike, kur të gjithë të tjerët tashmë po festojnë fitoren.

SHBA-ja po i maskon shqetësimet e saj në lidhje me zhvillimin e inteligjencës artificiale kineze me argumente morale, duke këmbëngulur në “IA demokratike”. Ky argument po bëhet gjithnjë e më i zbrazët, kur kjo IA demokratike bazohet në një oligopol korporativ të udhëhequr nga disa prej individëve më të pasur në botë, një oligopol që po kontribuon në mënyrë aktive në çmontimin e shtyllave demokratike të SHBA-së.

Ky nuk është vetëm një problem teknologjik, por është një ndryshim kulturor. Besimi se e ardhmja do të vijë nga Perëndimi, përfshirë SHBA-në, tani është thjesht një nocion nostalgjik në shumë pjesë të botës. Në Indonezi, Kenia dhe Brazil, të rinjtë po shikojnë gjithnjë e më shumë drejt Lindjes për arsim, inovacion dhe përparim ekonomik.

- Mbetet e vërteta: Kina nuk është demokraci. Vendit i mungon liria e medias, pluralizmi dhe garantimi i të drejtave të njeriut. Por, a është kjo arsye e mjaftueshme, që Perëndimi të rrijë duarkryq dhe të jetë i vetëkënaqur?

Gjithashtu po bëhet shumë e qartë në demokracitë perëndimore, se themelet po shkatërrohen. Ekonomikisht, BE-ja po përjeton një rënie të moderuar, me ish-fuqitë ekonomike Gjermaninë dhe Francën, që po

dobësohen aq drastikisht, sa kërcënojnë të ndikojnë përgjithmonë në mënyrë ngjitëse në pjesën tjetër të BE-së. Jemi aq larg normave të mira të rritjes, sa është jeta në Mars e njerëzimit.

Një situatë e ngjashme po zhvillohet në lidhje me pranimin e sistemeve politike. Besimi është monedha e demokracisë dhe për shumë njerëz është zhvlerësuar ndjeshëm vitet e fundit. Sipas një sondazhi të “YouGov”, vetëm një shumicë e vogël e të rinjve europianë ende besojnë se demokracia është forma më e mirë e qeverisjes. Në Francë, mbështetja për demokracinë është nën 50 për qind. Në Gjermani, pothuajse 30 për qind votojnë për partitë populiste të krahut të djathtë. Në SHBA, një president po përballet me gjyqe të shumta për minimin e demokracisë.

Këto demokraci nuk po japin më rezultate. As në drejtësi sociale, as në arsim, as në infrastrukturë dhe, sigurisht, as në teknologji. Ndërsa qendra gjigante të inteligjencës artificiale po ndërtohen në kohë rekord në Pekin, ne në Europë jemi në prag të marrjes së miratimit edhe për një zonë të vdekur në rrjetin tonë celular. Ne në Perëndim shpesh reagojmë ose me arrogancë (“është e gjitha një kopje, asnjë përparim i vërtetë”) ose të alarmuar (“Kina po na shkatërron”). Këto qëndrime janë kundërproduktive. Na duhet diçka tjetër: *ndershmëria intelektuale*. Dhe kuptimi se nëse nuk duam ta humbasim garën globale për modernitet, së pari duhet ta pranojmë atë. Kjo do të thotë: asnjë panik, asnjë imitim, por më në fund, përsëri ambicie. Perëndimi ende zotëron pika të forta të mëdha: shkencë, shoqëri të hapura, sipërmarrje, diversitet mendimi. Por ne do t’i humbasim këto pika të forta, nëse nuk i kultivojmë dhe modernizojmë ato.

- Pse demokracitë nuk janë më në gjendje të marrin vendime të qarta? Pse politika është e bllokuar në procedura, ndërsa startup-et po ndërtojnë përpunues? Pse një projekt hekurudhor gjerman zgjat 20 vjet, por një superkompjuter kinez është gati brenda 24 muajsh?

Liberalizmi nuk është i garantuar. Demokracia nuk është ligj i natyrës. Ato janë sisteme që duhet të dëshmojnë veten nga e para çdo ditë. Jo përmes ideologjisë, por përmes rezultateve. Kjo do të thotë: infrastrukturë moderne, një administratë funksionale, arsim bashkëkohor dhe politikë industriale që shikon përpara. Ata që nuk arrijnë t'i përmbushin këto premtime nuk humbasin vetëm zgjedhjet, por përfundimisht të gjithë lojën.

Kina nuk na ka mposhtur, por po e sfidon Perëndimin deri në thelb. Përgjigjja nuk qëndron në bunkerin e arrogancës, por në guximin për të reformuar veten. Perëndimi nuk ka nevojë të rishpikë veten, por duhet të bëjë një përpjekje më të madhe dhe të ndryshme. Ish-Sekretari i Mbrojtjes i SHBA-së, Donald Rumsfeld në vitin 2003 shpiku termin “Europa e vjetër”. Në atë kohë ishte në lidhje me pjesëmarrjen në Luftën e Irakut dhe nuk ishte një kompliment.

Rumsfeld thjesht nuk e kuptoi atëherë se ai ishte përfshirë, si pjesë e Perëndimit të vjetër. Për të historia nuk ka mbaruar ende, thjesht ka gjetur një pionier të ri. Dhe ata që nuk e ndjekin përfundimisht, bëhen shënime në fund të faqes.

Shënim: Dr. Miriam Meckel është profesoreshë e menaxhimit të komunikimit në Universitetin e St. Gallen, CH dhe sipërmarrëse.

3.5 LUFTA PO E SHNDËRRON IRANIN NË NJË SUPERFUQI BOTËRORE

Nga dr. Rober A. Pape

Vitet e fundit, mençuria konvencionale gjeopolitike ka qenë se rendi botëror po lëvizte drejt tri qendrave të pushtetit: Shteteve të Bashkuara, Kinës dhe Rusisë. Kjo pikëpamje supozonte se fuqia rridhte kryesisht nga shkalla ekonomike dhe aftësia ushtarake.

Ky supozim nuk qëndron më. Një qendër e katërt e fuqisë globale po shfaqet me shpejtësi. Kjo qendër është Irani, i cili nuk i rivalizon këto tri kombe ekonomikisht apo ushtarakisht. Në vend të kësaj, fuqia e tij e sapogjetur rrjedh nga kontrolli i tij mbi pikën më të rëndësishme të bllokimit të energjisë në ekonominë globale: Ngushticën e Hormuzit.

Ngushtica kishte qenë prej kohësh një rrugë ujore ndërkombëtare, përmes së cilës mund të udhëtonin anijet nga të gjitha vendet. Por fushata e përbashkët ushtarake, që Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli filluan të zhvillonin kundër Iranit këtë vit, e ka shtyrë Iranin të krijojë një bllokadë ushtarake selektive të ngushticës.

Përafërsisht një e pesta e furnizimit botëror me naftë dhe gaz natyror të lëngshëm lëviz përmes ngushticës. Nuk ka alternativa reale për këto rrugë furnizimi në afat të shkurtër. Nëse kontrolli iranian mbi ngushticën vazhdon për muaj apo vite, siç besoj se mund të ndodhë, ai do të riformësojë rrënjësisht rendin global në dëm të Shteteve të Bashkuara. Shumë analistë besojnë se kontrolli i Iranit mbi Ngushticën e Hormuzit është vetëm i përkohshëm. Një pritshmëri e përhapur është se forcat detare të SHBA-së dhe aleatëve së shpejti do të stabilizojnë situatën dhe se flukset e naftës do të rifillojnë sipas linjave të njohura.

Kjo pritshmëri është e gabuar. Ajo supozon se për të vazhduar kontrollin e ngushticës, Irani duhet ta mbyllë atë fizikisht. Por, siç e kemi parë tashmë, ju mund ta kontrolloni ngushticën pa e mbyllur atë. Sot ngushtica mbetet e hapur për tankierët. Megjithatë, trafiku ka rënë me mbi 90 për qind që kur filloi lufta, jo sepse Irani ka mbytur çdo

anije që hynte në ngushticë, por sepse, duke pasur parasysh kërcënimin e besueshëm të një sulmi, siguruesit tërhoqën ose rishikuan çmimin e mbulimit të rrezikut të luftës. Goditja e një anijeje mallrash një ndër tri-katër ditë ishte sinjal më se i qartë për ta bërë rrezikun të papranueshëm.

Ekonomitë moderne nuk kërkojnë thjesht naftë. Ato kërkojnë gjithashtu naftë të dorëzuar në kohë, në shkallë të gjerë dhe me rrezik të parashikueshëm. Kur kjo besueshmëri prishet, tregjet e sigurimeve shtrëngohen, tarifat rriten dhe qeveritë fillojnë ta shohin aksesin në energji si një sfidë komplekse strategjike dhe jo si një transaksion të thjeshtë tregtar.

Problemi për Shtetet e Bashkuara është asimetria. Mbrojtja e çdo dërgese naftë që kalon përmes Ngushticës së Hormuzit kundër sulmeve të mundshme, minave, dronëve, sulmeve me raketa, është një operacion me kohë të plotë. Kërkon prani të vazhdueshme ushtarake. Iranit i duhet vetëm të godasë një tankier naftë herë pas here, për të hedhur dyshime mbi besueshmërinë e dërgesave botërore të naftës.

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, për këtë çështje deklaroi se hapja e Ngushticës së Hormuzit me forcë ishte “jorealiste” dhe se “kjo mund të bëhet vetëm në akord me Iranin”. Ai pothuajse po pranonte se rrjedha e naftës nuk mund të garantohet pa pëlqimin e Iranit. Për dekada të tëra, Gjiri Persik kishte një marrëveshje të thjeshtë: prodhuesit e naftës eksportonin, tregjet caktonin çmimin dhe Shtetet e Bashkuara siguronin rrugën. Ky sistem lejoi rivalitetin pa paqëndrueshmëri. Tani ai po shpërbëhet.

Shtetet e Gjirit varen shumë nga eksportet e energjisë për të dhënat shtetërore. Kur normat e sigurimit rriten dhe transporti bëhet i pasigurt, ndikimi fiskal është i menjëhershëm. Qeveritë përshtaten. Ngarkesat ridrejtohen. Kontratat rinegociohen.

Nëse pasiguria vazhdon, marrëveshja e Gjirit në mënyrë të pashmangshme do të ndryshojë, duke i lënë vendin një rendi rajonal të ndryshëm, një rend në të cilin shtetet e Gjirit akomodojnë gjithnjë e më shumë aktorin që mund të ndikojë më drejtpërdrejt në besueshmërinë e

eksporteve të tyre. Ky aktor tani është Irani. Pasojat globale do të jenë më të theksuara në Azi, Japoni, Korenë e Jugut dhe Indi dhe varen shumë nga energjia e Gjirit. Kina, megjithëse më e diversifikuar, varet gjithashtu nga rajoni për një pjesë të madhe të importeve të saj të energjisë. Këto varësi janë të ngulitura në infrastrukturë, si: rafineri, rrugë transporti dhe sisteme magazinimi që nuk mund të rikonfigurohen shpejt.

Nëse ndërprerja e furnizimit me energji vazhdon, efektet do të jenë të gjera. Kostot më të larta të sigurimit dhe faktit do të rrisin çmimet. Bilancet tregtare do të përkeqësohen. Monedhat do të dobësohen. Inflacioni do të rritet. Varësia nga energjia do të fillojë të formësojë politikën. Qeveritë do të prioritzojnë qasjen në energji. Zgjidhjet diplomatike do të ngushtohen. Veprimet që rrezikojnë paqëndrueshmëri të mëtejshme do të bëhen më të vështira për t'u mbajtur. Një botë e viteve 1970 në të cilën goditjet e naftës çojnë në vite stagflacioni nuk do të jetë më një kujtim i largët, por një realitet që po afrohet.

Përsëri Irani do të përfitojë

Kina varet nga energjia e Gjirit për të mbajtur rritjen. Rusia përfiton nga çmimet më të larta dhe më të luhatshme të energjisë. Irani fiton influencë nga pozicioni i tij në pikën e bllokimit në Hormuz. Secili prej këtyre tri kombeve ka stimuj që bien ndesh me stabilitetin ekonomik të Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të tyre. Këto tri kombe nuk kanë nevojë të koordinohen në mënyrë formale. Struktura e sistemit i shtyn ata në të njëjtin drejtim. Kështu shfaqet një rend i ri jo përmes një aleance formale (të paktën jo në fillim), por përmes stimujve konvergjentë që përforcojnë njëri-tjetrin me kalimin e kohës.

Skenarë të tjerë të besueshëm në rendin e ri botëror në shfaqje janë edhe më të errët. Imagjinoni Iranin me kontrollin e rreth 20 për qind të naftës në botë, Rusinë me rreth 11 për qind dhe Kinën, të aftë për të thithur pjesën më të madhe të këtij furnizimi. Ata do të formonin një kartel për t'i mohuar Perëndimit 30 për qind të naftës në botë. Nuk

keni nevojë për analiza të sofistikuara për të njohur pasojat katastrofike: rënie të vrullshme të fuqisë për Shtetet e Bashkuara dhe Europën dhe një zhvendosje globale drejt Kinës, Rusisë dhe Iranit.

Shtetet e Bashkuara përballen me një zgjedhje të vështirë: ose të angazhohen në një përpjekje afatgjatë për të ripohuar kontrollin mbi Ngushticën e Hormuzit, ose të pranojnë një marrëveshje të re globale për energjinë, në të cilën kontrolli i SHBA-së nuk është më i siguar. Nëse zgjedh pranimin, rezultati është i qartë: sistemi ndërkombëtar do të riorganizohet me Iranin si qendrën e katërt të fuqisë globale. Megjithatë, nëse Shtetet e Bashkuara zgjedhin të ripohojnë kontrollin ushtarak, ato i pret një betejë e gjatë, të cilën mund ta humbasin.

Lufta e Iranit nuk është një konflikt ushtarak, nga i cili Shtetet e Bashkuara mund të tërhiqen thjesht, me gjërat që kthehen siç ishin më parë. Irani me siguri do të kërkonte një çmim të lartë në një akomodim të ri me Shtetet e Bashkuara, por ky çmim do të jetë sigurisht më pak kushtues se ai i së ardhmes alternative. Kjo është një luftë transformuese dhe nëse këto ndryshime vazhdojnë qoftë edhe për pak vite, rendi global do të ndryshojë në mënyrë të pakthyeshme.

[Përktheu: Dan GASHI]

Shënim: Robert Anthony Pape është politolog amerikan që studion çështjet e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, me fokus në fuqinë ajrore, dhunën politike, propagandën në mediat sociale dhe terrorizmin.

3.6 KONKURRENCA PËR BURIME ME KINËN QËNDRONTE PAS LUFTËS SË TRUMP-IT NDAJ IRANIT

Nga dr. Guy Laron

Lufta e SHBA-së kundër Iranit mund të jetë dukur si një lëvizje irracionale nga një president që është po aq i pamenduar dhe impulsiv, sa edhe shkatërrues. Por kishte një logjikë gjeopolitike pas sulmit, e bazuar në dëshirën e Uashingtonit, për t'i mohuar Kinës gasjen te burimet jetike. Luftërat për burime midis SHBA-së dhe Kinës kanë përshpejtuar vendosmërinë e të dyja palëve për të shpëtuar nga varësitë e tyre ndaj njëra-tjetrës. Dy fuqitë e mëdha po çmontojnë ekonominë e integruar, të cilën kanë pesëdhjetë vjet që po e ndërtojnë së bashku.

Në mëngjesin e 23 shkurtit 2026, Benjamin Netanyahu telefonoi Donald Trump-in nga Jerusalemi për t'i dhënë informacione inteligjente, që do të ndryshonin rrjedhën e luftës së tyre kundër Iranit. Zyrtarë të lartë iranianë, përfshirë vetë Udhëheqësin Suprem Ali Khamenei, kishin planifikuar të mblidheshin në një kompleks në Teheran atë të shtunë, të pambrojtur ndaj një sulmi të vetëm ajror. Trump-i ishte në Mar-a-Lago kur erdhi telefonata.

Dy javë më parë, Trump-i dhe Netanyahu ishin takuar në Uashington për tri orë në një seancë të përshkruar nga të pranishmit si e rëndë dhe e zymtë, duke planifikuar një operacion të koordinuar me hollësi të mëdha. Edhe para se të takoheshin, Trump-i kishte urdhëruar një dislokim masiv trupash në Lindjen e Mesme pas një kryengritjeje në Iran, që udhëheqësit e tij e shtypën me gjak. Presidenti sigurisht po mendonte të sulmonte Iranin, por nuk kishte vendosur ende për kohën.

Pas bisedës telefonike me Netanyahu, Trump-i urdhëroi CIA-n të verifikonte inteligjencën e Izraelit. Ajo rezultoi e saktë. Tri ditë më vonë, të dërguarit e tij, Jared Kushner dhe Steve Witkoff, telefonuan nga Gjeneva. Negociatat me Iranin nuk po shkonin askund, thanë ata.

Tani gjithçka u bë bashkë për Trump-in: plani, mundësia operacionale, bllokimi diplomatik. Rezultati ishte operacioni “Epic Fury”, një sulm i befasishëm i përbashkët amerikan dhe izraelit, që vrau Khamenein dhe shkaktoi luftën.

Megjithatë, përplasja midis Iranit dhe Shteteve të Bashkuara nuk filloi me atë telefonatë, as me uraniumin e pasuruar thellë nën tokë në Isfahan. Ajo filloi tetë vite më parë, kur Uashingtoni dhe Pekini hynë në një përballje të heshtur ekzistenciale mbi arkitekturën fizike të së ardhmes. Kjo ishte një luftë e ashpër pozicionesh, e fshehur në njoftime të mërzitshme të Ministrive të Tregtisë, për minerale që shumica e njerëzve nuk i kanë dëgjuar kurrë. Për të kuptuar pse avionët amerikanë dhe izraelitë goditën Teheranin atë mëngjes të së shtunës, duhet të udhëtojmë jo në Gjirin Persik, por në fshatrat e kancerit të Mongolisë së Brendshme.

Kanceri në Mongoli

Në zonën minerare *Bayan Obo* në Mongolinë e Brendshme, 150 kilometra në veri të Baotout, toka përmban minerale, që e bëjnë botën moderne të funksionojë. Më shumë se 80 për qind e rezervave të tokave të rralla të Kinës janë të përqendruara aty, në skajin e shkretëtirës Gobi. Prodhimi nuk mori hov deri në vitet 1990, kur qeveritë perëndimore bënë një llogaritje të heshtur, se nxjerrja e këtyre mineraleve ishte shumë e ndotur dhe shumë toksike për t’ua imponuar qytetarëve të tyre. Më mirë ta bënte Kina. Midis viteve 1990 dhe 2000, prodhimi kinez u rrit me 450 për qind. Perëndimi mbylli minierat e veta dhe ktheu kokën nga ana tjetër.

Ajo që u injorua ishte mbetja toksike dhe radioaktive e prodhuar nga fabrikat e përpunimit, që derdhej në gropa të hapura dhe rezervuarë pa mbrojtje, duke depërtuar drejt Lumit të Verdhë, burimi kryesor i ujit të pijshëm për pjesën më të madhe të Kinës Veriore. Fshatrat rreth Baotout u bënë të njohura, me një qartësi të zyrtë, si “fshatrat e kancerit”. Hetuesit dokumentuan valë çrregullimesh ortopedike dhe defekte lindjeje. Fëmijët thithnin pluhur radioaktiv thjesht duke luajtur në rrugë.

Teknologjitë për të nxjerrë mineralet e rralla me më pak shkatërrim ekzistojnë, por kushtojnë më shumë. Pekini zgjodhi metodën më të lirë. Mbetjet e shkatërruara të fshatrave të kancerit ende qëndrojnë të shpërndara mes tubave të ndryshkur dhe magazinave të braktisura. Kina nuk arriti dominimin e saj vetëm nga fati gjeologjik. Elementet e tokave të rralla gjenden në të gjithë botën, por rrallë në depozita mjaft të pasura për t'u nxjerrë në mënyrë efikase dhe pothuajse kurrë në forma të lehta për t'u ndarë nga njëra-tjetra. Thyerja e lidhjeve kimike, që i mbajnë bashkë në natyrë, mund të kërkojë më shumë se njëqind faza përpunimi dhe sasi të mëdha acidesh të fuqishme.

Që nga viti 1980, Pekini ka investuar miliarda për ta zotëruar këtë proces, duke subvencionuar çdo fazë të zinxhirit të furnizimit, derisa kontrolloi jo vetëm minierat, por edhe kiminë. Sot Kina nxjerr rreth 70 për qind të mineraleve të rralla në botë dhe përpunon 90 për qind të furnizimit global, përfshirë gati gjysmën e mineralit amerikan, i cili kalon Paqësorin për t'u përpunuar dhe kthehet si material i përfunduar. Përdorimet nuk janë ekzotike; ato janë kudo, nga motorët elektrikë tek ekranet e telefonave inteligjentë dhe te motorët e avionëve. Por dimensionin ushtarak ishte ai që i mbante zgjuar natën planifikuesit e Pentagonit. Tokat e rralla janë të përfshira në shtyllën kurrizore të luftës amerikane: avionët F-35, nëndetëset e klasës “Virginia”, raketat “Tomahawk”, dronët “Predator”. Deri në fund të vitit 2025, Shtetet e Bashkuara nuk kishin asnjë burim operativ jashtë Kinës për disa nga tokat e rralla të rënda më kritike. Skeleti i fshehur i botës moderne rezultoi se kishte një pronar të vetëm. Pekini së shpejti do ta shfrytëzonte këtë avantazh.

Njoftimi 61

Gjatë gjithë vitit 2025, Trump-i kishte rritur tarifat ndaj mallrave kineze në një seri goditjesh të përshkallëzuara. Kina ishte përgjigjur çdo herë me kundërmasa të kalibruara. Megjithatë, ndërsa lufta tarifore ishte e dhimbshme për Pekinin, lufta teknologjike ishte ekzistenciale. Rrënjët e zemërimit të Kinës mund të gjurmohen përtëj “Ditës së Çlirimit” në

prill 2025, deri në vitin 2018, kur administrata e parë *Trump* nisi një fushatë diplomatike të heshtur për të penguar Kinën që të merrte teknologjinë më të avancuar të prodhimit të çipave nga ASML-ja.

ASML-ja, një kompani holandeze dhe prodhuesi i vetëm i makinave të litografisë me rreze ultravjollcë, pa të cilat nuk mund të prodhohen gjysmëpërçuesit më të avancuar, ishte në prag të dërgimit të një makine prej 150 milionë dollarësh te një klient kinez. Megjithatë, Sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, personalisht lloboi te kryeministri holandez, Mark Rutte, dhe makina nuk u dërgua kurrë.

Ajo që filloi si një bllokim i synuar i një shitjeje u shndërrua, gjatë viteve të Joe Biden-it dhe në mandatin e dytë të Trump-it, në një bllokadë teknologjike të rrënjosur strukturalisht, që synonte jo vetëm makinat që prodhojnë çipa të avancuar, por edhe vetë çipat, duke zbritur gradualisht në shkallën teknologjike dhe duke shtuar kompani në listat e zeza. Logjika ishte e drejtpërdrejtë dhe brutale: mohoji Kinës çipat e avancuar që fuqizojnë inteligjencën artificiale dhe kjo i mohon asaj teknologjinë dominuese të gjeneratës së ardhshme.

Për Pekinin kjo nuk ishte thjesht një mosmarrëveshje tregtare. Ishte një rrethim strategjik, një përpjekje e qëllimshme për ta ngrirë Kinën në një gjendje të përhershme të statusit teknologjik të nivelit të dytë, pikërisht kur ajo kishte arritur pragun e primatit global. Fyerja përfundimtare ishte se Uashingtoni po bllokonte qasjen e Kinës në teknologjitë e rafinuara nga vetë mineralet e tokave të rralla, që punëtorët kinezë po helmoheshin duke i nxjerrë nga toka rreth Baotou. Kina ishte mjaftueshëm e mirë për të nxjerrë dheun. Nuk do të lejohej të përfitonte nga ajo, që kjo tokë bënte të mundur.

Në prill 2025, durimi i Pekinit u shter. Ai vendosi kufizime eksporti për disa produkte kyç të tokave të rralla, një paralajmërim i drejtpërdrejtë ndaj prodhuesve amerikanë të mbrojtjes. Ishte njëkohësisht një protestë kundër tarifave treshe të Trump-it dhe një përgjigje ndaj shtatë viteve të kufizimeve në përshkallëzim për gjysmëpërçuesit. Kërcënimi funksionoi mjaftueshëm për të prodhuar një armëpushim nëntëdhjetëditor, të rënë dakord në Gjenevë në maj, i

cili uli tarifat në 30 për qind dhe pezulloi kontrollet mbi mineralet. Por tre muaj nuk ishin të mjaftueshëm për të zgjidhur asgjë. Në tetor 2025, me marrëveshjen e Gjenevës që po shpërbëhej, Pekini iu kthye sërish armës së tokave të rralla, këtë herë me shumë më tepër ambicie dhe shumë më pak përmbytje.

Njoftimi nr. 61 i Ministrisë së Tregtisë të Kinës ishte i thatë në gjuhë dhe shkatërrues në implikime. Ai zgjeroi kontrollet e eksportit në dymbëdhjetë, nga shtatëmbëdhjetë elementet e tokave të rralla, dhe vendosi kërkesa për licencim për çdo magnet që përmbante qoftë edhe një gjurmë materiali me origjinë kineze, pavarësisht se ku ishte prodhuar.

Kjo do të thoshte se, nëse për shembull, një kompani gjermane përdorte edhe një sasi shumë të vogël elementesh kineze të tokave të rralla për të prodhuar një produkt, ajo duhej të kërkonte leje nga Pekini për ta eksportuar atë kudo tjetër në botë. Njoftimi 61 gjithashtu ndaloi plotësisht eksportet e tokave të rralla për çdo përdorim ushtarak. Arkitektura ligjore ishte huazuar pothuajse fjalë për fjalë nga vetë praktika e Uashingtonit: rregulli i produktit të drejtpërdrejtë të huaj, një mekanizëm që Shtetet e Bashkuara e kishin përdorur prej kohësh për të kufizuar qasjen e Kinës në gjysmëpërçues të avancuar, tani i kthyer kundër krijuesve të tij.

Uashingtoni u trondit. Qasja e tij në gjakun jetësor të industrive më të avancuara u kufizua në mënyrë dramatike. Sekretari i Thesarit, Scott Bessent, deklaroi se Pekini kishte “drejtuar një bazukë drejt zinxhirëve të furnizimit dhe bazës industriale të gjithë botës së lirë.” Përgjigjja e Trump-it ishte shpërthyes. Ai njoftoi një tarifë shtesë prej 100 për qindësh mbi mallrat kineze, mbi 30 për qind që ishin tashmë në fuqi; kërcënoi kontrolle të gjera mbi softuerin kritik dhe anuloi takimin e planifikuar me Xi Jinping-un në Korenë e Jugut. Por zemërimi nuk zgjati.

Brenda pak ditësh nga shpërthimi i Trump-it në “Truth Social”, të dyja palët po kërkonin në heshtje një rrugëdalje. Më 30 tetor, Trump-i dhe Xi u takuan në margjinat e samitit të Bashkëpunimit Ekonomik

Azi-Paqësor në aeroportin ndërkombëtar *Gimhae* në Busan, Kore e Jugut. Marrëveshja që arritën ishte një rikthim i kujdesshëm i *status quo*-së para tetorit, i paraqitur si një përparim. Uashingtoni uli ndjeshëm tarifat dhe gjithashtu pezulloi rregullat që kufizonin eksportin e gjysmëpërçuesve dhe makinave për prodhimin e çipave drejt firmave të lidhura me Kinën. Pekini, nga ana e tij, pezulloi *Njoftimin 61* për një vit. Kriza e mineraleve të tokave të rralla u shty përkohësisht. Por “bazuka”, siç e quajti Bessent, vetëm u kthye në vendin e saj. Ajo ishte ende aty, që Pekini ta përdorte.

Trump-i u tha gazetarëve se do ta vlerësonte takimin me Xi-në si “dymbëdhjetë” në një shkallë nga zero në dhjetë. Vëzhgues të tjerë nuk e blenë këtë interpretim optimist. Studiuesi Jin Canrong deklaroi se Busani tregoi që Kina dhe Shtetet e Bashkuara ishin bërë “fuqi të mëdha të barabarta”. Elitat kineze nxorën mësimin, se kundërkërcënimet e vendosura funksiononin dhe se Uashingtoni mund të vihej në kënd. Megjithatë, Trump-i nxori një mësim tjetër. Ai ishte poshtëruar nga ekzistenca e një pike ngushtimi që nuk e kontrollonte. Pyetja ishte nëse mund të gjente një të vetën. Ai tashmë kishte një kandidat në mendje: rafineritë e provincës Shandong.

Çajnikët e Shandongut

Përgjatë bregdetit të provincës Shandong, për qindra kilometra shtrihet një peizazh industrial: depozita, kulla përpunimi dhe struktura rafinerish që ngrihen mbi fshatrat e peshkatarëve. Rafineritë e pavarura të grumbulluara aty, të njohura si “çajnikë”, për shkak të shkallës së tyre fillestare modeste, filluan të merrnin licenca importi vetëm në vitin 2015, kur Pekini theu monopolin shtetëror mbi blerjet e naftës.

Brenda një dekade, ato u bënë një e katërta e kapacitetit total të rafinimit të Kinës, motori i një ekonomie provinciale me vlerë gati 10 trilionë yuanë, me qindra mijëra vende pune që shtrihen nga fabrika te logjistika, kimikatet dhe shërbimet ndihmëse. Kompleksi i rafinerive të Shandongut luan një rol kyç në ekonominë kineze, megjithatë funksionon me një lloj shumë të veçantë karburanti. Sekret i ishin

sanksionet. Kur Shtetet e Bashkuara ndërprejnë Iranin dhe Venezuelën nga blerësit perëndimorë, pa dashje krijuan një klasë furnizuesish, që shisnin me zbritje të theksuara kujt do që pranonte të merrte ngarkesat pa bërë shumë pyetje. “Çajnikët” nuk bënin asnjë. Nafta e rëndë iraniane dhe venezuelase mbërrinte e rietiketuara si malajziane, omanase ose indoneziane, e riemërtuar pas transferimeve anije-më-anije në ujëra ndërkombëtare nga cisterna që lundronin me transponderë të fikur.

Deri në vitin 2025, nafta nën sanksione nga Irani dhe Venezuela përbënte rreth 17 deri në 18 për qind të importeve totale të naftës së Kinës. Rafineritë gjigante shtetërore të Kinës mbanin duart e pastra dhe distancën. “Çajnikët” bënin punën e pistë, nominalisht privatisht, por të ndërthurur me shtetin kinez përmes partneriteteve me kompani shtetërore. Pekini siguron qasjen në porte dhe indiferencën e studiuar, që bëjnë të mundur të gjithë sistemin. Vetë tiparet që i bënin “çajnikët” konkurrues, varësia nga nafta e rëndë me zbritje, logjistika në hije, furnizues të sanksionuar, i bënin ata jashtëzakonisht të cënueshëm ndaj kujt do që ishte i gatshëm të godiste fundin e zinxhirit të furnizimit dhe jo vetë rafineritë. Trump-i duket se e vuri re këtë dhe filloi të synonte furnizuesit e Shandongut.

Lufta e re e Ftohtë vjen në Karaibe

Natën e 3 janarit 2026, forcat speciale amerikane kapën Nicolás Maduro-n në rezidencën e tij në Karakas dhe e transferuan në Nju-Jork për t’u përballur me akuza për narkoterrorizëm. Për Uashingtonin ishte një operacion i zbatimit të ligjit. Për Pekinin, ishte diçka më afër një katastrofe. Venezuela nuk ishte thjesht një partner tregtar për Kinën; ishte përfituesi më i madh i huadhënies së mbështetur nga shteti kinez në Amerikën Latine, me 106 angazhime kredie, që arrinin mbi 100 miliardë dollarë, shumica dërrmuese të strukturuara si marrëveshje shlyerjeje të garantuara me naftë. Banka e Zhvillimit të Kinës kishte vënë në rrezik gjithçka mbi naftën venezuelase si kolateral. Me largimin e Maduros dhe me Uashingtonin që njoftonte se do të merrte kontrollin

e eksporteve të naftës së Venezuelës, ky kolateral tani ishte në duart e Amerikës.

Pekini shprehu “shqetësim të thellë” dhe kërkoi lirimin e menjëhershëm të Maduros. Administrata “Trump” nuk u mundua as të përgjigjej. Të ardhurat nga shitjet e para të naftës venezuelase, gjysmë miliardi dollarë, u transferuan në një llogari bankare në Katar, të vendosura me kujdes përtej arritjes së kreditorëve, venezuelianë dhe kinezë njësor, që kishin pretendime mbi atë rrjedhë të ardhurash.

Ajo që pasoi ishte një demonstrim se si energjia mund të përdoret si armë me saktësi kirurgjikale. Venezuela kishte furnizuar Kubën me rreth tridhjetë e pesë mijë fuçi naftë në ditë, jetike për ishullin, rrjeti energjetik i të cilit funksiononte pothuajse tërësisht me naftë. Trump-i e ndërpreu menjëherë këtë rrjedhë, duke kërcënuar me tarifa ndaj çdo vendi, që do të përpiqej ta zëvendësonte. Brenda javësh, centralet kubane filluan të dështonin. Deri në mars, rrjeti ishte shembur plotësisht, duke shkaktuar një ndërprerje të energjisë në të gjithë ishullin. Protestat shpërthyen në rrugë, në një vend ku demonstratat e paautorizuara sjellin dënime me burg.

Logjika strategjike pas kësaj mbyetjeje u shpjegua te vetë urdhri ekzekutiv i Trump-it: Kuba priste instalimin më të madh të inteligjencës së sinjaleve jashtë vendit të Rusisë në Lourdes, një kompleks i madh antenash pranë Havanës, që kishte përgjuar komunikimet ushtarake amerikane që nga Lufta e Ftohtë. Ajo kishte gjithashtu katër poste dëgjimi kineze, përfshirë instalimin në Bejucal, pjatat satelitore të të cilit shikonin përmes pyllit tropikal drejt selisë së Komandës Qendrore, që mbikëqyr Lindjen e Mesme, për të mos përmendur rezidencën *Mar-a-Lago* të Trump-it dhe të vetmin poligon stërvitor amerikan, që mund të simulojë luftime në Ngushticën e Tajvanit.

Trump-i bëri të qartë, se kushti i tij për heqjen e embargos së naftës ndaj Kubës ishte ndryshimi i regjimit në Havanë. Pasi të ndodhte kjo, me gjasë, Rusia dhe Kina “do të verboheshin”. Për rafineritë “çajnikë” të Shandongut, kapja e Maduros ishte një goditje furnizimi, për të cilën nuk ishin përgatitur. Nafta e rëndë venezuelase kishte qenë

lënda bazë, mbi të cilën ishte ndërtuar i gjithë modeli i tyre i biznesit: e pasur me squfur, teknikisht e vështirë për t'u përpunuar, por me zbritje 10 deri në 15 dollarë nën "Brent" (klasifikimi tregtar për këtë lloj naftë), çka e bënte kompleksitetin të vlefshëm.

Brenda javësh nga operacioni, eksportet drejt Azisë ranë me 67 për qind. Blerësit kinezë, të cilët kishin marrë tri të katërtat e të gjithë naftës venezuelase vitin e kaluar, zbuluan se rregullat e lojës kishin ndryshuar. Trump-i e bëri të qartë, se ata do të paguanin çmime të tregut botëror, duke eliminuar zbritjen menjëherë. Rafineritë e Shandongut tani përballeshin me një zgjedhje të ashpër: të gjenin një zëvendësues të barabartë ose të shikonin fitimet e tyre të shembeshin. Analistët dhe tregtarët tani po mendonin se nga do të drejtoheshin. Nafta e rëndë iraniane ishte alternativa më e lirë e disponueshme, me zbritje rreth 10 dollarë nën "Brent". Pekini priste që zëvendësimi të ishte i drejtpërdrejtë. Netanyahu dhe Trump-i kishin plane të tjera.

Ëndrrat trans-arabiane

Ndërsa avionët amerikanë dhe izraelitë po godisnin objektiva në të gjithë Iranin, Trump-i dhe Netanyahu po mendonin për naftën. Ajo që Izraeli donte nga lufta, shkonte përtej eliminimit të regjimit iranian. Netanyahu kishte në mendje një arkitekturë rajonale. Mbyllja e Ngushticës së Hormuzit, të cilën forcat iraniane e minuan dhe e bllokuan brenda ditësh nga sulmet fillestare, nga perspektiva izraelite nuk ishte thjesht një krizë për t'u menaxhuar, por një mundësi për t'u shfrytëzuar. Për dekada, nafta e Gjirit kishte rrjedhur Lindje-Perëndim përmes Hormuzit. Një alternativë ishte propozuar më parë: tubacioni trans-arabian, i njohur si *Tapline*, i ndërtuar në fund të viteve 1940 nga korporata amerikane për të transportuar naftën saudite në tokë përmes Jordanisë dhe Sirisë drejt portit libanez të Sidonit. Në atë kohë ishte një nga tubacionet më të gjata në botë. Megjithatë, politika arabe dhe konfliktet rajonale e bënë atë të pavlefshëm nga mesi i viteve 1970.

Vizioni i Netanyahu-t ishte një ringjallje e këtij koncepti, por me Izraelin si pikë përfundimtare. Propozimi i tij fillestar nga viti 2017

parashikonte një rrugë tubacioni prej shtatëqind kilometrash nga porti saudit “Yanbu” përmes Jordanisë deri në Eilat, dhe prej andej përmes tubacionit ekzistues “Eilat-Ashkelon” drejtpërdrejt në Mesdhe, duke anashkaluar plotësisht Hormuzin dhe Bab-el-Mandebin. Tarifat e përdorimit, të vlerësuara në qindra milionë dollarë në vit, do të rridhnin në thesarin izraelit, ndërsa nafta do të rridhte drejt Europës.

Administrata e parë “Trump” e kishte pëlqyer idenë, por sauditët kishin reaguar ftohtë ndaj saj. Kriza e Hormuzit në vitin 2026 i dha asaj urgjencë të re, dhe Netanyahu e përdori rastin për ta paraqitur publikisht planin. Ai madje argumentoi, se tubacioni i ri “Yanbu-Eilat” mund të ndërtohej për tre vjet. Logjika gjeopolitike shkonte edhe më thellë. Një regjim tubacionesh që do të drejtonte naftën e Gjirit drejt porteve mesdhetare, në vend që të kalonte përmes Ngushticës së Hormuzit, do të riformësonte ekonominë e të gjithë konkurrencës SHBA-Kinë. Nafta që do të udhëtonte në tokë drejt Ashkelonit dhe më tej në tregjet europiane do të kushtonte më shumë për blerësit aziatikë dhe më pak për ata europianë, duke ridrejtuar rrjedhat e energjisë larg Kinës dhe drejt aleatëve të Amerikës. Një pasojë që Netanyahu mund ta ketë parashikuar, ose edhe mirëpritur, ishte një Iran i fragmentuar, por i radikalizuar, armiqësia e të cilit ndaj monarkive të Gjirit do t’i bënte këto shtete të ndiheshin vazhdimisht të kërcënuara. Shtetet e Gjirit do të mbeteshin me një përfundim të qartë: vetëm Izraeli mund t’i mbrojë ato.

Deri në fund të marsit 2026, këshilltari diplomatik i Emirateve të Bashkuara Arabe, Anwar Gargash, kishte konfirmuar atë që kishte planifikuar Netanyahu: sulmet me raketa dhe dronë të Iranit ndaj shteteve të Gjirit e kishin forcuar Teheranin si kërcënimin kryesor rajonal, duke i detyruar vendet arabe të rishikonin aleancat e tyre. “Nuk po shohim dy mijë raketa dhe dronë izraelitë që na synojnë, - vërejti Gargash, - po shohim dy mijë raketa dhe dronë iranianë që na synojnë”.

Ngushtica e Trump-it

Trump-i, duke ndier momentin, në fund të marsit i bëri thirrje Arabisë Saudite t'i bashkohej “Marrëveshjeve të Abrahamit”. Por ndërsa Netanyahu kishte në sy tubacionet, Trump-i donte të kapte fushat e naftës. Modeli që kishte në mendje ishte tashmë në funksion në Karakas.

Delcy Rodríguez, zëvendëspresidentja e Maduros, kishte mbetur në detyrë pasi shefi i saj u kap, duke u bërë bashkëbiseduesja e bindur e Uashingtonit për naftën venezuelase. Trump-i donte të njëjtën marrëveshje në Teheran: një regjim pasues të manipulueshëm, që do të bashkëpunonte për prodhimin dhe çmimet. “Gjithçka ka të bëjë me vendosjen e dikujt si Delcy Rodríguez”, u tha një zyrtar i administratës gazetarëve. Vetë Trump-i i tha “Financial Times” në fund të marsit: “Të jem i sinqertë me ju, gjëja ime e preferuar është të marr naftën në Iran”.

Nëse diplomacia dështonte, kishte një opsion më të ashpër. Ishulli Kharg, terminali përmes të cilit rrjedh rreth 90 për qind e eksporteve të naftës iraniane, ndodhej në Gjirin Verior, brenda arritjes së forcave amerikane. “Na duhet rreth një muaj për t'i dobësuar më shumë iranianët”, tha një burim i njohur me mendimin e Shtëpisë së Bardhë. “Të marrim ishullin [Kharg] dhe pastaj i kemi në dorë dhe i përdorim për negociata”. Trump-i shpjegoi më vonë se, nëse SHBA-ja do të merrte Khargun, “do të thoshte gjithashtu, se do të duhej të qëndronim aty për një kohë.”

Më 26 mars, Trump-i hodhi një tjetër mundësi: që Ngushtica e Hormuzit do të kontrollohej nga “unë dhe Ajatollahu”. Një ditë më vonë, ai shkoi më tej, duke iu referuar Ngushticës së Hormuzit si “Ngushtica e Trumpit”. Vija lidhëse nga Karakasi në Teheran nuk ishte oportunitizëm i rastësishëm. Ishte skica e dukshme e një strategjie, e artikuluar më qartë nga Michael Every, një strateg në Rabobank. Për dekada të tëra, Kina kishte manovruar më mirë se SHBA-ja, duke përdorur politikat industriale dhe tregtare, si armë gjeopolitike: duke ndërtuar monopole, duke kontrolluar zinxhirët e furnizimit, duke kthyer varësitë ekonomike në mjet presioni. Megjithatë, Kina varej nga

burimet që vinin nga çdo cep i botës për të ushqyer makinën e saj industriale, dhe përgjigjja logjike amerikane ishte të përdorte instrumentin që Kina ende nuk mund ta barazonte.

“Ne kemi një ushtri dhe një aparat ushtarak, që mund të projektojë fuqi globalisht, - argumentoi Every. - Kina do ta ketë një të tillë pas dhjetë apo pesëmbëdhjetë vjetësh. Tani për tani nuk e ka”. Loja, siç e përshkroi ai, ishte të merrej kontrolli mbi mallrat kyç, përpara se kjo dritare të mbyllej, duke siguruar që burimet të rridhnin drejt zinxhirëve të furnizimit amerikan, të mbeteshin të çmuara në dollarë dhe të mbërrinin në anën tjetër të Paqësorit më shtrenjtë ose aspak. Venezuela ishte prova e konceptit. Irani ishte lëvizja e radhës.

Helen Thompson, një ekonomiste politike në Universitetin e Kembrixhit, duke iu qasur së njëjtës çështje nga perspektiva e gjeopolitikës së energjisë, arrin në një përfundim më të errët: *“Nëse kthehemi te raporti strategjik i sigurisë i vjeshtës së kaluar, është e qartë se bollëku energjetik, siç i pëlqen administratës “Trump” ta quajë, njëkohësisht është qëllim dhe mjet për të hyrë në konkurrencë gjeopolitike”*. Shtetet e Bashkuara ishin të pavarura energjetikisht, eksportuesi më i madh në botë i gazit natyror të lëngshëm (LNG), të mbrojtura nga pasojat e një Ngushtice të Hormuzit të mbyllur, në mënyra që Kina, importuesi më i madh i energjisë në botë thjesht nuk ishte. Siç e sheh Thompson: “Nëse ka probleme në Gji në këtë mënyrë, vendi që preket më pak janë Shtetet e Bashkuara... Në parim, atëherë mund të jetë përfitues”, sepse SHBA-ja do të merrte çmime më të larta për LNG-në që eksporton.

Në të kundërt, një mbyllje e zgjatur e Hormuzit do ta godiste Kinën si një hemorragji e ngadaltë: kosto më të larta importi, marzhe industriale të shtrydhura, erëra kundër për një ekonomi tashmë nën presion. Vetë Trump-i, i pyetur në fund të marsit për mbylljen e Hormuzit, ishte edhe më i drejtpërdrejtë: “Ne nuk kemi nevojë për Ngushticën e Hormuzit. Kemi kaq shumë naftë dhe vendi ynë nuk preket nga kjo”. Kjo ishte, pothuajse fjalë për fjalë, teza e Helen

Thompson-it e shprehur si politikë. Por strategjia e pikës së ngushtimit e Trump-it hasi në një pikë ngushtimi të vetën.

Porta e tarifës së Teheranit

Brenda ditësh nga fillimi i armiqësive, Republika Islamike e Iranit arriti diçka që një dekadë më parë do të dukej e pamundur. Pa një flotë detare të aftë të sfidonte grupet e aeroplanmbajtëseve amerikane, ajo e mbylli efektivisht pikën më të rëndësishme detare të botës. Arma ishte droni: i lirë, i shpenzueshëm dhe shkatërrues për kalkulimin e sigurimeve detare. Trafiku ditor përmes ngushticës kishte qenë mesatarisht 138 anije në ditë, por tani ishte reduktuar në një rrjedhë të dobët me shifra njëshifrore. Anijet që ende ishin të gatshme të kalonin, drejtoheshin në ujërat territoriale iraniane, ku njësitë e Gardës Revolucionare kontrollonin dokumentet, verifikonin ngarkesat dhe, në të paktën dy raste të dokumentuara, mbledhnin pagesa deri në 2 milionë dollarë për kalim, të shlyera në juanë kinezë.

I gjithë operacioni dukej se sfidonte primatin global të dollarit. Që nga vitet 1970, ai kishte ruajtur statusin e monedhës rezervë, sepse vendet e Gjirit Persik e çmonin naftën në dollarë. Nëse një vend nuk kishte dollarë, qasja e tij në naftë kufizohej. Ana e marrëveshjes për Uashingtonin ishte ombrella e sigurisë: garanci amerikane, baza amerikane, aeroplanmbajtëse amerikane në Gjirin Persik. Shtetet e Bashkuara ishin të gatshme të hynin në luftë për të mbrojtur monarkitë e Gjirit dhe e bënë këtë gjatë viteve 1980 dhe '90. Por, papritur, për shkak të krizës në Gjirin Persik, petrodollari, siç u bë i njohur, rrezikonte të zëvendësohej nga petro-juani.

Juani përbën rreth 2 për qind të rezervave globale valutore, kundrejt 57 për qind të dollarit. Arsyeja për këtë pabarazi është se juani nuk është ende mjaftueshëm likuid, i besueshëm apo i disponueshëm për të zëvendësuar dollarin. Pavarësisht ambicieve të Pekinit, juani nuk është gati për skenën kryesore, dhe një pikë tarifimi në Ngushticën e Hormuzit, sado dramatike, nuk mund ta ndryshojë këtë aritmetikë.

Ironia më e thellë ishte e dukshme jo në rrugët detare, por te vetë Teherani. Ndërsa regjimi po nxirrte tarifa kalimi të shprehura në juanë nga supertankerët, qytetarët e tij po çmonin gjithçka në dollarë, që nga picat te kontratat e apartamenteve. Inflacioni mbi 70 për qind kishte bërë atë që asnjë sanksion amerikan nuk e kishte arritur plotësisht: e kishte bërë dollarin monedhën e jetës së përditshme brenda Republikës Islamike. Regjimi që sapo kishte demonstruar zotërim asimetrik të luftës me dronë dhe kontrollit të pikave detare, njëkohësisht ishte shumë i dobët për të ruajtur besimin në monedhën e vet. Dhe, megjithatë, në fund edhe kjo “portë pagese” doli e negociueshme. Sipas kushteve të një armëpushimi dyjavor të arritur në fillim të prillit, Shtetet e Bashkuara dhe Irani ranë dakord të ndalonin armiqësitë ndërsa negociatat vazhdonin.

Trump-i, në mënyrë karakteristike, filloi menjëherë të improvizonte. I pyetur për planin e Iranit për të tarifuar anijet që kalonin ngushticën, ai njoftoi se po konsideronte ta kthente atë në një “sipërmarrje të përbashkët” me Teheranin. “Është një mënyrë për ta siguruar, - u tha ai gazetarëve. - Është një gjë e bukur”. Ajo që duket si kontradiktë, në fakt nënvizon qëndrueshmërinë e Trump-it. Pas kaq shumë luftërash dhe gjakderdhjesh, ai ishte ende i përqendruar në gjetjen e “Delcy Rodríguez-it” iranian, që do t’i lejonte të kontrollonte naftën e Iranit; nëse jo përmes Khargut, atëherë përmes një “sipërmarrjeje të përbashkët” në Ngushticën e Hormuzit.

Shkëputje së bashku

Për Kinën, lufta e ekspozoi me qartësi brutale atë për të cilën strategët kishin paralajmëruar prej kohësh: rreth 40 për qind e naftës dhe 30 për qind e importeve të saj të LNG-së kalonin përmes Ngushticës së Hormuzit, një pikë ngushtimi që ajo nuk mund ta mbronte dhe nuk e kontrollonte. Përgjigjja ishin tubacionet tokësore që asnjë grup aeroplanmbajtësesh amerikane nuk mund t’i kërcënonte.

Plani më i fundit pesëvjeçar i Kinës, i publikuar në fillim të marsit kërkon avancimin e “punës përgatitore për rrugën qendrore të

tubacionit të gazit natyror Kinë-Rusi”, një term diplomatik për “Power of Siberia 2”, një tubacion prej 2 600 kilometrash nga gadishulli Yamal i Rusisë në Kinë përmes Mongolisë, që kishte ngecur për vite, për shkak të mosmarrëveshjeve mbi çmimet. Lufta e ndryshoi këtë llogaritje dhe duket se Kina tani është e gatshme të rrisë varësinë e saj energjetike nga Rusia. Njëkohësisht, në një kompleks me siguri të lartë në Shenzhen, inxhinierë kinezë që punojnë me identitete të rreme dhe akses të kufizuar në telefona po testojnë një prototip makinerie litografie me rreze ultravjollcë ekstrem. Makina e ndërtuar nga ish-inxhinierë të ASML-së të rekrutuar me bonuse nënshkrimi deri në 700 000 dollarë, zë pothuajse të gjithë sipërfaqen e një fabrike. Ajo ende nuk ka prodhuar çipa funksionalë, por mund ta bëjë këtë deri në vitin 2030. Drejtimi është i qartë: Kina dëshiron, siç tha një burim, “100 për qind të përjashtuara nga zinxhirët e saj të furnizimit”.

Uashingtoni po vrapon në të njëjtën garë nga ana tjetër. Administrata “Trump” mbledhi pesëdhjetë e katër vende në një takim ministror për mineralet kritike në shkurt, duke nënshkruar korniza dypalëshe me njëmbëdhjetë vende dhe duke mobilizuar mbi 30 miliardë dollarë kredi, investime dhe garanci kredie për projekte të tokave të rralla në vend dhe tek aleatët. Administrata “Trump” investoi 1,6 miliardë dollarë në “USA Rare Earth”, një firmë në Oklahoma që kontrollon depozitat e tokave të rralla, më kritike për teknologjitë e mbrojtjes. Siç shpjegoi Sekretari i Tregtisë, Howard Lutnick: “Ky investim siguron që zinxhirët tanë të furnizimit janë të qëndrueshëm dhe nuk varen më nga vende të huaja”.

Luftërat për burime midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara kanë përshpejtuar vendosmërinë e të dyja palëve për të shpëtuar nga varësitë e tyre ndaj njëra-tjetrës. Këto tensione e detyrojnë pjesën tjetër të botës të përthithë tronditjen e dy fuqive të mëdha, që po çmontojnë ekonominë e integruar që kaluan pesëdhjetë vjet duke ndërtuar së bashku. Kostoja paguhet nga fëmijët që thithin pluhur radioaktiv rreth Baotou-t, nga familjet kubane që përballen me ndërprerje energjie, nga marinarët e bllokuar në Gjirin Persik, që presin që fuqitë e mëdha të

përfundojnë debatin e tyre. Për më tepër, luftërat për burime kërkojnë konsolidim autoritar, në vend për të menaxhuar këto kosto sociale. Ky konsolidim është i dukshëm në Pekin dhe Teheran, në Tel Aviv dhe Karakas, dhe gjithnjë e më shumë edhe te vetë Uashingtoni.

Detyra e së majtës nuk është të zgjedhë anë në këtë luftë, por ta emërtojë atë për atë që është: një përplasje midis shteteve për kontrollin e materialeve që fuqizojnë revolucionin e ardhshëm industrial, e zhvilluar në kurriz të njerëzve që jetojnë më afër këtyre materialeve dhe më larg vendimeve për mënyrën se si përdoren ato. Minierat, tubacionet, pikat e ngushtimit nuk janë pronë e qeverive që pretendojnë mbi to. Ato janë trashëgimia e përbashkët e të gjithëve që jetojnë në planetin që i përmban. Kjo nuk është thjesht një parullë, por është alternativa e vetme praktike ndaj botës që kjo ese ka përshkruar. [Përktheu: Dan Gashi]

Shënim: Dr. Guy Laron është ligjërues i lartë i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Hebraik të Jerusalemit.

Burimi: <https://jacobin.com/2026/04/trump-china-iran-resource-competition-war>

3.7 LUFTA E GJIRIT PO NDRYSHON TË ARDHMEN E LUFTËS GLOBALE

Nga Dan Gashi, Nju-Jork

Shtetet e Bashkuara po shpenzojnë miliarda dollarë në luftë me Iranin, duke futur botën në një spirale vicioze të kolapsit të çmimeve të naftës dhe krizës ekonomike. Ndërkohë, Kina po publikon dokumentin, platformën ekonomike ndoshta më vendimtare të dekadës, pothuajse pa u vënë re. Ky ndryshim në vëmendje, jo me pompozitet si në të kaluarën, është pikërisht thelbi i problemit.

Ndërsa bota është fokusuar në teatrin e luftës dhe luhatjet energjetike, Pekini po përcakton me shkrim arkitekturën e tij teknologjike, industriale dhe fuqinë strategjike për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme. Plani i 15-të Pesëvjeçar i 5 marsit që iu prezantua Kongresit Kombëtar Popullor, një dokument prej 141 faqesh, i cili ka pak ritualitet dhe fare pak reflektim burokratik nga dokumente të tilla nga tradita e kaluar. Hapësirë prominente në këtë tekst nxë inteligjenca artificiale, që theksohet më shumë se pesëdhjetë herë, duke lënë të kuptohet se ajo nuk konsiderohet vetëm një sektor mes të tjerëve, por shtylla kurrizore e të gjithë transformimit ekonomik. Pekini synon të sigurojë që deri në vitin 2027, 70% e ekonomisë kombëtare të integrojë zgjidhjet e IA-së dhe që kjo pjesë të rritet në 90% deri në vitin 2030, duke e shndërruar efektivisht IA-në në një infrastrukturë po aq të përhapur sa energjia elektrike apo lidhja digjitale.

Në këtë plan, rëndësi të veçantë i kushtohet robotikës dhe në veçanti robotikës humanoide, si një nga shtyllat e fazës së re industriale të Kinës, me qëllimin për të dyfishuar prodhimin e robotëve brenda pesë vitesh. Krahës kësaj, dokumenti përshkruan ambicie shumë të qarta në fushën e teknologjive të avancuara si rrjetet e komunikimit kuantik, fuzionit bërthamor të kontrolluar dhe zhvillimin sistematik të ndërfaqeve tru-kompjuter. Ky dokument ambicioz tregon se Kina nuk po ndjek vetëm inovacionet ekzistuese, por po synon trajektoren e

teknologjive më dominuese dhe shkatërruese. Plan i përcakton objektiva, të cilët qartësojnë fushëveprimin e kësaj strategjie. Vlera totale e industrive lidhur me inteligjencën artificiale pritet të kalojë 10 trilionë juanë, ose rreth 1,38 trilionë dollarë, duke e renditur sektorin e IA-së ndër katalizatorët kryesorë të ekonomisë kombëtare, si dhe përpjekje të jashtëzakonshme për të arritur një shkallë të lartë të vetëmjaftueshmërisë në zinxhirët e elementeve që konsiderohen kritikë: mineralet e rralla, gjysmëpërçuesit dhe komponentët e avancuar. Ky program kaq ambicioz me një dimension të veçantë ekonomik, është në sinkron me planet strategjiko-ushtarake të Kinës, që përmes kontrollit të zinxhirëve të furnizimit të kontrollojë dhe të dominojë me aftësitë luftarake të çdo fuqie rivale.

Për këtë arsye, ky nuk është thjesht një plan ekonomik, përkundrazi është një plan i vërtetë lufte për një konflikt që tashmë ka filluar, por që po luftohet në një terren që Shtetet e Bashkuara, të zhytura në luftëra konvencionale dhe kriza rajonale, vazhdojnë ta nënvlerësojnë. Uashingtoni drejton burimet dhe vëmendjen te lufta e nxehtë në Lindjen e Mesme, ndërsa Pekini strukturon një luftë teknologjike, industriale dhe logjistike “të ftohtë”, që synon të përcaktojë se kush do të kontrollojë mjetet materiale, kapitalin ekonomik dhe digjital të luftërave të ardhshme.

“CHIPS Act” si një armë kundër ekspansionit

Përgjigjja e SHBA-së ndaj sfidës teknologjike të Kinës deri më tani ka qenë “CHIPS and Science Act”, i miratuar në vitin 2022, projekt për të cilin u ndanë 52,7 miliardë dollarë për ngritjen dhe përforcimin në sektorin e gjysmëpërçuesve. Kjo masë e qeverisë ka nxitur mbi 640 miliardë dollarë investime private, por problemi është se ajo synon vetëm një segment të kufizuar. Disproporcioni i ambicieve dhe i synimeve të SHBA-së dhe asaj të Kinës është një asimetri e qartë. Programi “CHIPS Act” është, në fakt, një armë e vetme e drejtuar drejt një objektivi specifik: prodhimin të çipave të avancuar, ndërsa Plan i 15-të Pesëvjeçar i Kinës i ngjan një arsenali të plotë, që mbulon çdo

fushë, përfshirë IA në të gjithë sektorët, robotikën si shtyllë kurrizore të industrisë, infrastrukturën hapësinore, llogaritjen kuantike dhe forcimin e dominimit në përpunimin e mineraleve të rralla.

Mineralet e rralla, kompleksi ushtarak dhe “Opsioni Samson”

Çështja e mineraleve të rralla është pika ku plani ekonomik gërshetohet më qartë me dimensionin e luftës. Sot Pekini kontrollon rreth 90% të kapacitetit botëror të përpunimit të këtyre elementeve. Çdo avion luftarak F-35 kërkon qindra kilogramë elemente të rralla; çdo raketë “Patriot” apo municion i lëshuar mbi Iran mbështetet te materialet e rafinuara në Kinë. Kjo levë tashmë është vendosur në lëvizje: në prill 2025, Pekini prezantoi kontrolle të eksportit për të 17 elementet e klasifikuara si minerale të rralla. Në praktikë, lufta kundër Iranit po konsumon me shpejtësi sistemet e armëve, ndërsa Kina po ngulfat zinxhirin dhe prodhimin industrial të këtyre armëve.

Nga rafineritë e Iranit te shkatërrimi i infrastrukturës jetike të shteteve të rajonit

Eskalimi i shpejtë ose “kurthi i eskalimit” në këtë kontekst të luftës në Lindjen e Mesme merr karakteristikat e një “Opsioni Samson”, që nuk është vetëm ushtarak, por edhe energjetik e mjedisor. Pas goditjes së rafinerive në Teheran, u goditën edhe ato të impianteve të desalinizimit të ujit. SHBA-ja dhe Izraeli i kanë dhënë efektivisht autorizim Teheranit që të godasë infrastrukturën e furnizimit me ujë të Izraelit, që furnizon mbi 60% të vendit me ujë. Sulme të tilla në infrastrukturën jetike të vendeve fqinje që mbajnë krahun e SHBA-së do të sulmohen në varësi të dinamikës së eskalimit, gjegjësisht bombardimeve të SHBA-së dhe Izraelit. Kjo qasje me dinamikë të shpejtë eskaluese mbart në vete rrezik të trefishtë për SHBA-në:

1. Dëmtimi i marrëdhënieve me vendet prodhuese të naftës në rajon.
2. Rrezikimin e infrastrukturës energjetike në Gjirin Persik, që mund të rrisë çmimin e naftës në 150-200 dollarë.

3. Pasojat afatshkurtra dhe afatgjata sistemike në ekonominë globale dhe situatën financiare të SHBA-së, inflacion dhe tensione sociale.

Rrënimi i rendit ndërkombëtar dhe projektimi i modelit të hegjemonisë së re

Shkërmoqja e rendit ndërkombëtar që Uashingtoni dhe aleatët e tij e kanë mbajtur gjallë me sakrifica ka hyrë në një rrugë pa kthim. Tani është infrastruktura materiale; energjia, burimet, logjistika, teknologjitë kritike, ato që po i japin konturet një rendi botëror në formësim e sipër. Lindja e këtij rendi të ri botëror po përcillet me kontraste simbolike. Nga njëra anë, Presidenti Trump mbështetet në slogane në mediat sociale, si “shkatërrim i të gjithë armiqve të SHBA-së dhe Izraelit, aneksime, kërcënim me luftë dhe invazione etj.”; nga ana tjetër, Xi Jinping në heshtje miratoi një plan prej 141 faqesh, që detajon se si të sigurohet kontrolli i materialeve, i teknologjisë dhe, eventualisht, dominimi global. Udhëheqësi i Botës Perëndimore është kurthuar në një luftë që po përhapet shpejt dhe me tendencë të një lufte globale. Ai i Botës së Lindjes dhe autokracisë po projekton një rend pa luftë, me strategji për të përcaktuar kushtet strukturore dhe modelin që e bëjnë luftën e së ardhmes të qëndrueshme për veten dhe të papërballueshme për të tjerët.

IV. GJEOEKONOMI

4.1 LUFTA NË IRAN, BURSAT, NAFTA DHE ARI ME BITCOIN

Nga akademik Anastas Angjeli

Në situatën e tanishme gjeopolitike, Lindja e Mesme mbetet epiqendra, ku tensionet ushtarake përkthehen menjëherë në goditje sizmike jo vetëm për tregjet financiare globale, por edhe për ekonominë botërore. Por konflikti i hapur në Iran përfaqëson diçka shumë më të rëndë se një luhatje e zakonshme e bursave. Ai përbën një kërcënim ekzistencial për stabilitetin e furnizimit me energji dhe arkitekturën ekonomike të rajonit dhe të të gjithë botës.

Bursat: orakulli i parashikimit ekonomik në kohë lufte

Kur analizojmë pasojat e një lufte rajonale, nuk e fillojmë me analizat ekonomike të shifrave të prodhimit industrial apo me papunësinë, por me bursat. Kjo, sepse të parat janë “pasqyra e së shkuarës”, ndërsa bursat janë “parashikueset e së ardhmes”, që lidhen me shpejtësinë e reagimit, psikologjinë ekonomike të investitorëve dhe alokimin e kapitalit. Më konkretisht, bursat tregojnë gjendjen ekonomike në kohë reale. Ndërsa të dhënat e GDP-së apo të inflacionit duan muaj të përpunohen dhe të publikohen nga agjencitë shtetërore, bursa reagon brenda sekondave pas lajmit të parë të një konflikti. Ajo tregon menjëherë, në kohë reale, se sa i rrezikuar ndihet “kapitali global”. Në rastin konkret, lufta në një rajon si Lindja e Mesme prek menjëherë burimet strategjike, si naftën dhe gazin.

Bursat e këtyre lëndëve kushtëzojnë dhe ndikojnë thellësisht në koston e ardhshme të energjisë dhe të shumicës së mallrave. Nëse bursa thotë se nafta do të kushtojë ndoshta edhe mbi 80 euro, ky çmim reflektohet menjëherë te transporti, prodhimi dhe konsumatori. Gjithashtu, duke parë bursën, ne kuptojmë shkallën e pritshmërisë për

inflacion, i cili në vetvete përcakton përqindjen e interesit, që është faktori kryesor i kreditimit, në një epokë ku 80% e transaksioneve bëhen me kredi. Të tre faktorët e lartpërmendur bëjnë që çdo analizë ekonomike e një gjendjeje ekuilibri botëror të fillojë me bursat. Bursa është instrumenti më i pastër i maturimit të besimit. Kur fillon një luftë, investitorët lëvizin paratë nga asetet e rrezikshme (aksionet) drejt aseteve të sigurta (ari, bonot e thesarit etj.).

Nëse shohim që ari rritet dhe aksionet e teknologjisë bien, kjo na tregon se tregu po përgatitet për një periudhë “depresioni” ekonomik. Nga ana tjetër, bursa ka një efekt psikologjik të fuqishëm edhe te konsumatorët. Kur lajmet raportojnë rënie drastike të bursave, pronarët e bizneseve dhe konsumatorët priren të ulin shpenzimet. Kjo krijon një vetëpërmbytje, për pasojë, edhe të postulatit se “frika në bursë çon në ulje të konsumit”, si dhe pa kuptuar krijohet një reaksion, që çon realisht në recension. Së fundi, likuiditeti shtetëror është një element që trondit jo vetëm qeveritë, por të gjithë ekosistemin ekonomik, që edhe ai është pasojë e bursës. Në kohë lufte, qeveritë duhet të marrin borxh për të mbuluar shpenzimet e jashtëzakonshme. Bursa e obligacioneve (bonot e thesarit) na tregon menjëherë se sa i kushtueshëm do të jetë ky borxh. Nëse interesi i bonove rritet, kjo do të thotë se shteti do të ketë më pak para për shërbime sociale, sepse do t'i duhet të paguajë interesat e lartë të borxhit të luftës. Bursa nuk është thjesht një lojë numrash, është një makineri votimi, ku miliona njerëz dhe algoritme vendosin çdo sekondë se sa vlen e ardhmja nën dritën e një konflikti të ri.

Prandaj analizat fillojnë nga bursat. Çfarë na treguan ato (bursat) këto ditë dhe si i parashikojnë ato specialistët të ardhmen?

Konfliktit ushtarak në Iran ka shkaktuar një reaksion zinxhir në qendrat financiare nga Nju-Jorku në Frankfurt. Ndërsa bota po përpiquej të stabilizonte ritmet e rritjes pas një periudhe të gjatë pasigurie inflacioniste, “shoku i luftës” i ka detyruar investitorët të rishikojnë rrënjësisht portofolat e tyre. Diferenca në reagimin e bursave amerikane (Wall Street) dhe atyre europiane (Euro Stoxx 50, DAX, FTSE 100)

pasqyron jo vetëm afërsinë gjeografike, por edhe varësinë e ndryshme energjetike dhe ekspozimin ndaj riskut gjeopolitik. Tregjet amerikane, të përfaqësuara nga indekset *S&P 500* dhe *Nasdaq*, treguan një qëndrueshmëri befasuese, por selektive. Në ditët e para të konfliktit, *Dow Jones* regjistroi rënie me mbi 400 pikë, por rikuperimi erdhi shpejt, falë natyrës së ekonomisë amerikane si një eksportuese neto e energjisë.

Kompanitë e mbrojtjes, si “Lockheed Martin” dhe “Northrop Grumman”, patën rritje dyshifrore të aksioneve të tyre, të nxitura nga pritshmëritë për kontrata të reja qeveritare. Po ashtu, gjigantët e naftës, si “ExxonMobil” dhe “Cheuron” përfituan nga kërcimi i çmimit të naftës “Brent” mbi 80 dollarë. Sektori teknologjik i përfaqësuar nga “Nasdaq” pësoi goditjen më të madhe fillestare. Interesi i lartë për Inteligjencën Artificiale (IA), që kishte udhëhequr tregun në fillim të vitit 2026, u zëvendësua nga një rotacion drejt aseteve “Safe Haven” (*Strehë e sigurt*). Kompanitë e teknologjisë, të cilat varen nga zinxhirët globalë të furnizimit dhe normat e ulëta të interesit, u gjendën nën presionin e frikës së Rezervës Federale (FED), e cila mund të mbajë normat e larta të interesit për të luftuar inflacionin e importuar nga energjia. Për Europën, lufta në Iran nuk është thjesht një shqetësim gjeopolitik, por një rrezik i drejtpërdrejtë për de-industrializimin.

Tregu europian i aksioneve të 15 vendeve të euros “dogji” për dy ditë më shumë se 500 miliardë euro, gjë që kapërceu nivelin e krizës së “Covid-19”, duke reflektuar frikën e një recensionit të ri. Kur rrezet e para të diellit prekën bursat e Lindjes së Largët (bursat hapen gjithmonë në Lindje) në fillim të marsit të vitit 2026, pasiguria rreth konfliktit në Iran ishte shndërruar tashmë në një forcë gravitacionale, që tërhiqte indekset drejt kuotave të kuqe. Japonia, si një nga importueset më të mëdha të naftës në botë, e ndjeu goditjen menjëherë në indeksin “Nikkei”. Në rrugët e Tokios, lajmi për tensionet në Ngushticën e Hormuzit nuk ishte thjesht një titull gjeopolitik, por një paralajmërim për rritjen e kostove të prodhimit për emra, si “Toyota” dhe “Panasonic”.

Ky ankth energjetik u përhap shpejt edhe në Hong Kong, ku indeksi “Hang Seng” u lëkund nën presionin e pasigurisë detare, duke reflektuar frikën se arteriet kryesore të tregtisë globale po bllokoheshin nga hiri i luftës. Në Kinë, reagimi i bursave të Shangait dhe Shenzhenit ishte më i ngjyrosur në të kuqe, por po aq dramatik. Si klienti kryesor i energjisë iraniane, Kina u gjend në një udhëkryq strategjik. Nga njëra anë, aksionet e kompanive shtetërore të naftës po vuanin nga rritja e kostove të sigurimit të anijeve, ndërsa nga ana tjetër, investitorët po i kthenin sytë nga sektori i energjisë së gjelbër si një shpëtim i mundshëm.

Ndërkohë, në Indi, bursa e Bombeit (*Sensex*) u bë dëshmitare e një largimi masiv të kapitalit të huaj. Rritja e çmimit të naftës “Brent” vuri nën presion të jashtëzakonshëm monedhën vendase, duke i detyruar investitorët të braktisnin asetet e rrezikshme aziatike për t’u strehuar te dollari amerikan, (që pati pak rritje), duke krijuar një “ftohje” të menjëhershme të likuiditetit në të gjithë rajonin. Megjithatë, epiqendra e vërtetë e tronditjes teknologjike u zhvendos në Tajvan dhe Korenë e Jugut, ku bursa e Seulit (*Kospi*) dhe ajo e Taipeit (*Taiex*) reflektuan një kërcënim të ri për botën digjitale. Gjigantët e gjysmëpërçuesve, si TSMC dhe “Samsung”, u gjendën nën presionin e dyfishtë të rritjes së kostove të logjistikës dhe frikës për një ndërprerje të furnizimit me gazra inerte dhe lëndë të para që nevojiten për prodhimin e mikroçipave.

Çdo luhatje në Iran u përkthye në një rënie të aksioneve të këtyre kompanive, pasi tregjet parashikuan një shtrenjtim të produkteve elektronike në shkallë globale. Kjo tregon se lufta në Iran nuk preku vetëm naftën, por goditi vetë “trupin” e teknologjisë moderne, duke vënë në rrezik prodhimin e gjithçkaje, nga telefonat inteligjentë deri te serverët e fuqishëm të Inteligjencës Artificiale. Lufta në Iran ka provokuar një “tërmet” financiar, që ka tejkaluar kufijtë rajonalë, duke krijuar një efekt domino në të gjitha kontinentet. Nëse bursat aziatike reagojnë me ankthin e ndërprerjes së furnizimit dhe ato europiane me

frikën e deindustrializimit, tregjet në Amerikën Latine dhe Afrikë u gjendën përballë një realiteti të dyzuar.

Brazili dhe Nigeria, si eksportues nafte, panë një rritje të përkohshme të indekseve të tyre energjetike, por kjo u eklipsua shpejt nga rritja e kostove të importit të ushqimeve dhe plehrave kimike, duke nxitur inflacionin vendas. Në nivel global, kjo krizë ka shkaktuar një “lëvizje kapitalesh”, ku kapitali masiv u largua nga tregjet në zhvillim, për t’u strehuar në asetet e sigurta amerikane, duke zhvlerësuar monedhat lokale kudo në botë. Ky sinkronizim i rënies së bursave dëshmon se ekonomia e vitit 2026 është një organizëm tërësisht i ndërlikur.

Kur rrugëve të naftës nuk u bëhet dot “Bypass”

Në dhomat e tregtimit të naftës në Londër dhe Nju-Jork, termi “Ngushtica e Hormuzit” nuk është thjesht një referencë gjeografike, është një pikë kyç, ku varet fati i rritjes ekonomike botërore. Me bllokimin e kësaj arterieje jetike si pasojë e konfliktit në Iran, botës i është ndalur fryma. Sipas analizave të fundit ekonomike, ky bllokim nuk përfaqëson thjesht një krizë furnizimi, por një thyerje rrënjësore të paradigmes energjetike, që ka mbajtur stabilitetin relativ të dekadës së fundit. Ngushtica e Hormuzit, një rrip i ngushtë uji që lidh Gjirin Persik me Oqeanin Indian, shërben si korridor, përmes të cilit kalojnë mbi 21 milionë fuçi naftë në ditë. Kur lajmet e para për bllokimin e saj goditën ekranet e terminaleve “Bloomberg”, reagimi ishte i frikshëm.

Analistët e shohin këtë si “skenarin e fundit të botës” për tregjet e mallrave. Në formë narrative, kjo mund të përshkruhet si një ndalesë kardiake për tregtinë detare. Kostot e transportit u rritën me mbi 40% brenda javës së parë. Ky devijim nuk shton vetëm kosto, por edhe kohë, duke krijuar një zbrazëti në rafineritë europiane dhe aziatike, që nuk mund të mbushet me rezervat strategjike. Ekspertët parashikojnë që nafta të kalojë pragun e 120 dollarëve dhe tregu mund të hyjë në një fazë “paralize blerëse”. Për vendet në zhvillim, ky çmim është një dënim me vdekje për buxhetet e tyre shtetërore.

Në këtë narrativë ekonomike, çmimi i naftës nuk është thjesht një numër në bursë, por një taksë e papritur mbi çdo aspekt të jetës njerëzore, nga plastika e paketimit deri te plehrat kimike që ushqejnë bujqësinë. Çdo gjë po shtrenjtohet. Revistat ekonomike po i referohen kësaj periudhe si “Stagflacioni i madh i vitit 2026”, ku rritja ekonomike ndalet, ndërsa çmimet vazhdojnë të fluturojnë, të ushqyera nga frika se bllokimi mund të zgjasë me muaj. Nëse SHBA-ja mund të mbështetet në naftën e saj për të zbutur goditjen, Azia është e ekspozuar plotësisht. “Nikkei Asia” ka raportuar se rafineritë në Korenë e Jugut dhe Japoni kanë filluar të operojnë me kapacitet minimal, duke racionalizuar furnizimet. Kina, blerësi më i madh në botë, gjendet në një pozitë tragjike. Megjithëse ka rezerva strategjike për afro 90 ditë, bllokimi i Hormuzit do të thotë se motori i saj industrial po punon me “bateri të huazuara”.

Narrativa ekonomike këtu ndryshon nga tregtia te mbijetesat. Kina mund të detyrohet të përdorë fuqinë e saj diplomatike për të hapur ngushticën, pasi çdo ditë bllokimi i kushton miliarda dollarë në prodhim të humbur. Kjo e shndërron naftën nga një mall tregtar, në një mjet presioni politik të nivelit të lartë, ku çmimi i lartë shërben si një thikë me dy tehe për të gjitha palët e përfshira. Një aspekt interesant që nxjerrin në pah revistat, si “Harvard Business Review” është se kjo krizë mund të jetë “goditja e fundit” që i duhet botës për të braktisur karburantet fosile. Kur nafta bëhet kaq e pasigurt dhe kaq e shtrenjtë, investimet në energjinë diellore, bërthamore dhe me hidrogjen nuk shihen më si opsione ekologjike, por si domosdoshmëri për sigurinë kombëtare.

Megjithatë, tranzicioni nuk ndodh brenda natës. Kjo është ironia e madhe ekonomike e luftës: në përpjekje për të siguruar energjinë, bota po kthehet hapa pas në kohë, duke sakrifikuar objektivat klimatike përpara altarit të sigurisë energjetike. Në mbyllje të kësaj analize narrative, mund të themi se çmimi i naftës pas bllokimit të Hormuzit nuk do të kthehet kurrë në nivelet e mëparshme “normale”. Edhe nëse ngushtica hapet nesër, “primi i rrezikut” do të mbetet i lartë për vite me

radhë. Bllokimi i Hormuzit nuk mbylli vetëm një rrugë detare, por mbylli një kapitull të historisë ekonomike, ku energjia e lirë dhe e bollshme merrej si e mirëqenë.

Ari dhe Bitcoin: dueli i strehëve të sigurta në epokën e revolucionit 4.0

Kur rreziku i një lufte të shkallës së gjerë në Lindjen e Mesme u bë realitet, tregjet financiare dëshmuan një fenomen unik, një garë paralele mes arit fizik dhe Bitcoin-it. Ky moment shënon një pikë kthese në historinë ekonomike, ku teknologjia e *Revolucionit 4.0 (Blockchain)* u vu në provë përballë vlerës mijëvjeçare të arit. Analiza e këtyre dy aseteve nuk tregon vetëm ku po shkojnë paratë, por si po ndryshon koncepti ynë për sigurinë në një botë të digjitalizuar. Ari nga ana e tij po sheh atë që shumë e quajnë *rilindja e “Monedhës së Fundit”*. Për shekuj me radhë, ari ka qenë barometri i frikës njerëzore. Me bllokimin e Hormuzit dhe rritjen e tensioneve bërthamore, ari kaloi përsëri në trendin rritës që kishte nga frika e inflacionit një muaj më parë. Ky reagim ishte i paparashikueshëm, kështu që investitorët institucionalë, bankat qendrore dhe fondet sovraane u rikthyen te mjeti që nuk varet nga asnjë qeveri dhe asnjë rrjet elektrik. Në kushtet e luftës, ari përfaqëson “analogen”, diçka që mund ta prekësh dhe ta ruash fizikisht, kur sistemet globale janë në rrezik.

Ari mbetet “spiranca” që mban varkën e ekonomisë, kur stuhia gjeopolitike bëhet e papërballueshme. Shumë specialistë me zë e quajtnë Bitcoin-in “pagëzimi me zjarr i arit digjital”. Në ditët e para të konfliktit, BTC pësoi një rënie të lehtë, duke u sjellë si një aset rreziku (si aksionet e teknologjisë). Megjithatë, sapo u bë e qartë se lufta do të sillte sanksione të rrepta dhe kontroll të lëvizjes së kapitalit, Bitcoin filloi një ngjitje vertikale. Për herë të parë, bota pa se si *Revolucioni 4.0* po ofronte një “dalje emergjence” nga sistemet tradicionale. Bitcoin-i u përdor masivisht për transfera ndërkombëtare, që anashkalonin zonat e luftës dhe bankat e bllokuara. Në një botë, ku një raketë mund të godasë një qendër të dhënash bankare, rrjeti i decentralizuar i Bitcoin-it mbetet

i paprekur, duke u bërë streha e parë digjitale në histori për kapitalin e rrezikuar. Lëvizjet e Bitcoin-it dhe e arit në vitin 2026 tregojnë se *Revolucioni 4.0* ka hyrë në një fazë të re: në atë të reziliencës (qëndrueshmërisë). Lufta në Iran nuk po bëhet vetëm me drone dhe raketa, por edhe me algoritme. Kjo betejë ka vënë në pah rëndësinë e “Blockchain”, Inteligjencës Artificiale (IA) dhe Internetit të Gjërave (IoT) në mirëmbajtjen e flukseve ekonomike.

Ndërsa Ngushtica e Hormuzit u bllokua, kompanitë që kishin integruar teknologjinë “Blockchain” në zinxhirët e tyre të furnizimit mundën të ridrejtonin mallrat me një shpejtësi marramendëse, duke gjetur rrugë alternative përmes Azisë Qendrore. Kjo tregon se *Revolucioni 4.0* nuk është thjesht për robotët, por për menaxhimin e të dhënave që parandalojnë kolapsin total. Gjatë luftës, pamë një rritje të arit (të kontrolluar) dhe përfaqësime digjitale të arit fizik në “Blockchain”. Kjo i lejoi investitorët të blinin sigurinë e arit me shpejtësinë e dritës, pa pasur nevojë të transportonin fizikisht metalin nëpër zona konflikti. Ky është kulmi i shkrirjes mes vlerës së vjetër tradicionale dhe teknologjisë së re. Nëse ari është “muzeu” i sigurisë sonë, *Bitcoin* dhe *Blockchain* janë “autostradat” që na lejojnë të lëvizim edhe kur bota është në flakë. Ky dualitet do të përcaktojë arkitekturën e re financiare globale për pjesën tjetër të dekadës. Kështu, mes kaosit, ne pamë lindjen e një dualiteti të ri, qëndrueshmërinë e arit të lashtë dhe hovin e pandalshëm të *Revolucionit 4.0*. *Bitcoin* dhe teknologjia *Blockchain* nuk ishin më thjesht eksperimente digjitale, por mburoja që mbajtën gjallë qarkullimin e vlerës kur rrugët fizike u mbyllën. Një rend i ri global po formatësohet dhe, pa dyshim, edhe një rend i ri ekonomik. A do të jetë ky një rend, ku fuqia nuk matet më vetëm me fuçi naftë, por me shpejtësinë e përshtatjes ndaj një bote që nuk njeh më qetësi absolute? Kjo mbetet për t’u vërtetuar.

V. HISTORI

5.1 KULTPROTEKTORATI PËR KATOLIKËT E SHQIPËRISË

Nga dr. Mark Palnikaj

Protektorati i Kultit mbi popullsinë katolike të Shqipërisë, sidomos mbi popullsinë e trevave veriore, ka filluar qysh në shekullin XVI dhe ka pasur ndikim shumë të madh për vetë mbijetesën e kombit shqiptar dhe krijimin e shtetit të tij në kufijtë ndërkombëtarë që janë sot.

Shumë studiues që janë marrë me historikun e krijimit të shtetit shqiptar pas pushtimit katërshekullor nga Perandoria Osmane, janë të mendimit se një faktor përcaktues për formimin e këtij shteti ka luajtur prania e popullsisë katolike, kryesisht në Shqipërinë Veriore. Midis shumë studiuesve që janë marrë me çështjen e mbijetesës së katolicizmit në Shqipëri dhe me mbrojtësit e kësaj popullsie janë edhe Zef Prela, i cili ka shkruar një artikull në revistën “Studime historike”, nr. 3, viti 1965, si dhe studiuesi Kurt Gostentschnigg, i cili ka shkruar një artikull me temë “Protektorati i Kultit austro-hungarez mbi popullsinë katolike të Shqipërisë së Veriut” në revistën “Phoenix”, 15-16 (2000/1-2).

Për mbrojtjen e katolikëve të Shqipërisë nga Perandoria Austro-Hungareze është shkruar edhe në një numër shumë të madh punimesh, ku qëllimi ka qenë nxjerrja në pah e kontributit të këtij shteti.

Nga analiza që i kemi bërë kësaj çështjeje gjatë një studimi mbi dioqezën e Pultit, për mbijetesën e popullsisë së kësaj dioqeze si të krishterë katolikë, rezulton se mbrojtja e të krishterëve në trevat ballkanike nuk ka qenë problem vetëm i Perandorisë Austro-Hungareze, por edhe i Francës, Italisë, Rusisë, Prusisë etj. Disa nga pikat kulmore të shfaqjes së kësaj mbrojtjeje ose protektorati, quajeni si të doni, kanë filluar të shfaqen menjëherë pas pushtimit turk të Ballkanit në shekullin XV.

- 1448 - Turqit pushtuan Kosovën.
- 1453 - Shteti turk pranon zyrtarisht Patriarkanën e Stambollit si subjekt fetar në Perandori. [1] Këtë veprim nuk e bëri për Kishën Katolike të Romës. Kjo e vështirësonte funksionimin normal të veprimtarisë fetare për katolikët e ritit romak.
- 1462 - Më datë 8 nëntor, kryeipeshkvi i Durrësit dhe këshilltari i Skënderbeut, Pal Engjëlli, në një sinod me pjesëmarrjen e disa meshtarëve nga e gjithë Shqipëria, shkroi një qarkore, që kishte fuqinë e një kushtetute (Constitute) baritore, që u drejtohej meshtarëve të fshehur nëpër male dhe shpella të Malësive, mbi aktivitetin baritor që nevojitej të ndërmerrnin dhe mbi doktrinën e krishterë të sakramenteve bazë. [2]
- 1479 - Turqit pushtuan Shkodrën.
- 1480 - 5 tetor, gjenerali turk Ahmet Gjedik Pasha me ushtarët e tij masakruan 800 shqiptarë brenda një dite. [3]
- 1485 - Pushtuesi turk i Shqipërisë bëri regjistrimin e parë të banorëve dhe inventarizimin e pasurisë së zonave të pushtuara. Fshatarët e lirë, që i paguanin pushtuesit turk 50 akçe të argjendta në vit, ishin edhe fiset shqiptare të Piprit, Hotit, Palabardhit, tokat e Pjetër Spanit (Petrispan-ili) dhe disa fshatra të Shestanit [4]
- 1535 - Në emër të *Kultprotektoratit*, në vitin 1535, kur Franca sundohej nga Fransua I (Francois I^{er}), ky shtet fitoi “*të drejtën e mbrojtjes së kultit dhe të kishës së krishterë në vendet e Perandorisë Osmane*” [5] dhe i ka përkitur vetëm Francës.
- 1615 - Ndikimi politik dhe ekonomik i Austro-Hungarisë mbi popullin shqiptar u vu në veprim me anë të Protektoratit të Kultit, të cilin Monarkia e arriti me Paqen e Sitvatorokut më 1615 dhe parashihte fillimisht mbrojtjen e klerit katolik në Perandorinë Osmane.
- 1698 - Në Paqen e Karlovacit bisedimet filluan në dhjetor 1698 dhe zgjatën 70 ditë. Marrëveshja u nënshkrua më 26 janar 1699. Sipas kësaj marrëveshjeje, Sulltani u detyrua të ripohonte të drejtën për

lirinë e kultit të nënshtetasve të tij katolikë. Vjena do të ndërhynte në favor të tyre nëse u shkeleshin të drejtat.

- 1718 - Në korrik të vitit 1718 u nënshkrua marrëveshja e Pasaroviçit (Pozharevac). Austriakët sipas kësaj marrëveshjeje do të dërgonin konsuj në Perandorinë Osmane, të cilët përveç punëve të tjera, do të mbronin të drejtat e kultit të popullsive të krishtera.
- 1739 - Marrëveshja e Beogradit u nënshkrua më 18 shtator të vitit 1739. Sipas kësaj marrëveshjeje, këto të drejta fituan me të vërtetë një zbatim, në të cilin Habsburgëve iu dha një leje e posaçme e trashëguar më parë prej Venedikut e që kishte të bënte me mbrojtjen e të gjithë katolikëve të Europës nën pushtimin turk.
- 1774 - Më 21 korrik 1774 u nënshkrua Marrëveshja e Kyçyk-Kajnarxhasë, që ndodhej në një fshat të “Çezmës së Vogël”, pranë Silistrës në Bullgarinë e sotme. Kjo marrëveshje parashikonte mbrojtjen nga ana e Rusisë të të krishterëve të Perandorisë Osmane.
- 1791 - Paqja e Sistovit u nënshkrua në gusht të vitit 1791 në këtë qytet, që ndodhet në breg të Danubit në Bullgari. Kjo marrëveshje i lejonte Austro-Hungarisë të hapte një konsullatë në Shkodër dhe një nënkonsullatë në Durrës, duke i rikonfirmuar marrëveshjet e mëparshme në mbrojtje të popullsive katolike në Perandorinë Osmane.
- 1815 - Në Kongresin e Vjenës më 1815, Monarkisë Austriake iu dha e drejta të kishte nënkonsullata të tjera, si në Vlorë, Janinë dhe Prevezë. Konsulli ishte përfaqësuesi i drejtpërdrejtë i politikës së Protektoratit të Kultit. Ndër detyrat e tij bënin pjesë veprime humaniste, ngritja e nivelit të formimit, mbështetja e zhvillimit kombëtar dhe ndarja e parave. Vetëm me diplomatë të tillë, si: August Král, Theodor Anton Ippen dhe Alfred Rappaport, të cilët e njihnin mirë Shqipërinë dhe ishin njëkohësisht miq të popullit shqiptar, u arrit të kryhej një punë e mirë fillestare në vendosjen e bazave të marrëdhënieve të mira mes Monarkisë Danubiane dhe shqiptarëve.

- 1837 - Më 1837 edhe Selia e Shenjtë njohu, më në fund, të drejtat e Monarkisë Dualiste mbi katolikët shqiptarë.
- 1855 - Një etapë e rëndësishme në zhvillimin e Protektoratit të Kultit shënohet në vitin 1855, kur u arrit Konkordati mes Vatikanit dhe Austrisë, i cili parashihte mbështetjen e një “Programi veprimi” të Ballplatz-it nga ana e Vatikanit dhe posaçërisht veprimtarinë e Propagandës Fide.
- 1878 - Në Kongresin e Berlinit më 1878, gjithnjë në kuadrin e Kultprotektoratit, Austro-Hungaria zgjeroi të drejtat e saj në mbrojtje të katolikëve të Shqipërisë. Edhe pas vitit 1878, angazhimi i Austro-Hungarisë për mbrojtjen e të drejtave të popullsisë katolike të veriut shqiptar ka vazhduar. Analistët e sotëm, mbështetur mbi një numër shumë të madh dokumentesh arkivore të shkruara nga konsujt e ndryshëm që kanë shërbyer në qytete të ndryshme të Shqipërisë, kuptojnë se protektorati i kultit nuk është kufizuar vetëm në të drejtën për ushtrimin e lirë të fesë si të krishterë katolikë, por edhe për zhvillimin e kulturës dhe të vetëdijes kombëtare me qëllimin final: shkëputjen nga Turqia dhe krijimin e shteteve kombëtare të disa shteteve të Ballkanit.

Ndikimi politik dhe ekonomik i Austro-Hungarisë mbi popullin shqiptar gjatë pushtimit turk ka qenë i madh. Pas Paqes së Karlovacit, më 1699, u arrit zgjerimi i protektoratit mbi të gjithë të krishterët nën sundimin turk. Pas Marrëveshjes së Beogradit të vitit 1739, këto të drejta, tashmë të konfirmuara realisht edhe nga Sulltani, fituan të zbatoheshin me njëfarë realizmi, të paktën sa për sy e faqe. Pas paqes së Sistovit të vitit 1791, ndikimi i Perandorisë Danubiane u rrit ndjeshëm. Shteti Austro-Hungarez u lejua të hapte konsullatë në Shkodër dhe një nënkonsullatë në Durrës. Më vonë, në Kongresin e Vjenës, Monarkisë Austriake iu dha e drejta të kishte nënkonsullata edhe në Vlorë, Janinë dhe Prevezë. Nga 240 institucione katolike të Protektoratit të Kultit që ishin në Perandorinë Osmane, 220 prej tyre ndodheshin në Shqipëri. Ndikimi i Austro-Hungarisë në kuadër të

protektoratit të kultit shtrihej në shtatë dioqezat katolike: Shkodër, Lezhë, Durrës, Prizren, Sapë, Pult dhe Mirditë. Konsulli ishte përfaqësuesi i drejtpërdrejtë i politikës së Protektoratit të Kultit. Ndër detyrat e tij bënin pjesë veprime humaniste, ngritja e nivelit të formimit, mbështetja e zhvillimit kombëtar dhe ndihmat financiare.

Në vitin 1914, konsujt u morën me normalizimin e tensioneve mes popullsive me besim fetar të ndryshëm, si dhe me mobilizimin e fiseve të Veriut kundra Serbisë dhe Malit të Zi. Baroni Nopça, me katolikët e Mirditës, Lezhës, Pukës, Nikaj Mërturit, Shalës, Shoshit, Kelmendit, por edhe me popullsitë e Gashit, Krasniqes, Hotit dhe Grudës ka zhvilluar veprimtari direkte në pajtimin dhe koordinimin e veprimeve për konsolidimin e shtetit të sapokrijuar shqiptar. Ai ka bërë marrëveshje, ka organizuar takime krerësh dhe ka krijuar besëlidhje dhe aleanca midis fiseve, ka shpërndarë para dhe armë, me qëllim ruajtjen e identitetit të një shteti shqiptar. Në katër vite, nga viti 1914 deri në vitin 1918, me ndihmën financiare dhe organizative të austriakëve, në zonën nga lumi Shkumbin deri në Kosovë janë hapur 432 shkolla shqipe. Françeskanët ishin mbështetja më e fuqishme e Protektoratit të Kultit. Vrasja e françeskanit Luigj Palaj në rrethinat e Gjakovës nga forcat serbo-malaziasë shkaktoi një revoltë shumë të madhe te katolikët shqiptarë dhe një reagim shumë të ashpër të qeverisë së Austrisë. Trupi i klerikut u zhvarros dhe iu krye ekspertiza mjekësore-ligjore, ku u vërtetua me fakte vrasja në mënyrë makabre e tij për motive dhe interesa në shërbim të pushtuesve. Detyra zyrtare e Protektoratit të Kultit qëndronte në ndërtimin dhe mbajtjen e kishave, në shkollimin e klerit dhe në mbrojtjen e kongregatave në Shqipëri. Mjafton të përmendim faktin e dhënë nga Arqipeshkvi i Durrësit, D'Ambrosio, i cili thotë se dioqeza e tij deri nga mesi i shekullit XIX kishte vetëm 13 kisha dhe 10 kapela, të cilat ishin drejt shkatërrimit të plotë. Ndërsa në fund të po këtij shekulli, me ndihmën materiale të Vjenës u ndërtuan tashmë 22 kisha, 2 oratorë dhe 23 kapela.

Në mënyrë jozyrtare, kjo ndihmë u shfrytëzua nga Ministria e Jashtme e Austrisë për të ndikuar mbi popullsinë katolike të Shqipërisë

së Veriut. Nga dokumentet arkivore të shtetit të Austrisë kuptohet se politika e subvencionit, në pjesën më të madhe i shërbeu protektoratit të Kultit për përmbushjen e detyrave “zyrtare” dhe “jozyrtare”. Dhe në detyrat “jozyrtare” përfshiheshin ndikimi i Perandorisë së Austro-Hungarisë për krijimin e shtetit shqiptar.

Në pjesën jozyrtare të veprimtarisë përfshihet veprimtaria e Johann Georg von Hahn-in, i cili ishte studiues i albanologjisë austro-hungareze dhe i albanologjisë gjermane. Po ashtu, përfshihet veprimtaria studimore e studiuesve Franz Miklosich, slloven i Austrisë; Gustav Meyer-it me kombësi gjermane; shtetas austriak; Wilhelm Meyer Lübkes, Maximilian Lambertz-it, Ludwig von Thallóczy-t, Josef Konstantin Jireček-u, Franz Baron Nopcsa-s, Milan von Šufflai-t etj.

Këta studiues dhanë një kontribut madhor për nxjerrjen në dritë të historisë dhe kulturës së popullsisë shqiptare, tashmë të harruar në pushtimin pesëshekullor turk dhe për ngritjen e vetëdijes kombëtare të popullit shqiptar. Përveç një pune të madhe studimore për historinë, fiset, zakonet, veshjet, ata shërbyen si nxitje, që edhe shumë persona që kishin studiuar në shkollat e kësaj perandorie, të kryenin punime brilante për historinë dhe kulturën shqiptare. Të kësaj periudhe janë botimi i romanit të parë nga Dom Ndoc Nikaj, botimi i një historie të Shqipërisë nga po ky autor, punimet e Fishtës, Mjedës, Gjeçovit, Abat Doçit dhe shumë figura të tjera të shquara.

Përfaqësuesit e Rilindjes Kombëtare Shqiptare që gjendeshin jashtë Shqipërisë u mbështetën financiarisht nga Vjena. Revista “Albania” në Bruksel, e botuar nga Faik Konica, u subvencionua për 11 vjet nga Austro-Hungaria.

Politika zyrtare e Vjenës angazhohej që të kishte në mbështetje të saj njerëz besnikë nga radhët e parisë së fiseve të veriut. Nopça ishte veprimtari kryesor në lidhjet me prijësit dhe me bajraktarët e Veriut katolik, por edhe të popullsisë muhamedane. Ai ia arriti në përgjithësi, me pak përjashtime, që të mobilizonte parinë dhe popullsinë e kësaj zone në luftë kundra pushtuesve serbo-malazezë, të cilët pas largimit të

pushtuesve turq, ishin armiqtë më të betuar kundër krijimit të një shteti shqiptar në Ballkan.

Nuk u lanë jashtë vëmendjes edhe udhëheqësit shpirtërorë, si: priftërinjtë, ipeshkvijtë, veçanërisht prelatët, të cilët në pjesën dërmuese ishin prej Dalmacisë, Istrias dhe Tirolit të Jugut.

Fretërit françeskanë u dalluan si organizatorë dhe udhëheqës të masave popullore kundra pushtuesve serbo-malazezë, duke kundërshtuar dhe denoncuar masakrat e tmerrshme që kryenin ata mbi popullsinë e pafajshme të këtyre zonave. Në pjesën më të madhe, këta fretër e kishin kryer shkollimin e tyre në qytetet e Austrisë, si: Vjenë, Graz, Linz, Innsbruck, Villach etj.

Vjena krijoi edhe fonde financiare dhe mundësi materiale, me qëllim që të gjithë klerikët që kishin përfunduar studimet dhe noviciaten¹ e tyre në Shkodër të mundeshin të studionin në Austri për teologji dhe filozofi. Shumica e këtyre klerikëve nuk studioi vetëm teologji dhe filozofi, por në Universitetet Perandorake ata studiuin edhe histori, arkeologji, matematikë, fizikë, kimi, farmaci dhe muzikë. Në sajë të këtij programi të Monarkisë Danubiane në atë kohë u formuan personalitetet më në zë nga kisha, politika, shoqëria dhe arsimi, të cilët më pas do të luanin një rol të rëndësishëm në historinë e kombit shqiptar.

Mbarimi i Luftës së Parë Botërore shënon edhe fundin e një bashkëpunimi treqindvjeçarë midis Perandorisë Danubiane dhe popullsive katolike të Veriut shqiptar. Me shkatërrimin e Monarkisë së Danubit dhe krijimin e shtetit të Austrisë merr zyrtarisht fund Protektorati i Kultit ndaj popullsive të krishtera.

1. Gaspër Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, f. 141.

2. Letra e Pal Engjëllit, Arkivi i QSA-së, Tiranë.

3. Zef Mirdita, *Krishterimi ndër shqiptarë, Drita*, Prizren-Zagreb, 1998, f. 174.

4. Selami Pulaha, *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485*", Tiranë, 1974, f. 24.

5. Pellissie du Rausas, G., *Le regime des capitulations dans l'Empire Ottoman*, Vol. I.Paris 1910, f. 6.

¹ Periudha e provës dhe e formimit për dikë që hyn në një urdhër fetar.

VI. INTERVISTA

6.1 Albin Kurti: “Ne jemi qartësisht të përkushtuar ndaj vlerave të demokracisë perëndimore. Ne duam të bashkohemi me BE-në dhe NATO-n... Unë kurrë nuk kam qenë rebel pa kauzë, gjithmonë kam pasur një qëllim. Sot jam një kryeministër me një qëllim”.

Nga Georg Häsler

Në një intervistë me NZZ, Kurti diskuton ndikimin e situatës gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor dhe vizionin e lidhjes së Kosovës me pjesën tjetër të Europës

- Ju keni fituar një mandat të ri me mbi 50 për qind të votave. Kjo ishte një surprizë e vërtetë, z. Kurti.

Ne kemi arritur fitoren tonë më të madhe zgjedhore deri më sot. Ndihem jashtëzakonisht i mbështetur nga populli. Por kjo sjell me vete edhe një përgjegjësi të jashtëzakonshme. Ky mandat është, nga njëra anë, një mandat për siguri dhe mbrojtje dhe, nga ana tjetër, dua të investoj.

- Ku?

Ne do të ndajmë një miliard euro për të mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Kosovë, përmes garancive dhe investimeve shtesë në vende pune, si dhe një miliard euro shtesë për mbrojtjen kombëtare. Brenda këtij kuadri, ne do të krijojmë një fondacion industrial, duke përfshirë një fabrikë municionesh në Gjakovë. Gjithashtu është planifikuar një stadium i ri kombëtar me 8000 vende, pasi Kosova do të jetë bashkorganizatore e Lojërave Mesdhetare 2028 me partnerët e saj europianë.

- A nuk do të ishte energjia, fusha më urgjente? Dy termocentralet me qymyr pranë Prishtinës janë ende në funksion dhe ndotin ajrin.

Ne po kryejmë një studim fizibiliteti për një lidhje gazi me Europën. Kemi rezerva të mëdha qymyri, që aktualisht ofrojnë ngarkesën bazë për prodhimin tonë të energjisë. Megjithatë, në planin afatgjatë, duam ta eliminojmë gradualisht qymyrin. Gazifikimi është vetëm një zgjidhje kalimtare. Paralelisht, ne po përqendrohemi në energjitë e rinovueshme. Gjithashtu duam të ndërtojmë linja hekurudhore...

- Po mbani një orë SBB, apo jo?

Po, më pëlqen shumë kjo orë. Është një dhuratë nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës dhe ish-Presidenti i Konfederatës Zvicerane, Alain Berset.

- Por, a është kjo gjithashtu një shenjë se doni të investoni veçanërisht në hekurudhë?

Po. Hekurudhat janë të gjelbra dhe të sigurta. Ne duam të krijojmë një lidhje hekurudhore midis Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës dhe kryeqytetit të Prishtinës. Ne e dimë se ka 27 fluturime direkte midis Prishtinës dhe Zvicrës gjatë muajve të verës, korrik dhe gusht për në Bazel, Cyrih dhe Gjenevë.

- Hekurudha gjithashtu mund të përmirësojë lidhjet ndërkombëtare të Kosovës.

Absolutisht po! Nëse shikoni një hartë të hekurudhave europiane, mund të shihni se Kosova ka një disavantazh strukturor në Ballkan. Të ashtuquajturit Korridore 8 dhe 10 anashkalojnë vendin tonë. Por lidhja veri-jug në Ballkanin Perëndimor, linja hekurudhore 10, mund të na lidhë veçanërisht drejt Greqisë. Trafiku po rritet përsëri. Këtë herë nuk duam vetëm ta menaxhojmë atë, por të investojmë në të në mënyrë strategjike. Me ekspertizën zvicerane, veçanërisht në sektorin hekurudhor, dhe me Zvicrën si një vend partner miqësor, ne mund të

kombinojmë shumë efektivisht etikën e punës, njohuritë e specializuara dhe investimet.

- Më parë përmendët mbrojtjen kombëtare. A po mësoni edhe nga Zvicra në aspektin e çështjeve ushtarake?

Po. Megjithatë, kur bëhet fjalë për strukturën e forcave tona të armatosura, ne jemi më të lidhur me modelet e Suedisë dhe shteteve baltike, veçanërisht në lidhje me konceptin e mbrojtjes gjithëpërfshirëse. Situata e tyre është e qartë: kur ke një fqinj të madh, duhet të mendosh ndryshe.

- Po i referohesh Serbisë, e cila ka rritur ndjeshëm shpenzimet e saj ushtarake vitet e fundit.

Do ta thosha kështu: duke pasur parasysh kërcënimin, nuk mund të përballojmë kaos. Na duhet një rend i qartë. Çdo qytetar duhet të dijë saktësisht se çfarë roli luan në rast të një fatkeqësie ose lufte.

- Pra, në rastin e zjarreve ose tërmeteve, si dhe konfliktit të armatosur?

Pikërisht. Për më tepër, duke ndjekur shembullin e Polonisë, ne po prezantojmë trajnime të përgjithshme sigurie për të gjithë, veçanërisht për të edukuar të rinjtë.

- Në fakt, ende është në fuqi Marrëveshja e Kumanovës e vitit 1999, sipas së cilës forcat paqeruajtëse të NATO-s janë përgjegjëse për sigurinë e jashtme të Kosovës. A ndikon kjo në këto plane?

Jo, kjo nuk paraqet problem. Ne duam të bëhemi anëtarë të NATO-s. NATO-ja aktualisht ndodhet në një fazë riorganizimi, dhe ne synojmë njëkohësisht të përfitojmë dhe të kontribuojmë. Po vendosim një rezervë vullnetare, kemi dyfishuar numrin e ushtarëve, kemi trefishuar shpenzimet për mbrojtjen dhe kemi katërfishuar trajnimin e oficerëve tanë në kuadër të NATO-s. Kosova duhet dhe do të jetë në gjendje të mbrohet vetë. Ne nuk e shohim veten si një forcë të izoluar ushtarake,

por si pjesë të NATO-s. Prandaj edhe po furnizohemi me pajisje ushtarake nga shtetet anëtare të NATO-s, nga armët kundërtanke, te dronët dhe artileria mobile. Ushtria jonë po fiton kapacitete moderne në këto fusha.

- Gjeopolitikisht, Kosova ndodhet në një pikë të ndërmjetme mes Perëndimit, Turqisë dhe Rusesë. Kjo nënkupton për Kosovën një akt balancimi...

Ne nuk po krijojmë balancë mes Lindjes dhe Perëndimit. Jemi qartësisht të përkushtuar ndaj vlerave të demokracisë perëndimore. Synojmë anëtarësimin në BE dhe në NATO. Turqia, siç dihet, është anëtare e NATO-s, prandaj po blejmë edhe pajisje, si dronët “TB2 Bayraktar” dhe sisteme të tjera turke. Sa i përket Rusesë, gjithmonë kemi pasur një distancë të shëndetshme ndaj saj.

- Rusia vazhdon të ruajë marrëdhënie të mira në rajon.

Sapo ndikimi rus, veçanërisht në Serbi dhe në Republikën Srpska, të zbehet, rajoni do të stabilizohet. Brenda gjashtë vendeve të Ballkanit nuk ekziston as vullneti dhe as kapaciteti për dhunë ndërshtetërore. Problem mbetet ndikimi hibrid i Rusesë përmes energjisë, ushtrisë dhe medieve. Ndryshimet reale varen nga forcat demokratike në Serbi.

- BE-ja e ka mbajtur rajonin për shumë kohë në pritje, me premtimin e anëtarësimit, veçanërisht Serbinë. Pikërisht për këtë arsye, Rusia arriti të fitojë kaq shumë ndikim.

Duhet të kemi parasysh edhe këtë: Serbia nuk mund ta bllokojë më integrimin europian të të gjithë rajonit. Nuk kemi më nevojë të presim, që Serbia të distancohet nga Rusia. Me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, të cilat tashmë janë në NATO, procesi ka hyrë në lëvizje dhe ky është progres. Serbia nuk ka më “fuqi vetoje” mbi rajonin.

Kancelari federal austriak, Christian Stocker, deklaroi në një intervistë për NZZ, se Mali i Zi mund të anëtarësohet relativisht shpejt. Ka ardhur koha, që Ballkani Perëndimor të bëhet, më në fund ,politikisht pjesë e Europës. Kjo do të thotë se BE-ja duhet të zgjerohet sërish. Unë mbroj një politikë

të vullnetit, jo vetëm të pranimi pasiv. Deri tani Brukseli është përqendruar shumë te pyetja se kush mund të pranohet dhe më pak te kush dëshiron të anëtarësohet. Nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, pesë kanë shumicë pro BE-së, përjashtuar Serbinë. Parimi vendimtar duhet të jetë: kush dëshiron të anëtarësohet, duhet të mbështetet. Kosova po u përgjigjet me disiplinë mijëra pyetjeve të pyetësorit të Komisionit European. Ky proces integrimi forcon veçanërisht gjyqësorin dhe administratën.

- Nga ana tjetër, ekzistojnë pesë vende të BE-së, që ende nuk e njohin Kosovën si shtet, si: Spanja, Qiproja, Greqia, Sllovakia dhe Rumania. Kjo nuk ndihmon procesin e integrit.

Disa vende, si Spanja apo Greqia, ngurrojnë, por ato pranojnë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe liberalizimin e vizave në hapësirën “Shengen”. Spanja tashmë i njeh edhe pasaportat kosovare. Duke pasur parasysh kërcënimin e Europës nga Rusia, nuk kemi më luksin e skepticizmit të tepruar ndërmjet shteteve europiane.

- T’i kthehemi politikës së brendshme. Ju keni një mandat të fortë, por së shpejti në parlament zhvillohen zgjedhjet presidenciale. Një kandidat ka nevojë për dy të tretat e votave. Si do ta menaxhoni këtë? A ekziston rreziku i bllokadës?

Së pari do ta konstituojmë parlamentin, do të zgjedhim kryesinë dhe qeverinë, do të miratojmë buxhetin për vitin 2026 dhe disa marrëveshje ndërkombëtare, përfshirë Planin e Rritjes së BE-së prej 882 milionë eurosh: 30 për qind janë grante dhe 70 për qind kredi. Pastaj vjen zgjedhja e presidentit. Për këtë na duhet kompromis me opozitën. Një shumicë prej dy të tretash kërkon dialog.

- Këto janë tone të reja, më pajtuese nga ana juaj. Dikur ju konsideroheshit rebeli i madh në Kosovë.

Unë kurrë nuk kam qenë “rebel pa kauzë”; gjithmonë kam pasur një qëllim. Sot jam kryeministër me një qëllim. [Përktheu: ISHGJ]

6.2 DR. SEBASTIAN SONS: “SHTETET E GJIRIT NUK KANË INTERES PËR NJË IRAN DEMOKRATIK”

Nga [Jonas Roth](#) [NZZ]

Lufta e Iranit i ka vënë monarkitë e Gjirit në një dilemë, thotë shkencëtari islamik dhe politik Sebastian Sons. Ato ndodhen në një moment kritik në historinë e tyre dhe duhet të riorganizohen strategjikisht përballë Iranit dhe SHBA-së.

- Z. Sons, Donald Trump tha së fundmi, se ishte i befasuar nga sulmet iraniane ndaj shteteve të Gjirit. A jeni të befasuar edhe ju?

Që do të kishte sulme, pritej. Megjithatë, ajo që më habiti është shkalla. Sulmet nuk drejtohen vetëm kundër bazave ushtarake amerikane, por edhe kundër infrastrukturës kritike, si: aeroportet, rafineritë e naftës dhe të gazit dhe impiantet e shkripëzimit të ujit të detit. Ato synojnë pikat e cenueshme të shteteve të Gjirit: modelin e tyre të biznesit, por edhe qëndrueshmërinë e tyre sociale. Kjo është një vijë e kuqe, që Irani e ka kaluar.

- Shtetet e Gjirit nuk e filluan këtë luftë, por tani po paguajnë një çmim të lartë. Cili është reagimi në këto vende?

Humori luhet midis optimizmit pragmatik dhe frustrimit. Nga njëra anë, ende ekziston bindja se ata kanë ndërtuar një reputacion që nuk do të zhduket thjesht: si një qendër për tregtinë, si një qendër për inovacionin dhe rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, shtetet e Gjirit janë të frustruara, sepse kjo narrativë e Iranit si një parajsë stabiliteti është vënë në pikëpyetje. Kjo çon në zhgënjim dhe armiqësitë e vjetra ringjallen. Një paranojë e Iranit po shfaqet, duke e bërë afrimin e viteve të fundit të panevojshëm për momentin.

- Shtetet e Gjirit kanë investuar kapital të konsiderueshëm diplomatik në marrëdhëniet e tyre me Teheranin. Kjo strategji ka

dështuar. Si do të pozicionohen në të ardhmen shtetet e Gjirit ndaj Iranit?

Kjo varet nga mënyra se si Irani do të dalë nga kjo luftë. Shtetet e Gjirit janë të vetëdijshme se Iranin e kanë një fqinj të drejtpërdrejtë, me të cilin duhet të vazhdojnë të bashkëjetojnë në njëfarë mënyre. Ata gjithashtu pranojnë se strategjia e afrimit ka dështuar. Në të njëjtën kohë, ata e kuptojnë se duhet të ketë rrugë për dialog. Afrimi i viteve të fundit nuk u karakterizua nga besimi i thellë, por më tepër nga pragmatizmi. Në një moment, ky pragmatizëm do të nevojitet përsëri.

- Gjithashtu ka zëra në Gjirin Persik, që thonë: “Ne nuk e kërkuam këtë luftë, por tani që është këtu, duhet të shihet deri në fund. A ka ndonjë shpresë të fshehtë për ndryshimin e regjimit?”

Ka shpresë se do të shfaqet një Iran, i cili do të jetë më i lehtë për t'u kontrolluar dhe më pak ideologjik. Që nga revolucioni i vitit 1979 në Iran, shumica e shteteve të Gjirit e kanë parë Republikën Islamike jo si një shtet-komb racional, por si një ideologji ekspansioniste. Në të njëjtën kohë, ata nuk kanë interes për një Iran demokratik. Ata kanë frikë nga një model si ai pas Pranverës Arabe, kur monarkitë e Gjirit panë sistemin e tyre të qeverisjes të sfidohej nga strukturat islamiko-demokratike në Egjipt dhe Tunizi. Por ata gjithashtu nuk duan një skenar “shteti të dështuar”, në të cilin një vend me 90 milionë banorë bie në kaos.

- Disa shtete të Gjirit kanë theksuar së fundmi, të drejtën e tyre për vetëmbrojtje. A është e mundur që ato vetë ta sulmojnë Iranin?

Ky kërcënim ekziston, por aktualisht është i pamundur. Presioni mbi Iranin rritet duke deklaruar publikisht: “Ju keni bërë një gabim serioz strategjik dhe duhet të përballeni me pasojat”. Sundimtarët e Gjirit po e përdorin këtë taktikë për të ruajtur reputacionin e tyre si mbrojtës të popullit të tyre. Megjithatë, nuk besoj se ata kanë ndonjë interes në ndërhyrjen ushtarake. Arabia Saudite, në veçanti, dëshiron të shmangë përshtypjen e bashkimit me luftën në anën e Izraelit. Por mund t'i

imagjinoj ata duke zgjedhur mjete të tjera, siç është ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike.

- A duhet që shtetet e Gjirit të rishqyrtojnë tani marrëdhënien e tyre me SHBA-në? Partneritetet e tyre me Uashingtonin nuk kanë ofruar sigurinë e shpresuar.

Shtetet e Gjirit kanë rënë në një dilemë. Nga njëra anë, ato kanë nevojë për SHBA-në. Nga ana tjetër, këto lidhje të ngushta me Uashingtonin janë bërë një rrezik sigurie. Është e qartë se varësia e tyre e sigurisë nga SHBA-ja do të vazhdojë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, shtetet e Gjirit do të duhet të zhvillojnë aleanca të reja dhe të intensifikojnë partneritetet ekzistuese, për shembull me Kinën ose Europën. Ato gjithashtu kanë filluar tashmë të forcojnë industritë e tyre ushtarake për të siguruar autonomi më të madhe strategjike.

- Mos vallë në Gji po fillon një garë e madhe armatimesh?

Është e mundur që një garë armatimesh tani të vihet në lëvizje. Shtetet e Gjirit tashmë po investojnë shumë në mbrojtjen e tyre ajrore dhe po kanë sukses me to. Mbi 90 për qind e të gjithë dronëve dhe raketave iraniane janë kapur. Megjithatë, kjo është tepër e kushtueshme. Për më tepër, secili shtet vepron në mënyrë të pavarur. Nuk ka një mekanizëm të koordinuar mbrojtës midis shteteve të Gjirit. Diskutimet rreth nevojës për bashkëpunim më të ngushtë kanë vazhduar që nga vitet 1980.

- A mund të lindë tani një aleancë mbrojtëse e Gjirit?

Aktualisht ndodhemi në një pikë shumë kritike në historinë e shteteve të Gjirit. Është e mundur që radhët tani të ngushtohen jo vetëm në aspektin retorik, por edhe në aspektin e politikës së sigurisë, për shembull, përmes një strukture të përbashkët komanduese. Kjo do të kishte gjithashtu një efekt pengues dhe do të nxiste integrimin rajonal brenda Gjirit.

- Shtetet e Gjirit ende nuk po ushtrojnë presion të vërtetë mbi SHBA-në për t'i dhënë fund luftës. Kur do të ndryshojë kjo?

Për momentin, shtetet e Gjirit mund të kompensojnë humbjen e të ardhurave dhe nuk po vuajnë shumë nga sulmet. Por kjo mund të ndryshojë, nëse lufta zgjatet. Një faktor tjetër janë rrugët detare. Bllokada e Ngushticës së Hormuzit është një problem i madh, por Arabia Saudite, për shembull, gjithashtu mund të transportojë furnizimet e saj me naftë nëpërmjet Detit të Kuq. Megjithatë, nëse Huthët në Jemen nisin sulme të reja atje dhe bllokojnë Ngushticën *Bab al-Mandab*, kjo do të bëhet dukshëm më problematike për shtetet e Gjirit. Atëherë ata nuk do të kenë zgjidhje tjetër, veçse të përpiqen të ulin tensionin e konfliktit.

- Pse nuk e kanë bërë ende këtë?

Ata nuk duan të luajnë në llogaritjet e Iranit. Teherani shpreson të rrisë kostot për shtetet e Gjirit në një masë të tillë, sa të ushtrojnë presion mbi Trump-in për t'i dhënë fund luftës. Por situata nuk është e njëjtë për të gjitha shtetet e Gjirit: Arabia Saudite mund ta përballojë këtë konflikt më mirë sesa një vend si Katari, i cili u detyrua ta ndalte plotësisht prodhimin e gazit, sepse nuk mund të eksportonte më asgjë.

- Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, tha së fundmi, se dobësimi i Iranit mund të hapë derën e paqes midis Izraelit dhe Arabisë Saudite. A është e besueshme kjo?

Nga një perspektivë saudite, kjo është aktualisht e paimagjinueshme. Që nga masakra e Hamasit më 7 tetor 2023, Izraeli është perceptuar si një forcë agresive, një hegjemon që kërkon të rivizatojë kufijtë kombëtarë. Për vende si Arabia Saudite, kjo është një çështje legjitimiteti, por edhe një shqetësim sigurie. Shumë nga kolegët e mi në Mbretëri e shohin normalizimin si një mendim të dëshiruar nga ana e Izraelit. Dhe pyetja e thjeshtë është: çfarë do të fitonte Arabia Saudite nga kjo tani? Por ndoshta në një moment, dikush duhet të zgjedhë anë.

- Çfarë doni të thoni me këtë?

Shtetet e Gjirit po ndjekin një politikë 360 gradë, duke u angazhuar me të gjithë aktorët për të shmangur tërheqjen në konflikte. Tani po shohim se kjo strategji ka kufijtë e saj. Në një moment, shtetet e Gjirit mund të detyrohen të mbajnë një qëndrim më të fortë përballë polarizimit global në rritje, edhe nëse duan ta shmangin këtë me çdo kusht.

- Por kjo ka më pak të bëjë me luftën kundër Iranit dhe më shumë me gjendjen e përgjithshme të botës?

Pikërisht. Pesë nga gjashtë shtetet e Gjirit e kanë Kinën partnerin e tyre më të rëndësishëm tregtar. Këto marrëdhënie nuk mund të zëvendësohen thjesht. Por Gjiri nuk është imun ndaj tensioneve gjeopolitike midis SHBA-së, Kinës dhe Rusisë. Europa mund ta ofrojë veten si një alternativë këtu, në mënyrë që shtetet e Gjirit të mos ndihen sikur po shtypen midis superfuqive të botës.

Shënim: Dr. Sebastian Sons është një hulumtues i lartë në grupin e mendimit “Carpo” në Bon dhe bën kërkime mbi monarkitë e Gjirit Arab.

VII. KOMENTI

7.1 Kriza në Unionin European

Nga Shqiprim Pula, PhD

“Ne jemi një komb që ka një qeveri dhe jo anasjelltas, dhe kjo na bën të veçantë midis kombeve të tokës. Qeveria jonë nuk ka pushtet tjetër, përveç atij që i është dhënë nga populli. Është koha për të kontrolluar rritjen e qeverisë, e cila jep shenja se është rritur përtej pëlqimit të të qeverisurve”. Kështu është thënë Roland Regan, në fjalimin inaugurues të tij si president i SHBA-së më 20 janar 1981.

Sipas përmbajtjes dhe porosisë që jep ky fjalim hyrës gjatë ceremonisë inauguruese të presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe gjendjes reale që po mbretëron në Bruksel prej më tepër se një dekade tashmë, Unioni European (UE) sot është në krizë! Pushteti i burokratëve, zyrtarëve të emëruar burokratë, është rritur jashtë kontrollit e në mënyrë të egër. Edhe pse UE-ja është qeverisur nga një administratë në dukje liberale gjatë dekadës së fundit, në fakt ajo dominohet edhe nga aktivistë politikë dhe burokratë me agjenda të tyre personale. Zyrtarët e emëruar në të gjitha institucionet supozohet që të ndjekin politikat e shkruara në traktate të përcaktuara nga institucioni që i ka zgjedhur dhe votuar nga deputetët e Parlamentit European, por në fakt, ata i përmbysin në mënyrë aktive e të përsëritur politikat e thellimit, zgjerimit dhe integritit. Këta burokratë jo të zgjedhur drejtpërdrejt nga elektorati european po minojnë institucionin përfaqësues: Parlamentin. Të gjithë janë pjesë e asaj, që e ndjera Jeane Kirkpatrick e ka emëruar si “turma e fajësimit së pari”. Ata e shohin UE-në, por jo armiq të UE-së, si burimin e të këqijave të hapësirës ku jetojnë. Kriza po çon në dobësi e mungesë qëllimi dhe, në fund të fundit, në shumë mjegullime të synimeve të përcaktuara me traktatet e saj të themelimit. Winston Churchill dikur vuri në dukje se Lufta e Dytë Botërore ishte lufta më e panevojshme në histori. Sikur udhëheqësit në Perëndim, në atë kohë, të kishin pasur vullnetin, largpamësinë dhe

guximin për të mbajtur një qëndrim të vendosur, Adolf Hitleri do të ishte ndaluar dhe vdekjet e atyre 72 milionë njerëzve do të mund të shmangeshin.

Sot, një kërcënim nga një sëmundje që do kurim paraqet Unioni European, udhëheqësit e të cilit kanë miratuar një strategji sekrete për të mposhtur parimet dhe qëllimet e formimit të UE-së, me agjenda personale e klanore të tyre, si armë prolongimi, kërcënimi dhe ndëshkimi, kryesisht ndaj shteteve me demokraci solide, por aspirante për anëtarësim në këtë organizatë: Union. Rreziqe të tjera përfshijnë lejimin e një Serbie të ringjallur e autoritare e mbështetur nga Rusia dhe Kina, e cila pa ndalur rrit kapacitetin e armatimeve dhe është e vendosur të rimarrë statusin e hegjemonisë së humbur jugosllave, që përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për Republikën e Kosovës, por edhe fqinjët e tjerë, sa dhe vitet e negociatave u treguan të pafuqishme, edhe pse të promovuara nga burokratët e UE-së, që bënë pak për të promovuar çarmatimin dhe demokratizimin për një ekuilibrim politik rajonal. Në vend të kësaj, shtetit autoritar në kuptim të demokracisë i dhanë kohë dhe, në fund të fundit, legjitimitet ndërkombëtar që nuk e meritonte.

Burokratët dhe karrieristët, zyrtarë në nivelet e larta dhe të mesme të institucioneve të Unionit European, kanë miratuar politika dhe agjenda të përcaktuara, si të tilla që e shohin UE-në jo armik të UE-së, si burim të së keqes të Europës Juglindore Ballkanike. Ata nxiten nga antiparimet e tyre, pavarësisht se si ushtrohet nga një forcë “e butë” si UE-ja. Kjo krizë e burokracisë së Unionit European po përshpejtohet. Problemi në institucionet e UE-së është se burokratët e gabuar kanë ardhur për të dominuar të gjithë sistemin. Mënyra e tyre e veprimit është fare pak e njohur. Këta burokratë e kanë bërë rajonin tonë të rrezikshëm dhe kanë identifikuar dobësinë kryesore të UE-së, duke përdorur gënjeshtër dhe gjysmë të vërteta për të mohuar rreziqet, duke besuar në drejtues të gabuar dhe duke keqlexuar situatat. Dhe tani, ata burokratë, fuqia e të cilëve vazhdon të rritet, në emër të UE-së po dërgojnë sinjale të gabuara e të rrezikshme si për miqtë, ashtu edhe për

armiqtë e saj. Si rezultat, këta burokratë kanë bllokuar ose përmbysur politikat fundamentale, që e kanë rritur UE-në drejt shteteve aspiruese për anëtarësim. Shtetet anëtare të UE-së i lanë burokratët me një fuqi të madhe si të emëruar politikë, gjithashtu si të dërguar, politikat e të cilëve janë të lexuara në dritë, por të padukshme në errësirë.

Kontrolli i burokratëve të Unionit European duhet të jetë prioritet i lartë i vetë Unionit: parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit European. Në të kundërtën, mungesa e kontrollit të këtij sistemi burokratësh dhe mbështetësve të tyre neoliberalë, Unioni në kuptimin e konceptit si ekzistencë do të lëngoje nga kjo sëmundje në qëllimet e tij të krijimit dhe formësimit institucional.

E para dhe më e rëndësishmja se çfarë duhet të bëjnë Parlamenti European dhe Këshilli i Unionit European për të shmangur këtë frymë të sëmurë të burokratëve të saj, është të kundërshtojnë agjendat për minimin e hapur të UE-së. Kjo do të vlerësonte sfidat e paraqitura nga shtete joanëtare e jodemokratike, të tilla si Serbia e Rusia, dhe jo vetëm.

7.2 SAMITI I ARDHSHËM I NATO-S DHE PARADIGMA E TURQISË

Dan GSHI, Nju-Jork

Turqia do të jetë mikpritëse e Samitit të NATO-s më 7-8 korrik 2026, i cili pritet të mbahet në Kompleksin Presidencial (Beştepe) në Ankara. Samiti i parë i aleancës i organizuar nga Turqia u zhvillua në Stamboll në vitin 2004, i përqendruar atëherë në Afganistan, Irak dhe Lindjen e Mesme.

Ky samit u vlerësua në atë kohë si një “sukses diplomatik” për Turqinë. Sot, Turqia është shndërruar në një bazë kyç për zgjerimin ushtarak të NATO-s drejt Lindjes së Mesme dhe Azisë Jugore. Pas njëzet e dy vjetësh, në agjendë nuk janë më Afganistani apo Iraku, por forcimi ushtarak në Europën Lindore, i nxitur nga lufta në Ukrainë dhe tensionet në rritje me Rusinë. Ndonëse temat dhe preokupimet ndryshojnë, strategjia kryesore mbetet e njëjtë: zgjerimi dhe forcimi i pranisë ushtarake të NATO-s.

Çështja kryesore në Samitin e 36-të të Krerëve të Shteteve dhe Qeverive nuk do të jenë thjesht përgatitjet për luftë, por objektivi i rritjes së shpenzimeve të mbrojtjes deri në 5 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) për shtetet anëtare.

Ky objektivi, i mbështetur në vazhdimësi nga Donald Trump dhe Sekretari i Përgjithshëm, Mark Rutte, pritet të shkaktojë polemika të mëdha të brendshme. Kjo kërkesë po trondit veçanërisht anëtarët europianë, që përballen me kriza të thella ekonomike, sociale dhe politike.

Çfarë do të thotë objektivi 5 për qind për Turqinë?

Turqia është ndër vendet që e kanë miratuar pa ngurrim këtë rritje, duke deklaruar vazhdimisht se po i shton shpenzimet ushtarake për të arritur këtë synim. Megjithatë, realiteti aktual mbetet sfidues. Shpenzimet aktuale të Turqisë janë rreth 2 për qind e PBB-së (afërsisht 40-50 miliardë dollarë), bazuar në PBB-në e saj prej 1 538 trilionë dollarësh.

Përmbushja e objektivit prej 5 për qindësh do të kërkonte më shumë se dyfishimi e buxhetit, duke e çuar atë në mbi 80 miliardë dollarë, një barrë shtesë prej 40-50 miliardë dollarësh mbi nivelet aktuale.

Për ta arritur këtë, zakonisht ndiqen dy rrugë:

1. **Reduktime graduale në sferën civile:** Shkurtime në arsim, shëndetësi, ndihmë sociale dhe pensione, një metodë që shumë vende europiane po e planifikojnë tashmë.

Ripërcaktimi i industrisë së mbrojtjes: Kompanitë turke, të promovuara si “vendore dhe kombëtare” shpesh në retorikë kundër Perëndimin, do t’u nënshtrohen certifikimeve të NATO-s dhe integritit të plotë në prioritetet ushtarake të aleancës. Nëse anëtarët dështojnë ta arrijnë këtë shifër, pavarësisht zotimeve në Samitin e Hagës (2025), ata duhet të paraqesin plane konkrete dhjetëvjeçare deri në vitin 2035. Ndonëse dokumentet e NATO-s nuk parashikojnë sanksione apo përjashtime, raportet vjetore të progresit do të rrisin presionin dhe obligimin e përshtatjes vit pas viti. Për shtetet që ngecin, mund të mundësohen “kompensime” përmes rritjes së kapaciteteve operacionale: marrja e më shumë misioneve ushtarake dhe pjesëmarrja më intensive në zonat e rrezikut.

Roli i Turqisë në sigurinë rajonale

Samiti i Ankarasë do të përcaktojë nëse prania në Europën Lindore do të kthehet në një rajon të përhershëm sigurie, ku Turqia pritet të veprojë si një “zbatues i suksesshëm” dhe mbikëqyrës. Me ushtrinë tokësore më të madhe në NATO pas SHBA-së, angazhimi i forcave turke në “rajone me rrezik të lartë” duket i logjikshëm. Dialogu i Turqisë me Rusinë e bën këtë rol një nga opsionet më racionale për sigurinë rajonale. Ky proces do të pasohet nga *NATO Edge 26* në Izmir (nëntor 2026), ku do të promovohen inovacioni dhe gatishmëria. Qëllimi është krijimi i një platforme, ku teknologjitë ushtarake dhe industria e mbrojtjes integrohen plotësisht në strukturat e NATO-s. Sipas deklaratës së Agjencisë së Komunikimit dhe Informacionit të NATO-s (NCIA): “*NATO Edge 26* do të përqendrohet në forcimin e gatishmërisë për luftë

përmes një bashkëpunimi më të shpejtë dhe më të avancuar me industrinë”. Në strategjinë e parashikuar të Izmirit, industria e mbrojtjes do të ketë rol qendror, duke krijuar një ekosistem ushtarak, që funksionon mbi logjikën e tregut dhe partneriteteve të ngushta mes kompanive dhe komandave ushtarake.

Kalkulimet e NATO-s, gjegjësisht Turqisë

Të marra së bashku, Samiti i Ankarasë dhe *NATO Edge 26* sugjerojnë se NATO-ja po e pozicionon Turqinë në një rol edhe më të varur si politikisht, ashtu edhe teknologjikisht. Megjithatë, edhe Turqia ka kalkulimet e veta. Ajo llogarit në “qëndrime gri” dhe “ambiguitet në pjesëmarrje, gjegjësisht dhënie përparësie interesave kombëtarë” ose “mbrojtja nga aleanca, ndërsa është brenda aleancës”, duke blerë kohë në rritjen dhe forcimin e saj si faktor gjithnjë e më relevant rajonal dhe aktor gjeopolitik global.

NATO-ja, e cila ka ndikuar fuqishëm në strukturën politike turke për më shumë se gjysmë shekulli, duket e vetëdijshme se konceptet e Turqisë së Erdoganit, si: pavarësia, sovraniteti dhe interesat kombëtarë, duhet të akomodohen brenda aleancës, edhe nëse ato nuk janë plotësisht në harmoni me teorinë, konceptin dhe strukturën politike e ideologjike të saj.

VIII. OPINIONI

8.1 LUFTA E JASHARAJVE DHE NDIKIMI I SAJ

Nga Dilaver GOXHAI, kolonel

Sa e vështirë është të jesh hero mes shqiptarëve! Por sa mizore është kjo gjë në thelb për shqiptarët: edhe e kotë, edhe e pakuptimtë! Tipar ky që nuk e ka asnjë popull tjetër në këto përmasa që e kemi ne shqiptarët! Të jetë vallë ndonjë mallkim hyjnor?

28 vite më parë, më 5-7 mars 1998, në trojet shqiptare, në Drenicën kryengritëse të Kosovës, ndodhi një ngjarje e madhe, e cila njihet me emrin *Lufta e Prekazit*. Ajo luftë u zhvillua nga familja e madhe e Jasharajve, e udhëhequr prej Adem Jasharit, në rrethim të plotë dhe zgjati 36 orë pa ndërprerë. Luftuan në rrethim 60 burra, gra e fëmijë të Jasharajve, të ngjujar në tri godina, të rrethuara të tria me një mur avllie dy metra të lartë. Ajo luftë në rrethim është një rast unik, jo vetëm në historinë shqiptare, por edhe në historinë botërore, ku një familje edhe pse shumë e madhe, por në një unitet mendimi dhe veprimi të jashtëzakonshëm, luftoi si një trup i vetëm dhe e gjithë ajo ushtri e atij fisi, 56 pjesëtarët e saj, luftëtarë të të gjitha moshave, ranë theror për çlirimin dhe krijimin e një shteti të ri: për çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e saj me shtetin amë, Shqipërinë.

Ajo luftë heroike me të drejtë mori përmasat e një legjende. Ngaqë populli shqiptar në Kosovë, përveç të qenit për 85 vite koloni e Serbisë, në dekadën e fundit të atij kolonizimi (1989-1998) jetonte edhe jetën e robit “të zbutur” prej një pluralizmi politik pacifist shqiptar. Ajo politikë, në vend që të organizonte dhe ta bindte atë popull që të çlirohej nga ai kolonizim shekullor, edhe pse ishte kombi i tretë më i madh i ish-Federatës Jugosllave, po bënte të kundërtën: u bënte thirrje dhe propagandë shqiptarëve të bashkëjetonin në paqe “demokratike” me vrasësit dhe shfrytëzuesit të tyre të urryer, me të cilët kishin 14 shekuj resht që ndesheshin, ndërkohë që ajo politikë pacifiste vendase e

dinte se marrëdhëniet e këtij populli me Serbinë kanë qenë një konflikt midis kokës dhe zemrës.

Kjo gjendje psikologjike ishte rezultat i mashtrimit prej propagandës: “Po të vazhdojmë të rrimë urtë e pa u ndier, lirinë do të na e dhurojnë të tjerët, se Serbia është e fortë dhe nuk mund ta mundim me forcat tona”. Mirëpo, ndryshe është ta fitosh vetë lirinë, e tjetër është të ta bëjnë dhuratë të tjerë; dhe aq më keq kur duan të të bindin se është penduar vrasësi yt. Është e rrallë, për mos të thënë e pamundur, që një popull i pushtuar e i shtypur me shekuj nga një diktaturë e huaj, siç ishte populli shqiptar në Kosovë dhe në trevat e tjera të ish-Jugosllavisë, të mund të çlirohet pa luftë me armë. Dhe më në fund, erdhi një çast padurimi. Ai çast ishin ditët e para të muajit mars 1998. Ato ditë ndodhi ajo që ishte kërkuar për gati një shekull, prej vitit 1913, ku u takuan individ i duhur, me situatën kritike të duhur. Ai moment takimi i këtyre dy faktorëve, (njëri aktiv dhe tjetri pasiv), bëri të mundur që të çohet brof mekanizmi, nga i cili historia në Kosovë mori një drejtim 180 gradë në të kundërt me politikën pacifiste 10-vjeçare shqiptare. Ai takim i individit të duhur me momentin e duhur ishte qëndresa heroike e Jasharajve kundër Ushtrisë Shtetërore serbe; ishte lufta e fisit Jasharaj, e udhëhequr nga njëri prej djemve të atij fisi: Adem Jashari, të cilët shfrytëzuan momentin e duhur.

Kjo luftë, sado e shkurtër, u shndërrua në një NËNË, që e çliroi atë popull prej kompleksit të inferioritetit. Lindi ai çlirim psikologjik, nga i cili lindi ushtria çlirimtare e popullit shqiptar në Kosovë. Lindi ajo ushtri, e cila çliroi atë popull. Këtu qëndron madhështia më e madhe e Luftës së Prekazit, e personifikuar kjo me emrin e Adem Jasharit. Ajo luftë 36-orëshe ishte pikërisht ajo që populli shqiptar në Kosovë e pandehte të pamundur: shqiptarët u zgjuan nga gjumi pacifist që u kishte mjegulluar zgjuarsinë dhe u kishte topitur arsyen. Kjo është arsyeja kryesore, pse Lufta e Prekazit për atë popull u shndërrua në *Legjendën më të Re Shqiptare*. Ai heroizëm ishte një përmbysje historike e madhe, ngaqë populli shqiptar në Kosovë, më në fund, e gjeti të fshehtë e rrugës së vërtetë drejt lirisë së tij: lufta me armë.

Askush nuk e zgjon ndërgjegjen e popullit, si heroit që hyn vetë në betejë. Në rastin e Luftës së Prekazit është vërtetuar thënia realiste e Gjeneralit Norman Shvarckof: “Nuk duhet një hero për të udhëhequr njerëzit të hyjnë në betejë, por duhet një hero që të hyjë në betejë”. Dhe ky hero që hyri në betejë ishte i gjithë fisi i Jasharajve në Prekaz të Drenicës.

Për fatin tonë, Lufta e Prekazit nuk mori fund me sakrificën e madhe të Jasharajve me në krye Adem Jasharin, heroizëm që u bë i njohur për të gjithë botën. Ajo ishte embrioni i qëndresës luftarake, është sakrifica që mori përmasat e një legjende, ishte fillimi i një pikënisjeje të madhe, ishte mision me rëndësi kombëtare. Prandaj, me të drejtë, Përfaqësuesi i parë Special i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, guvernatori i parë i saj ndërkombëtar, Bernard Kushner, deklaroi: *“Nëse do të kishte çmim ‘Nobel’ për një lloj të tillë sakrifice, kjo familje do të ishte e para në historinë botërore që do ta gëzonte atë”*.

Deri atë ditë, i gjithë kombi shqiptar dhe i gjithë Kontinenti European e më gjerë kishin njohuri për vetëshpalljen e Kosovës republikë në kuadrin e Jugosllavisë së mbetur (Serbi, Mal i Zi dhe krahinat Vojvodinë dhe Kosovë, edhe pse Millosheviqi ia kishte hequr Kosovës edhe statusin e krahinës autonome). Kishin njohuri që Ibrahim Rugova ishte zgjedhur President i kësaj republike, madje Ibrahim Rugova ishte zgjedhur me referendum popullor, (edhe pse nën pushtim dragonian të Serbisë!), ndërkohë që edhe përfaqësuesit e këtij populli e kishin zgjedhur Rugovën me kushtetutë Komandant të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Kosovës (FARK). Mirëpo ato ditë kur ndodhi lufta, ose më saktë Beteja e Prekazit më 5-7 marsin e vitit 1998, çdo shqiptar i bëri këto pyetje vetes: Ku janë Forcat e Armatosura të Kosovës? Ku është Komandanti i Përgjithshëm i FARK-ut? Pse nuk u bënë të gjallë as FARK-u dhe as Komandanti i FARK-ut? Natyrisht që çdo shqiptar ua dha vetë përgjigjen këtyre pyetjeve: FARK-u ishte një lloj valiumi dhe asgjë tjetër. Derisa nuk ekzistonte FARK-u, çfarë forcash do të komandonte Komandanti i Përgjithshëm i asaj ushtrie in-

ekzistente? Pra, FARK-u nuk u ndie, se nuk ekzistonte. Që do të thotë se FARK-u nuk ishte ushtri për çlirimin e Kosovës, por një mashtrim, që të mos ngrihej populli në luftë.

Faktet treguan se ajo do të ishte ushtri e Kosovës kur Kosova të njihet nga OKB-ja. Dhe çudia është se këtë lloj ushtrie inekzistente e kishin shpallur përfaqësuesit (deputetët) e zgjedhur nga populli i Kosovës. Edhe pse kjo ushtri inekzistente (FARK-u) nuk u pa në ato ditët e Betejës së Prekazit, Presidenti i Kosovës dhe Komandanti i FARK-ut tri javë pas asaj beteje organizuan përsëritjen e zgjedhjes së tyre nga vetë populli dhe përsëri i thoshin popullit se kemi FARK. Çfarë ironie fati! Dhe populli duartrokiste Rugovën dhe fyente UÇK-në! Nuk besoj se ka ndodhur me ndonjë popull tjetër në këtë mënyrë dhe kaq masivisht si në rastin tonë. Me një fjalë, FARK-u nuk ishte ushtri për çlirimin e Kosovës, sepse nuk ekzistonte. Kemi, pra, dy emërtime ushtrish krejt të ndryshme, emërtime që tregojnë dy përmbajtje krejt të ndryshme, dy funksione krejt të ndryshme. Kemi FARK-un që mbron Republikën, kur republikë nuk kemi, por kemi edhe Ushtri Çlirimtare për të çliruar vendin nga pushtuesi, që të krijohet republika e pavarur.

Thuhej se kishim FARK, po si mund të kishim FARK, kur nuk kishim Republikë të Kosovës?! Madje, FARK-un Kosova nuk e ka ende as sot e 25 vite pas çlirimit të saj nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e themeluar nga Komandanti Legjendar i saj, Adem Jashari; Republika e Kosovës nuk e ka FARK-un edhe sot, që Kosova ka pavarësi të mbikëqyrur nga OKB-ja.

Duhej të ndodhte “lindja” e përjetshme e Adem Jasharit dhe e 56 heronjve të tjerë të asaj beteje, që bënë korrigjimin edhe të emërtimeve të ushtrisë, duke e quajtur *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, e cila e çliroi Kosovën dhe i tha popullit të saj: “Tashti kini mundësinë të shpallni Republikën e Kosovës!”.

Pra, për të pasur Republikë të Kosovës, duhej të lindte ushtria për krijimin e saj; duhej të flijoheshin 56 heronj të Jasharajve, që të themelohej Ushtria për Çlirimin e Kosovës (UÇK-ja); duhej të kishim, së pari, Ushtri Çlirimtare, që të çlirohej trualli shqiptar me emërtimin e

lashtë Dardani, (që sot thirret Kosovë), së cilës vetëm tashti i janë krijuar kushtet për të themeluar ushtrinë e saj të emërtuar FARK. Por edhe ata që e emërtuan FARK as nuk e kanë pasur të qartë dhe as nuk e kanë edhe sot, se me termin Forca të Armatosura kuptohet që t'i kesh të gjitha llojet e forcave të armatosura:

(1) Forcat Tokësore, në përbërje të së cilave janë të gjitha llojet e armëve (këmbësoria, artileria tokësore, artileria kundërajrore, arma e tankeve, arma e xhenios, armët kimike, si dhe të gjitha llojet e shërbimeve etj.), si dhe

(2) Forcat Ajrore dhe, nëse do të kesh edhe kufi detar, duhet të kesh edhe **Forcat Detare**. Pas asaj ngjarjeje të madhe dhe të përmasave të një legjende, në Prekazin e muajit mars 1998 do të vinte periodha e provave të mëdha.

Prej 7 marsit 1998 deri në 10 qershorin e vitit 1998 patëm një periudhë përgatitore për themelimin e Ushtrisë së vërtetë Çlirimtare të Kosovës, e cila bindi popullin, se deri atë ditë nuk kishim ushtri në Kosovë; gjithçka kishte qenë një rrenë e madhe. Krijimi i Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës pas Luftës në Prekaz ishte sfida e dytë që i bëhej jo vetëm Serbisë, por edhe politikës pacifiste të Kosovës; ishte sfida që bashkoi kombin shqiptar me UÇK-në. Dhe kjo sfidë e dytë lindi nga Beteja e Prekazit, e udhëhequr nga Adem Jashari. Ishte kjo sfida e dytë që bëri të mundur të vihen në vend padrejtësitë që popullit tonë i ka bërë historia; ishte Beteja e Prekazit, që lindi rastin, që kombi shqiptar të arrinte të kryente këtë sfidën e dytë, duke i shtyrë tej të gjitha komplotet që i ishin zhvilluar prej fqinjëve të tij të ndihmuar nga Europa; ishte kjo sfida e dytë që i tha Europës: “Jam gjallë dhe nuk kam për të vdekur kurrë!”. Por asgjë nuk do të ishte më e keqe, nëse nuk do të realizohej nga UÇK-ja kjo sfidë e dytë.

Nëse kombi ynë nuk do të qëndronte i bashkuar, nëse do të dorëzoheshim, sikundër u tentua në Konferencën e Rambujesë, atëherë ajo sakrificë e madhe e Jasharajve, e cila e bëri të njohur atë popull në mbarë botën, do të zhvlerësohej dhe misioni i nisur më 5 mars 1998 do të falimentonte e do të harrohej shumë shpejt. Ajo luftë-ferr vuri në

provë të gjithë burrat e vërtetë të kombit shqiptar; vuri në provë të gjithë politikanët që i kishin rënë gjoksit të atdhetarit deri atëherë. Ata që iu bashkuan UÇK-së treguan se nuk ia kishin me hile popullit. Ata politikanë që nuk u rreshtuan në radhët e UÇK-së, si dhe ata që e anatemuan dhe po e anatemojnë edhe sot UÇK-në janë armiq të Kosovës, pavarësisht se vijojnë t'i bien gjoksit, që gjoja ata e sollën lirinë e popullit që jeton në Kosovë. Këtë ndriçim të mendjeve të popullit e bëri Lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës.

Organizatori dhe drejtuesi i Betejës së Prekazit, Adem Jashari, u bë edhe sinonim i UÇK-së, për vetë faktin që Ai, edhe pse i rrethuar nga një ushtri prej 6 000 policësh e ushtarësh të armatosur edhe me artilleri dhe tanke, i përballoi derisa u vra edhe fëmija i fundit e asaj familjeje heroinë. Si i tillë, Adem Jashari u shndërrua në simbol të krenarisë sonë kombëtare, si rrallëkush, jo me dekrete presidentësh, as me vendime parlamenti apo kongrese partish, por me veprimtarinë e tij personale.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, duke e pasur Adem Jasharin simbol të Komandantit të saj, bëri të mundur që, edhe pse një ushtri gati 10-15 herë më e vogël se ushtria armike e saj, arriti ta përballonte atë Ushtri Shtetërore Klasike serbe, njësoj siç e përballoi atë rrethim komandanti simbol i saj, me sukses, që rrallëherë është arritur në historinë e luftërave botërore. Atë sukses UÇK-ja e arriti përmes luftës guerile të saj, lloj lufte që ua kalon gjithmonë edhe ushtrive më moderne. Është ajo fitore që, edhe pse u çarmatos me pëlqimin e drejtuesve politikë të saj e të Kosovës, edhe pse e burgosën, edhe pse e çuan në Gjyq racist Ndërkombëtar armiq të saj të brendshëm e të jashtëm për ta pushkatuar, duke e quajtur atë ushtri çlirimtare “ndërmarrje e përbashkët kriminale”, megjithatë shumica e popullit të thjeshtë shqiptar e ka dhe do ta ketë UÇK-në kurorë lavdie.

Ata që mbushën radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk i rrëmbyen armët me mendimin se dikush do t'i falënderonte apo do t'i shpërblente, pasi nuk e dinin se do të ktheheshin të gjallë, por sepse të tilla ishin dhe janë parimet e atyre pjesëtarëve të saj, sepse kështu ishin

gatuat ata, ngaqë ishin dhe janë njerëz me dinjitet, si komandanti i tyre i shndërruar në legjendë.

Të gjithë pjesëtarët e UÇK-së, edhe pse pacifistët, indiferentët dhe ata që u arratisën nga Kosova kur ata djem, vajza, burra dhe gra flijoheshin për lirinë edhe të atyre që u arratisën dhe që shumë prej tyre vijojnë t'i etiketojnë ata çlirimtarë se “janë enveristë, janë të marrët!”, i quanin dhe i quajnë edhe sot indiferentët dhe pacifistët shqiptarë. Por ja që “të marrët”, Adem Jashari dhe UÇK-ja, janë ata që bënë historinë, dhe jo logjika e politikanëve anti-UÇK.

Jo më kot shkencëtari i njerëzimit, Ajnshtajni, ka thënë: *“Ne, idealistëve, na quajnë të marrët, por po të mos ishim ne, “të marrët”, shoqëria nuk do të kishte ecur kurrë përpara”*. Por historia shqiptare jo rrallë ka treguar se më të mirët, domethënë idealistët e saj, “të marrët”, pasi kanë bërë historinë, ose janë flakur në rrugë, ose kanë përfunduar burgjeve. Kurse indiferentët dhe ata që përshtaten, që bëjnë kompromise, që janë pa shtyllë kurrizore dhe ata që heshtin, që binden apo tradhetojnë dhe pranojnë të jenë skllevër, këta jo vetëm që nuk përfundojnë kurrë në rrugë apo nëpër burgje, por bëhen edhe politikanë, edhe deputetë, edhe ministra, edhe kryeministra, edhe presidentë, si dhe pas vdekjes, por edhe për së gjalli u ngrihen buste dhe monumente nëpër sheshet kryesore të qyteteve e kryeqyteteve shqiptare!

8.3 ALBIN KURTI NË GIJOTINË!

Nga dr. Agim Vinca

Tashmë mund të thuhet lirisht, se demonizimi i Albin Kurtit është bërë sport kombëtar ndër shqiptarë. Ngado që të sillesh, kudo që të shkosh, nuk dëgjon gjë tjetër, veçse sharje e mallkime për kryetarin e Lëvizjes *Vetëvendosje*, si dhe kryeministrin e Republikës së Kosovës, tani në detyrë, Albin Kurtin.

Hap radion, ndez televizorin, hap kompjuterin, merr në dorë celularin, kudo i njëjti avaz! Akuza nga më të rëndat shqiptohen çdo natë në ekran, në Prishtinë, por edhe në Tiranë, ku jo rrallë ftohen në studio njerëz, që flasin me gjuhën e rrugës për Albin Kurtin dhe qeverinë e Kosovës.

Albin Kurti është i vetmi kryeministër në botë, që shahet edhe gjatë transmetimit të ndeshjeve futbollistike. Disa media në Kosovë mezi presin që dikush, qoftë edhe ndonjë anonim, të postojë ndonjë fjalë kundër Albinit në “Facebook”, për t’i bërë vend sa hap e mbyll sytë në mediumin e tyre. Askush nuk ia konteston askujt të drejtën, që për Albin Kurtin dhe qeverinë që kryeson ai, sikurse edhe për subjektin politik që drejton (Lëvizjen *Vetëvendosje*!) të ketë mendim kritik dhe ta shprehë atë lirisht kudo e në çdo kohë. Por, nuk duhet shumë mend për të konstatuar se këtu, fatkeqësisht, nuk bëhet fjalë për kritikë, por për fushatë, madje jo thjesht fushatë, por linç publik. Dhe kjo fushatë linçuese zhvillohet horizontalisht dhe vertikalisht, nga Prishtina në Tiranë, në Shkup, Tetovë, Strugë e Elbasan dhe nga maja e kupolës e deri në bazë. Nga lart rri e vështron Vëllai i Madh, karizmatik, që modelin *Kurti* e sheh si rrezik.

Është e pamundur të numërohen të gjitha akuzat që i bëhen Albin Kurtit, por po përmendim vetëm disa prej tyre që dëgjohen më shpesh: “mashtues”, “njeri i Serbisë”, “agent i Rusisë”, “antiamerikan”; “stalinist”, “maoist”, “fundamentalist”, “populist”; “komunist”; “kundërshtar i UÇK-së”; “përçarës i shqiptarëve të

Maqedonisë dhe të luginës së Preshevës”; “prishës i marrëdhënieve ndërmjet Tiranës dhe Prishtinës”, e sa e sa gjepura të tjera, që s’i rrok mendja e shëndoshë.

Disa e quajnë edhe ardhaçak (“njeri nga Mali i Zi”), edhe pse Albini ka lindur dhe është rritur në Prishtinë, ku edhe jeton. (Babai i tij, një burrë i nderuar, ka ardhur në Kosovë, si shumë të tjerë, nga një fshat shqiptar i Malit të Zi dhe kjo është e gjitha). Nuk ka mbetur gjë pa u thënë për të, nuk ka mbetur sharje e fyerje që nuk i është bërë. Edhe kur ia ul rrogën vetes, Albin Kurti shkel ligjin! Fushatë kundër Albin Kurtit zhvillohet edhe në Serbi, e edhe nga militantët e Vuçiqit në “Kosovë e Metohi”, por kjo s’është temë e këtij shkrimi. Veç një gjë nuk e kuptoj dhe nuk di si ta shpjegoj: si ka mundësi që i njëjti njeri të jetë shqiptari më i urryer në Serbi dhe, njëkohësisht, edhe njeriu më i urryer në Shqiptari?! Në Beograd quhet “njeri që i urren serbët”, “terrorist” dhe “shiptar”, kurse në Prishtinë, Shkup e Tiranë, natyrisht në qarqe të caktuara, “njeri që lufton për pushtet”, “karrierist” dhe “antikombëtar”! Kur i dëgjon aleatët, e quajnë “të pavendosur” e “frikacak”, kur ndodh të mos i dëgjojë për ndonjë çështje si puna e targave dhe e dinarit, e shpallin “antiamerikan” dhe “antiperëndimor”.

Hip se të vrava, zbrit se të vrava!

Gazetarë, analistë, reporterë, moderatorë, drejtues OJQ-sh, politikanë, ish-politikanë, kryetarë komunash, kryetarë partish, deputetë, ish-deputetë, biznesmenë, oligarkë, ish-anëtarë të VV-së, një lukuni e tërë, s’lënë gjë pa thënë për njeriun që, në krye të këtij vendi, ka ardhur me verdiktin e popullit, në zgjedhje të lira e të rregullta, të njohura edhe nga rivalët e tij politikë, të cilët duket se pikërisht kjo gjë i tërbon.

Flasin për keqeverisje, për borde e punësime, për shpenzime e privilegje; s’lënë gjë pa thënë, ata që kur ishin vetë në pushtet, s’lanë gjë pa bërë! Nuk mungojnë as akuzat për korrupsion! Kërkojnë burgosjen e Albinit për “hajni”, ata që s’ia dinë skajin pasurisë... Kur kapobanda thërret: “Kapeni hajnin!”, edhe qorri e di sa është sahati: në ç’gjendje është katandisur morali, etika dhe politika. E ritheksojmë:

askush nuk është kundër kritikës, si asaj që vjen nga opozita, ashtu edhe nga shoqëria civile dhe media, por kjo për të cilën po flasim s’është kritikë, por propagandë që ka për qëllim diskreditimin e kundërshtarit politik, i cili trajtohet si armik! Është shumë e rëndë akuza që i bëhet në vazhdimësi Kryeministrit të Kosovës, se ai qenka kundër UÇK-së, se paska qenë dikur dhe vazhduaka të jetë edhe sot, sado që faktet flasin ndryshe. Në vitet nëntëdhjetë Albini ishte sekretar i përfaqësuesit politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Prishtinë, Adem Demaçi, dorë e djathtë e “Bacës”, i cili nuk do të mund të funksiononte, sidomos në raport me botën, pa shërbimet e djaloshit flokëgjatë, që e zotëronte në mënyrë perfekte anglishten dhe teknologjinë, e kjo do të thotë se ai u bë edhe vetë pjesë e luftës, për çka edhe u dënua me 12 vite burg si “terrorist”. Ne e dimë mirë kush ka deponuar në Hagë kundër UÇK-së, përveç Serbisë, vite me radhë. Edhe ata që e drejtojnë gishtin kah VV-ja, shumica syresh, e dinë, por e bëjnë me qëllim.

Shpif e shpif, se diçka do të mbesë!

Askush si Albini nuk i nderon dëshmorët; familjen Jashari dhe familjet e tjera të dëshmorëve; përpjekjet e pareshtura të atdhetarëve të të gjithë brezave, nga viti 1912 e deri më sot; ish-të burgosurit politikë, që e kaluan rininë burgjeve dhe të gjithë ata veprimtarë, intelektualë e të tjerë që kontribuan në çfarëdo mënyre për lirinë e Kosovës dhe për kauzën kombëtare.

Por, kot! Argumentet nuk vlejnë kur urrejtja e errëson arsyen.

Albin Kurti është fajtori kryesor për gjithçka që ndodh në Kosovë. Ai dhe askush tjetër. I ka fituar zgjedhjet, por nuk i ka numrat për të zgjedhur kryeparlamentarin dhe për të konstituuar Kuvendin. Pas shumë seancash, votimesh e zhvotimesh, akuzash e kundërakuzash, më në fund zgjidhet kryetari i Kuvendit, por jo edhe të pestë nënkryetarët. Puna ka ngecur te përfaqësuesi i komunitetit serb, që duhet të vihet në këtë pozitë.

Përse PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja nuk e votuan deputetin Nenad Rashiqi për nënkryetar të Kuvendit, njeriun që e njih shtetin e

Kosovës dhe institucionet e tij, por kërkojnë që ai të jetë patjetër nga radhët e Listës Serbe, e cila e hap fushatën për zgjedhjet lokale me himnin e Serbisë dhe me sloganin “për çlirim nga Albin Kurti”?! Duan ta vazhdojnë bllokadën, me pretendimin se po mbrojnë Kushtetutën, duke fajësuar përsëri shkaktarin e të gjitha të këqijave që i paskëshin rënë mbi kokë Kosovës dhe mohuesin e të gjitha të arriturave të saj: Albin Kurtin.

Janë po ata që e shkarkuan në mars të 2020-ës, në kulmin e pandemisë, me 61 vota (vota e fundit, e 61-ta, e siguruar me angazhimin personal të Presidentit dhe të ish-Kryeministrit në orët e vona të natës) dhe është po ajo mendësi: “Do t’ia nxijmë jetën!”. Marrëzia arrin deri aty, sa të thonë se edhe fakultetin e paskësh kryer me ndërhyrje!

Qeveria *Kurti* nuk është pa të meta: disa nga ministrat lënë për të dëshiruar; shumë nga premtimet nuk janë përmbushur, jo vetëm për mungesë të vullnetit politik, por edhe për shkak të rrethanave, në të cilat i ra për hise liderit të *Vetëvendosjes* ta drejtonte Republikën e Kosovës. Në fillim pandemia, që u menaxhua mirë, pastaj lufta në Ukrainë dhe pozicionimi i drejtë kundruall saj; obstruksionet e vazhdueshme të Serbisë dhe qëndrimi tolerant i BE-së ndaj Beogradit zyrtar, madje edhe pas sulmeve terroriste si ai në Banjskë dhe në Ibër-Lepenc, gjithnjë me pretekstin e largimit të Serbisë nga prehri i Rusisë. Për të gjitha këto probleme duhet të flitet në mënyrë racionale e jo me turr, zjarrmi e mësymje. Kurrgjë mos pastë bërë kjo qeveri, ajo e ka ndryshuar dukshëm gjendjen në Veri, duke e shtrirë autoritetin e shtetit edhe në këtë pjesë të territorit të Kosovës, betejë që ende nuk ka përfunduar dhe që kërkon angazhimin e të gjithëve.

Vërtet i ndaloi referendumet që mbante Serbia më parë në Kosovë dhe nuk e formoi Asociacionin, të cilin ia lanë në dorë pararendësit, por nuk u ka cenuar asnjë të drejtë pjesëtarëve të komunitetit serb, të cilëve u drejtohet pa kompleks edhe në gjuhën e tyre. Vendimi i Departamentit të Shtetit për “pezullimin e dialogut strategjik”, i bërë publik nga e ngarkuara me punë e ambasadës së

SHBA-së në Prishtinë, i dha impuls të ri luftës politike në Kosovë dhe fushatës kundër “shkaktarit të bllokadës”. Natyrisht që ky vendim nuk është një lajm i mirë për Kosovën dhe duhet të na brengosë të gjithëve, por askush nuk duhet t’i gëzohet rikthimit të skenarit të emisarit të dekoruar në Beograd nga mandati i parë i Presidentit Trump. Ende pa u përhapur mirë lajmi, shpërtheu cunami: “Ja ku na solli!”.

I kuptoj politikanët që luftojnë për pushtet, por nuk e kuptoj ish-politikanin Ben Blushi, i cili, tani në rolin e shkrimtarit, lëshon fetvanë kundër Albin Kurtit, sepse nuk mund të quhet ndryshe artikulli i tij, ku ai e quan *Vetëvendosjen* “sekt”, kurse elektoratin kosovar “insekt”!

Ajatollahët e Iranit e falën dikur shkrimtarin “heretik” Salman Ruzhdi, por ai mbeti pa një sy!

Ne këtij tonit duam t’ia nxjerrim që të dy!

8.4 NUK BËHEJ FJALË PËR SHKËMBIM TERRITORESH, POR PËR TREGTI ME SOVRANITETIN E SHTETIT

Nga Lirim Gashi

Nuk bëhej fjalë për një projekt të shkëmbimit të territoreve, siç u përpoq Hashim Thaçi ta paraqiste në mënyrë të maskuar diskursin e tij publik.

Në thelb ishte një nismë e zhveshur nga çdo parim shtetformues, një përpjekje për të blerë lirinë personale nga Gjykata Speciale përmes një pazari të errët me Aleksandar Vuçiqin, të ndërmjetësuar nga “vëllezërit” e tij shqipfolës: Edi Rama, Baton Haxhiu dhe Shkëlzen Maliqi.

Çmimi i kësaj “lirie” nuk ishte aspak simbolik: ishte vetë Veriu i Kosovës, i dorëzuar pa kushte, pa reciprocitet dhe pa rikthimin qoftë edhe të një pjese të vetme të territorit të humbur. Këtë nuk e dëshmon vetëm logjika e ftohtë e analizës politike, por edhe deklaratimet dhe qëndrimet e Sabina Çudiqit, të cilat e zhveshin këtë projekt nga çdo iluzion diplomatik dhe e vendosin në kuadrin e tij real, si një akt të rrezikshëm të tregtisë me sovranitetin e shtetit.

Përmbysja e vetë kuptimit të luftës çlirimtare

Nga këndvështrimi historik, ky mentalitet përfaqëson një rikthim tragjik në traditat më të errëta të politikës shqiptare, ku territori dhe fati i kombit trajtoheshin si monedha shkëmbimi për interesat personale të elitave.

Ishte një mohim i sakrificës kolektive dhe i gjakut të derdhur për liri, një përmbysje e vetë kuptimit të luftës çlirimtare.

Nga aspekti psikologjik, kemi të bëjmë me një sindromë frike, ku politikanët e korruptuar dhe të shitur përpiqen ta shmangin fajin e tyre, të gatshëm ta sakrifikojnë interesin publik dhe shtetëror për ta shpëtuar vetveten.

Është psikologjia e njeriut që, përballë drejtësisë, nuk mbrohet me të vërtetën, por me pazare. Në planin politik, kjo përfaqëson formën

më të pastër të kapjes së shtetit, kur politika nuk shërben më si instrument i qytetarëve, por si mburojë e krimeve dhe e tradhtive të individëve të caktuar. Sepse një kryetar shteti që negocion territorin për hallin e tij dhe të disa individëve të ngjashëm me të, pushon së qeni personifikim i shtetit ligjor dhe shndërrohet në një ndërmarrje private me flamur. Nga këndvështrimi filozofik shtrohet pyetja themelore: *A mund të blihet dhe të shitet liria?*

Nëse liria personale blihet me shitjen e një pjese të territorit të shtetit, atëherë ajo nuk është më liri, por një iluzion i ngritur mbi padrejtësi. Nga aspekti etik dhe moral, një projekt i tillë bie ndesh me çdo normë të përgjegjësisë publike. Askush nuk ka të drejtë morale të dhurojë tokë që nuk i përket, aq më pak për ta shpëtuar vetveten nga përgjegjësia morale dhe ligjore. Është një akt që cenon besimin e qytetarëve dhe dëmton dinjitetin e një kombi të tërë. Në fund, ky nuk është thjesht një episod politik, është një provë për ndërgjegjen kolektive: nëse një shoqëri pranon që liria e disa individëve të blihet me copëtimin e atdheut, atëherë ajo rrezikon të humbasë jo vetëm territorin, por edhe shpirtin e saj.

Për mbrojtësit e Hashim Thaçit

Problemi juaj nuk është vetëm keqleximi, është ose keqinterpretimi i qëllimshëm, ose keqinterpretimi injorant i realitetit. Për çfarë po flasim këtu?

Për një njeri që në vitin 2013, në të ashtuquajturat “bisedime teknike”, ka vendosur mbi tryezën e bisedimeve teknike çështje politike dhe territoriale, që prekin drejtpërdrejt sovranitetin e shtetit, përballë një armiku shekullor, që edhe sot e kësaj dite e konsideron Kosovën si pjesë të territorit të vet në Kushtetutën e tij. E ka bërë këtë, edhe pse e ka ditur që Serbia është një shtet gjenocidal, që jo vetëm nuk ka kërkuar falje për gjenocidin, por që vazhdon ta destabilizojë vendin përmes strukturave kriminale dhe terroriste, si Lista Serbe, të përbëra nga individë me të kaluar kriminale, të cilët ushtrojnë kontroll dhe presion në veri me metoda që nuk kanë asgjë të përbashkët me demokracinë.

Pyetja thelbësore është kjo: *Me çfarë të drejte e ka negociuar Hashim Thaçi territorin e shtetit? Kush ia ka dhënë këtë mandat? Populli? Jo. Kushtetuta? Jo. Atëherë si duhet të quhet një njeri i tillë? Atdhetar?! Atdhetari nuk e konsideron territorin e shtetit dhe pasurinë e popullit si pronë private.*

Pra, ai nuk është atdhetar, ai është tradhtar.

Në çdo shtet normal me institucione funksionale, profesionale dhe të paanshme të drejtësisë dhe prokurorisë, që e respektojnë Kushtetutën, një veprim i tillë do të mjaftonte për dënim me burgim të përjetshëm, pa ia përmendur fare veprat e tjera të mundshme, lista e së cilave është aq e gjatë, sa do të mbushte libra të tërë. Pse nuk i ka vënë në tavolinë pasuritë personale, shtëpitë, vilat, bizneset, por ka vënë në pazar integritetin territorial të Kosovës?

Edhe më shqetësuese është kontradikta e hapur në qëndrimet e tij: në vitin 2013 deklaroi se Asociacioni është në përputhje me Kushtetutën, ndërsa në vitin 2019 e quan atë “kancer me metastaza”, duke thënë se nuk e ka nënshkruar ai, por Isa Mustafa. Kjo nuk është vetëm mospërputhje politike, por është mungesë serioziteti dhe përgjegjësie shtetërore. Dhe këtu lind pyetja tjetër e pashmangshme: *Si e ka merituar Serbia një koncesion të tillë?*

Në çdo shtet funksional, me standarde minimale të përgjegjësisë, veprime të tilla do të hetoheshin seriozisht si cenim i interesit shtetëror. Ndërsa këtu, përkundrazi, shohim përpjekje për relativizim dhe mbrojtje të figurave, që edhe vetë bashkëpunëtorët e tyre politikë dikur i kanë konsideruar problematike, përpara se t'i ndryshonin qëndrimet për interesa pushteti. Prandaj, përpara se të mbronin individë të caktuar, do të ishte më e ndershme të përballeni me faktet. Sepse këtu nuk bëhet fjalë për simpati apo antipati politike, por bëhet fjalë për përgjegjësi ndaj shtetit.

IX. RECENSIONE

9.1 DEMOKRACIA NË KOHËN E ZHVESHJES SË RENDIT BOTËROR APO DEMOKRACIA PAS DEMOKRACISË

Nga dr. Martin Berishaj

Recension për librin “Metamorfoza e demokracisë - Shteti në dritën e gjeopolitikës kritike”, me autor dr. Sadri Ramabaja

Ky libër nuk i drejtohet lexuesit si një rrëfim linear mbi zhvillimet politike të kohës sonë, as si inventar krizash që kërkojnë korrigjim teknik. Ai i drejtohet lexuesit si subjekt historik, i vendosur përballë një epoke, ku rendi i njohur po shpërbëhet dhe ku asnjë kategori e trashëguar nuk mund të merret më e mirëqenë. Në këtë kuptim, “*Metamorfoza e demokracisë - shteti në dritën e gjeopolitikës kritike*” nuk është thjesht analizë, por thirrje për vetëdije politike.

Ne jetojmë në një kohë, kur demokracia vazhdon të përmendet me zell, por gjithnjë e më rrallë kuptohet si formë reale e pushtetit. Ajo përdoret si simbol moral, si etiketë legjitimuese, si gjuhë rituale e institucioneve, por gjithnjë e më pak si mekanizëm i aftë për të mbrojtur shoqëritë nga rreziku ekzistencial. Ky libër nis pikërisht aty ku mbaron diskursi konvencional: te pyetja nëse demokracia, në formën që e kemi njohur, është ende e aftë të përballojë botën që po lind. Autori nuk e trajton këtë çështje si problem teknik, por si çështje ontologjike. Demokracia këtu nuk është model institucional i eksportueshëm, por produkt historik i një rendi të caktuar ndërkombëtar, rend i cili sot është duke u shembur. Me rënien e këtij rendi, bie edhe iluzioni se politika mund të çlirohet nga konflikti, se sovraniteti mund të zëvendësohet nga procedura dhe se siguria mund të delegohet pafundësisht. Kjo është arsyeja pse libri flet për *metamorfozë* dhe jo për *krizë*. Kriza presupozon kthim në normalitet; metamorfoza presupozon ndryshim të natyrës së

vetë formës politike. Demokracia nuk po dështon, sepse është keqmenaxhuar. Ajo po transformohet, sepse kushtet që e bënë të mundur formën e saj liberale janë zhdukur. Lufta, rivaliteti strategjik, rikthimi i fuqisë si kategori themelore e politikës dhe fragmentimi i rendit global e kanë zhveshur demokracinë nga mburoja e saj historike.

Në këtë kontekst, shteti nuk mund të mbetet më administrator neutral i ligjit. Ai kthehet në atë që gjithmonë ka qenë në momentet kufitare të historisë: instrument i mbijetesës kolektive. Ky libër e rikthen shtetin në qendër të mendimit politik jo për ta idealizuar, por për ta shpëtuar nga reduktimi teknokratik, që e ka shndërruar në aparat pa vullnet. Sovraniteti këtu nuk është kategori juridike, por aftësi për të marrë vendim në kushtet e pasigurisë. Megjithatë, autori nuk bie në grackën e apologjisë së fuqisë së zhveshur. Përkundrazi, një nga tensionet më produktive të librit është përpjekja për të ribashkuar dy dimensionet, që moderniteti i vonë i ka ndarë artificialisht: demokraci dhe fuqi. Demokracia pa fuqi reduktohet në ritual; fuqia pa demokraci degjeneron në dhunë. Metamorfoza që analizohet këtu është përpjekje për të ndërtuar një rend, ku këto dy pole nuk e përjashtojnë, por e kushtëzojnë njëri-tjetrin.

Në këtë horizont duhet kuptuar edhe ideja e Federatës Shqiptare, e cila nuk shfaqet si projekt identitar apo nostalgjik, por si përgjigje strategjike ndaj dobësisë strukturore. Fragmentarizimi politik shqiptar nuk trajtohet si padrejtësi abstrakte, por si rrezik konkret, në një botë ku shtetet e vogla mbijetojnë vetëm përmes kohezionit. Federata, në këtë kuptim, nuk është mit kombëtar, por arkitekturë pushteti, mekanizëm koordinimi sovranitetesh dhe formë e re e subjektivitetit politik në rajon. Ballkani Perëndimor, i analizuar në këtë libër, del nga statusi i periferisë problematike dhe shfaqet si hapësirë ku manifestohet kriza strategjike europiane. Dështimi për të prodhuar stabilitet nuk vjen nga mungesa e dialogut, por nga mungesa e vizionit politik. Tolerimi i agresionit, relativizimi i drejtësisë dhe obsesioni me menaxhimin e krizave e kanë shndërruar rajonin në laborator të pasigurisë së qëndrueshme. Në këtë kontekst, Kosova nuk paraqitet si demokraci e

papjekur, por si demokraci rezistence. Demokraci që ekziston nën presion, që nuk ka luksin e neutralitetit dhe që çdo vendim e merr nën hijen e rrezikut ekzistencial. Ky është një nga kontributet më origjinale të librit: çlirimi i demokracisë nga idealizimi konsensual dhe rikthimi i saj në terrenin real të historisë.

Lufta në Ukrainë, e trajtuar në këtë vepër, shërben si zbulesë paradigmatiche. Ajo ka rrëzuar iluzionin e rendit normativ global dhe ka treguar se normat ekzistojnë vetëm aty sa ka vullnet dhe kapacitet për t'i mbrojtur. Në këtë kuptim, lufta nuk është aksident, por mekanizëm i rikompozimit të rendit botëror.

Ky libër nuk kërkon ta qetësojë lexuesin. Ai nuk ofron receta dhe nuk premteton stabilitet. Përkundrazi, ai e vendos lexuesin përballë një zgjedhjeje themelore: ose të vazhdojë të mendojë politikën si menaxhim të së tashmes, ose ta pranojë atë si fat historik që kërkon vendim, vizion dhe guxim. *Metamorfoza e demokracisë* është, në thelb, një akt i mendimit sovran. Një përpjekje për t'i kthyer politikës dinjitetin e saj tragjik dhe për ta çliruar demokracinë nga iluzioni se mund të mbijetojë pa u transformuar. Ky libër nuk kërkon pajtim. Ai kërkon zgjim. Libri *Metamorfoza e demokracisë - shteti në dritën e gjeopolitikës kritike* nuk mund të lexohet brenda kornizës së zakonshme të analizës politologjike. Çdo përpjekje për ta futur në kategoritë standarde të teorisë demokratike do të ishte reduktim konceptual. Sepse kjo vepër nuk analizon një krizë funksionale të demokracisë, por shpërfaq një krizë ontologjike të vetë politikës moderne. Autori e vendos demokracinë jo në raport me idealin normativ, por në raport me kushtet e mundësisë së saj historike. Pyetja që përshkon librin nuk është: *si ta përmirësojmë demokracinë?*, por a është ende demokracia forma e duhur e pushtetit, në një botë ku politika ka rifituar dimensionin e saj ekzistencial? Kjo pyetje e nxjerr mendimin nga rehatia liberale dhe e vendos në territorin e rrezikut teorik, aty ku politika nuk është më çështje procedurash, por çështje mbijetese. Një nga shtyllat më subversive të librit është çmontimi i idesë se demokracia mund të ekzistojë si rend neutral, i shkëputur nga konflikti

dhe nga fuqia. Autori e ekspozon demokracinë procedurale si një formë postpolitike, e ndërtuar mbi mohimin e armikut, mbi zhdukjen e antagonizmit dhe mbi besimin se ligji mund të zëvendësojë vendimin. Por historia e shekullit XXI, lufta, përshkallëzimi, rivaliteti global, ka treguar se politika që refuzon të njohë konfliktin, e fton atë në formën më brutale. Demokracia që nuk e mendon rrezikun, prodhon dobësi; dhe dobësia në politikë nuk është gjendje morale, por ftesë për dominim. Këtu libri bën një kthesë të fortë teorike: ai sugjeron se demokracia moderne ka jetuar për dekada mbi sigurinë e deleguar, mbi faktin se dikush tjetër garantonte kufijtë, rendin dhe paqen.

Me rënien e kësaj garancie, demokracia e zhveshur nga fuqia zbulohet si formë e pambrojtur. Evidenca e debatit në këtë libër shihet edhe në aspektin se si duhet t'i qasemi çështjes fundamentale, pra asaj mes shtetit dhe procedurës, e që me të drejtë shtron dilemën se është shteti si vendim, jo si procedurë. Në këtë kontekst, shteti nuk mund të mbetet më administrator i normës. Autori e rimendon shtetin si vendim politik në kushtet e pasigurisë, si strukturë që ekziston për të marrë përgjegjësinë e rrezikut kolektiv. Kjo është një kthesë e thellë kundër mendimit juridik, që e ka reduktuar shtetin në aparat rregullash. Shteti, në këtë libër, nuk legjitimohet nga neutraliteti, por nga aftësia për të mbrojtur ekzistencën politike të bashkësisë. Ky është një konceptim që e vendos sovranitetin jo në tekst kushtetues, por në kapacitetin për të vepruar në situata kufitare. Por ky nuk është rehabilitim i autoritarizmit. Përkundrazi, autori ndërton një tension produktiv mes dy poleve:

- fuqia që nuk kontrollohet, shndërrohet në dhunë;
- demokracia që nuk mbrohet, shndërrohet në iluzion.

Metamorfoza që ai propozon është ribashkim i këtyre dy dimensioneve që moderniteti liberal i ka ndarë artificialisht duke e vendosur Politikën si fat, jo si menaxhim. Një element thelbësor i librit është refuzimi i konceptit të politikës si menaxhim racional i interesave. Autori e rikthen politikën në dimensionin e saj tragjik: si hapësirë ku vendimet

merren pa garanci, ku çdo zgjedhje ka kosto ekzistenciale dhe ku neutraliteti është vetë një zgjedhje politike. Kjo e bën librin thellësisht anti-teknokratik. Ai e sheh teknokracinë jo si zgjidhje, por si formë të shtyrjes së vendimit, si mekanizëm për të shmangur përgjegjësinë historike. Në këtë kuptim, demokracia teknokratike shfaqet si formë e shtyrjes së konfliktit, jo e zgjidhjes së tij. Ideja e Federatës Shqiptare në këtë libër nuk është projekt identitar, por akt sovran kolektiv. Ajo lind nga vetëdija se fragmentimi politik është formë e dobësisë ontologjike. Autori e lexon kombin jo si entitet sentimental, por si subjekt politik që ose vepron në mënyrë të bashkërenduar, ose zhduket nga historia aktive. Federata këtu nuk është mit, por arkitekturë pushteti. Ajo nuk synon të krijojë identitet, por të prodhojë kapacitet veprimi. Ky është një ndryshim rrënjësor nga nacionalizmi romantik: kombi nuk është kujtesë, por projekt strategjik. Në analizën e Kosovës, libri artikulon një koncept të ri: demokracia e rezistencës. Kjo nuk është demokraci konsensuale, por demokraci që ekziston nën presion konstant, që nuk ka luksin e neutralitetit dhe që çdo zgjedhje e bën në hijen e rrezikut. Këtu demokracia nuk është formë e paqes, por formë e qëndrimit përballë kërcënimit. Ky është një koncept i ri në mendimin politik shqiptar dhe më gjerë, sepse e çliron demokracinë nga idealizimi dhe e vendos në terrenin real të historisë.

Ky libër nuk është thjesht analizë. Ai është akt mendimi sovran. Ai refuzon të jetë komod, refuzon të jetë i pëlqyeshëm dhe refuzon të jetë neutral. Ai kërkon nga lexuesi jo miratim, por përgjegjësi. Demokracia, pas këtij libri, nuk mund të mendohet më si dhuratë morale. Ajo shfaqet si barrë historike, si formë pushteti që duhet mbrojtur, rimenduar dhe, nëse është e nevojshme, transformuar rrënjësisht për të mbijetuar. Kjo vepër nuk pyet se *çfarë nuk po funksionon në demokraci*, por shtron një pyetje shumë më radikale dhe më të rrezikshme për mendimin liberal: *çfarë është bërë demokracia kur rendi që e prodhoi atë po shembet?* Që në këtë pikë, Ramabaja e zhvendos debatin nga niveli normativ (ku demokracia gjykohet sipas standardeve morale) në nivelin ontologjik, ku demokracia trajtohet si

formë historike e pushtetit, e kushtëzuar nga raportet e forcës, nga arkitektura e sigurisë dhe nga koniunkturat gjeopolitike. Kjo e bën librin jo vetëm kritik, por subversiv ndaj konsensusit akademik pas Luftës së Ftohtë.

Një nga tezat themelore (dhe më tronditëset) të këtij libri është se demokracia liberale nuk po kalon krizë, por po humb statusin e saj si formë universale e organizimit politik. Ky dallim është vendimtar. Kriza presupozon rikthim; humbja e statusit ontologjik presupozon transformim ose zhdukje. Ramabaja argumenton se demokracia pas vitit 1991 u ndërtua mbi një keqkuptim historik monumental: besimin se politika mund të çlirohej nga konflikti, se fuqia mund të zëvendësohej nga norma dhe se gjeopolitika mund të zëvendësohej nga globalizmi ekonomik dhe menaxhimi teknokratik.

Ky projekt prodhoi një demokraci procedurale, por strategjikisht të çarmatosur, një rend që dinte të administronte zgjedhje, por jo rreziqe ekzistenciale. Metamorfoza që analizon Ramabaja nuk është as degradim moral, as devijim autoritar, por përplasje mes një forme politike të vjetruar dhe një realiteti historik brutal. Në një botë ku lufta rikthehet si instrument legjitim, ku sovraniteti matet me kapacitet mbrojtjeje dhe ku aleancat janë fluide, demokracia që refuzon të mendojë fuqinë shndërrohet në luks të pambrojtur.

Një nga kontributet më origjinale të këtij libri është rikonceptimi i shtetit jo si garant neutral i rendit juridik, por si subjekt strategjik i mbijetesës kolektive. Ramabaja e sfidon drejtpërdrejt konceptin liberal të shtetit minimal dhe të depolitizuar, duke treguar se ky model funksionon vetëm në kushte sigurie të garantuara nga të tjerët. Në kushtet e sotme, shteti që nuk mendon sigurinë, fuqinë, parandalimin dhe pozicionimin gjeopolitik, pushon së qeni shtet sovran, pavarësisht fasadës kushtetuese. Këtu sovraniteti nuk përkufizohet si kategori juridike, por si funksion dinamik i aftësisë për të mbijetuar në një rend konfliktual. Autori arrin një ekuilibër të rrallë teorik: ai refuzon njëkohësisht fetishizimin liberal të ligjit dhe cinizmin realist të fuqisë së zhveshur. Demokracia, sipas tij, nuk duhet të militarizohet, por të

ribëhet strategjike; fuqia nuk duhet të absolutizohet, por të demokratizohet. Ky është një pozicion teorik jashtë skemave klasike të realizmit dhe të liberalizmit.

Federata Shqiptare

Ideja e Federatës Shqiptare përfaqëson pikën, ku mendimi teorik i librit kalon në projekt historik konkret. Ajo lëviz nga harku i idesë identitare në arkitekturë gjeopolitike. Por ajo që e bën këtë ide të veçantë, është fakti se nuk ndërtohet mbi nostalgji kombëtare, por mbi logjikën e ftohtë të mbijetesës politike në një rajon armiqësor. Ramabaja argumenton se fragmentarizimi shqiptar nuk është thjesht padrejtësi historike, por dobësi strukturore. Në një rend botëror, ku shtetet e vogla mbijetojnë vetëm përmes kohezionit strategjik, shqiptarët e fragmentuar mbeten objekt, jo subjekt i gjeopolitikës. Federata, në këtë kuptim, nuk është projekt homogjenizues, por mekanizëm koordinimi të sovraniteteve, një formë e re e shtetit-kompozitë, që u përgjigjet realiteteve të shekullit XXI. Kjo nxjerr mendimin shqiptar nga romantizmi nacional dhe e vendos në terrenin e teorisë së sigurisë dhe të integritimit politik funksional.

Në analizën e Ballkanit Perëndimor, libri arrin një nivel, që rrallë shihet në literaturën rajonale. Ballkani shihet si hapësirë eksperimentale e dështimit europian. Rajoni nuk paraqitet si “problem i pazgjidhur”, por si pasojë e drejtpërdrejtë e krizës strategjike europiane. Dialogët e pafund, kompromiset asimetrike dhe tolerimi i agresionit shfaqen si simptoma të një Europe, e cila ka humbur aftësinë për të menduar politikisht. Serbia, në këtë aspekt, konceptualizohet si aktor destabilizues racional, jo si devijim aksidental. Autori e lexon atë përmes nocionit të “deep state”-it ballkanik, duke treguar se destabiliteti nuk është dështim, por instrument pushteti. Kosova përballë kësaj strukture shfaqet si demokraci rezistence, jo si demokraci konsensuale. Kjo është një nga risitë më të forta teorike të librit: demokracia nuk përkufizohet më si harmoni, por si aftësi për të qëndruar në kushte rrethimi.

Ukraina dhe fundi i rendit normativ

Lufta në Ukrainë interpretohet jo si devijim, por si moment zbulimi i natyrës reale të rendit ndërkombëtar. Ramabaja e lexon këtë konflikt si pikë ku bien të gjitha tabutë: mbi luftën, mbi sovranitetin, mbi moralin global. Lufta në Ukrainë, në këtë libër, nuk është ngjarje, por zbulim. Ajo e zhvesh rendin ndërkombëtar nga retorika morale dhe e ekspozon si fushë force. Normat nuk zhduken, por varen nga kapaciteti për t'i mbrojtur. Kjo e çon librin drejt një përfundimi të ashpër, por realist: rendi botëror nuk po reformohet, ai po rikompozohet përmes konfliktit. Këtu, Përfundimi nuk paraqitet as hero, as fajtor, por i pavendosur ontologjikisht: i kapur mes frikës nga përshkallëzimi dhe paaftësisë për të mbrojtur normat, të cilat po vetë i ka shpallur universale. Ky tension e shndërron Ukrainën në laborator të rendit të ri botëror.

“Metamorfoza e demokracisë” nuk është libër që kërkon dakordësi, por kërkon vetëdije. Nuk fton në rehati morale, por në përgjegjësi historike. Është tekst që e sheh mendimin politik jo si luks akademik, por si instrument mbijetese kolektive. *Ky libër shënon një kthesë të rrallë në mendimin politik shqiptar: nga reagimi te projekti, nga viktimizimi te strategjia, nga retorika tek arkitektura e pushtetit. Ai nuk është thjesht libër për demokracinë, është libër për çmimin e ekzistencës politike në një botë pa garanci.*

Prandaj libri “Metamorfoza e demokracisë - shteti në dritën e gjeopolitikës kritike” i dr. Sadri Ramabajës përfaqëson një ndërhyrje të rrallë dhe substanciale në mendimin politik bashkëkohor shqiptar dhe më gjerë, duke u pozicionuar jo thjesht si analizë e zhvillimeve aktuale, por si një vepër teorike me ambicie paradigmatiche, që synon rikonceptimin e demokracisë në kushtet e transformimit rrënjësor të rendit ndërkombëtar. Që në titull, autori e bën të qartë se nuk kemi të bëjmë me një studim mbi “krizën e demokracisë” në kuptimin konvencional, por me një proces metamorfoze, pra me një kalim ontologjik nga një formë historike e demokracisë drejt një forme tjetër ende të pakonsoliduar. Ky pozicionim teorik e nxjerr veprën nga

kornizat e diskursit normativ liberal dhe e vendos në territorin e gjeopolitikës kritike, ku demokracia nuk trajtohet më si vlerë abstrakte universale, por si mekanizëm historik i mbijetesës politike.

Një nga meritat themelore të këtij libri qëndron në çmontimin sistematik të mitologjisë pas vitit 1991, sipas së cilës demokracia liberale përfaqësonte stadin përfundimtar të evolucionit politik. Ramabaja e sfidon drejtpërdrejt këtë tezë, duke argumentuar se demokracia e reduktuar në procedurë, në ritual elektoral dhe në formalizëm juridik ka humbur aftësinë për të prodhuar siguri, konsensus dhe legjitimitet real. Në këtë kuptim, “metamorfoza” nuk është as regres dhe as devijim, por përgjigje strukturore ndaj rikthimit të fuqisë si kategori qendrore e politikës botërore. Autori demonstroi se gjeopolitika, e shpallur dikur e tejkaluar nga globalizmi dhe teknokracia, është rikthyer si bosht përcaktues i fatit të shteteve dhe demokracive. Kjo e bën të pamundur mbijetesën e një demokracie të shkëputur nga kapaciteti strategjik dhe nga fuqia reale.

Një nga kontributet më të thella teorike të veprës është rikonceptimi i shtetit. Ramabaja e zhvendos shtetin nga pozicioni i një administratori neutral të procedurave drejt rolit të njësisë themelore të mbijetesës kolektive. Në kushtet e luftës hibride, presionit ekonomik, manipulimit informativ dhe rivaliteteve gjeopolitike, shteti nuk mund të mbetet aparat teknik; ai duhet të shndërrohet në subjekt strategjik. Ky argument e vendos librin në dialog kritik me traditën liberale perëndimore, duke e afruar më shumë me mendimin realist dhe post-realist, por pa rrëshqitur në apologji të autoritarizmit. Përkundrazi, autori ngul këmbë se demokracia dhe fuqia nuk janë kategori përjashtuese, por komplementare: pa fuqi, demokracia zbrazet; pa demokraci, fuqia degjeneron.

9. 2 ARGUMENTE SHTERUESE KUNDËR IDESË ANTIISTORIKE TË TË ASHTUQUAJTURIT “KOMB KOSOVAR”

Nga Bedri Halimi, shkrimtar, studiues

Dr. Xhevat Hasani: “S’ka dhe s’mund të ketë komb kosovar (kundër ideve kombndarëse të N. Spahiut)

Prolog

Ka kohë që në opinionin shqiptar, e në veçanti në Kosovë, disa individë që mund të numërohen me gishtërinjtë e njëres dorë, kanë lansuar një tezë problematike për çështjen kombëtare shqiptare në përgjithësi, e në veçanti për shqiptarët në Kosovë. Një ndër ta është edhe Nexhmedin Spahiu, i cili këtë tezë për krijimin e “kombit kosovar” përpiqet ta promovojë në çdo hapësirë publike ku i jepet mundësia.

Ai nuk është ndalur vetëm në deklarime sporadike, por është përpjekur ta artikulojë këtë ide edhe në disa libra të tij. Ndërkohë, një pjesë e intelektualëve e kanë injoruar këtë tezë, duke e konsideruar si të pabazë dhe të paqenë. Megjithatë, një sërë intelektualësh e kanë parë të domosdoshme t’i kundërvihen në mënyrë argumentuese kësaj ideje prapavajtëse.

Një ndër ta është edhe dr. Xhevat Hasani, i cili në veprën e tij “S’ka dhe s’mund të ketë komb kosovar” bën një analizë të thelluar dhe sistematike për ta rrëzuar këtë tezë të rrezikshme. Pra, në hapësirën publike shqiptare, herë pas here rikthehet kjo tezë nga bartësi i saj, që, megjithëse e varfër në baza shkencore, kërkon të imponohet me këmbëngulje: ideja për ekzistencën apo krijimin e një “kombit kosovar”, e që nismëtari i saj e ka kthyer këtë tezë në mision personal publik. Problemi nuk është thjesht ekzistenca e një ideje të gabuar. Problemi është përpjekja për ta paraqitur atë si alternativë serioze shkencore, madje si realitet në ndërtim. Pikërisht këtu ndërhyr dr. Xhevat Hasani me librin e tij “S’ka dhe s’mund të ketë komb kosovar”, në të cilin nuk merret me retorikë boshe, por me argumente konkrete.

Shkërmoqja fundamentale e tezës për “kombin kosovar”

Dr. Xhevat Hasani e çmonton këtë tezë, duke e trajtuar siç është: një konstrukt artificial pa mbështetje historike, juridike dhe sociologjike. Ai tregon se kemi të bëjmë me një përpjekje për të krijuar një realitet politik përmes përsëritjes, jo përmes provës. Në këtë kuptim, libri i dr. Xhevat Hasanit është më shumë se kritikë: është demaskim. Ai nxjerr në pah mekanizmin e zakonshëm të propagandës, përdorimin selektiv të gjërave, keqinterpretimin e koncepteve dhe analogjitë e rreme. Dr. Xhevat Hasani në këtë vepër bën një analizë të detajuar, duke i demaskuar të gjitha të ashtuquajturat “argumente” të Nexhmedin Spahiut. Ai i trajton ato si manipulime të qëllimshme, të cila synojnë krijimin e një realiteti artificial politik. Hasani argumenton pse një ide e tillë është e paqëndrueshme, duke theksuar pasojat e mundshme negative, si përçarja e raportit Kosovë-Shqipëri dhe dobësimi i identitetit kombëtar shqiptar në Ballkan. Ka ide që mund t’i diskutosh pafund. Ka dhe ca ide të tjera, që thjesht duhet t’u thuash nuk qëndrojnë. Nga argumentet e shumta të dr. Xhevat Hasanit, del se ideja e “kombit kosovar” është një prej tyre që nuk qëndron. Në këtë rast, dr. Xhevat Hasani nuk bën kompromis me paqartësinë. Ai e thotë troç: kjo tezë nuk qëndron, duke sjellë argumente të shumta.

Kundërshtimi i keqinterpretimeve kushtetuese dhe juridike

Një nga shtyllat kryesore të argumentimit të dr. Xhevat Hasanit është demaskimi i keqinterpretimeve të Kushtetutës së Kosovës. Ai tregon se përdorimi i termi “komb” në kontekste të caktuara institucionale nuk nënkupton ekzistimin e një “kombit kosovar”. “Simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës janë: flamuri, stema dhe himni”. Ky citim përdoret për të sqaruar dallimin midis identitetit shtetëror dhe atij kombëtar, duke hedhur poshtë interpretimet e shtrembëruara, të cilat tentojnë t’i barazojnë këto dy kategori. Pra, dr. Xhevat Hasani e rikthen temën në binarë racionalë: shteti dhe kombi nuk janë kategori identike. Identiteti shtetëror nuk prodhon automatikisht një identitet të ri kombëtar.

Argumentet historike dhe ndërkombëtare kundër kësaj teze prapavajtëse

Një tjetër argument e bën këtë ide të bjerë po aq lehtë është se nuk ekziston asnjë dokument ndërkombëtar, që kërkon apo sugjeron krijimin e një “kombit kosovar”. Përkundrazi, thekson dr. Xhevat Hasani, “Subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës nuk varet nga kombi joekzistues “kosovar”. Kjo e zhvesh tezën nga çdo pretendim serioz. Shtetet njihen si subjekte juridike ndërkombëtare, pa pasur nevojë të shpikin kombe të reja. Pra, dr. Xhevat Hasani argumenton bindshëm, se asnjë dokument ndërkombëtar nuk kërkon krijimin e një “kombi kosovar”. Ai, gjithashtu, përmes shembujve krahasues (si: Gjermania, Vietnami apo vendet arabe), argumenton se ekzistenca e më shumë shteteve nuk nënkupton domosdoshmërisht krijimin e kombeve të reja. Pretendimi bie që në themel. Nuk ke nevojë të shpikësh një komb për të pasur shtet.

Keqpërdorimi i teorive (gjermane dhe franceze): një akrobaci e keqpërdorimeve teorike

Një nga elementet më problematike është përdorimi i teorive mbi kombin. Dr. Xhevat Hasani tregon se këtu kemi të bëjmë me një përzierje të pasaktë dhe të qëllimshme. “Thënie se, sipas teorive franceze, kombet janë krijesa artificiale, vlejnë për kombet multietnike...” Pra, teoritë që citohen nga Spahiu nuk mbështesin tezën për idenë e “kombit kosovar”, por e rrëzojnë atë. Ato aplikohen jashtë kontekstit, në një përpjekje për të krijuar një iluzion akademik. Ndërkaq, autori dr. Xhevat Hasani trajton në mënyrë të veçantë keqpërdorimin e teorive mbi kombin. Ai argumenton se teoritë gjermane mbi kombin mbështesin konceptin e kombeve monoetnike, ndërsa teoritë franceze vlejnë kryesisht për kombe multietnike të krijuara politikisht.

Kjo ndarje teorike shërben për të treguar se koncepti i “kombit kosovar” nuk gjen mbështetje në asnjërën prej këtyre botëkuptimeve. Këtu ndodh një tjetër shtrembërim: teoritë për kombin përdoren jashtë

kontekstit. Pra, vetë teoritë që citohen nuk mbështesin tezën e pretenduar, por e rrëzojnë atë.

Demantimi i manipulimeve simbolike dhe kulturore

Një tjetër dimension i kësaj teze është përdorimi i gjuhës simbolike si argument politik. Dr. Xhevat Hasani e përkufizon saktë këtë devijim: “Me simbolika dhe metafora bëhet letërsi, por nuk mund të krijohet ndonjë komb i ri”.

Kjo është një vijë ndarëse thelbësore: letërsia mund të frymëzojë, por nuk mund të zëvendësojë historinë dhe realitetin shoqëror. Kjo vë në pah kufirin midis diskursit letrar dhe realitetit politik. Kjo duhet të ishte e vetëkuptueshme. Por kur mungojnë faktet, metaforat fillojnë të përdoren si zëvendësim i tyre.

Analogjitë e rreme: kur historia keqpërdoret

Përpyekjet për të legjitimuar tezën përmes shembujve të tjerë bien po ashtu.

Historia nuk është katalog analogjish të gatshme. Çdo proces kombformimi ka kontekstin e vet. Krahasimet e sipërfaqshme janë më shumë mashtrim sesa argument. Kështu, dr. Xhevat Hasani u kundërvihet analogjive të pasakta historike, si rasti i kombit malazez, moldav, austriak etj., duke argumentuar se këto procese historike kanë kontekste të ndryshme dhe nuk mund të përdoren si modele për Kosovën. Historia nuk është meny ku zgjedh shembuj që të leverdisin. Çdo rast ka kontekstin e vet.

Nga ide në propagandë

Dr. Xhevat Hasani nuk ndalet vetëm tek analiza teorike. Ai e vendos këtë fenomen në një kontekst më të gjerë pragmatik, kur thotë: “*Askush nuk ka të drejtë, që fantazitë e tij figurative t’ua imponojë të tjerëve si fakte të kryera...*”

Ky është thelbi i këtij farë debati të paqenë, por të pretenduar: kur një ide e pabazë kërkon të shndërrohet në normë përmes imponimit.

Pra, autori dr. Xhevat Hasani analizon edhe përpjekjet për institucionalizimin e kësaj ideje përmes botimeve të ndryshme.

Ky dimension nxjerr në pah përplasjen midis realitetit shkencor dhe diskursit propagandistik. Përdoren terma akademikë, përmenden modele ndërkombëtare, por në thelb kemi një përpjekje për të krijuar një realitet që nuk ekziston. Të gjitha këto pretendime Xhevat Hasani i çmonton hap pas hapi. Ai tregon se “argumentet” janë selektive, analogjitet të sforcuara dhe përfundimet të parapërcaktuara. Problemi nuk është vetëm ideja. Problemi është tentimi për ta imponuar atë si fakt. Kjo është pika, ku çështja bëhet serioze: kur një narrativë e pabazë kërkon të zëvendësojë realitetin.

Kujtesa historike si vijë e kuqe

Një nga argumentet më të fuqishme lidhet me historinë konkrete të shqiptarëve në Kosovë, ku dr. Xhevat Hasani decidivisht thotë: *“Ekzistenca e shtetit të Kosovës varet nga ekzistenca e kombit shqiptar...”*. Ky nuk është vetëm argument historik, por edhe politik e etik. Ai e vendos debatin në një terren, ku faktet nuk mund të relativizohen. Ky argument e lidh drejtpërdrejt identitetin shtetëror me atë kombëtar historik. Historia e Kosovës nuk filloi dje. Ajo është e lidhur drejtpërdrejt me historinë e shqiptarëve. Kjo nuk është çështje interpretimi, është fakt.

Rikapitullim i tezave kryesore të veprës

Në pjesën përmbyllëse, autori sintetizon argumentet kryesore, duke theksuar rolin e përkatësisë etnike, vetëdijes kombëtare, historisë së përbashkët, bashkëpunimit kulturor Kosovë-Shqipëri.

Në vend të përfundimit: një tezë që shembet nën peshën e vet

Në fund, ajo që duhet të theksohet është se një tezë e tillë e “kombit kosovar” është ide që nuk qëndron. Ajo nuk ka bazë historike, nuk ka mbështetje teorike dhe nuk ka legjitimitet juridik. *“Idetë lineare njëdimensionale sa herë nuk përputhen me rezultatin objektiv, janë ide*

të gabuara...”, thekson dr. Xhevat Hasani. Libri “S’ka dhe s’mund të ketë komb kosovar” i dr. Xhevat Hasanit nuk është thjesht një kundërpërgjigje. Ai është një ndërhyrje e domosdoshme në një debat të qëllimtë, që nuk duhet lënë në duart e retorikës. Në një kohë kur konceptet themelore si *kombi* dhe *identiteti* tentohen të relativizohen për interesa të ngushtë, kjo vepër rikthen standardin: argumentin mbi propagandën, faktin mbi spekulimin dhe historinë mbi improvizimin. Dhe pikërisht për këtë arsye, ky libër mbetet një nevojë për një lexim të domosdoshëm rreth kësaj ideje paravajtëse historike për kombin shqiptar. Pra, autori dr. Xhevat Hasani në këtë libër sintetizon gjithë argumentimin e veprës, duke e vendosur debatin në një kornizë racionale dhe shkencore.

Epilog

Ky shkrim analitik dëshmon se libri i dr. Xhevat Hasanit përbën një kundëragumentim të fuqishëm ndaj tezës për “kombin kosovar”. Përmes një kombinimi të argumenteve historike, juridike dhe teorike, ai arrin të ndërtojë një kritikë të qëndrueshme dhe të artikuluar ndaj kësaj ideje. Në këtë kuptim, vepra e dr. Xhevat Hasanit nuk është vetëm një reagim polemik, por një ndërhyrje e rëndësishme në diskursin shkencor dhe publik mbi identitetin kombëtar shqiptar. Kjo nuk është çështje për t’u relativizuar. Nuk është çështje “opinionesh të ndryshme”. Ka ide që duhen sfiduar drejtpërdrejt, sepse janë të pasakta. Libri i dr. Xhevat Hasanit e bën këtë pa ngurrim. Dhe kjo është arsyeja pse duhet lexuar: jo për polemikë, por për qartësi. Një shoqëri që nuk mbron të vërtetën, rrezikon të mësohet me të pavërtetën. Ajo që nuk duhet harruar në veprën “S’ka dhe s’mund të ketë komb kosovar”, është se “ekzistenca e shtetit të Kosovës varet nga ekzistenca e kombit shqiptar...”. Kjo nuk është thjesht tezë. Është përvojë historike. Është diçka që është jetuar, jo vetëm shkruar. Në fund, duhet të sqarojmë se, në disa raste gjatë leximit të librit, disa argumente janë përsëritur. Por, duke e pasur parasysh kompleksitetin dhe rrezikun e keqinterpretimeve rreth kësaj ideje të mbrapshtë, autori nuk i ka shmangur këto përsëritje, sepse

shumë nga keqinterpretimet janë bërë në forma e variante nga më të ndryshmet, prej bartësit të kësaj ideje.

Prandaj autori, pos që është i vetëdijshëm për këtë çështje, e ka konceptuar librin në atë formë, që edhe lexuesi më i thjeshtë të mund ta kuptojë se përse bëhet fjalë. Autori i ka sqaruar gjërat aq bindshëm, saqë edhe lexuesi i thjeshtë, mjafton të lexojë vetëm një kapitull të këtij libri, dhe ta kuptojë se sa e rrezikshme dhe e mbrapshtë është ideja e ashtuquajtur e “kombit kosovar”, që po përpiqet të përhapet në mesin e shqiptarëve në Kosovës.

9.3 RIKONCEPTUALIZIMI I ZHVILLIMIT POLITIK SHQIPTAR: HISTORIA LIGJORE, VAZHDIMËSIA INSTITUCIONALE DHE E ARDHMJA E SHTET-KOMBIT

Nga dr. Sadri Ramabaja

***Recension për librin “Organizimi politik në trojet shqiptare”, të
prof. dr. Ksenofon Krisafit***

1. Hyrje

Vepra “*Organizimi politik në trojet shqiptare*” e profesor Ksenofon Krisafit përfaqëson një ndër ndërmarrjet më të plota studimore në historiografinë juridiko-politike shqiptare, duke synuar të rindërtojë evolucionin institucional dhe politik të shqiptarëve në një hark të gjatë kohor historik, nga antikiteti deri në zhvillimet bashkëkohore. Botuar nga “UET Press” në vitin 2014, libri përbën një sintezë të rrallë ndërdisiplinore midis historisë politike, së drejtës publike dhe analizës së marrëdhënieve ndërkombëtare.

Bazuar në leximin kritik të historisë në rrafshin ndërkombëtar, çështja shqiptare pas çlirimit të Kosovës (1999), por sidomos pas pavarësimit të saj (2008), konsiderohet si e zgjidhur. Por, ndërkohë, këtë lexim kritik të historisë dhe këtë vlerësim po e vënë në pikëpyetje si qarqe të veçanta akademike europiane, ashtu edhe ato diplomatike, që e njohin këtë çështje më në themel.

Ndër qarqet akademike shqiptare pohimi i këtij fakti nuk ka munguar, por kanë munguar në masë të ndjeshme idetë se si do të duhej të zgjidhej kjo çështje tashmë, pasi ishte bërë një hap kolosal me çlirimin e Kosovës.

Një nga ata, që me përkushtim të veçantë i ishte kthyer kësaj teme në shkrimet me karakter hulumtues, ndoshta një zë nga më të veçantit, është gjithsesi autori i këtij libri, prof. Ksenofon Krisafi.

2. Metodologjia: ndërthurja e historisë me të drejtën

Krisafi vjen në këtë studim me një bagazh të konsoliduar akademik dhe diplomatik në fushën e së drejtës ndërkombëtare publike dhe diplomacisë, çka ndikon drejtpërdrejt në mënyrën se si konceptohet objekti i analizës: organizimi politik nuk trajtohet thjesht si fenomen historiografik, por si proces juridiko-institucional i ndërtimit të sovranitetit.

Një nga vlerat më të spikatura të librit është metodologjia ndërdisiplinore. Qasja metodologjike e autorit ndërthur:

- analizën historike dokumentare,
- interpretimin juridiko-kushtetues,
- perspektivën e së drejtës ndërkombëtare,
- analizën e zhvillimeve diplomatike, që kanë ndikuar në formimin politik shqiptar.

Studimet e përfshira në libër karakterizohen si kërkime të mirëfillta juridiko-ndërkombëtare dhe kushtetuese, të mbështetura në një dokumentacion të gjerë historik dhe normativ. Kjo metodë i lejon autorit të identifikojë elemente juridike në zhvillimet historike shqiptare dhe të rindërtojë evolucionin institucional të iliro-shqiptarëve në një horizont dymijëvjeçar.

Në këtë mënyrë, historia politike shqiptare çlirohet nga interpretimet romantike apo etnografike dhe vendoset në një analizë të së drejtës dhe institucioneve.

3. Teza qendrore e veprës

Teza themelore e Krisafit është se organizimi politik i shqiptarëve nuk është fenomen i vonshëm i shekullit XIX apo produkt ekskluziv i shtetformimit modern, por një proces historik i vazhdueshëm institucional, i cili shfaqet në forma të ndryshme politike përgjatë dy mijëvjeçarëve.

Autori argumenton se:

- strukturat politike ilire dhe arbërore nuk mund të reduktohen në modele primitive apo pirate, siç është paraqitur shpesh në historiografinë tradicionale;
- shqiptarët kanë prodhuar forma të organizimit politik, të krahasueshme me qytetërimet mesdhetare bashkëkohëse;
- ndërprerjet historike nuk kanë zhdukur kontinuitetin juridik dhe institucional shqiptar.

Kjo qasje përbën një zhvendosje metodologjike të rëndësishme: historia politike nuk trajtohet më si seri shtetesh të ndërprera, por si proces institucional me vazhdimësi strukturore.

Në këtë kuptim, Krisafi i afrohet paradigmës së *longue durée* të historiografisë strukturore, duke e interpretuar organizimin politik si fenomen civilizues dhe jo thjesht si produkt të sovranitetit modern.

Kjo tezë përbën një ndër kontributet më të rëndësishme të librit, pasi sfidon narrativat reduksioniste mbi mungesën e traditës shtetformuese shqiptare.

4. Sfidimi i narrativave reduksioniste

Një nga kontributet më të rëndësishme teorike të veprës është dekonstruktimi i narrativës së “mungesës së traditës shtetformuese shqiptare”, narrativë e përhapur në historiografinë klasike ballkanike.

Krisafi argumenton se:

- organizimi politik nuk identifikohet domosdoshmërisht me shtetin territorial modern;
- ekzistenca e normave juridike, autonomive lokale dhe mekanizmave të vetëqeverisjes përbën një formë të organizimit politik;
- identiteti institucional shqiptar ka mbijetuar përmes adaptimit dhe jo përmes ndërprerjes.

Kjo perspektivë e zhvendos debatin nga pyetja “kur u krijua shteti shqiptar?” drejt pyetjes më të thellë: “Si mbijetojnë institucionet politike në mungesë të shtetit sovran?”.

5. Shtet-kombi - organizim politik modern dhe Federata Shqiptare

Debati mbi formën optimale të organizimit politik shqiptar përbën një nga çështjet më të qëndrueshme të mendimit politik në hapësirën shqiptare. Nga përpjekjet për shtetformim në shekullin XIX deri te proceset aktuale të integrimit europian, dilema themelore mbetet raporti ndërmjet shtet-kombit klasik dhe formave të reja të sovranitetit të ndarë. Në këtë kontekst, studimi i prof. Ksenofon Krisafit, “*Organizimi politik në trojet shqiptare*”, përfaqëson një analizë sistematike historiko-juridike të evolucionit institucional shqiptar, ndërkaq disertacioni im “*Federata Shqiptare - kohezioni i shtet-kombit në BE*” e zhvendos debatin nga dimensionin historik drejt një projekti normativ dhe strategjik për të ardhmen.

Këto dy vepra nuk qëndrojnë në kundërshtim, përkundrazi ato përbëjnë dy nivele të së njëjtës pyetje teorike: si transformohet shtet-kombi shqiptar në kushtet e integrimit europian dhe të rendit post-vestfalian?

Teza doktrinale e kësaj ndërthurjeje të mendimit politik shqiptar tashmë të etabluar është: ***Federata Shqiptare nuk është alternativë ndaj shtet-kombit, por faza e tij e pjekurisë politike.***

5.1 Federata Shqiptare nga analiza historike te projekti normativ

Disertacioni “*Federata Shqiptare - kohezioni i shtet-kombit në BE*” merr si pikënisje pikërisht fragmentimin historik që trajton gjerësisht profesor Krisafi dhe e interpreton atë jo si dobësi, por si potencial federalizues.¹

Në dallim nga profesor Krisafi, i cili analizon si është organizuar politika shqiptare, në disertacionin tim, përveç të tjerash, gjatë përvijimit të tezës qendrore kam parashtruar pyetjen: *si duhet të organizohet ajo në epokën e integrimit europian?* Duke e paraqitur

Federatën Shqiptare si mekanizëm kohezioni kombëtar, respektivisht model kompatibël me *acquis communautaire* dhe formë të sovranitetit funksional brenda Bashkimit European, është përvijuar teza qendrore, se në këtë mënyrë të ristrukturimit të shtetit modern shqiptar shtet-kombi nuk zhduket, por rikonfigurohet. Rrjedhimisht, mund të konkludojmë se pa analizën historike të Krisafit, projekti federal do të rrezikonte të dukej abstrakt, ndërkaq pa perspektivën e organizimit federal, historia institucionale do të mbetej retrospektive.

5.2 Nacionalizmi progresiv dhe Federata Shqiptare

Në traditën e mendimit politik european, nacionalizmi nuk ka qenë domosdoshmërisht reaksionar. Në fazën e tij liberale ai lidhej me sovranitetin popullor, barazinë qytetare dhe progresin politik, elemente këto që buruan nga nacionalizmi demokratik i Revolucionit Francez dhe ideja e vullnetit të përgjithshëm të qytetarëve. Kjo e bën të mundur konceptimin e **nacionalizmit progresiv**, si nacionalizëm qytetar, inkluziv dhe kompatibël me integrimin supranacional, pra një bazë teorike e përshtatshme për modelin federal shqiptar brenda arkitekturës europiane.²

Në fazën e zgjimit kombëtar ndër shqiptarë që kultivuar ndjenja e nacionalizmit progresiv dhe kjo vërehej sidomos në mesin e tri komuniteteve më specifike, që ishin bartëse të nacionalizmit modern shqiptar, te komuniteti katolik, ai ortodoks dhe sufrit (në mesin e shqiptarëve të përkatësisë islame), që në një mënyrë a në një tjetër ishte disi i ngjashëm me nacionalizmin gjerman të fillimeve të tij, të formuluar në mënyrë më ekzemplare të mundshme nga Johann Gottlieb Fichte. Edhe te Fichte nacionalizmi në thelb ishte progresiv, dominonte filozofia imediate e organizimit kundër armikut të jashtëm; te gjermanët i identifikuar qartë me Francën dhe francezët, në themel kishte idenë e copëtimit të hapësirës gjermane, ndërkaq në rastin tonë, ky nacionalizëm progresiv përqendrohej tek emancipimi politik i etnisë mbi rrezikun që paraqitnin idetë megalomane të shovinistëve fqinjë, para së gjithash Naçërtania e Serbisë dhe megallo-ideja e Greqisë, për të

copëtuar Shqipërinë. Të dyja këto forma të nacionalizmit progresiv theksonin elementet e përbashkësisë, si: gjuhën, lashtësinë, historinë, kulturën dhe arsimin.

Por, në dallim nga nacionalizmi polak, ai kroat, arab etj., që me kalimin e kohës ishin përmbytur nga elementi i theksuar religjioz, nacionalizmi progresiv shqiptar i kultivuar fillimisht të rilindësit tanë, me të drejtë nuk e kishte konsideruar religjionin si element bazë për ngjizjen e vetëdijes kombëtare, përkundrazi ishte përqendruar tek elementet përbashkuese: të gjuha dhe kultura, të tradita, më përpara se tek elementi etnopsikologjik dhe fryma progresive politike që po vinte nga Perëndimi, duke i garantuar mbijetesës reale edhe sot nacionalizmin progresiv.

Kjo mbijetesë gjen vend në programet politike të forcave të ndryshme, që bëjnë jetë aktive në skenën politike shqiptare, në kërkesat e tyre për një bashkim dhe strukturim qoftë në formë të federatës apo të konfederatës, siç shprehet profesor Kristafi në studimin *“E ardhmja politike e shqiptarëve nën vështrimin juridiko-ndërkombëtar”*, që vjen në fund të librit. Kushdo që merret me studimin a projektimin e së ardhmes politike të shqiptarëve, thekson që në hyrje të këtij studimi profesor Krisafi, duhet të mbajë parasysh edhe zhvillimet historike në trojet shqiptare në fillimet e shekullit të kaluar, sidomos kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912, vendimin e Kuvendit Kombëtar të Vlorës për qëllimet e shtetit të pavarur shqiptar, si dhe vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës të viteve 1912-1913, bashkë me ngjarjet që rrodhën pas saj.³

Pavarësisht hapit historik që është bërë më 17 shkurt 2008 me Shpalljen e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, çështja kombëtare shqiptare, konstaton me të drejtë profesor Krisafi, mbetet ende e pazgjedhur.

Sipas “Historisë së Shqipërisë”, botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, territoret e banuara në shumicë nga popullsia shqiptare para vendosjes së kufijve shtetërorë të Shqipërisë më 1913 zinin një sipërfaqe prej 52 mijë km².

Në këtë kohë, në këto territore banonin 1 550 000 njerëz, prej të cilëve rreth 1 330 000 ishin shqiptarë etnikë. Në Shqipërinë e njohur si shtet nga Konferenca e Londrës u përfshinë vetëm 28 000 km² dhe një popullsi rreth 740 000 banorë. Kufijtë e miratuar nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës lanë jashtë shtetit shqiptar trojet shqiptare të Kosovës, të Dibrës, të Maqedonisë së sotme Perëndimore, të Çamërisë etj.⁴

6. Struktura analitike dhe dimensionimi kronologjik

Ky botim ndërton një trajektore historike të organizimit politik në disa etapa:

1. **Periudha ilire dhe antike** – analizë e formave proto-shtetërore dhe strukturave politike lokale.
2. **Mesjeta arbërore** - evoluimi i principatave dhe raporti me rendin feudal europian.
3. **Periudha osmane** - transformimi institucional dhe mbijetesja e autonomive lokale.
4. **Rilindja Kombëtare** - artikulumet politik i identitetit kombëtar.
5. **Shteti shqiptar modern dhe sfidat ndërkombëtare** - dimensionimi juridik i sovranitetit dhe diplomacisë shqiptare.

Kjo ndarje i jep veprës karakterin e një historie institucionale të gjatë, duke shmangur fragmentarizimin kronologjik, që shpesh karakterizon historiografinë shqiptare.

7. Kontributi teorik dhe epistemologjik

Rëndësia akademike e librit qëndron në tri risi kryesore:

a) Juridizimi i historisë politike

Krisafi interpreton historinë përmes kategorive të së drejtës ndërkombëtare dhe kushtetuese, duke e kthyer analizën historike në analizë normative.

b) Dekonstruktimi i narrativave periferike

Autori kundërshton perceptimin e shqiptarëve si subjekt pasiv historik, duke evidentuar agjencinë politike dhe diplomatike në periudha të ndryshme.

c) Ndërlidhja histori-diplomaci

Përvoja diplomatike e autorit reflektohet në interpretimin e çështjeve territoriale dhe të sovranitetit, duke i dhënë veprës një dimension praktik-politik.

8. Vlerësimi kritik

Megjithëse libri përfaqëson një studim të konsoliduar, disa elemente mund të diskutohen duke u riparë me sy kritik:

- prania e fortë e perspektivës juridike ndonjëherë redukton analizën sociologjike të proceseve politike;
- interpretimi në linjën e kontinuitetit mund të kërkonte dialog më të thellë me historiografinë kritike bashkëkohore europiane;

dimensioni krahasues ndërkombëtar mund të zgjerohej më tej, për të vendosur rastin shqiptar në modele më të gjera të shtetformimit ballkanik. Megjithatë, këto nuk e zbehin vlerën themelore të veprës si studim referencial.

9. Rëndësia në studimet shqiptare

“Organizimi politik në trojet shqiptare” duhet parë si një tërësi, si një tekst referimi për historinë e shtetit dhe të së drejtës shqiptare; një urë ndërmjet historiografisë dhe shkencave juridike dhe, në masë të ndjeshme, edhe si një kontribut në debatet mbi legjitimitetin historik të shtetësisë shqiptare.

Libri vendos një standard metodologjik, që i afrohet traditës europiane të historisë institucionale dhe juridike, duke e pozicionuar studimin shqiptar në një kornizë më të gjerë akademike.

Duke qenë se autori është specialist i teorisë juridike dhe, njëkohësisht, edhe njohës i jashtëzakonshëm i historisë politike, në librin e tij me

titull *“Organizimi politik në trojet shqiptare”*, profesor Krisafi u përkushtohet pikërisht ideve se si do të duhej të zgjidhej çështja shqiptare tashmë, pas krijimit të Republikës së dytë. Prandaj ky impenjim vjen krejt i natyrshëm, me prurje të reja, duke sugjeruar edhe zgjidhje të mundshme.

Ndërkaq, në studimet e fundit të përfshira brenda këtij libri, si ai me titull *“Raporti midis të drejtës së brendshme dhe të drejtës ndërkombëtare sipas Kushtetutës së Kosovës”* dhe ai që për mua ishte më specifik, *“E ardhmja politike e shqiptarëve në vështrimin juridiko-ndërkombëtar”*, janë kontribute të veçanta në fushën e mendimit juridiko-politik, që i hapin rrugë organizimit të ri politik brenda hapësirës shqiptare, tashmë pas çlirimit të Kosovës.

Librit i paraprin një parathënie e gjatë, shkruar nga akademik Marenglen Verli, si një uverturë e shkëlqyeshme e tij. Në kuadër të librit janë përfshirë studimet, që autori i kishte publikuar gjithandej në revista të ndryshme dhe të rëndësishme brenda hapësirës kombëtare, por edhe jashtë.

Objekt i hulumtimeve dhe i studimeve të tij janë strukturat politike dhe shtetërore që u ngritën gjatë historisë në siujdhesën ilire dhe më pas në hapësirën shqiptare. Si një studiues kritik, natyrisht pas një hulumtimi të gjerë të materies, ai nuk ngurron të sjellë mendimin e tij, duke u përballur jo rrallë me lagje të tëra ekspertësh të huaj, që e cilësonin shtetin e ilirëve si shtet të piratëve.

10. Përfundime - Nga historia drejt projektimit strategjik

Vepra e prof. dr. Ksenofon Krisafit përbën një sintezë të rëndësishme shkencore, që rikoncepton historinë politike shqiptare si proces të vazhdueshëm institucional dhe juridik. Duke ndërthurur kompetencën e historianit me atë të juristit dhe diplomatit, autori arrin të ndërtojë një narrativë analitike, që shkon përtej historiografisë tradicionale dhe kontribuon në kuptimin teorik të shtetformimit shqiptar.

Në këtë kuptim, libri nuk është vetëm një studim historik, por edhe një reflektim mbi legjitimitetin politik dhe juridik të ekzistencës

shtetërore shqiptare në kohën moderne. Leximi kritik i veprës së profesor Ksenofon Krisafit sugjeron një tezë të rëndësishme për mendimin politik shqiptar: *historia e organizimit politik shqiptar nuk çon drejt tejkalimit të shtet-kombit, por drejt transformimit të tij*.

Në këtë kuptim, studimi i Krisafit shpjegon origjinën, ndërkah Federata Shqiptare mbetet destinacioni politik. Shtet-kombi shqiptar, i lindur në një epokë rivalitetesh imperiale, mund të gjejë stabilitet afatgjatë vetëm përmes një forme federative kohezive, që harmonizon identitetin kombëtar me arkitekturën politike të Bashkimit European.

Bibliografi

1. https://zeri.info/kultura/429662/platforma-politike-qe-na-kam-munguar-libri-federata-shqiptare-ndash-kohezioni-i-shtetit-komb-ne-be/?utm_source=chatgpt.com
2. https://ishgj.net/analize/nacionalizmi-modern-shqiptar-dhe-federata-shqiptare/?utm_source=chatgpt.com
3. Ksenofon Krisafi, *Organizimi politik në trojet shqiptare*, “UET Press”, Tiranë, 2012, f. 229.
4. *Historia e Popullit Shqiptar, III*, Akademia e Shkencave, “Toena”, 2007, f. 30.

X: ANALYSIS IN ENGLISH

10. 1 THE RE-ARMAMENT OF GERMANY: GEOGRAPHY, POWER, AND THE ARCHITECTURE OF EUROPEAN SECURITY

Dr. Dritan HOTI

The strategic evolution of Germany has long been one of the decisive factors in shaping the structure of power on the European continent. Few states embody so vividly the interplay between geography, industrial capability, and geopolitical aspiration. From the founding of the Reich in 1871 to its contemporary trajectory, Germany's military posture has continuously influenced the configuration of alliances, the anxieties of its neighbors, and the balance of continental authority. Today, as Berlin moves toward an unprecedented reinvestment in its defence establishment, the question of Germany's re-armament re-emerges-not as a historical echo of imperial or totalitarian ambition, but as a central element in the reconstruction of Europe's security architecture in the shadow of Russian revisionism.

Industrial Expansion and the Geopolitical Chain Reaction (1871–1914)

The unification of Germany under Prussian leadership in 1871 produced not merely a new political actor, but a continental industrial power whose speed of consolidation transformed Europe's strategic landscape. The Reich's industrial output grew at a pace unmatched by its neighbors, enabling a rapid modernization of its armed forces and a professionalization of the General Staff that became the envy and the concern of European capitals. By the early twentieth century, Germany possessed the most sophisticated military bureaucracy in Europe and one of the most formidable armies in the world.

This accelerating military-industrial consolidation triggered a chain reaction. France, alarmed by the rise of a unified and assertive power to its east, sought diplomatic counterweights. Russia, perceiving Germany's economic dynamism and military preparedness as a looming threat to its own strategic depth, entered into closer consultation with Paris. Britain, traditionally aloof from continental rivalries, gradually leaned toward Paris and St. Petersburg as Berlin's naval expansion began to threaten the maritime equilibrium of the North Sea. Thus emerged the Triple Entente-France, Russia, and Great Britain-a coalition whose formation was in many ways a direct consequence of Germany's accelerated rise. What German strategists once called "*das Bündnis-Albtraum*"- the nightmare of encirclement-was in fact a geopolitical response to the Reich's industrial and military assertiveness.

Germany and Russia in the First World War

During the First World War, Germany confronted Russia on the Eastern Front with a combination of operational discipline, logistical coordination, and technological sophistication that produced decisive victories. German forces overwhelmed the Russian armies in several major engagements, accelerating the collapse of the tsarist regime. These defeats, combined with the internal exhaustion of the empire, created the political vacuum through which Lenin and his revolutionaries seized power. The fact that the Bolshevik takeover was facilitated by Russia's military collapse-shaped in significant measure by German pressure-reveals how deeply German military performance influenced the geopolitical reconfiguration of Eurasia.

The Wehrmacht and the Second Encounter with Russia

The Second World War, though morally and politically inseparable from the destructive ideology that animated it, also revealed the unmatched organizational sophistication of the German military machine. As noted by a prominent French philosopher in his work *Paix et guerres entre les nations*, the Wehrmacht was arguably the most effectively organized army in the world at the time. Its operational coherence, tactical flexibility, and command efficiency were extraordinary - yet tragically placed in the service of an ideology bent on domination through force.

In its confrontation with the Soviet Union, Germany inflicted catastrophic human and infrastructural losses - losses of a scale that remain nearly unimaginable even today. Despite its eventual defeat, the magnitude of the destruction Germany caused underscores both the operational strength of its military system and the enduring, almost structural tension between the two continental giants.

The Contemporary Re-Armament: A Strategic Transformation

Today, Germany finds itself again compelled by geography, geopolitics, and alliance commitments to reconsider the foundations of its military power. Berlin's current defence plan-allocating approximately €166 billion through 2029-marks the most significant re-armament initiative since the early Cold War. Although officially framed as a response to changing security threats, it reflects deeper strategic imperatives: the consolidation of civilian and military infrastructure, the modernization of force projection capabilities, and the integration of German military planning with NATO partners and European allies in the face of a potential Russian threat.

This re-armament is not merely quantitative. It represents a conceptual shift. Germany is redefining its military identity from a restrained power focused on internal European reconciliation to a central guarantor of continental stability. The country's economic scale and industrial depth-arguably unmatched in Europe-grant it the rare

ability to translate strategic intention into rapid military transformation. The statements of the U.S. ambassador to NATO reinforce this reality: Germany is increasingly perceived as the pivotal actor within Europe capable of counterbalancing Russian ambitions.

Geography: From the “Nightmare of Coalitions” to the Anchor of Defence

Historically, Germany’s central position-surrounded by multiple great powers-created the perpetual fear of encirclement, or what French strategic literature described as “*le cauchemar des coalitions*.” Today, the same geography that once generated insecurity has become a strategic asset. Instead of being the potential target of coalitions, Germany now serves as the central node of European defence: logistically, politically, and geographically indispensable for any credible deterrent posture against Russia.

This transformation represents a fundamental inversion: Europe’s security now depends on Germany’s ability to project stability rather than on efforts to contain German ambition.

A New Strategic Reality: Germany and Russia Once More

For the third time in a little over a century, Germany’s trajectory may bring it into geopolitical opposition with Russia-though under vastly different circumstances. The first two encounters produced devastating military confrontations driven by incompatible imperial projects. The current dynamic, however, is shaped by alliance obligations, democratic legitimacy, and strategic necessity. Germany’s role today is not that of a revisionist power, but that of a stabilizer whose military strength is intended to deter aggression and preserve the democratic order of Europe.

This evolution may, of course, provoke latent frustrations in certain corners of Europe. Historical memories are not easily erased, and the concept of a militarily robust Germany can still awaken old anxieties. Yet the alternative-an under-armed Germany in an era of

Russian revanchism-would leave Europe exposed to fragmentation and coercion. A strong democratic Germany, firmly rooted in NATO and the European Union, is therefore not a threat but a prerequisite for continental security.

Conclusion: The Return of a Central Power

Germany's re-armament is less a rupture than a return to historical continuity-tempered by democratic institutions, constrained by alliance frameworks, and shaped by a strategic environment that demands responsibility rather than retreat. Europe's stability has always depended on the equilibrium between its central powers; today, that equilibrium requires Germany to assume the role of guardian rather than disruptor.

In a world defined by renewed geopolitical competition, Berlin's re-armament does not signal a resurgence of militarism, but a recognition that power, when responsibly employed, is indispensable for preserving peace. Europe's future may well hinge on Germany's willingness and ability to shoulder this burden and on the wisdom with which it wields the tools that history has once again placed in its hands.

10.2 THE NATION-STATE AS A STRUCTURAL ACTOR OF DEMOCRATIC METAMORPHOSIS

Dr. Sadri RAMABAJA

ABSTRACT

This study examines the return of the nation-state as a structural actor in the contemporary transformation of democracy. Starting from the critique of the post-sovereignty paradigm of the 1990s—which predicted the progressive erosion of state sovereignty in the face of globalization and multi-level governance—the paper argues that developments of the last decade have shown the analytical limits of this model. The financial crises, the COVID-19 pandemic, the return of war in Europe, and geopolitical rivalry between great powers have restored the nation-state as a central node of security, political economy, and democratic legitimacy. The paper also treats the case of Albania and Kosova as a micro-laboratory of this democratic metamorphosis, where the tensions between limited sovereignty, institutional legitimacy, and geopolitical pressure appear in a condensed manner. The analysis argues that without a functional state and real capacities for action, democracy risks being reduced to a formal procedure, while the strengthening of the state—if it remains within the democratic framework—conserve as a prerequisite for institutional resilience. In conclusion, the study suggests that the return of the nation-state should not be interpreted as a historical regression, but as a sign of an ontological metamorphosis of democracy in the post-neoliberal order. In this process, the nation-state appears as a political space where sovereignty, security and democratic representation are negotiated, while for the Albanian space the reconfiguration of state capacities and their functional integration appear as key factors for democratic stability and geopolitical role in Southeast Europe.

Keywords: Nation-state, contemporary democracy, functional sovereignty, metamorphosis of democracy, Kosova and Albania in geopolitics

INTRODUCTION

The contemporary debate on democracy is taking place at a moment of profound paradigmatic dislocation. The theoretical frameworks that dominated after the end of the Cold War –especially those that predicted the progressive decline of the nation-state in the face of globalization, supranational integration, and multilevel governance –are now confronted with an empirical reality that challenges them to their foundations. Instead of a “post-sovereign” world, characterized by the steady transfer of powers to transnational actors, an international order is crystallizing in which the nation-state is restored as a structural node of power, security, and democratic legitimacy. This essay seeks to position the nation-state not as an anachronistic remnant of political modernity, but as a structural actor of democratic metamorphosis in the conditions of the post-neoliberal order and geopolitical fragmentation. The central argument is that democracy can no longer be understood as a purely procedural or normatively universal architecture, detached from the real capacities of the state to exercise functional sovereignty. On the contrary, the current transformation of democracy is inseparable from the transformation of the nation-state itself: from a minimalist guarantor of market rules to a strategic actor that combines security, political economy, and the protection of democratic order. In this sense, the post-sovereignty paradigm of the 1990s – which treated sovereignty as an obstacle and the state as a unit destined to be overcome – appears today as theoretically inadequate and analytically reductive. It underestimated the conflictual dimension of international politics, overestimated the autonomy of markets, and assumed that democracy could survive without a strong and coherent state substrate. Developments of the last decade –from financial crises and pandemics to war, economic sanctions, and technological rivalries –have shown

that without a functional state there is no democratic resilience. The introduction to this chapter aims, therefore, to establish the theoretical framework for a reconceptualization of the relationship between the state, sovereignty, and democracy. Starting from the critique of the post-sovereignty paradigm and from realist and geopolitical readings of the international order, this essay argues that the nation-state is not in historical regression, but in a process of metamorphosis. It is precisely in this process that it becomes a necessary condition for the survival and deepening of democracy in an increasingly polarized and uncertain world.

1. The Post-Sovereignty Paradigm and Its Analytical Limits

The dominant discourse on democracy in the last three decades has been built on the assumption that the nation-state represents a historically outdated form of political organization. Globalization, supranational integration, and liberal normative universalism have been presented as inevitable horizons of “democratic maturity,” while state sovereignty has been reduced to an obstructive relic of transnational flows. This approach, embedded in the post-sovereignty paradigm of the 1990s, has functioned more as a normative project than as an analysis of political reality (Mearsheimer, 2018). Recent geopolitical developments—the return of great power competition, the militarization of economic security, and the fragmentation of the liberal international order—have exposed the structural limits of this paradigm. Instead of the nation-state’s disappearance, we are witnessing its reconfiguration as the central actor of a democracy in transformation.

2. The return of the nation-state: from normative relic to structural node

In this context, the nation-state is not returning as ideological nostalgia or authoritarian regression, but as a structural actor of democratic metamorphosis. This return does not imply the restoration of absolute sovereignty in the classical sense, but the reconceptualization of state

functions in the conditions of an unstable international order and a democracy that is experiencing an ontological transition. The state no longer appears only as a procedural guarantor of the constitutional order, but as a space where tensions between security, sovereignty and democratic legitimacy are confronted, negotiated and reconfigured. This transformation is clearly illustrated by the response of democratic states to the COVID-19 pandemic. In a moment of systemic crisis, even the most economically integrated democracies were forced to restore state control over borders, supply chains, health policies and strategic production capacities. The decisive decision-making was not carried out by markets or abstract transnational mechanisms, but by states, which once again became the guarantors of collective survival and public trust. Democracy, in this case, was based not on the minimization of the state, but on its ability to act. A second representative example is Russia's war against Ukraine, which has brought territorial security and military defence back to the center of European democratic politics. Decisionssuch as the drastic increase in the defence budget in Germany (Zeitenwende), the militarization of European industrial policy, and the state coordination of economic sanctions show that democracies cannot survive without the state's capacity to exercise power. In this context, the nation-state appears as the node through which democracy is protected from existential threats, rather than as an obstacle to it. The paradigmatic shift in economic and technological policies also confirms this return. Massive state subsidy programs in the US (Inflation Reduction Act), the industrial policies of the United Nations In all these cases, the nation-state does not operate as an absolute sovereign, but as a coordinating node between society, the economy and the international order. Democracy is not displaced beyond the state, but is reshaped within it. It is here that it becomes clear that the current crisis of democracy does not stem from the "excess of the state", but from its functional weakening. The return of the nation-state is, in this sense, a prerequisite for the reconstruction of a democracy that is able to cope with uncertainty, conflict and historical responsibility. The E-market for

chips and energy, as well as the control of strategic investments, prove that the free market is no longer perceived as a sufficient self-regulating mechanism. The state has returned as a strategic planner, not to replace democracy, but to make it functional in conditions of geopolitical rivalry. In all these cases, the nation-state does not operate as an absolute sovereign, but as a coordinating node between society, the economy and the international order. Democracy does not move beyond the state, but is reshaped within it. It is here that it becomes clear that the current crisis of democracy does not stem from the “excess of the state”, but from its functional weakening. The return of the nation-state is, in this sense, a prerequisite for the reconstruction of a democracy that is able to cope with uncertainty, conflict and historical responsibility.

2.1 The Case of Albania & Kosova as a Micro-Laboratory of Democratic Metamorphosis

The Albanian case, with two formally separate but historically, socially and geopolitically interdependent states, offers a unique micro-laboratory to observe the turn of the nation-state as a structural actor of democracy in transformation. Albania and Kosova are not simply the peripheries of a European democratic order, but spaces where tensions between limited sovereignty, international security and democratic legitimacy appear in condensed form. In Kosova, the state was built from the beginning under conditions of supervised sovereignty, with an institutional architecture designed to guarantee democratic procedures, but not necessarily the capacity for state action. For more than a decade, democracy was reduced to electoral ritual and the technical management of pluralism, while the real functions of the state –the rule of law, control of territory, the fight against oligarchic capture – remained fragmented. This is a typical example of what can be called procedural democracy without a functional state.

The recent crisis of electoral credibility, including suspicions of vote manipulation within political entities and attempts to delegitimize

the electoral process, has clearly exposed this structural gap. Reactions such as the intervention of the prosecutor's office in Prizren are not simply technical acts of justice, but signs of a return of the state as a normative authority. At this point, the state does not act to protect the political status quo, but to reestablish the boundary between democratic conflict and the criminalization of politics. This represents precisely the moment when democracy moves from formal administration to substantial protection. Albania also represents another variant of the same metamorphosis. After a long period in which the state was perceived mainly as an instrument of clientelistic capture and informal management of power, international pressure and the need for regional stability have forced the Albanian state to reconceptualize its role as a guarantor of order and security. The reform of the judiciary, despite its limitations and tensions, is the most significant example of this effort to reconstruct state authority as a condition for functional democracy. In both cases, Albania and Kosova are not moving towards a post-sovereign model, but towards a functional sovereignty, limited by international alliances, but necessary for democratic survival. Here it becomes clear that without a state capable of action, democracy is reduced to rhetoric; while without democracy, the state risks slipping into authoritarianism. The democratic metamorphosis occurs precisely in this tension. In this sense, the Albanian space also takes on a special geopolitical dimension.

Albania and Kosova constitute the operational depth of NATO and the US in Southeast Europe. This positioning is not only military, but also political: it requires functional, stable and legitimate states. Albanian democracy cannot survive as a weak institutional project in a militarized geopolitical environment. Therefore, the return of the state as a structural actor is not an ideological luxury, but a strategic necessity. The Albanian/Kosovar case thus shows that the return of the nation-state is not a regression, but a condition for democratic emancipation. It proves that 21st century democracy cannot function without a state that has the capacity to act, to impose the law and to

manage risk. Precisely for this reason, this Balkan micro-laboratory makes visible what in the great Western centers often remains hidden: that the metamorphosis of democracy passes through the reconstruction of the nation-state, not beyond it.

3. Sovereign decision and the crisis of procedural liberalism

Carl Schmitt early articulated the fundamental tension between procedural liberalism and real sovereignty, arguing that it is the sovereign who decides on the state of emergency (Schmitt, 1922/2005). Twentieth-century liberal democracy attempted to neutralize this problem through the humidification of politics and the depoliticization of decision-making.

However, the multiple crises of the last decade have brought back to the center precisely what liberalism had tried to exclude: political decision as a sovereign act. Democratic procedures increasingly function in a space where real power operates outside them, exposing the limits of procedural democracy.

4. Democracy as an ontological issue: power, security, and the administration of life

In this sense, the metamorphosis of democracy is not simply institutional, but ontological. Democracy can no longer be reduced to a system of procedural rules, because these procedures operate in a space void of control over the real mechanisms of power.

Michel Foucault argues that contemporary power is no longer located exclusively in formal institutions, but circulates through the dispositifs of security, population management and life control (Foucault, 2007). If democracy does not intervene in these areas, it loses its political character and is transformed into technocratic administration.

5. The nation-state as a negotiating space of democratic sovereignty

The return of the nation-state occurs precisely as an attempt to

rearticulate this political capacity. The state regains functions that go beyond the formal guarantee of democratic procedures and becomes the space where the tension between sovereignty, security and new forms of political participation is negotiated.

Without this negotiating space, democracy either degenerates into affective populism or hardens into post-political technocracy-two forms that, while seemingly antagonistic, are essentially symbiotic.

6. The state of emergency: danger or moment of reconfiguration?

Giorgio Agamben has described this dilemma through the concept of the permanent state of emergency, where law remains formal, but politics operates through its suspension (Agamben, 2005). However, contrary to Agamben's pessimistic reading, the democratic metamorphosis should not be understood only as an authoritarian risk, but also as a moment of reconfiguration.

The central question is not whether the state is being strengthened, but whether this strengthening is taking place within or outside a democratic framework.

7. The Nation-State and the Geopolitical Space of Democracy

The change that the international order has been experiencing in the last 15 years is not cyclical, but structural. The neoliberal order, built on the functional separation between the market and politics, on economic interdependence as a mechanism for peace, and on the assumption that globalization is a linear and irreversible process, is shaking at its foundations. What we are seeing is not simply a course correction, but the return of state power as the central category of political and geopolitical organization.

From the perspective of critical geopolitics, the nation-state remains the fundamental node where space, power, and political identity are intertwined (O Tuathail, 1996). Democracy does not exist in a normative vacuum, but is always anchored in concrete spaces of sovereignty.

Attempts to universalize democracy by ignoring this dimension have produced weak forms of statehood, dependent democracies, and political systems exposed to external interference.

7.1 The Nation-State after Neoliberalism: From Arbitrator to Actor

In the neoliberal order, the nation-state was conceived primarily as a procedural guarantor: regulator of markets, supervisor of competition, and administrator of macroeconomic stability. Security was delegated (NATO), economic development was privatized, and technology was globalized. This model functioned as long as the geopolitical environment was relatively stable.

Today, this environment has changed radically. Great power competition, the fragmentation of supply chains, the militarization of technology, the transformation of energy and trade into a tool of war, and the return of conventional warfare in Europe have made it clear that markets are not neutral and globalization is not politically innocent.

In this context, the nation-state is returning not as an ideological relic, but as:

- strategic security actor,
- architect of economic and technological resilience,
- defender of democratic space from external interference.

This is why there is talk today of a “geo-economic paradigm shift”: the economy is no longer seen as an autonomous sphere, but as an instrument of power and political survival.

8. Structural Realism and the Limits of Normative Democracy

As structural realism emphasizes, the international order remains anarchic and states remain the main actors of security and survival (Mearsheimer, 2001). Democracy, if detached from this logic, risks becoming an unprotected normative luxury. In this sense, the nation-state is a prerequisite not only for sovereignty, but also for democratic survival.

8.1 The Geopolitical Space of Democracy: From Normative Universalism to Strategic Functionality

In the post-Cold War liberal order, democracy was treated as an abstract universal value, detached from space, history and real power relations. The experience of the last three decades has shown the limits of this universalism: democracies exported without a functional state, without real sovereignty and without defensive capacities turned out to be fragile, dependent or susceptible to capture. [See: Slovakia, Hungary, Serbia, Bulgaria...]

In the new order in formation, democracy is being re-anchored geopolitically [the case of Kosova]. It is being valued not only for its procedures, but above all for its ability to survive under conditions of strategic pressure; then for the capacity it demonstrates to produce security, stability and credibility; for its role in the broader architecture of collective security.

This means that the geopolitical space of democracy is no longer neutral. Democracy exists and consolidates within concrete spaces of power, and where these spaces are fragmented, democracy also remains vulnerable.

8.2 Albania and Kosova: from normative periphery to operational depth

In this reconfiguration, Albania and Kosova are not simply “small democracies in transition”, but part of a Euro-Atlantic operational depth in Southeastern Europe. This space has not only political, but also military (NATO), energy and infrastructure, technological and digital and geostrategic importance in relation to Russia, China and Turkey. The political and institutional fragmentation of the Albanian space weakens this role. Two separate states, with limited capacities and different dependencies, are more exposed to external-pressures and less functional as strategic nodes.

8.3 The Albanian Federation in the geopolitical vortex: from identity ideas to functional solutions

In this context, the Albanian Federation does not appear as a romantic project or as a deviation from the Euro-Atlantic order, but as a logical result of the reconceptualization of the state, democracy and security.

In an order where sovereignty is being restored as a real capacity for action, where democracy is also being measured by its strategic functionality and small and fragmented spaces are losing weight, a federation between political Albania and the Republic of Kosova would increase state and democratic capacity, not weaken it; would consolidate the Albanian space as a geopolitical node, not as a periphery; it would reinforce the NATO architecture and American interests in the region, offering a more coherent and resilient partner.

In this geopolitical vortex, the Albanian Federation appears as a new form of functional sovereignty, adapted to the realities of the post-neoliberal order: neither a classical isolated nation-state, nor a dispersed post-sovereign space, but a political structure capable of managing security, democracy, and development in an integrated manner.

8.4 Political Participation and the Reformation of Representation

Liberal procedural democracy was built on the figure of the periodic citizen-voter; contemporary reality produces citizens who are constantly mobilized but excluded from real decision-making. Without a state capable of institutionalizing this political energy, participation is either channelled into destructive forms of antagonism, or dissipates into fragmented activism without structural impact. The nation-state remains, in this context, the only political space where a new equilibrium can be built between classical representation and new forms of participatory democracy. 10. Conclusion: from the “crisis of democracy” to its metamorphosis Therefore, the return of the nation-state should not be interpreted through the worn-out paradigm of the “crisis of democracy”, but as a sign of an ontological transformation of democracy itself. Democracy is not collapsing; it is changing form. In

this process of metamorphosis, the nation-state is not an obstacle, but the structural node where this transformation becomes conceivable and politically feasible. The rebirth of state power is not a return to history, but an adaptation to a more dangerous and fragmented world. In this world, democracies that do not reconceptualize their relationship with the state, space and power risk remaining empty forms. For the Albanian space, this means that the question is not whether the Albanian Federation is ideologically desirable, but whether it is functionally necessary. And in the logic of the new geopolitical order, the answer is becoming increasingly clear.

REFERENCE

1. Agamben, G. (2005). *Security, Territory, Population*. Palgrave Macmillan.
2. Mearsheimer, J. J. (2001). *The Tragedy of Great Power Politics*. Norton.
3. Mearsheimer, J. J. (2018). *The Great Delusion: Liberal Dreams and International Realities*. Yale University Press.
4. Habermas, J. (2001). *The postnational constellation: Political essays*. MIT Press.
5. O Tuathail, G. (1996). *Critical Geopolitics*. University of Minnesota Press.
6. Schmitt, C. (2005). *Political Theology* (orig. 1922). University of Chicago Press.

10.3 TÜRKİYE AND ALBANIA: A DYNAMIC DEFENCE PARTNERSHIP

Peter Marko Tase, Berat/ÇIKAGO

On July 23rd, 2025, the Albanian Government signed an amendment to the “Financial Assistance Protocol,” with the Ministry of Defence of Türkiye. The minister of Defence of Albania Mr. Pirro Vengu, and Turkey’s Defence Minister Yaşar Güler, held a meeting on the sidelines of the International Defence Industry Fair in Istanbul 2025.

This bilateral agreement will provide the Albanian Armed Forces with 105 mm artillery systems and broaden the scope of cooperation between the two countries. Moreover, it includes academic training, seminars, logistical aid, transportation, and institutional support, to further embolden the strategic cooperation and resilience of the Albanian Defence Forces. Albanian coastline, with over 480 km of maritime access along the Adriatic and Ionian Seas, has an obsolete Navy Force Technology and equipment.

Moreover, Albania, as a full-fledged member of NATO, does not have a well-structured NAVAL Base on its Coastline, Tirana’s cash-strapped government does not even have resources to clean up the renowned Submarine Tunnels of Porto Palermo, and Pasha Liman Base (that are completely abandoned by the current Albanian Government) built by the Socialist People’s Republic of Albania (1950 – 1974) during the peak of the Cold War tensions and provocations between the Warsaw Pact and NATO Alliance.

During the Socialist Government, under the leadership of Enver Hoxha, Albania had a well-equipped coastal defence force with four Whiskey-class Submarines: three T43 open-ocean minesweepers (built by the Soviet Navy from 1948 to 1957). In 1956-1961 the Albanian Navy was gradually established and consolidated as a separate force; it was imperviously separated from the Army and become a fully independent branch of service; the same path was pursued by the Albanian Air Force. Furthermore, Albanian Navy was equipped with

six P 4- class Soviet made torpedo boats, commonly known as the Komsomolets class: six inshore minesweepers of the T 301 type, four Kronshtadt cruiser patrol and submarine chasers, eleven minesweeping boats of other sorts and two dozen of auxiliary navy vessels. In 1991, the end of the Cold War was marked by the fall of the Berlin Wall and by a complete dismemberment and total obliteration of all Albanian Navy Assets, orchestrated by Tirana's newly established post – communist political elite. Today, Tirana's defence partnership with Ankara, is geopolitically crucial and portends to defend Europe's Southern Shores and ensure Albania's maritime and commercial interests in the region.

As history records contemporary leaders for posterity, tragically, many are misunderstood and thus recorded with a lack of accuracy, comprehension and candor.

One of the most eminently relevant yet misconstrued leaders of the Western world is Turkish President Recep Tayyip Erdoğan. Despite the frequently inaccurate and seemingly prejudicial rhetoric associated with him, he is, in reality, a reformer and has persistently sought to enshrine democratic and humanitarian values.

Throughout his rather pragmatic over-twenty-two years-tenure, Ankara has become a key player in promoting governance reforms in international organizations, grown into a large donor of international aid, heavily contributed financial resources toward global infrastructure and invested in programs destined to strengthen output growth and agricultural productivity.

Regardless of North America's mainstream media's reporting, international audiences are well aware of Türkiye's enormous leap forward in its geopolitical role and admirable economic growth, the waves of which are felt from Central Asia to Vietnam to Ecuador.

Mr. Erdoğan's robust and collaborative foreign policy even beyond the realm of Europe and the Middle East paved the way for Turkey to secure two bilateral agreements with Vietnam (Prevention of

Double Taxation; Civil Aviation and Maritime Cooperation) in 2014-2015.

On April 18-19, 2014, Mr. Ditmir Bushati, Albanian Foreign Minister, conducted his first official visit to the Republic of Turkey. Mr. Bushati's arrival to Ankara is the continuation of an extensive dialogue and bilateral cooperation between both nations which has gained a new momentum with the official visit to Albania by Turkish Foreign Minister,

Prof. Ahmet Davutoğlu, on October 4-5, 2013, as well as the first official visit to Ankara of the Hon. Mimi Kodheli, Albanian Defence Minister, on April 18th, 2014. Immediately after the leader of Albanian Socialist Party, Edi Rama became a Prime Minister, in September 2013, after the general elections of June 23rd, 2013; Albania's strategic relations with Türkiye were given a special priority and became economically important for Tirana.

According to Prime Minister Rama, Turkey is considered a strategic partner in Albania's Foreign Policy Strategy, and his government aims to further strengthen the bilateral cooperation with Ankara, especially in the economic, defence and commercial partnership. Under this framework, in February 2014, was held in Tirana the Albania-Turkey Economic and Trade Forum. In his statement Prime Minister Rama emphasized that Turkish investors will very soon experience a tremendous reduction of bureaucracy and amiable policies towards the opening of their businesses in Albania. He added: "We consider you as ambassadors and promoters of our country in the world." [1] Türkiye is the second largest trading partner of Albania and its daily consumption products;

merchandises and commodities are always present in Albania's markets. Some of the largest Turkish companies, with a focus in areas such as construction, telecommunications, transportation and education are ENKA, Gintaş, Armada, Metal Yapı, Aldemir, Servomatik, Çalık Holding/Türk Telekom, Makro-Tel/Hes Kablo, Albanian Airlines (Evsen Group), Gülistan Foundation, Istanbul Foundation.

In his visit to Ankara, Minister Bushati had a lengthy conversation with his counterpart, Prof. Dr. Davutoğlu, and particularly addressed the strong bilateral economic relations, international and regional security issues, and most importantly, Tirana's aspirations to establish a bilateral "High Level Partnership and Cooperation Council" between Tirana and Ankara.

In their joint press conference, Foreign Minister Davutoğlu said that the two countries have agreed to establish the "High Level Partnership and Cooperation Council" and this bilateral body will be meeting in the weeks ahead, to discuss pending items of the mutually beneficial agenda. Turkish investments in Albania have increased by US\$ 2 billion and the bilateral trade volume has reached more than US\$1 billion, from US\$400 million, only five years ago.

Another item in the discussions were the potential venues of strengthening the cooperation between the two ministries, while placing a special importance to Albania's EU integration and membership status.

According to Minister Davutoğlu, the Turkish Diplomatic Chief: "We together endeavor for our common goals, will continue to work together at the highest level in international organizations as well. We agreed to establish the Turkey-Albania High Level Cooperation Council" [2]

In this occasion, the two counterparts signed an agreement and Memorandum of Understanding focused in the bilateral Cooperation of Information Technologies. Foreign Minister Davutoğlu visited Albania on October 2013; he met with Prime Minister Edi Rama, and Foreign Minister Bushati. During his visit, Turkish Foreign Minister initiated the dialogue to establish the High-Level Strategic Cooperation Mechanisms, that would be highly beneficial to both countries' economies, trade and bilateral political dialogue.

Albania and Turkey have maintained a close partnership within the North Atlantic Treaty Organization, the Southeast European Cooperation Process (SEEC) as well as have been working closely in Peace Keeping operations in Afghanistan, Bosnia Hercegovina and other hot spots in the world. This year, Tirana will assume the chairmanship of SEEC and under its leadership the strategic role of Turkey and its contributions will further be solidified in the Balkans.

In Tirana, Turkish Foreign Minister Davutoğlu met with President of Albania, Mr. Bujar Nishani, P M Edi Rama, and Mr. Ilir Meta, the Speaker of Albanian Parliament. Bilateral relations between Albania and Turkey, are characterized by a strong sense of cooperation, friendship, mutually beneficial regional stability and stronger commercial and economic ties.

On October 2024, the bilateral defence alliance of Türkiye with Albania reached new heights of success, when President Erdoğan stated: “We will also provide the necessary support to meet the needs of our strategic partner and NATO ally Albania’s armed forces in terms of military equipment and training. My dear friend, Prime Minister Rama and I also discussed the joint fight against terrorist organizations, especially FETÖ. Inshallah, we will continue our fight against terrorist organizations effectively with the decisions we have taken today. We also exchanged views on global and regional issues with the Prime Minister. We follow with appreciation Albania’s efforts to establish peace and stability both in our region and in the international arena. The Israeli atrocities in the occupied Palestinian territories, especially in Gaza, and in Lebanon were among the top agenda items of our talks.”

Over the last fifteen years there have been multiple official visits undertaken by top Albanian government officials to Ankara as well as the government of Prime Minister Erdogan has kept a keen interest towards Albania. In October 2011, Mr. Bamir Topi, Albania’s president, led an official visit to Ankara, which was a very productive and set the

tone for a closer cooperation between both countries. Mr. Topi's visit was followed by Sali Berisha, Albanian Prime Minister's visit to Turkey in April 2012 and Mr. Cemil Çiçek, Turkish Assembly Speaker to Tirana in June 2012.

Additionally, in October 2012, Albanian Foreign Minister, H.E. Edmond Panariti visited Ankara, and gave a keynote address in the International Conference entitled "From Balkan Wars to Balkan Peace" co-organized by the Center for Strategic Research of Ministry of Foreign Affairs. Minister Panariti held fruitful talks with Foreign Affairs Minister Davutoğlu and other high-level officials of the Turkish government.

Another important variable in Albania-Turkey strong bilateral cooperation is the high number of Turkish citizens of Albanian origin living in Turkey and the attendance of Albanian students and professionals who have decided to reside and work in Turkey.

There has historically been a significant bondage between Albania and Turkey, even the Albanian language has been influenced over many centuries by the Turkish language.

Currently, there are more than three thousand common words in Albanian and Turkish languages, that are used daily in both nations. [3]

Another important aspect is the cooperation in the areas of national defence training, and technological equipment. Albania depends heavily on Turkish forces' assistance in training and supply of cutting-edge defence technology as well as the reconstruction of Albania's military bases and their maintenance.

Over the last twenty years, Turkish military personnel, from various branches: infantry, land, naval and Air Force bases have trained Albanian Armed Forces, provided technological equipment and helped rebuild its military infrastructure. Albanian soldiers assigned to Afghanistan under the NATO mandate, are serving within the Turkish command deployed in Kabul.

Endnotes and references:

1. <http://gazeta-shqip.com/lajme/2014/02/27/rama-ne-forumin-ekonomik-cdo-detyrim-per-biznesin-ne-60-dite/>
2. http://www.mfa.gov.tr/foreign-minister-davutoglu_-we-agreed-to-establish-the-turkey_albania-high-level-cooperation-council.en.mfa
<https://dailycaller.com/2018/06/22/time-to-cut-erdogan-and-turkey-some-slack/https://www.tccb.tr/en/news/542/153935/-we-will-increase-our-trade-volume-with-albania-to-2-billion->
3. <http://www.mfa.gov.tr/relations-between-turkey-and-albania.en.mfa>

